

www.belyje
ISMET CIBAJ

Kambanat fe mésnádés

ROMAN

Ismet Cibaj

LIBRERIJA NATIONALE

ZAGREB ANHANG

Kambanat e mesnatës

roman



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redakteur

NATASHA DULAKU

lsmet Cibal

Kampusnast
e messnastës

lompa

БИБЛІОГРАФІЯ
ВІДКРИТИХ
ІНІЦІАТИВ

urte e shkallët me qëndroj e kambanores. —
Kambanari u var pas litarit të trashë.
Dom Kela bëri kryqin.

Mesnatë:
— Fillo! — urdhëroi dom Kela duke
zgjatur kokën nga shkallët e kambanores.
Dang... Dung. Dang... Dung.
— Mjaft! — urdhëroi dom Kela.
Kambanari u var pas litarit të trashë.
Dom Kela bëri kryqin.

— Amen! — tha kambanari dhe ndoqi
hapat e priftit, që doli jo si zakonisht nga
porta me kangjella, por nga deriçka e pas-
me.. Gjithnjë pas mesnatës... Dhe gjithnjë
katër herë, — tha kambanari me vete...
Dang... Dung... Dang... Pastaj: Mjaft! Ç'du-
het të jetë kjo? Qoftë lëvdue Krishti! —
përsëriti dhe lidhi litarin e trashë pas gan-
xhës metalike.

Prifti mori kthesën. Edhe një kthesë tje-

tër.. Edhe një tjetër. Ja shtëpia me portë hekuri... Sa keq që nuk mora diçka për zemrën... Qoftë dhe tri pika valerian... Pastaj trokiti në portë.

N.N. zgjati kokën dhe pa fundin e rruges. Iu duk një fund i mistershëm... Një fshesar mblidhët mbeturinat e ditës: copa letrash, gjethë vjeshte, mbeturina ambala-zhi, rrëke balte që rridhnin nga periferia!... Iu bë se dikush e ndiqte nga prapa me hap të lehtë, sikur gatitej të fillonte garën në një pistë vrapi. La kthesën dhe eci drejt. Pastaj një kthesë tjetër... Kthesë pas kthe-se. Zemra i rrihte si e çakorduar. Gjoksi i hidhej përpjetë, ndjeu dhimbje në bark, gulç dhe marrje fryme. Trokiti në portë.

Shandanët e mëdhenj i kujtuan se taverna ndodhej një kat më poshtë. Pa dhë-në asnje shenje hutimi përshkoi korridorin në të djathtë, u fut në kafe, zbriti shkallët e ngushta, shtyu derën me xham opak dhe, pasi kundroi sallën anekënd, u ul diku nga fundi, larg të tjerëve.

Kamerieri ndoqi me sy çdo lëvizje të këtij klienti që vinte për herë të parë në tavernën e «Dajtit» pa i shpëtuar eleganca dhe trupi i drejtë i tij. Duke rregulluar peçtën e bardhë mbi dorën e majtë dhe duke

numëruar hapat, po mendonte se në ç'gjuhë duhej të kërkonte dëshirën e tij... I porsaardhuri ua nguli syrin flokëve të lëpirë, mustaqeve dhe papionit të kamerierit që kishin të njëjtën ngjyrë, të zezë. Ashtu bëri edhe kamerieri. I buzëqeshi dhe përkuli trupin. Pastaj e pyeti:

— What do you prefer, sër?!

— Krishtin! — tha ai pa ia ndarë sytë kamerierit që gati s'bërtiti nga kjo e papritur. — Dua të ha Krishtin pra! — qeshi klienti që tashti po vërtiste nëpër duar mënynë.

— Nuk ju prisnim kaq shpejt, sër... — ia ktheu përgjigjen kamerieri me një anglishte të gjysmuar.

— Krishti ka lindur në kashtë!...

— Ai kurrë s'ka dhënë urdhëritë ndahen tokat, — u përgjigj kamerieri.

— Okej!

Kamerieri mori porosinë. Pasi u darkua më nge, klienti ngjiti shkallët, hyri në kafe, përshkoi hollin, duke shkelur në tapetin e butë, pastaj zbriti shkallët dhe hipi në xhipsin e tij. Kaloi bulevardin dhe u ndal në Rrugën e Dibrës. Makinën e la në një cep të errët, kurse vetë u fut në një rrujgicë. U fsheh në një kthesë... Dredhoi dhe pastaj trokiti në portë. Ky ishte mister S. që kishte veshë, hundë, gojë dhe vetëm një sy... Kishte dhe një sy të dytë, nën një copë mbalomë prej meshini... Edhe ai bëri kryqin dhe lëvdoi Jesuin si i krishterë i mirë që ishte.

1) (anglisht) — Çfarë do të dëshironit, zotëri?

Në një shtëpi në qendër të kryeqytetit
gruaja trashaluqe, që vuante nga shëndeti i
tepërt dhe astma, i ledhatoi ballin të sho-
qit.

— A?... Çfarë? — pyeti deputeti që
mezi hapi sytë e skleposur.

— Kambana!

— Dangu?

— Të të kisha bërë një kafe. Pika mua!

— S'ka kohë... Galoshet.

— Sade e do?

— Bëje si të duash!.. O perëndi!...

-Në dyqanin e reklamave Ahmet Bregu
përgjonte pas grilave të copëtuara... Për-
gjonte dangun... Dung... Dang...

Shtëpia nr. 13, me papafingo e portë
hekuri, kishte korridor të ngushtë. Shkallë
të errëta. Karriget e poltronat e vjetra që
prisnin njerëz ishin vendosur larg njëra-
-tjetrës në cepat e bodrumit.

Zego Korbi, pasi dëgjoi tingullin meta-
lik të kambanës, zbriti shkallët, hapi portën
dhe priti hapa... Trokitje... Dhe ata me in-
tervale, tërë frikë, të ftohtë si akulli, hynë
njëri pas tjetrit. Njerëz që shtrëngonin duart
në parmakët prej druri. Që mbanin syze
të errëta. Bereta të vjetra. Mustaqe të zbar-
dhura. Njerëz të ngrirë. Si kufoma. Si vde-

kja. I kishte ftuar dangu... Ata zunë vend larg e larg që të mos e shihnin njëri-tjetrin, që mundësishët të mos njihnin njëri-tjetrin... As priftin, as zotin N.N... A.B., mister S..., zonjën A.

— All of you?¹⁾ — pyeti njeriu që kishte mballomë në sy e dukej sikur zbreste nga hëna (ndoshta vinte edhe nga stepat). Ngjyra e zezë e ftyrës të krijonte përshtypjen se kishte udhëtar përmes Saharasë.

Dikush përktheu dhe pastaj, po në gjuhën që fliste i huaji me theks hundor e duke i përtypur fjalët, iu përgjigj:

— Yes! All of us.¹⁾

Pastaj fjala e tij tingëlloi si kambanë. U përzien në të Shtetet e Bashkuara, Inglitera dhe më pas ca emra të frikshëm:

— Maliq Bushati!

Përkthyesi kësaj here heshti.

— Lef Nosi.

Përsëri përkthyesi që e ndjeu veten ngushtë, lëvizi në karrige.

— Patër Anton Arapi!

Dikush iu lut zotit.

— Ç'do të thotë kjo? — pyeti me zë të ulët një tjetër.

1) (anglisht) — Të gjithë?

2) (anglisht) — Po, të gjithë!

«Apeli i të vdekurve... Pusho!»

— Shefqet Beja!

Pas zërit hundor të njeriut që s'dihet nga ç'planet kishte zbritur, u bë heshtje varri. Akullnajë kontinentale.

— Të vdekurit presin!... Presim edhe ne aleatët... — u përzje zëri i përkthyesit me tingujt hundore të «oratorit».

— Çfarë? — pyeti përsëri njëri me zë të ulët.

— Zbarkimin!... Zbarkimin pra! Hapi veshët!

— Për mbledhjen e dytë do t'ju lajmërojmë. Ditën. Vendin. Orën, — tha i huaj në gjuhën e tij, ndërsa përkthyesi akoma vazhdonte të hante zanoret hundore.

— Ditën e...? — vazhdoi pyetjen ai që kishte bërë si hinkë llapën e veshit.

— Ku?

— Po ora allaturka apo allafrënga?

Ishin orët e mesnatës të datës 11 nëntor 1946. Bënte ftohtë. Binte shi.

KAPITULLI I

1

Në fillim u dëgjua bilbili i policit të trafikut, Pastaj ulërima e një femre që u duk se erdhi nga dritarja e shtëpisë dykatëshe me papafingo. Një burrë doli midis rrugës dhe ngriti dorën lart. Shoferi frenoi. Rrotat e makinës, që u ferkuan mbi asfaltin e lagur, lanë pas dy njolla të zgjatura të zëza.

I plagosuri kishte rënë përmbyss. Mbi të binte shi i situr,

— Spatalin! Lajmëro spatalin!

— Gjeni një rrobë ta mbulojmë,

— Mua më zë gjaku!

— Bu-bu!

— O perëndi!

— Lëre allahun në punën e tij, nëno!

— Për kokë të djalit...

— Vraponi... Një copë rrobë ta mbulojmë.

- Vdiq?
— Nuk dihet!
— Cili është?
— S'e njohim!
— I shkreti!
— Ç'thua, more? Unë e pashë me këta sy.
— Çfarë pe?
— Sikur ju...
— Për ideal, jo!

Polici i trafikut shënoi emrat e tre qytetarëve.

Shoferi ndiqte në heshtje këtë të papritur tronditëse.

Grumbulli i njerëzve sa vinte e shtohej.

Ndonëse të aksidentuarin e mbuluan me rrobën e bardhë, pamja sa vinte bëhej më e rëndë, më e pështirë, nga plagët vazhdonte t'i rridhët gjak, kurse gjymtyrët nën rrobën e trashë, çdo çast që kalonte, e humbisnin më shumë formën e tyre. Është e natyrshme, në këto raste, njeriu kërkon që t'i shmanget çdo gjëje dhe të ikë, po qe e mundur, sa më larg, aq larg sa të harrojë gjithçka që ka parë e dëgjuar.

Kështu bëri edhe Astrit Pema. Ai pa edhe një herë njollat e gjakut që ishin trazuar me baltën dhe lagështinë e asfaltit, mbulesën e bardhë që po njollosej me blanga të kuqe, tha diçka me gjysmë zëri, zbuloi me fundin e patericës cepin e rrobës sikur deshi të verifikonte një të fshehtë që e mundonte, ndoshta edhe veshjen e të aksidentuarit, mblodhi buzët dhe, me bërryla të tendosur, çau rrethin e kureshtarëve që vazhdonin ta ngushtonin së tepërmë atë copë vend. Pastaj la prapa kryqëzimin e rrugës, nxitoi përmes bulevardit dhe qëndroi vetëm kur arriti në fund të Rrugës së Barrikadave. Hodhi sytë anash. Lart. Në thellësi të qytetit. Rrëth tij ki-

shite gropat me baltë, copat hekurishtesh të hedhura pa kujdes, qepena të prishur, mure të rrëzuara, shtëpi përdhese me suva të rëna e gërvishtje plumbash në trupin e tyre. Iu duk se kjo lagje ishte pjesa më e lodhur e qytetit. Ndoshta kjo i krijoj përshtypjen se kryeqyteti gjatë viteve të mungesës së tij kishte ndryshuar në mënyrë të çuditshme, aq sa edhe qelli iu duk si një copë xham i plasaritur.

2

Në korridor u dëgjuan dridhjet e ziles elektriqe. U hap dera dhe një ushtar me uniformë gri nderoi me grusht.

— Shoferin, — tha Adil Çika.

— Si urdhëron, — u përgjigj ushtari me uniformën gri, por ndërkokë që bëri të dilte duket se iu kujtua diçka. U kthye nga kapiteni që kishte mbështetur shpatullat e holla në një karrige të madhe, veshur me lëkurë në ngjyrën e kafesë e qëndisur me ca sumbulla bronzi anash.

— Ai nuk ndihet mirë, shoku kapiten. Gjithë kohën rrri i menduar dhe mallkon... S'di çfarë, — tha ushtari me uniformën gri dhe ngriti supet si të shprehte habi.

— I thoni toger Metes të ngjitet lart!

Kur u mbyll dera, kapiteni u ngrit në këmbë dhe iu afrua dritares me xhamatë pluhurosur. Qielli vazhdonte të ishte i ngrysur. Një sqotë e ftohtë dukej sikur po u merrte frymën rrugëve, shtëpive, pemëve anës trotuarit që më shumë se çdo gjë ruanin pamjën e vjeshtës. Në

xhamin e dritares kishte ngrirë, si në një fotografi të zbehtë, silueta e trupit të tij, flokët e lëshuar, yjet dhe shiriti i kuq që i shtrëngonte qafën. Ai i buzëqeshi vetes dhe kujtoi se ishte akoma i ri për detyrën që kryente. Ndryshe e kishte menduar të ardhmen e tij kur ishte në mal. Lufta do të mbaronte dhe ai do të kthehej në shtëpi. Por ja, tha!... Mendimet ia ndërpreu në mes e trokitura në derë. Ushtaraku që hyri kishte moshën e tij dhe ftyrë të qeshur. Ai deshi të nderonte, po kapiteni e ndali. Të dy iu afroan tavolinës.

— Dosja 171! — tha i qetë togeri. — Brenda ka vetëm ca të dhëna të pakta për të plagosurin.

Karakteristika të përgjithshme: biond, rrëth të tridhetave... Ndoshta edhe më i ri. Pantalla na kafe, këmishë me kuadrate, çizme... Më interesant është fakti se me vete nuk iu gjet asnje lloj dokumenti... Së paku asnje copë letër ku të shënohej emri i tij... Kurse veshja lë shumë për të dyshuar. Çizme... Kilot... Xhakavento.

Ndërsa dëgjonte informacionin, kryehetuesi shtoi në mend edhe lajmin që kishte marrë nga spitali. Disa minuta më parë, një zë i ngjitur e kishte lajmëruar nëpermjet telefonit se, përviktimin, akoma s'ishte interesuar njëri dhe përishtës sërisht i shkoi ndërmend se mos i aksidentuar. Ndonjë rregull nuk mund se mos i kërkohet që ata të rinj, që, për snobizëm, atë që afronte shumë me atë të sportistëve.

— Ndoshta do ta kemi vështirë! — u shpreh togeri duke rrudhur buzët.

Kapiteni e pa me habi si të kërkonte arsyen.

— Mendoj se vështirësia qëndron te dëmtimi i rëndë i ftyrës. E kanë fashuar krejtësisht... I kanë çarë gurmazin... Një tub gome... Mjekët

dhanë pak shpresa, — arsyetoi duke ngrënë fjalët togeri.

Kapiteni mori dosjen në duar.

— Vetëm në xhepin e djathtë të pantallonave iu gjetën dhjetë franga.

— Monedhë argjendi?

— Letër. Tepër të zhbravritura.

Kapiteni dha porosi që të mbante lidhje të vazhdueshme me spitalin.

Mete Jaupi nderoi dhë doli nga zyra e kryehetuesit.

Adil Çika, të cilit i pëlqeu kujdesi i kolegut të tij dhe më shumë shpjegimi lakonik, vuri buzën në gaz; nguli vështrimin në shpatullat e ngushta dhe, pasi doli ai, buzëqeshi me vete e hodhi vështrimin nga dritarja që dukej se kishte filluar ta kursente dritën. Përsëri iu duk diçka e pabesueshme që shteti i ri demokratik t'u kishte ngarkuar këtyre njëzetvjeçarëve detyra kaq të rëndësishme.

— Po! — iu përgjigj së trokiturës në derë kapiteni.

Në dhomë hyri një burrë i bëshëm që përhëndeti me lëvizjen e lehtë të kokës dhe iu afroa tryezës. Pas tij u duk ushtari me uniformën gri. **Kapitenit iu bë se në këtë pamje kishte diçka që nuk shkonte. Ndoshta këtë përshtypje e kri- joi njëfarë krenarie që shquhej në tiparet e këtij burri me kominoshe blu, ndoshta diferen- ca e moshës. Ndoshta heshtja e tij, ose edhe një lloj shpërfilljeje që dukej sikur thoshte: «Sa i ri që jeni në këtë detyrë, more djalosh!»...**

— Na lini vetëm!

Ushtari zbatoi urdhrin, Kapiteni, me një lë-

vizje të ftohtë, e ftoi shoferin më pranë tavolinës.

— Uluni! — i tha dhe pas këtij urdhri e pyeti nëse e pinte duhanin.

— Jo! Kam gjashtë muaj që s'e pi më, — tha shoferi.

— Emrin, ju lutem!

— Kamber!

— Mbiemrin?

— Tafa.

— Datëlindja dhe vendlindja?

— 1911. Në Tiranë.

— Profesioni?

— Ju këtë e dini, shoku kapiten. Shofer i automobilit «Fiat», 30-44, — tha ai disi i lodhur nga këto pyetje që e merrte me mend se për kapitenin ishin po aq të njoitura sa edhe aksidenti.

— Patentën, ju lutem!

— E mori kapteri i shërbimit. Gjatë gjithë kohës që ushtroj profesionin e shoferit s'kam bërë asnjë aksident, — tha ai dhe ferkoi duart me njëra-tjetrën, sikur deshi t'i shkarkonte nga një barrë e rëndë.

— Ju e kuptioni... janë formalitetet, — tha kapiteni, që kishte ndjekur me kujdes përgjigjet e të arrestuarit, — d.m.th. detyra e kërkon që... — dhe, pa ditur ç'ti thoshte më tej, iu kujtuan leksionet që merrte çdo javë nga një avokat i vjetër, i cili më mirë se legjislacionin e pushtetit të ri, njihte latinishten dhe postulatet e juridikcionit romak. — Përgjigjuni qartë dhe shkurt! — e këshilloi ai pas këtij pushimi dhe më pas i citoi një nga nenet e kodit penal, sipas të cilës, cilido qoftë, dënohej për thënie të rrëme. Pastaj i kërkoi sqarime për aksidentin që kishte kryer.

— Në mëngjesin e 12 nëntorit kthehesha prej Korçë. Kisha ngarkuar brrë për «Kontinentalin», Rruga kaloi mirë dhe s'bëra asnje gomë... S'pata asnje avari...

— Kishit pirë? — e ndërpree kapiteni.

— Jo, s'kisha hedhur asnje gotë dhe s'kisha gjumë, — tha shoferi që u duk se, pas përgjigjeve të para, e kishte marrë veten disi.

Adil Çikës iu përtéri mendimi se mos i pandehuri ironizonte: «C'kalama! Kujton se do t'i zberthehem menjëherë dhe do t'i hap edhe zorrët e barkut?»

— Kur jam në timon, e kam bërë zakon që ta shtrëngoj fort atë dhe të harroj çdo gjë. Bile edhe fëmijët, — tha shoferi me ton më të rendë. — Kur hyra në qytet, ecja me 20 kilometra në orë.

— Jo më shumë?

— Mundet edhe më pak. Dhe duhet të besoni në ndershmérinë e shoferit... Në rrugë kishte njerëz. Prandaj këmbën e mbaja më shumë mbi pedalin e frenave se në atë të gazit, aq më tepër se binte shi dhe ua kisha frikën tamburavë të lagura... Po këto janë hollësira të profesionit... C'na duhen! — tha ai dhe mbi ballë iu shtua edhe një rrudhë tjetër. — Kjo ishte e gjitha! — tha shoferi kur vuri re vëmendjen e kapitenit. — Pastaj dëgjova bilbilin e policit të trafikut... Dikush më bëri shenje dhe unë frenova. Frenat i kisha stop...

Kapiteni ngriti kokën nga fleta e shënimave dhe si pa përfillje pa njeriu që qëndronte përballë tij. Heshtja që zgjati disa minuta i kujtoj Adil Çikës se gjatë këtyre dy vjetëve në atë karrige ishin ulur njerëz nga më të ndryshmit: kriminelë lufte, devijatorë, kolaboracionistë, spinë, njerëz që kishin tentuar të arratiseshin,

klerikë që u vunë në shërbim të reaksiionit, siç ishin ata të kishës franceskane në Shkodër, veprimtari të cilën Adil Çika e kishte ndjekur nga afër si anëtar i grupit hetimor. Ky proces i kujtoi emrat e fretërve Mati Prenushit, Frano Gjinit, Cipron Nikajt, kokat e rrumbullakëta e mështore të dom Lazër Shantojës dhe dom Ndue Zadesë, uniformat e reja, me të cilat ishin paraqitur në seancat gjyqësore patër Anton Arapi, patër Fausti dhe patër Dajani. Ai ishte njohur edhe me një kategori tjetër, që ishte munduar shumë herë të krijonin konfuzion, pakënaqësi, bile edhe ndonjë gjendje kaotike, të pengonin shtetëzimin e kapitalit të huaj e atij vendas, Reformën Agrare, ndërrimin e monedhës, ndalimin e nxjerjes së valutës jashtë dhe qarkullimin e saj brenda vendit. Bashkë me këto fakte Adil Çikës iu kujtua konkurenca e grupit të kontrabandistëve që bashkëpunonin me italianin Papaleo. Hamdi Plasa e thyente një napolon flori me 640 franga shqiptare, kurse Xhevdet Begoli me 637... Të tjerë sabotonin hapjen e rrugëve automobilistike, ndërtimin e urave dhe u vinin zjarrin pyjeve. Në hekurudhën Durrës-Elbasan, ku sapo kishin filluar punimet, grupi i armiqve udhëhiqe nga një grua... Në këta dy vjet nuk kishin munguar as fajtorët ordinerë, spekulatorët, tentonin të kalonin kufirin, vjedhës, keqbërës, ose edhe ata që stimulonin kumarin dhe korrupsionin. Kjo kohë relativisht jo e shkurtër i kishte dhënë mundësi Adil Çikës që gjatë he timeve të futej në psikologjinë e këtyre njerëzve, të dallonte të veçantën te secili, shtirjen dhe lojën e improvizuar, apo në raste të tjera «pendimin», si përpjekje të fundit për t'i shpëtuar përgjegjësisë penale. Ndryshe nga gjithë këta

shembuj, duke ndjekur me vëmendje sjelljen e shoferit, të cilit përsëri i kundroi trupin e bëshëm, kryehetuesi ndjeu keqardhje dhe s'dihet pse aty për aty krijoi bindjen se ai duhej të ishte i pafajshëm.

— Domethënë ju nuk e patë se kishit shtypur një njeri? — pyeti ai pas kësaj kujtese të gjatë.

— Këtë e mësova nga polici i trafikut. Duket se e kisha zënë me rrotën e pasme, — tha shoferi që, pas pyetjes së fundit, u prish përsëri në fytyrë.

Adil Çika ndezi cigaren.

— Tjetër?

— Pastaj më shoqëruan dhe më sollën këtu.

— E pe njeriun që u shtyp?

— Jo, — tha shoferi. — Atë e kishin rrethuar njerëz... shumë njerëz.

— S'dëgjove asgjë për të?... Për shembull...

— Jo, jo! — tha shoferi! Asgjë! Ata ishin aq shumë, sa... Si t'ju them, shoku kapiten, m'u errën sytë dhe nuk munda të njihja asnë... Asnjë!

— Mbaruam, — tha kapiteni dhe u ngrit në këmbë. Pas tij edhe shoferi u ngrit instinktivisht. Të dy qëndronin në heshtje përballë njëri-tjetrit. Kapitenit i kishte bërë përshtypje siguria e deponimeve, që gati po i fshinte çdo hamendje që kishte ushqyer se aksidenti mund të kishte ndodhur thjesht nga pakujdesia e tij, kurse shoferit, gjakftohtësia e kapitenit, që ishte munduar ta ruante atë deri në fund. Po kjo zgjati pak çaste. Në derë hyri ushtari me uniformën gri. — Mbaruam! — përsëriti kapiteni stohtë.

Shoferit iu kujtua dhoma e izolimit, që ia shtoi më shumë shqetësimin. Ndjeu dridhje në

trup dhe, pa kërkuar leje, u ul përsëri në karrige.

Kapiteni e ndoqi në heshtje sjelljen e tij dhe, pasi kundroi me kujdes çdo lëvizje, e urdhëroi ushtarin të priste jashtë.

Sheferi kishte marrë kokën në duar dhe shikimi i tij lutës dukej sikur thoshte: «Mos q i shkruani këto, ose më mirë dëgjomëni dhe pastaj veproni si t'jua kërkojë detyra.»

— Ju pres! — e përmendi kapiteni.

— Kam tetë ditë që s'i kam parë fëmijët... As time shoqe.

— Udhëtim i gjatë! — tha kapiteni. Në sfalët e tij u shqua njëfarë ironie.

— Kështu ka ndodhur, shoku kapiten. Fabrika s'punonte, kurse magazina dhe pronari...

— Si duket nuk ishte mirë me shëndet.

— Jo! Ata po lanin hesapet... Po kryhej shtetëzimi i saj... Inventari... organizimi i ri shtetëror... Ç't'ju them, shoku kapiten. Ishte më mirë të prisja sesa të kthehesha bosh. Dje filloi prodhimi. Para se të nisësha nga Korça, fola me time shoqe në telefon, — tha shoferi. Pastaj mblodhi dorën dhe e shtrëngoi aq fort, sa u duk se diçka kërciti brenda grushtit të tij.

— Kaq? — pyeti kapiteni.

— Ajo më pret, — tha shoferi. — Para kâtër ditëve na ka lindur një fëmijë.

Kapitenit, që u duk se përfytyroi gjëzimin që ndien një baba kur merr vesh lajmin se i lind një fëmijë, i ra pena mbi fletën e shkruar. «Po me lehonën ç'do të ndodhë kur të mësojë se i shoqi ka shtypur një njeri?» — mendoi dhe ndjeu se edhe atij diçka i lëvizi brenda krahorit.

— Mos u shqetësoni. Ne do ta lajmërojmë, — shpejtoi të thoshte.

— Unë ju siguroj se atë e kanë zënë rrrotat e pasme! — tha shoferi.

— Këtë e vërteton vetëm ekspertiza, — tha kapiteni. — Ju lutem na jepni adresën!

— Rruga «Vojo Kushi» nr. 7. Gruan e quajnë Ylvije Tafa, — tha shoferi dhe, pa pritur asnje urdhër, u ngrit e shkoi drejt derës.

Adil Çika iu afroa dritares. Koha ishte hapur. Qyteti, përmes xhamit të pluhurosur, iu duk te-për i largët. «Ndoshta, — mendoi ai, — është me të vërtetë i pafajshëm, — dhe përsëri pa die-lin në perëndim, — Mos duhet liruar?», — tha.

Ishte errur kur u takua me Mete Jaupin që të linte përshtypjen se ishte tepër i mërzitur.

— Rrimë diku?

— Si të duash!

— Në «Internacional»?

— Më mirë në Shtëpinë e Oficerëve, — tha Mete Jaupi.

— Kontrollova të gjitha hotelet me radhë. Pastaj restorantet. U përshkrova veshjen, paraqitjen, por asnjeri s'e njeh. Asnjeri s'e ka njobur. Më duket si i rënë nga qielli.

Ecnin në rrugë. Edhe të tjerët shëtisnin të ngeshëm. Frynte puhizë e lehtë që të freskon-te ballin. Adil Çika ngriti kokën lart dhe pa yjet.

— Nesër do të kemi mot të mirë, — tha.

Mete Jaupi e pa me vëmendje si të kërkonte nëse ai me të vërtetë fliste pér kohën, apo pér diçka tjefër.

— Një fotografi, ose edhe një dokument tje-

tër, do të na kishte dhënë dorë për identifikimin e tij.

— Më mirë të harrojmë çdo gjë, — tha Adil Çika dhe e tërroqi Mete Jaupin në drejtim të Bankës së Shtetit.

— Nga?

— A nuk thamë se do të shkojmë në Shtëpinë e Oficerëve?

— Po Viton?

— Tashti është vonë.

— Ajo me siguri të pret.

Adil Çika i shtrëngoi krahun.

— Për mua do të kishte qenë më mirë të kisha dalë në lirim. Mund të bëja çdo punë tjetër veç kësaj të hetuesit.

Adil Çika qeshi.

— S'e kam fjalën te lodhja, por sesi e ndiej veten. Si të them, Më duket se s'do të mësohem kurrë me këtë detyrë...

Vitoja priste në dritare. Atë natë drita në familjen Marini mbeti e hapur deri vonë.

3

Kur u fut në Pazarin e Vjetër, Astrit Pema vuri re se kjo pjesë e qytetit kishte mbetur si më parë: rrugica të pleksura si zorrët. Kafene të vogla. Avokatore të vogla. Nevojtore të vogla. Punishte me erë të keqe që të pickonte hundët. Në këtë ngushtësi lëvrinin matrapazë që shisnin relikte e vjetërsira. Rroba. Sixhade. Enë bakri. Antika. Buzhuteri false. Avokatë që mbylleshin nën grilat e murrme. Hallvaxhinj. Qeleshebërës

që u ishin zbardhur duart nga shkuma e sapunit. Lustraxhinj të vegjël që bërtitnin tërë ditën: «Lustra. Lustra boja! Urdhéroni, myshteri!» Kovaçë që rrighthin kudhrat dhe lavdëronin çekiçët, kazmat, plugjet. Britma të tjera ftonin blerësit pranë vitrinave të hapura... Kartolina! Byzylykë!» Erë mishi të pjekur në skarë... Birrë dhe raki me shishe! Fshatarë që têrhiqnin kafshë pas vetes... Karroca. Biçikleta... Një mizéri të gjallësh, që lëvrinin si një masë kaotike. Dhe bashkë me këtë zhurmë monotone Astrit Pemës i rrithë në vesh tik-taku i patericës dhe tingulli i pafkës metalike të këpucës. Një. Dy. Një. Dy. Duke rënduar herë mbi patericat dhe herë mbi këmbën e vetme, mundohej të rikujtonte këto skuta të errëta. Këto rrugica me kalldrëm që disa vjet më parë i mposhtën me bujë të pashoqe ushtritë evropiane.

«Për Benito Musolini.»

«Haj Hitler!...»

«C'lavdi e shkurtër! — pëshpëriti Astrit Pema dhe iu duk diçka e çuditshme kur kujtoi që në këtë orë të mesditës të gjitha radiostacionet e botës vazhdonin të jepnin kuriozitete për betejat. Korparmatat. Gjeneralët. Sensacione për vdekjen e Hitlerit dhe të Eva Braunit... Dhe më pas muzikë. — C'turp», — tha dhe ndjeu lodhje. U fut në një gjellëtore. Më shumë se ushqimin shijoi qjetësinë dhe karrigen e drunjtë. Përtpej dhe dëgjonte altoparlantin që ishte mbërthyer diku në një shtyllë betoni. Zëri që vinte copa-copa dhe i ngrysur i përtériu mérzinë e rrugës Durrës-Tiranë, karrocën dhe dy kuajt e plakur. Qendrën e kryeqytetit. Shiun që binte dhe trupin e aksidentuar mbi asfaltin e zi.

Ju flet Tirana... Tirana... Tirana...

Zëri e bëri të harronte lodhjen dhe kryeqytetet e Evropës.

Ju flet Tirana... Tirana...

Spikeri dha një informacion për sigurimin e bukës në prefekturën e Vlorës, ku kishte arritur autokolona e parë me bereqet. Pastaj tha diçka për organizimin e ndërmarrjeve shtetërore në qytetin e Tiranës, të Durrësit dhe Shkodrës, që do të merreshin me furnizimin e popullatës me perime e veshmbathje dhe, në vazhdim, denaskoi një grup armiqsh të pushtetit të ri, spinë të misioneve të huaja, që kishin bërë përpjekje për të sabotuar tharjen e një kënete... Astrit Pema rikujtoi gjeografinë... «Maliqi! — tha. — Ku bie kjo kënetë?...» Spikeri përmendi ca emra: *Inxhinier Sharra!*... *Kujtim Beqiri!*... «Po i treti cili qe? — pyeti ai. Hëm! Na qenka edhe një grua me emrin Zyraka, apo si e tha, Zyrako.» Dhe pastaj gjithçka iu ngatërrua si në një përrallë. Njëfarë kënete. Ca inxhinierë... Një doktor Fulci... Harri Fulci. Sabotazh. Armiq! Dhe përsëri gjithçka humbi në hapësirën e mugët. U shkri me mjegullën.

Spikeri po me atë zë inatçor tha diçka për largimin e misionit amerikan dhe të personelit të UNRA-s nga Shqipëria... Foli për ca mina në gjirin e Korfuzit... Për një incident politik... Ndoshëta-ndoshta edhe ushtarak dhe pastaj rilexoingadalë e me kujdes deklaratën e gjeneralkolonel Enver Hoxhës, i cili në emër të popullit shqiptar kërkonte që UNO-ja të jepte urdhër për tërheqjen imediate të luftanijeve angleze nga ujërat territoriale. Astrit Pema kurrë nuk kishte dëgjuar zë më inatçor, më të hidhur! «Hëm! — përsëriti. — Kurse ai bircja në vapor më fliste për këngët.» Ndjeu dhimbje koke dhe aspirinat i kujtuan dy barnatoret e paraçlirimt. «Po ato

janë? Të shohimi.» — tha ëhe përsëri u përqendrua në zërin e spikerit që tashmë jepte lajme që u përkisnin kufijve dhe shteteve të tjera.

— Ju flet Tirana!... Po japim muzikë për...

Astrit Pemës iu rikujtua biseda që kishte bërrë në vapor me një njeri të huaj që e fliste keq italishten.

«Roma këndon,» — kishte thënë bashkudhëtar që tashti s'dihet ku e kishte thyer qafën.

«Edhe Berlini këndon.»

«Edhe Londra.»

«Edhe Parisi... Hape radion në çdo orë të ditës. Bile edhe mbas orëve të mesnatës dhe do të dëgjosh se të gjitha stacionet e botës kanë filluar të këndojnë. Botën s'e zë gjumi nga gjëzimi.»

«Ndoshta kjo vjen nga gjëzimi që lufta mbaroi,» — kishte thënë bashkudhëtar, që s'dihet ku e kishte thyer qafën.

«Ndoshta! Kurse mua më duket se kryeqytetet e Evropës këndojnë njësoj si më parë. Sikur të mos ishte bërë kurrë luftë. A nuk të duket edhe ty kështu?... Ja, dëgjo Romën! Roma po këndon. Dhe këngët më buçasin në vesh si marshet e luftës.»

«Edhe Berlini kështu këndon.»

«A thua kaq shpejt u harruan 50 milionë të vrarë?»

«Ndoshta më shumë,» — kishte thënë i huaji.

«Dhe megjithatë mua më gjan se këto këngë ndjellin uri.»

Pastaj ishte dëgjuar sirena e vaporit.

«Po të ishim përsëri bashkë, — mendoi Astrit Pema, — me siguri ai do të më thoshte me qesëndi: «Edhe Tirana këndon» dhe do të më shqiptonte po me atë zërin e tij hundor se në

këto këngë, ndryshe nga ato të Evropës, ndihej njëfarë primitivizmi... ose së paku njëfarë provincializmi.»

Pagoi, Përshëndeti kamerierin. Doli në rrugë dhe mori drejtimin nga pjesa jugore e qytetit ku kishte më shumë dyqane dhe kafene. U mundua të rikujtonte emrat e tyre, kohën kur në kryeqytetin e vogël u derdh tërë Evropa me kryeqytetet e saj që u fiksuan në tabelat metalike, në copëra dërrase, llamarina, në copa kartoni. «Berlini», «Londoni», «Kafe Roma», «Bela Veneçia»... «Parisi», «Vjena», «Kontinental». Emrat e kryeqyteteve i gjeje në rrugica, mbi dyert e berberhanave, rrobaqepsive dhe bulmetoreve ku shitej kos. Bile edhe në dyert e shurrtoreve ishin ngjitur kartonë me emrat e mjeruar të botës moderne. Këto mendime iu përzien me gjymtimin e qytetit, muret e rrëzuara e fasadat e rrjetpurat mbi të cilat dikur ishin vizatuar shpatat e Liktorit dhe më pas kryqi i thyer. Në një rrugë më poshtë, një i ri 17-vjeçar, kishte qëlluar perandorin. Kjo për të huajt kishte qenë ngjarja më tragjike e kohës, kurse përvendasit diçka e pritshme dhe shumë zakonore. Pikërisht në fund të kësaj rruge, futur në një rrugicë, Astrit Peçatia kishte rënë dhe mbi portën e braktisur kikujtohej, plakat e përdornin për të shëruar sëmundjet e veshëve. I erdhi mirë që koha kishte lejuar të rritej ky bar shërues mbi muret e shtëpisë së tij. Në dhomën e tij dikur kishte lënë edhe një mace që e ruante nga minjtë dhe në oborrin e shtëpisë një qen. Kishte lënë edhe dy pemë, pusin dhe një tavan që mezi mbahej në këmbë... U kthyte mbrapsht. Një fëmijë 12-vjeçar, i imët e shëndetlig po e shikonte me sytë

e mavijosur. Astrit Pema e pyeti për njëfarë...

— Kam dëgjuar, — tha fëmija.

— Ç'bëhet me të?

— Thonë se ka mbetur diku në kamp. — i tha ai dhe pastaj i tregoi fundin e rrugës ku ishte afishuar një listë e mbushur me emra. Fëmija u zhduk midis njerëzve të tjerë te të cilët ai dalloi diçka të veçantë, krenarinë. Të gjithë duken fitimtarë, tha Astrit Pema dhe ndali përballë një lajmërimi shkruar me germa të mëdha. Njoftimi kishte përbajtje mortore: Emra të mbetur në luftë. Pas tyre viktimat dhe së fundi ata që ende s'u dihej fati. Ai mbante numrin 23. «I njëzetetreti,» — përsëriti me vete dhe doli edhe një herë në rrugën kryesore. Ndjeu lodhje si atë ditë kur një italian e kishte shoqëruar të ngjiste shkallët e Koloseut. Me siguri cungu i këmbës i kishte rrjedhur gjak, se diçka e lëngshme lagu lëkurën e trashë.

Shtrëngoi dhëmbët dhe ngriti kokën lart. Qielli kishte pamje laryshime; ngjyrosur si lëkura e zvarranikëve të mureve. Dyngjyrësh: i bardhë dhe i përhimë.

Pastaj ra mbrëmja.

12 nëntor.

Mesnatë!

Në shtëpinë e Zego Korbit:

Drita tē fikura. Mure tē vjetruara. Papatingo me grila tē lēshuara... Qetësi varri. Rreth saj sillej vdekja.

Në kishë:

Fillo! — urdhëroi dom Kela.

Dang-dung... Dang... Dung...

— Vazhdo! — urdħeroi përséri dom Kela.

Kambanari që ishte bërë gati të varej pas litarit të trashë u çudit me dom Kelën që harroi të bënte kryqin, që eci me hapa të rëndë... Dhe më tepër akoma kur pa se ai doli jo si zakonisht nga deriçka e pasme, por nga porta me kangjella hekuri pa dhënë asnjë urdhër për numrin e goditjeve. «Pse kështu sonte, — mendoi ai. — Pa kufizime? Ç'do të thotë kjo dang... Kjo dung... pa numër? Qoftë lëvdue Krishti! — përsëriti ai. — Ai iku, kurse unë...» — dhe lidhi litarin pas ganxhës metalike.

Prifti, kur doli në bulevard, kapërdiu një tabletë për zemër dhe u fut në rrugicën që e shpinte në shtëpinë e tij...

Në redaksinë e gazetës:

N.N.-së i ngrinë gishterinjtë mbi tastierën e makinës së shkrimit. Përsëri dang?... «Ç'goditje të mistershme,» — tha dhe zgjati kokën në dritaren e zyrës. Dy kolegë vazhdonin të rrithnin shkronjat, kurse në rrugë po ai fshesar... Copa letre... Ambalazh... Gjethë vjeshte dhe mbeturina të tjerë rrëshqisnin para fshesës dhe bëheshin grumbull... «Duhet të mbaroj shkrimin për rrezikun e karkalecit... Kurse kambanat... Dang... O perëndi! U lut dhe përsëri i shkoi mendja te rreziku i tmerrshëm i karkalecit... Tek lufta kundër tij... Arsenati i sdiunit... Buburreci i Kolorados... Çfarë duhet tjetër?... Po zonat 13... 24?...» U ul në tavolinë dhe prapë trak-truku i shkronjave

që rrihte letrën e bardhë diçka donte të thoshte... Çfarë? «Lexoni gazetën «Bashkimi!»... Datë...»

Në shtëpinë në qendër të kryeqytetit:
Gruan trashaluqe, që vuante nga astma,
s'e kishte zënë gjumi.

Dung... Dung... Dong...

Ajo e tundi nga supi dhe si zakonisht i ledhatoi ballin.

— Çfarë? — pyeti deputeti që i kishin rrjedhur jargë të ngjyrosura mbi jastëk.

— Kambana!... Dangu!...

— O zot!... S'është e mundur!

— Ja, dëgjoi!

— Ç'të jetë vallë? — tha ai dhe fshiu sytë nga sklepat.

— Të të bëj një kafe?

— Bëje!

— Po galloshet i do?

— Jo!

— Sade?

— Me pak!

— Sa i qetë më dukesh sonte, deputeti im, — i tha ajo.

Ndërsa ai vriste mendjen për titullin e fjalimit që do të mbante në sesionin e S... Sytë i shkuat në faqen e gazetës që kishte mbetur e hapur mbi tavolinë. Rilexoi listën e një grupi të dënuarish politikë dhe vendimin e kolegjit të gjykatës ushtarake. Terror... Përpjekje për të siguruuar sa më shumë vota në kutitë boshe në zgjedhjet e

dhjetorit.. Ndjeu të dridhura në trup. Rru-fiti kafenë pa shkëmbyer asnje vështrim me të shoqen.

— Deputeti im!

Para hotel «Dajtit»:

Ai hipë në xhips dhe priti. Mister S., që edhe pse në ecje të linte përshtypjen e të dehurit, mendjen e kishte top.

— Vdiq?

— Jo!

— Ç'do të thotë kjo?

— Mund të vdesë, por vetëm pas orëve të mesnatës.

— I sigurt?

— Sipas premtimit të doktor Anxhelos!

— Okej! — Pastaj përsëri pyeti: — Ka rrezik të identifikohet?

— S'na e do mendja.

— Po më tej?

— Një varrim i shpejt, pa ceremoni, që do të arsyetohet me rrezikun e infektit mit dhe mungesën e kushteve të posaçme në morg.

— Okej!... Me ata ç'bëhet?

— U izoluan.

— Dhe pas izolimit?

— Pritëm orët e errëta. Mesnatën.

— Me siguri që e keni peshuar rrezikun që ju kanoset në qoftë se kanë mbetur gjallë.

— Mos u shqetësoni, sër!

— Vetëm jua kujtoj!... Okej! — përshën-

dëti mister S. dhe, ngaqë s'gjeti dot urim tjetër më të përshtatshëm në këtë orë të vonë, i shtrëngoi dorën.

Xhipsi la bulevardin, urën, kurse ai u fut në rrugicën që të shpinte në shtëpinë e dom Kelës.

Në dyqanin e reklamave:

- Orari i mameve?
- Si zakonisht!
- Po i barnatoreve?
- Gjithashtu!
- Të reja të tjera?
- S'ka! Fli i qetë!

Ahmet Bregu uli grilen e copëtar
dhe filloi të shkruante edhe dy lajmërimë
të porositura. I pari për ndeshjen e futbo-
llit që do të zhvillohej të pasnesërmen mi-
dis skuadrës së «Partizanit» dhe asaj të «17
Nëntorit», kurse të dytin për aksionin që do
të ndërmerrte organizata e rinisë së krye-
qytetit për hapjen e kanaleve të ujësjellësit
të ri në periferi, të gropave për gjelbërimin
e kodrave që akoma ruanin emrin e Fuat
beut, higjienizimin e pastrimin e rrugëve
kryesore. Pastaj u shtri. E zuri gjumi pa
vlerësuar dangun që u dëgjua si i mbytur.

Plaka që kishte pasur zymbyle në dorë:
— Allah!... Më fal, o perëndi, në qoftë

*se vdiq pér fajin tim! Ndéshkomë, o zot!..
Ose le tē më dënojë ligji ..*

Dang... Dung... Dang.

— I vaftë shpirti në...

— Çfarë ke, mama?

— Asgjë, bir! Fli! Nesër do ngrihesh shpejt.

11 JULY 22

KAPITULLI II

1

Kapiteni hoqi pallton dhe përmes dritares pa qytetin e fundosur në mjegull të dendur dhe në tymin e kaldajave që ngrihej i rrudhur e me përtesë nga oxhakët e ministrive. Ndjeu se trupi i dridhej si në ethe. «Nga pagjumësia,» — mendoi. Natën kishte bërë përpjekje që të harronte çdo gjë: të aksidentuarin, shoferin, gruan e shoferit, fëmijën. Kishte myllur sytë me zor dhe dhjetëra herë kishte numëruar goditjet e témthave në jastëk, po gjumi s'i ishte afruar. «Nga ajo dreq ngjarje,» — tha dhe u ul në karrigen e mbështjellë me lëkurë ngjyrë kafe e zbuluar me sumbulla metalike anash.

S'dihet ku kishte humbur mendjen, ndërkohë që zilja e telefonit binte pa pushim. Ai ngriti dorezën. Nga larg, si nga fundi i botës, dëgjoi një zë të mbytur.

— Vdiq? — pyeti së dyti duke afruar mikrofonin më afër gojës.

— Vdiq! — përsëriti toger Mete Jaupi që kishte hyrë pa trokitur.

— Në c'orë?

— Ndoshta në mesnatë!

— Janë dhënë porositë e duhura?

— Që të mos kryhet asnje veprim deri në një urdhër të dytë, ndonëse mjeku ngul këmbë për rrezikun e infekzionit. Dërgova grupin që ta fotografonin në disa pozicione, sepse fytyra i është dëmtuar rëndë.

— Varrimi duhet të shtyhet!

— Mjekët ngulin këmbë, — përsëriti Mete Jaupi dhe, pasi ndezi cigare e heshti gjatë, iu afrua sobës dhe zgjati duart mbi rrathët e saj, tha: — Sapo mora një informacion tjetër të papëlqyer.

— Aksident?

— Një femër është gjetur e mbytur në një gropë gëlqereje.

— E sigurt?

— Kështu deklaroi muratori që solli lajmin.

— Grupi i ekspertizës është gati? — pyeti kapiteni.

— Besoj, — tha togeri.

— Shkojmë! — tha kapiteni pasi veshi pallton.

Dolën në korridor, zbritën shkallët e drunjta dhe u futën në dhomën e oficerit të rojës. Adil Çika i zgjati dorën muratorit që kishte sjellë lajmin. Ai kishte moshë të thyer, rroba të njollosura me blanga llaçi e gëlqereje.

— Si ndodhi? — pyeti kapiteni.

— Unë nuk e di, — tha muratori që, së pari, në vend të fjalës «shoku», nxori një «z» të zgjatur... — Domethënë gjeometri më dërgoi këtu,

— Po ti s'e pe kufomën?

— E pashë, po vetëm kur e nxorën nga gropa, — tha punëtori i ndërtimit.

Adil Çika, Mete Jaupi dhe dy ushtarakë eks-pertë ecnin përbri njëri-tjetrit pa folur. Në rrugë kishte kalimtarë të tjerë. Mbi ta fluturoi një tufë shpendësh që kishte qëndruar mbi telat elektrikë. Kishin lënë rrugën kryesore dhe ishin futur në një rrugicë. Pastaj kaluan një derë të improvizuar me copa dërrasash, që kishte zëvendësuar pjesën e murit të rrëzuar. Në një kthinë të ngushtë ishin grumbulluar njerëz. Gjeometri i ftoi pranë kufomës që e kishte mbuluar me një copë katrama të zezë.

Kapiteni, ndryshe nga të tjerët, u afrua pranë gropës së gëlqeres, që, për kursim vendi, e kishin hapur rrëzë themeleve të një shtëpic dykatëshe, që i ngjiste çuditërisht një trupi të trashë me kokë të madhe e nofulla të dala. Këtë përshtypje ia krijoj më shumë se çdo pjesë e saj papafingoja.

— Kur e keni hapur? — pyeti ai duke përqendruar sytë në thellësinë e kopshtit.

— Javën e kaluar! — shpjegoi gjeometri.

— Po gëlqerja kur është shuar?

— Tri ditë më parë!

— Domethënë...

— Pa dyshim! Trupi është përvëluar! Gëlqerja është njësoj si zjarri, mos më keq, — tha gjeometri.

Kapiteni ngriti përsëri kokën lart dhe kundroi suvanë e rrëzuar, gjurmët e një ballkoni gjysmë të shkallmuar, një derë që përplasej nga era, dritaret me grila dhe përsëri papafingon mbi katin e dytë.

— E kujt është kjo shtëpi? — pyeti kapiteni.

— E një ish-tregtari... Në mos gaboj, nga fisi i Korbajve! — shpjegoi gjeometri. — Edhe kopshti... Po kohët e fundit ia shtetëzuan... Po hapim themelet për një godinë trekatëshe.

— Mos është hedhur andej? — pyeti kapiteni që shikonte derën e ballkonit.

— Nuk besoj. Njerëzit e familjes do të ishin bërë të gjallë. Trokitëm edhe në portë, po përsëri s'na u përgjigj njeri... Ose është ndonjë kalimtare e rastit, ose... S'di si të them... Duket se i është mërzitur jeta dhe është hedhur në gropë...

Ndërsa gjeometri e kishte futur bisedën në këto hollësira, Adil Çika nuk ia ndante sytë kopshtit, dheut të kuq, themeleve të hapura, pemëve të shtrira përtokë dhe kërcunjve që kuqonin sikur të ishin lyer me gjak dhe s'dihet pse në këtë mot të vrenjtur dhe të përbaltur i shkoi mendja te vapa. Kujtoi se në verë, nën hijen e këtyre pemëve, duhej të ishte shumë freskët dhe përsëri u mundua që të mos i shpëtonte asnjë hollësi nga ato që i duheshin për të gjykuar për ngjarjen.

— Gjithçka të ketë ndodhur natën?

— Mundet edhe ditën. Dje nuk punuam në këtë objekt. Binte shi.

— Rojë kishit lënë?

— Jemi akoma në hapjen e themeleve dhe...

— Po gropa?

— Ky është vend i veçuar, shoku kapiten... Duhet të keni bindje se viktima është hedhur vetë, ndryshe pse duhej të futej në këtë skutë?

— E çuditshme!

— Në fillim unë kujtova se dikush kishte hedhur një copë rrobë dhe zgjata një hekur ta hiqja, — shpjegoi një punëtor që ishte futur në bisedë. — Po pesha ishte e rëndë dhe thirra sho-

kët... Kur... Ç'tju them, more shokë oficerë!

Kryehetuesi pa edhe një herë trupin e mbuluar me katrama, pjesët e djegura, kopshtin, gropën e gëlqeres, shtëpinë, u dha porosi ushtarakëve, përshëndeti dhe doli në rrugë.

Adil Çika ishte në atë moshë kur njeriu shquan për forcën dhe bukurinë e tij. Kishte trup të drejtë, shpatulla të gjera, supe të ngritura që i jepnin pamjen e një detari, fytyrë të rrumbullakët, që mbaronte me një gropëz të vogël në mjekër (shumëkush e merr këtë si tipar zgjuarsie). Ishte i urtë dhe i dashur me shokët, aq sa ata shpesh harronin gradën dhe përgjegjësinë e tij dhe i thërrisin vëtem në emër, Adil. Në këto raste ai e ndiente veten të çliruar nga funksionet dhe gradat. Ishte përqendruar në aksidentin e ri. «E përse i duhet dhënë kaq rëndësi? A nuk është edhe ky një aksident si gjithë të tjerët? Një gjëmë dhe asgjë më shumë. Cilado qoftë arsyaja, çështje nderi apo pasurie, intime apo politike, ata me siguri e kanë menduar gjatë punën e tyre dhe mandej kanë vendosur me vetëdije që t'i japin fund jetës. E ç'ka pér t'u shqetësuar?» — tha ai dhe ngriti kokën lart. Një ballkon i heshtur iu shfaq para syve. Ndërsa shikonte herë ballkonin, herë njerëzit, një klerik i ri që i kaloi pranë, i buzë-qeshi ftohtë. Ishte një fytyrë që e shihte çdo ditë. E bardhë në të verdhë. Me lëkurë të hollë e mjekër të prerë sipas modës. Po ata sy të thellë, me ngjyrë të kaltër që fshiheshin tej syzeve me rrathë të verdhë. Po ajo veshje me

sqimë. Po ajo rasë e zezë. Po ajo kapelé me strehë të thyer. Po ato pantallona të zeza, të hekurosura. Po ato këpucë të ndritshme... Gjithçka te ky njeri i perëndisë, veç qafores së bardhë dhe kryqit të madh në ngjyrë sermi, ishte e zezë. Dhe bashkë me ngjyrën të binte në sy freskia e moshës dhe sidomos buzëqeshja e shtrë, që ai nuk e kursente, jo vetëm për besimtarët e tij, por edhe për bashkëqytetarët e tjerë.

Adil Çika ktheu kokën dhe e pa me vëmen-dje priftin që kishte hap të shpejtë. Pastaj u fut në një lokal të ngushtë. Piu kafe në këmbë dhe iu gjëzua zënkës së dy të rinvjë. Secili ngul-te këmbë në të tijën:

I pari: — Unë vë bast se votat u ndanë kështu: 11 pro, 2 abstenuan, kurse 7 kundra.

I dyti: — Mos ia fut kot. Ishin 10 pro dhe 3 abstenime.

I pari: — Eja! Bastin!

I dyti: — Me sa të duash. Gazetën e kam në shtëpi.

Adil Çika qeshi kur i ra ndër mend se ata grindeshin përfundimet e njërs nga seancat plenare të Konferencës së Paqes në Paris... Tundi kokën dhe kujtoi padrejtësinë që vazhdonte t'i bënte bota Shqipërisë së vogël. Ai nguli edhe një herë vështrimin mbi dy të rintjtë që s'e kishin ndërprerë zënkën dhe doli në rrugë. Një grumbull njerëzish ishin përqendruar mbi dy lajmërimë. I pari u bënte të ditur qytetarëve se së shpejti do të rihapej në kryeqytet shkolla e dansit nën dirigjimin e profesorëshës hungareze, zonjës Gizella. Për mësimin e dansit, vazhdonte njoftimi, do të jepeshin mësime private, të cilat siguronin klientelën se pas provave të shumta, kërcimi ishte i garantuar.

Lajmërimi i dytë i takonte kapitenit të parë

Jonuz Malo, që ditën e diel celebrohej me shqen Donika Mitro, arkëtare në Bankën e Shtetit. Dhe më poshtë ftesa për gjithë miqtë, shokët, farefisin.

— Të vijnë dëshmitarët! — i dha porosi oficerit të rojës, kur u fut në oborrin e seksionit të punëve të brendshme.

2

Dëshmitari i parë ishte grua e moshuar që pas çdo fjale përsëriste vazhdimisht «qyqja unë» dhe i lutej zotit. Kur kapiteni e pyeti se si kishte ndodhur aksidenti, ajo u përgjigj me frikë se kurrë në jetën e saj s'kishte parë me sy njeri të shtypur dhe kishte përsëritur: «Qyqja unë, biro, si s'më zuri gjaku! Shyqyr zotit që është në qiell.» Kur dëgjoi nga goja e kapitenit pyetjen se mos ai ishte hedhur vetë nën rrotat e makinës, ajo zuri kokën me duar dhe tha me habi:

— Po si u hidhka njeriu kot më së koti në rrotat e makinës, more bir?... Qyqja unë sa frikë i kam të flamosurat... — Adil Çika përsëri me buzë në gaz i kërkoi të tregonte se si ndodhi. — Po ja, more bir, unë bleva ca të flamosura barishte, lakra, biro, dhe po ecja e menduar anës rrugës... Në këtë kohë më ra trasta nga dora. Qyqja, thashë dhe hapa sytë. Ma kishte hequr nga dora një burrë që kaloi me vrap. Pika të rëntë, e nëma dhe ngrita trastën... Po do ti, more bir... Qyqja, qyqja, e shoh të birev e botës që e zuri rrota e makinës... Kam që

mbrëmë që s'më hiqet nga mendja. Kurrë s'kam pasur gojë të ligë, biro! Në i erdhi nga unë, dënomëni. Më futni në burg.

Kapiteni qeshi. Fjalët e fundit i kujtuan nënën e tij që ishte po kaq supersticioze dhe i lutej perëndisë sa edhe kjo plakë, së cilës kishte filluar t'i dilte kurrizi.

— Për kokën tuaj, biro, s'më ka zënë gjumi i natës, — tha plaka. — Këto ia thashë edhe djalit. Mos qesh. E kam oficer si ti...

Dëshmitari i dytë ishte ushtarak.

— Shoku kapiten, ne ju thirrëm për...

— E mora me mend.

— Një ngjarje akoma e errët...

— Unë isha në anë të kundërt të rrugës...

Dasha të them nuk më la kamioni që të shikoja si ndodhi aksidenti. Goma e pasme e kishte bërë përshesh. Bile dërgova një qytetar te bulmetorja që ishte afër. I hodhëm një rrobë, se, siç ju thashë, s'shihej me sy.

— Si mendoni të ketë ndodhur?

— Si t'ju them...

— Kamioni kishte shpejtësi?

— Me sa më kujtohet, jo!... Dikush tha se i aksidentuari ecte me vrap dhe duket se nuk e ka vënë re kamionin... Dikush tjetër bënte be se ai u hodh vetë nën rrota...

— Ndonjë emër?

— Jo!

— As të qara nuk dëgjove?

— Jo! Më lindi dyshim vetëm për një invalid,

— Po! — aprovoi kapiteni. — Çfarë ju bë-
ri përshtypje te ky njeri?

— Asgjë e veçantë... Po s'di pse nuk më
pëlqen diçka... S'di si të them. Kur trupin e të
aksidentuarit e kishim mbuluar me rrobën e
bardhë, vura re se ai me fundin e patericës
i *zbuloi* këmbën. Ne pamë çizmen e të plago-
surit. Edhe ai e pa dhe pastaj e tërhoqi përsëri
rrobën e bardhë. Rrudhi buzët, u vrenjt dhe
iku i zemëruar...

— E njeh këtë njeri?

— Jo. Ishte hera e parë që e shihja... E pa-
shë edhe sot në mëngjes. M'u bë se doli nga
hotel «Evropa» ose diku tjetër, s'më kujtohet.
Ndoshta duhet të pyesni... Ai ecte me paterica.

Dëshmitari i tretë ishte qytetari që i kishte
dhënë i pari shenjë shoferit që të ndalte
makinën.

— Sa larg ishe? — e pyeti kapiteni.

— Në trotuar! — tha ai.

— Cila rrotë e zuri?

— E prapmja.

— I sigurt në këto që thua?

— E pashë me këta sy, — tha dëshmitari.

— Thua të jetë verbuar?

— Ka mundësi! Ndryshe si ta shpjegosh?

— Ti je tiranas?

— Prej 40 vjetësh.

— Nuk ta ka zënë syri ndonjëherë këtë
njeri?

— Fytyrën ia kishte mbuluar gjaku dhe bal-
ta, — tha dëshmitari,

— Dikush pohoi se një invalid me fundin e patericës kishte zbuluar këmbën e të aksidentuarit. Të ra në sy një veprim i tillë?

— E pashë. Ishte edhe ai midis të tjerëve. Adil Çika falënderoi qytetarin për dëshminë dhe i tha se, në rast se do të lindte nevoja, mund ta thërrisin përsëri.

— Sa herë të dëshironi, — tha qytetari pasi vuri borsalinën në kokë.

Kur mbeti vetëm, ai u mundua të ripërtërinte deponimet e fundit dhe të larrinte së paku në njëfarë përfundimi nëse ishte aksident automobilistik, apo hedhje me dashje nën rrrotat e kamionit. «Edhe kjo e fundit mund të jetë, — tha ai dhe kujtoi leksionet e avokatit plak të mbushura me shembuj veprimesh të njerëzve që zakonisht vuajnë nga sëmundje deliri... — Mund ta kenë shtyrë dhe motive të tjera,» — tha.

3

Ushtari i shërbimit me uniformën gri e lajmëroi Adil Çikën se një qytetar kërkonte të takohej me të.

— A s'i thatë se jam i zënë?

— Jo!

— Nesër e pres në çdo orë!

— Po ju e keni kërkuar vetë. Është një invalid.

— Shoqërojeni! — tha kapiteni dhe, pasi ndezi cigaret, priti me mendimin se ndoshta takimi me invalidin do t'i sillte ndonjë fakt të ri çështjes që hetonin.

— Tungjatjeta! — dëgjoi kapiteni njeriun që u fut në derë.

— Mirëmbërëma, — ia ktheu përshëndetjen Adil Çika dhe e ftoi të ulej pa ia ndarë sytë atij trupi të hollë e të dobët me fytyrë të hequr dhe flokë aq të rrallë, sa e pati të vështirë të përcaktonte moshën e tij. Kapiteni vuri re se në vend të këmbës së djathtë, kishte protezë dhe, për të lehtësuar ecjen, ai vazhdimisht mbështetej mbi dy paterica druri. Zhurma e patericave ishte diçka e dhimbshme që të krijonte përshtypjen e një refreni të mërzitshëm. I porsaardhuri u ul në karrige, bashkoi dy patericat, mbuloi me cepin e pardësysë cungun e këmbës së prerë, që u veçua nga proteza si një kockë e dalë nga vendi.

— Jashtë bën ftohtë, — tha.

— E pini? — pyeti Adil Çika.

Ai zgjati dorën dhe mori cigare...

— Ne ju thirrëm për një çështje që na intereson.

— Sapo më lajmëruan, erdha.

— Na falni që ju munduam, por morëm vesh se jeni gjendur në vendin ku ndodhi ai aksidenti automobilistik.

— Kur arrita unë, çdo gjë kishte marrë fund. Ndoshta më me interes është t'ju them se shoferi s'ka faj.

— Tashti për tashti për këtë s'na duhen dëshmitarë! — tha oficeri gati i zemëruar.

— Atëherë më falni! E pashë që e morën të shoqëruar dhe e ndiej pér detyrë... Nejse... Më shumë respektova ftesën e seksionit tuaj.

— Po pse nxitonni, shoku qytetar? — e pyeti oficeri kur vuri re se ai u bë gati të ngrihej në këmbë.

— Jam tepër i lodhur.

— Meqë erdhët, të paktën të njihemi.

— Ju, përderisa më ftuat, me siguri që më njihni. Quhem Astrit Pema. Për të tjerat janë në dijeni organet shtetërore...

— Kurse unë jam Adil Çika. Oficer!

— Gëzohem... Sapo jam kthyer në atdhe... Po këto s'besoj të kënë ndonjë rëndësi për ju.

— Keni ditë? — pyeti tërë kuriozitet Adil Çika.

— Pak, — tha dhe përsëri shtoi: — Veç respektit për ftesën tuaj, erdha edhe për çështjen e shoferit. Ai s'ka faj! — përsëriti me të njëjtën siguri si edhe më parë. — S'e njoh fare atë... Kurse ai... me siguri që është hedhur vetë në rrotat e automobilit!...

— Cili ishte ai? — pyeti oficeri.

— A mund ta ndez? — tha dhe tregoi ciganen që gjatë bisedës ishte shuar.

Oficeri ia ndezi.

— Faleminderit!

— D.m.th. ju e njihni njeriun që u shtyp?

— Po, — tha ai me një siguri që kapitenit iu duk tepër e quditshme.

— Ju lutem na thoni ato që dini! — tha sërisht oficeri nga dëshira për të zënë qoftë edhe fillin e këtij procesi që vazhdonte të ruante tiparet e enigmës.

— Taketukan, ju lutem!

— Urdhëroni!

— Faleminderit! — tha ai dhe shkundi hirin e bardhë të cigares.

— Ku ishit ju kur ndodhi aksidenti?

— Si t'ju them... Ndoshta zbrisja shkallët. Ndoshta edhe në rrugë. Nuk e përcaktoj dot... Nuk më kujtohet mirë.

— Ju thoni se shoferi është i pafajshëm.

Apo jo? — e pyeti kapiteni dhe përsëri i zgjati cigare.

— Gjersa një njeri hidhet nën rrotat e makinës, s'ka si gjykohet ndryshe.

— Dëshmitë e dyshimta mbeten gjithnjë vetëm dyshime, — tha. Pastaj vuri buzën në gaz

— U shpreha gabim! Kështu është. Shoferi s'ka faj! — tha ai me siguri të plotë.

Kryehetuesi as vetë nuk e kuptoi pse i pëlqeu ky deponim. Ndoshta ngaqë shoferin e priste një grua dhe një fëmijë që kishte lindur para një javë.

— Nga këto që do t'ju them tashti shkruani ç'ju nevojitet! — tha pasi shtrëngoi përsëri patricat midis këmbëve. — Ndoshta do t'ju duhen të gjitha. Ndoshta... çdo gjë ndodh aq shpejt sa....

— Mbi të gjitha na intereson të dimë se cili është njeriu që u aksidentua!

— Ju nuk e njihni akoma?

— Jo! — tha kapiteni.

— Më falni që ju humba kaq kohë. Është nga familja e Korbajve.

— Korbaj? — pyeti kapiteni, i habitur ngaqë ky mbiemër i kujtoi ngjarjen e mëngjesit. Kopshtin. Gropën e gëlqeres. Kufomën e djegur. Shtëpinë dykatëshe me papafingo dhe pohimin e gjeometrit...

— Po. I biri i Zeqo Korbit.

— Po si ndodhi?

— Ju thashë se çdo gjë ndodhi aq shpejt...

— Ju lutem, mundohuni ta kujtoni!

— Më falni... E shoh edhe vetë se nuk jam në rregull. Ndoshta kjo vjen nga lodhja, ose si t'ju them... Nga gëzimi i rikthimit në atdhe.

— Ose nga ngjarja.

— Mundet! — tha invalidi.

Adil Çika që s'a ndante sytë u mundua ta qetësonte.

— Si ta shpjegoj? Është diçka personale... Mbasi shëtita pak dje paradite, shkova drejt Rrugës së Dibrës. Ecja strehëve, se, siç ju thashë, binte shi. Rruga pas pak vjetësh m'u duk e ngushtë sikur të merrte fryshtë. Dyqanet. Vitrinat. Njerëzit... Pa është kuptuar ndalova para një shtëpie dykatëshe... Pikërisht këtë shtëpi kërkoja dhe hodha sytë lart. Pashë po atë papafingo. Po ato grila... Pastaj suvanë me ngjyrë të verdhë dhe vitin 1929 që ishte gdhendur mbi një pllakë guri në qemerin e portës... Kur ishim të rinj, me qesëndi e kishim pagëzuar: «Gjeneral-shtëpi...» Dhe kjo...

Adil Çika mundohej të mos i shpëtonteasnë hollësi, ndonëse e nervozonte kjo stërgjatje pa vend, ky stërhollim dhe akoma më shumë pauzat e gjata.

— U drejtova andej dhe, kur iu afrova dyqanit, përmes xhamave dallova kosaxhiun e vjetër.

— C'ju lidhte me këtë shtëpi? — pyeti kapiteni, të cilit, pa asnë arsy, përsëri iu kujtua papafingoja e saj.

— Ndoshta inati!

Kryehetuesi ngriti supet.

— Ju nuk keni pasur ndonjëherë inat?... Tazëmë me një njeri që, pa asnë arsy, ju ka bërrë keq... Ose më saktë... Kisha një inat që më brente si tumor, — tha ai dha padashur hodhi sytë mbi këmbën-protezë dhe patericat që shtrëngonte midis shalëve. — Më kuptoni? Pra iu afrova xhamit të vitrinës dhe pashë kosaxhiun e vjetër... U mata të futesha brenda.

— E njihnit atë?

— Natyrisht. Doja ta pyesja nëse vazhdonin të jetonin në atë shtëpi Korbasti. Ata më kanë shumë borxhe, zoti oficer! Siç e shihni! — dhe

ai përsëri tregoi protezën. — Ata më gjymtuan. Më lanë pa shtëpi, pa jetë, me dy paterica dhe një këmbë druri, — tha dhe u mundua të lëvizte këmbën e djathtë, *po* cungu i saj nuk iu bind, diçka kërciti dhe ai u nervozua.

— Domethënë u futët në dyqan... Pastaj?

— Jo! Nuk u futa.

— Po ju thatë se patë përmes vitrinës kosa-xhiun plak, apo jo?

— Ashtu ndodhi. Po, ndërsa po bëhesha gati të futesha në bulmetore, ndjeva se u hap dera e shtëpisë dykatëshe... E shtëpisë që kisha përballë, — tha invalidi kur vuri re se kapiteni u bëgati të ndërhynte.

— Pastaj?

— Pastaj?... — përsëriti si i hutuar invalidi.

— Pashë se doli një njeri...

— Shoku qytetar! Ju pak më parë, kur ju pyeta se ku ishit kur ndodhi aksidenti, pohuat: «Duhet të zbrisja shkallët... ose në rrugë...», kur se tashti thoni se ishit pranë vitrinës së bulmetores. Si qëndron e vërteta?

— Ai doli në rrugë dhe ia krisi vrapi... I dëgjova mirë hapat e tij.

Kapitenit, ndërsa dëgjonte invalidin, iu kujtuan fjalët e plakës me trastë: «Një burrë kaloi me vrapi...» Dëshmitë përputheshin. Ai pa përsëri invalidin që dridhej dhe iu kujtuan fjalët: «Ju s'keni pasur ndonjëherë inat?»

— Po cili ishte njeriu që ia krisi vrapi?

— I biri i Zeqo Korbit pra, Telat Korbi.

Kapiteni i shkroi me nxitim dy emrat dhe përsëri pyeti:

— Më tej?

— Nuk më kujtohet asgjë tjetër, shoku officer, — tha invalidi. — Dëgjova bilbilin e polit, diçka të zhurmshme dhe një ulërimë femre di-

ku afër... Ndoshta erdhi edhe nga dritarja e shtëpisë... Pastaj dola në bulevard. Të shtypurin e kishin hequr mënjanë. Kaq!

— Nuk keni gjë tjetër për të na thënë?

— Jo!

— Atëherë, faleminderit!

— Mund të shkoj?

Kapiteni pohoi me kokë.

— Unë megjithatë ju siguroj se shoferi s'ka faj!... Për të tjerat është mirë të pyesni Zeqo Korbin! — tha dhe u ngrit. Po akoma pa bërë asnje hap, tha: — Më falni! Besoj se mbajtja e armës pa leje ndalohet; — dhe nxori nga xhepi një revolver që ia zgjati kryehetuesit.

— Po ky përse ju duhej?

— E kisha menduar jetën ndryshe. Të arratisurit andej ma kishin bërë çdo gjë gogol. Propaganda e huaj më kishte trembur aq shumë, sa gati-gati më bindi që të mos kthehesha. Po gjatë këtyre ditëve e pasqë se s'ka c'më duhet...

Adil Çika pohoi se ligji i ri e ndalonte mbajtjen e saj pa leje dhe pastaj e pyeti nëse kishte ndonjë nevojë.

— Faleminderit, — tha ai dhe i zgjati dorën.

Pasi doli invalidi, Adil Çika ndjeu dhimbje të fortë koke. Nuk kishte pushuar tërë ditën. Pas takimit me dëshmitarët kishte ngrënë drekë me nxitim dhe gati-gati në këmbë në mensën e oficerëve dhe përsëri ishte kthyer në zyrë... Kishte marrë në pyetje një të arrestuar politik dhe duhet t'i raportonte shefit të seksionit të punëve të brendshme për ngjarjet e fundit... Pastaj, papritur edhe Astrit Pema. (Njerëzit e ngarkuar, pasi kishin pyetur në komitetin ekzekutiv dhe s'kishin marrëasnje përgjigje, e kishin kërkuar me radhë në tërë hotelet e Tiranës.) «Një i rikthyer në atdhe, — përsëriti ai, — që na dha

atë që kërkonim. Po çne në shtëpinë e Korbajve? Dhe përsëri mendja i shkoi te revolveri. «Përse i duhej? Sidoqoftë, — tha ai, — ka kohë... Nesër... Në hotel...»

Ai thithi cigaren, lëshoi një shtëllungë tymi të dendur dhe, pasi shfletoi shënimet, nën vizoi diçka nga deponimet e Astrit Pemës. Ajo që pàra një ore ishte vetëm një arsyetim i mjegullt, tashти u bë paksa më reale dhe konkrete, sepse, mendoi me vete, kur nga dera e një shtëpie del një njeri, që, pa pritur e pa kujtuar, gjendet nën rrotat e makinës dhe po pranë kësaj shtëpie, në një gropë gëlqereje, gjendet një kufomë tjetër, nuk mund të rrish pa hamendësuar diçka. U ngrit, shoi cigaren në taketuken metalike dhe e përshkoi disa herë dhomën nga dritarja që shikonte pjesën jugore të qytetit, te tavolina e punës. Pastaj pa dritat e zbehta brenda fenerëve dhe vetëm tani vuri re se kishte rënë mbrëmja. Në këtë orë ai e kishte bërë zakon të dilte nga zyra dhe të takohej me Viton. Qortoi veten për vonesën, mbështeti ballin pas xhamit që u vesh nga fryma dhe përsëri iu shfaqën dy viktimat. «Vrasje, apo vetëvrasje... Dreqi me të birin,» — shqiptoi ai dhe përsëri kërkoi me mend versionin më të mundshëm.

Të nesërmen përsëri do të kishte shumë punë. Mbylli dosjen, kyci kasafortën dhe u bë gati të shuante dritat. Po në këtë kohë dëgjoi hapa në korridor dhe pas tyre pa Mete Jaupin që hyri brenda. Si zakonisht e mori për qafe.

Të dy ushtarakët ishin nga i njëjti qytet. Bile të një moshe dhe shokë klase në shkollën

tregtare, që Mete Jaupi ishte detyruar ta ndërpriste për arsyen ekonomike!... Pastaj të dy ishin aktivizuar me njësitet e para në qytet dhe më vonë ishin inkuadruar në një batalion. Bile në një kompani. Kjo kishte zgjatur deri në shkurtin e vitit 1943, kur Mete Jaupi ishte plagosur rëndë. Adil Çika dhe një shok tjetër e kishin marrë në krahë dhe e kishin nxjerrë nga rrëthimi. Pastaj atë e dërguan në spitalin partizan, në Zagori. Po, kur u kthye në batalion, nuk e gjeti më Adil Çikën, që ishte transferuar në një brigadë tjetër me detyrën e zëvendëskomisarit të batalionit. Pastaj erdhën muajt e gjatë në viset e Jugosllavisë dhe ata u takuan pas Çlirimit. Të dy i kishin thirrur në Ministrinë e Punëve të Brendshme... Ishin emëruar në organet e hetuesisë. «Si ështëjeta», — kishte thënë Mete Jaupi kur kishin dalë në rrugë. «Shumë e bukur,» — ishte përgjigjur Adil Çika dhe biseda e tyre ishte përqendruar në detyrën e re që i priste, në ndryshimet e mëdha që kishin ndodhur gjatë kësaj kohe të shkurtër, në përpjekjet që bënte armiku i klasës për të rimarrë pushtetin që i kishte shpëtuar nga duart. Kishin biseduar për synimet e aleatëve dhe manovrat e tyre për zbarkim, për bandat dhe diversantët që dërgonin fqinjët, të cilët synonin riaktivizimin e elementeve armiq brenda vendit, për luftën e divizonit të mbrojtjes kundër tyre... «Megjithatë e ardhmja është e popullit,» kishte po-huar Adil Çika dhe i kishte hedhur dorën në shpatulla. Mete Jaupi kishte mbrojtur krahun, që ende e ndiente të dobët.

- Si të shkoi puna sot? — pyeti Adil Çika.
- Keq! — u ashpërua Mete Jaupi dhe shpjegoi se nga autopsia nuk kishte dalë asgjë. — As helmim, as goditje... As...
- Domethënë është hedhur vetë, — ndërhyri Adil Çika.
- Të paktën kjo është përshtypja e parë. Adil Çika tundi kokën.
- Ishte bërë katran, — tha ai dhe pastaj shpjegoi se sa e kishin pastruar e sa u gjend mjeku që e operoi... (ai na paskësh kërkuar edhe një tjetër që të konsultohej) kishte shkuar dita e tërë.
- Po dëshmitarët?
- Në atë gjendje s'mund t'i ballafaqonim më viktimin, — tha Mete Jaupi dhe përsëri shtoi:
- Kisha parë të djegur, po gëlqerja të bëka ibret fare...
- Po me të vdekurin ç'u bë?
- Kur mbarova punë me të djegurën, mora takim me shokët e grupit që ishin ngarkuar për të kryer formalitetet e duhura...
- Pastaj?
- Mjekët kishin dhënë urdhër të varrosej.
- Kundër porosive tonë?
- Rreziku i infeksionit... kushtet e papërshtatshme të morgut...
- Keq! Shumë keq! — tha Adil Çika.
- Kemi fotografitë!
- Me siguri ato s'do të na e japid dot atë që kërkojmë! — tha Adil Çika që u mundua të shmangete inatin. Kishin dalë në rrugë. Asfalti ishte i lagur dhe vende-vende ishte bërë rrëshqitës.
- Mete Jaupi e tërroqi Adil Çikën në trotuar.
- Këtu ndodhi! — i tha ai.
- Çfarë? — pyeti kapiteni.

— Aksidenti i djeshëm. Makina vinte drejt, — tha ai dhe zgjati dorën për të treguar drejtimin. — Kaloi kryqëzimin dhe mori në të dja-thëtë. Ja atje... Në këtë kohë i biri i atij Korbit ka ardhur në këtë drejtim me vrap dhe është përplasur me makinën këtu...

— Duhet të jetë hedhur vetë nën rrota!

— Kështu thanë dëshmitarët?

— Edhe thanë edhe s'thanë, po kjo është logjika e ngjarjeve.

Mete Jaupi tundi kokën me dyshim.

— Atëherë si i bëhet me shoferin? — pyeti.

Adil Çika nuk dha përgjigje. Të dy vazhduan rrugën në heshtje... Ecnin në trotuar për t'iu shmangur erës së ftohtë.

— Këtej ishim edhe në mëngjes, — e përmendi Metja.

— E di, — tha Adil Çika që përballë shtëpisë dykatëshe me papafingo i mbajti këmbët.

Ai e kishte përqendruar vështrimin në pamjen e jashtme të shtëpisë, e cila, edhe pse ishte më e lartë nga të tjerat, i krijoj përshtypjen e një godine të harruar që të ndillte trishtim. Ndoshta këtë pamje ia jepte errësira e natës, dritaret e myllura, grilat dhe dritat e shuara. Pa portën jeshile, lexoi numrin dhe pa vetëdije pëshpëriti: «Gjeneral-shtëpi...» Pas këtyre iu kujtua se invalidi i kishte folur edhe për një bulmetore që ndodhej përballë saj. Dhe e tërroqi Mete Jaupin drejt një dyqani të vogël, ndërtuar me mur qerpiçi. Vitrina ishte mbushur me tava kosi, enë me gjalpë dhe djathë të freskët. Mbi çati zgjatej një degë fiku ku s'kishte mbetur asnjë fletë.

— Urdhëroni! — tha kosaxhiu që dremiste pranë banakut dhe u tregoi një tavolinë që e ruante vetëm për klientë të zgjedhur.

Adil Çika e pa me vëmendje tregëtarin që kishte fytyrë të verdhë me preka e rrudha të shumta që i vareshin në gushë.

— Urdhëroni! — përsëriti ai. Në gojë s'i kish-te mbetur asnje dhëmb, kurse buzët i ishin zvogëluar e futur brenda. — Po të dëshironi, kam edhe kos me tasa, — tha tregtari, — ose me pja-ta. Kosi është i ëmbël...

— Më parë duam të mësojmë se cili është pronar i kësaj bulmetoreje?

— Unë, zoti oficer, — tha kosaxhiu i trem-bur.

— Do të na pëlqente t'ju flisnim në emër!
— tha Adil Çika.

Kur dëgjoi këto, kosshitësi shtangu. Pas kë-tyre fjalëve që më shumë se dëshirë, shprehnin një urdhër, solli në mend se qëllimisht dhe për të humbur çdo gjurmë nga e kaluara, kishte zhdukur edhe tabelën që varej mbi derën e bul-metores, me anën e së cilës, dikur, lajméronte klientët, udhëtarët dhe këdo tjetër se ky dyqan ishte pronë e...

— Grigor ma thonë, — ndërpreu mendimet si i hutuar kosshitësi.

— Grigor kush?

— Thanasi, zoti oficer.

«Nga ky hundështypur me sy të vegjël, zor se nxjerr ndonjë të vërtetë,» — tha me vete Adil Çika dhe u ul përballë Mete Jaupit.

Kolibja e kosaxhiut ishte një skutë që të merrte fryshtë, kurse llamba e varur në tavanin e tymosur ndriçonte aq dobët, sa, në errësirë, hija e plakut dukej më e vogël dhe e shpërfy-tyruar.

Kosaxhiu u vuri përpara dy tasa prej balte.

— Keni kohë në këtë dyqan? — pyeti kapi-teni.

— E kam blerë para 20 vjetësh, zoti oficer, tha kosaxhiu duke e theksuar fjalën e fundit.

— Po në atë shtëpinë kundruall kush banon?

— pyeti si pa interes Adil Çika.

— Një ish-tregtar, — tha kosaxhiu dhe bashkë me këtë përgjigje nxori edhe një grahmë të keqe.

— Ju e njihni?

— Që prej 20 vjetësh, — tha kosaxhiu.

— Si quhet?

— Zeqir, po Zeqo i kanë folur prej kohësh.

— Po mbiemrin?

— Korbi.

— C'moshë ka?

— Të pesëdhjetat duhet t'i ketë kaluar.

— Mbahet mirë?

Këta dy vjetët tuaj e kanë vrarë pak.

Adil Çika e pa tregtarin e bulmetit në sy.

— Na u bë zakon t'i quajmë kështu ne të vjetërve, — u mundua të korrigjonte veten kosshitësi.

— Po pse i quan vetëm tanët këta dy vjet?

— Mos ma vër veshin mua plakut! — u duk sikur kërkoi mëshirë.

Adil Çika, ndërsa bisedonte me shitësin e bulmetit, s'i hiqte sytë nga shtëpia dykatëshe, konturet e së cilës, përmes xhamave të vitrinës, dukeshin të deformuara dhe të errëta.

— Ju e njobhi mirë! — tha Adil Çika duke u menduar për pyetjet e mëpasme.

— E kam prej vitesh myshteri. Edhe kur kishte të shoqen, kosin ua bëja unë.

— Pse, tashti s'e ka më?

— Jo, zoti oficer! Ka disa vjet që i ka vdekur. Jeton vetëm me vajzën.

— Po djalë ka?

Kosaxhiu mezi kapërdiu pështymën.

— Kishte, zoti oficer.

— Ç'domethënë kishte?

— Sepse s'dihet nëse është gjallë ose jo. Thonë se iku me forcat e Bazit... Ju me siguri keni dëgjuar për Bazin e Canes.

— Në ç'vit?

— Në prag të Çlirimt. Ishte oficer, — tha kosaxhiu.

Adil Çikës nuk i pëlqyen fjalët e fundit. Frika, ngurimi dhe hutimi në dhënien e shpjetgimeve, i krijuan përshtypjen se kosaxhiu diçka fshihte. Ato që dëgjoi iu dukën të çuditshme dhe jo shumë të favorshme. Pastaj gjithçka iu bë se u rrëzua dhe mori tatëpjetë si guri në brinjë. Dhe mendja i shkoi te njeriu me paterica, te dëshmia e tij. «Mos e gjitha është një trillim për të fituar kohë?» — mendoi aty për aty dhe përsëri qortoi veten, që ishte treguar aq entuziast.

Mete Jaupi vuri re rrudhat që iu formuan në ballë.

— Jeni i sigurt, xhaxha?

— Janë myshterinjtë më të vjetër... Rrallë ka ndodhur që të mos marrin kos... Vetëm dje... As sot s'kanë blerë. Ja edhe dritat i kanë të fikura.

— Si duket s'duhet të janë në shtëpi.

— Mundet. Trokita edhe dje, edhe sot, po s'm'u përgjigj njeri. As ata nuk janë kujtuar për kosin.

— Ndoshata kanë shkuar gjökundi... Në fshat, ose në ndonjë qytet tjetër, — vazhdoi bisedën kapiteni jo pa qëllim.

— Me sa di unë, rrallë largohen nga shtëpia... Edhe kur të tjerët shikonin qejfin jashtë shtetit, ai kurrë s'ka menduar për të.

— E çuditshme!

— Bile as plazhin e Durrësit... As malin e Dajtit s'i njihet. Shikonte punën e tij. Tregtinë...

Adil Çika, pa lënë asnje gjurmë dyshimi e si rastësisht, e pyeti për aksidentin që kishte ndodhur një ditë më parë në afërsi të dyqanit të tij.

— Po, — tha kosaxhiu. — Dëgjova zhurmë dhe dola në derë. Ishin grumbulluar njerëz, po unë e kisha dyqanin vetëm. Pastaj dikush erdhi mori një çarçaf të bardhë për të mbuluar kufomën. Kaq di!

Adil Çika u ngrit në këmbë.

— Po hajeni kosin, zotërinj. Është taze.

Kryehetuesi mori tasin në dorë dhe gjerbi me lugën e ndritshme. Ashtu bëri edhe Mete Jaupi. Kosshitetësi po i ndiqte me sy si të numëronte lugët dhe më pas, s'i s'gjeti dot fjalë tjetër, uroi t'u bënte mirë.

Të dy ushtarakët dolën përsëri në rrugë.

Shtëpia dykatëshe vazhdonte të qëndronte e fundosur në errësirë. E ftohtë dhe e vëtmuar. Me grila të myllura që ngjanin si blanga të zeza, ose më shumë si copa suvaje të rrëzuara. E zhveshur, rrëthuar nga shtëpi të tjera përdhese me mure qerpiçi e çati të deformuara. Kjo disharmoni, pa e kuptuar, të krijon imazhin e diçkaje në ikje, si në panik... «Rreth kësaj shtëpie duket se sillet vdekja!» — tha me vete Adil Çika dhe i shkoi ndër mend të trokiste e të futej brenda. Po ai e dinte se një veprim i tillë ishte i jashtëligjshëm dhe i tha Mete Jaupit që të nesërmen të bisedonte me shokët e këshillit. Veç të tjerave do t'u interesonte të mësonin diçka më shumë për Telat Korbin.

Edhe kur kishin arritur në qendër të qytetit, pa e pasur mendjen te njerëzit që shëtisnin të ngeshëm, ai vazhdonte të rikujtonte dëshmitë e

fundit dhe të bënte krahasimin e tyre: Cila duhej të ishte e vërteta? I aksidentuar ishte i biri i Zego Korbit, Telati, ashtu siç kishte depojuar dëshmitari Astrit Pema, apo një i panjohur, siç tha kosaxhiu? «Dreq pune! Mos ai invalidi është ndonjë i njojur i shoferit që mundohet të lehtësojë fajin e tij?... Po kosaxhiu plak mos... Edhe atij s'i duhet besuar shumë. Matufi!» — e shau me mend Adil Çika. Fytyra e tij s'dihet pse i kujtoi atë të fallxhorëve.

— Na duhet patjetër që të identifikojmë femrën që u dogj në gropën e gëlqeres, — i tha Mete Jaupit pas kësaj heshtjeje të gjatë dhe hodi sytë nga qielli që ishte pastruar e kishte marrë ngjyrë gri.

4

Edhe për Astrit Pemën dita kishte qenë aq e lodhshme, sa ai kishte humbur çdo nocion të masës dhe të kohës. I ftohtë si enë e zbrazur iu bë sikur këmba, proteza dhe patericat ishin fundosur thellë në asfaltin e rrugës dhe çdo hap e hidhte me aq vështirësi, sa iu krijua përshtypja se, në vend që t'i afrohej qendrës, shtyhej më tej... Më tej. Si somnambul. Qëndroi, u mbështet pas trungut të një pishe me kurorë të dendur dhe u mundua të shkundej nga kjo peshë e rëndë. Në qill, si pellgje të dendura, ishin ngulur ca re të zeza që s'linin të dukej as hëna, as yjet. Mjegulla qëndronte pezull mbi rrugët, pemët dhe qytetin e përgjumur. Kështu iu shfaqën edhe dritat e varura pa kujdes nëpër

shtylla... Edhe afishet nëpër mure. Edhe lajmërimet për oferta tregtare, ankandet, fejesat, përshtipirtjet. Listat e të shpronësuarve. Vendimet e gjykatës ushtarake. Veshët filluan t'i buçisnin dhe në thellësinë e tyre lodronte një zë i papërcaktuar që tingëllonte si dy fjalë «po», «jo» dhe pastaj: Një, dy «Po-në» e lëshonte pafka metalike që kishte ngjitur në thembrën e kë-pucës së vetme, «jo-në», dy patericat e drunjta. Pa e kuptuar kishte kaluar urën e Lanës dhe i ishte afruar hotel «Dajtit». Pa dritat dhe sëri-shmi iu bë se dëgjoi: «Një, dy. Po, jo. Një, dy.» U drejtua nga ish-«Bar Berlini», ku dikur mbli-dhej ajka e kryeqytetit. Qëndroi para vetrata-vë. Vuri re se ai kishte mbetur pa emër, kurse, në vend të reklamës me drita, që dikur ndizeshin e shuheshin me një rregullsi automati, dalloi një blangë të zbehtë, pa ngjyrë. Ngjiti shka llët. Shtyu derën. Afshi i nxeh të dhe tymi i duhanit i ngacmuani hundën. Dikush teshtiu. Një tjetër qeshi aq fort, sa Astrit Pema qëndroi dhe pa me vëmendje. «S'e kanë me mua. As me këmbën time,» — tha dhe u ul. Në këtë lokal ai ishte ulur edhe herë tjetër, por jo si sonte... Atöherë kishte dy këmbë, ishte i ri dhe i fortë. Aq i fortë, sa mund të rrëzonte edhe një kalë.

— Urdhëroni! — i tha kamerieri e i zgjati menynë.

— Diçka të çastit.

— Tjetër?

— Një gotë verë!

— Do të prisni! — tha kamerieri.

I mjaftoi kjo kohë që të kujtonte një mbrëmje të vitit 1944 kur orkestra luante një marsh të rëndë, ndoshta edhe atë të Kryqit. Një çunak i vogël shiste gazeten e mbrëmjes. Një burrë,

kikirik dhe bajame të pjekura. Zëri i tij ishte i getë.

«Kikirik! Bajame!...»

Kënga, zérat, të bërtiturat u ndërprenë kur në sallë ishte futur tërë autoritet një oficer që mbante gradat e majorit të Gestapos. Të pranishmit ishin ngritur në këmbë. Kështu kishte bërë edhe Astrit Pema, që kishte pëlqyer mbi të gjitha uniformën e tij. Ushtaraku ishte i ri, thatanik, po me trup të drejtë, fytyrë të ashpër, nofulla të dala, syzet me rrathë të verdhë. Ai ngriti dorën dhe me zë të plotë bërtiti: «Hajl Hitler!» «Hajl» — iu përgjigjën një grup ushtarakësh që kishin zënë vend në krye të sallës. Kështu bënë edhe dy anëtarë të regjencës. Dhe tre nëpunës të bashkisë që imituan ushtarakët. Pastaj u duk se gjithçka mori pamje solemne, kushdo mund të mendonte se nuk ishte në një lokal çlodhës, po në një pritje zyrtare.

«Majori Fon Brymer,» — kishte pëshpëritur njëri, ndërkohë që ushtaraku ishte zhdukur pas perdes së rëndë në ngjyrën e arit. Astrit Pema, që kishte parë me vëmendje sytë e vegjël të majorit, fytyrën e verdhë dhe ato veprime kaq pompoze, e mori me mend se ai duhej të ishte ndonjë ushtarak i zellshëm, që çdo gjë e kishte parë me mospërfillje. Ecja, buzëqeshja cinike, uniforma dhe kryqi i hekurt që varej në gjoksin e ngushtë dukej sikur i ngrinin më lart meritat e tij dhe përbuznin njerëzit ose i bënin apel përqeshjes për ta. Astrit Pema kishte dëgjuar se në Shqipëri, në një post të rëndësishëm shërbente nipi i Geringut. «Ndoshta është ai,» — tha. Kishte dëgjuar edhe për një tridhjetëvjeçar tjetër, famën e të cilët e kishte ngritur lart vetë Himleri. Kjo kishte bërë që ai të trajtohej si ushtaraku më i privilegjuar në

Gestapo. Madje flitej se majori Fon Brymer ishte i preferuari i tij personal, që, në fillim të luftës e kishte dërguar në Poloni, më pas në Bjellorusi dhe ja së fundi në Shqipëri. Ndoshta nga kjo arsyе këtij shefi të ri, që s'e kishte mbushur muajin në Shqipëri, raportet e para të vartësve për temperamentin e këtij populli iu dukën naive dhe tepër paradoksale. Kishte ardhur me avion në Shqipëri dhe, edhe nga lartësitë, kishte formuar një ide për këtë vend të vogël, ku natyrisht, sipas tij, duhet të jetonte edhe një popull i vogël, i pafuqishëm sa mund ta mbështillje në pëllëmbën e dorës sa herë që të doje. Ta shtrydhje dhe t'i dërrmoje brinjët. Kjo logjikë e kishte bërë që të tallej me paraardhësit e tij dhe t'u mohonte bile edhe racën arjane e t'i quante thjesht një tufë idiotësh që i kishin hapur mjaft telashe Rajhut.

— Urdhëroni! — tha kamerieri dhe i vuri pjatën përpara.

Atij iu duk se ky zë i erdhi përmes viteve. E mblodhi veten. Gjithçka i përkiste së kaluarës. Buzëqeshi. U përtyp më nge dhe përsëri kujtoi copa jete nën okupacionin fashist dhe atë lavdi famëkeqe e aq të bujshme të të huajve. I lindi dëshira që verën ta shoqëronte me cigare. «Fon Brymer!» — tha dhe vuri buzën në gaz. Iu bë se tri krisma revolveri i tingëlluan sérishmi pranë veshit. Trupi i Fon Brymerit ishte shtrirë në dyshemenë e ftohtë e me lagështirë, qëndisur me mozaik. Kështu kishte ndodhur... Ai s'dinte asnje hollësi më tej. As të dhënat e nekrologjisë që u botuan të nesërmen s'pati mundësi t'i mësonte kurrë, sepse ajo lëkurë e verdhë ishte paguar shumë shtrenjtë. Atë natë u arrestuan dhe u ndëshkuau dhjetëra njerëz. Bashkë me ta edhe Astrit Pema. Prandaj s'kishte pasur

mundësi të mësonte se ç'ndodhi më tej, se cili ishte ai?

Piu edhe një gotë verë, ndezi edhe një cigarette tjetër dhe doli nga lokalit. Të ftohtët ishte shtuar dhe errësira ishte bërë e dendur. Ndjeu dridhje në trup dhe mori rrugën e hotelit, që vazhdonte të mbante po atë emër aq pompoz: «Evropa».

Zgjidhi me kujdes protezën, kundroi cungun e këmbës që i ishte skuqur dhe u fut në shtrat. Iu bë se një zë i foli... Se dikush po i shpjegonte për këtë përbysje të madhe që kishte ndodhur gjatë këtyre tre vjetëve, që kishte përfshirë strukturën dhe superstrukturën e shtetit. Klasat. Shtresat. Të mundurit dhe fitimtarët. «E pabesueshme,» — tha dhe gjithçka e krahasoi me një dramë me subjekt të ngjeshur. Pastaj përsëri ai u mundua të mbyllte sytë dhe të harronte çdo gjë. Po gjumi ishte larguar si në parfundësi dhe iu bë sikur dëgjoi një zë tjetër, gati fëmijëror, me tingëllim metalik, që i ngjiste më shumë zukamës së insektit kur përplaset pas xhamit të dritares. Ngriti kokën. «Më buçasin veshët,» — tha dhe përsëri mbështeti faqen në jastëkun e butë. Po zëri metalik s'i ndahej. Pas zërit iu shfaq i mjegullt, i përgjysmuar, me një sy njeriu me të cilin kishte udhëtuar në det, ai çast kur të dy kishin lënë sa llën e ngushtë të pasagjerëve dhe kishin ngjitur shkallët që të nxirrnin në kuvertë ku, veç errësirës, plekseshin nëpër direktë e trashë ca litarë dhe kavo, që të krijonin përshtypjen se udhëtoje në një anije që u përkiste shekujve të kaluar.

Ata kishin heshtur për shumë kohë. Dhe kjo heshtje ndoshta vinte sepse më shumë se biseda për këngët, kryeqytetet e Evropës, gjene-

ralët dhe të vrarët, aq e gjatë e aq e lodhshme
në atë udhëtim u kishte pëlqyer të shihnin ngjy-
rën e errët të qiellet dhe hapësirën e vogël
që shtrihej para syve...

Dang... Dung... Dang...!

«Pernaté kambanat! — tha. — Ç'té jené?»
Dhe përséri dang... dung...

— «Megjithatëjeta këtu ka ndryshuar shumë,» — tha dhe iu mbyllën sytë.

13 nëntor

Para mesnatës!

Kambanarit iu kujtua porosia e dom Kelës.
Zgjidhi litarin nga ganxha e trashë dhe... Dang...
Dung... Dhe përsëri u çudit ç'duheshin kambanat
kur s'kishte vdekur njeri. Kur dita e ringjalljes
së Krishtit ishte akoma larg!

Dang... Dung... «Ai fle, kurse unë...» — mur-
muriti me vete kambanari dhe, pasi lidhi litarin
pas ganxhës metalike, doli në rrugë pa bërë as
kryqin, pa lëvduar as Krishtin...

— Në Selinë e misionit të huaj:

— Tri vdekje me të vërtetë dinjitoze që do t'i

kisha zili! — u tall ai duke i lënë fjalët aq larg njëra-tjetrës sikur t'i kishte kushtuar vëmendje të veçantë zgjedhjes së tyre. Qeshi.

— Kurse ne...

— Është e kotë të vrashim mendjen për të tjerat, miku im, — tha sërisht dhe, pasi i futi krahun, i kujtoi lajmëtarit se tashti çdo gjë kishte marrë fund.

— Natyrisht, por unë...

— Pas kësaj mos u shqetëso më për asgjë... Mjafton që të jesh i sigurt në ato që the.

— Të gjitha i pashë me sy... Dy kufomat janë në morg, kurse ai... — tha dhe solli në mendje atë dialogun e çuditshëm atë natë pasi ishin larguar të gjithë. Edhe zoti deputet. Edhe gazetari N.N. Edhe Zonja A... Edhe...

«Zoti Telat?» — kishte pyetur i huaji.

«S'jeni gabuar, koleg!» — i ishte përgjigjur ai me një anglishtë të gjymtuar.

Njeriu me një sy kishte parë përkthyesin.

«Si të jetë më mirë për ju, sër!»

«S'ka nevojë, — ia kishte kthyer diplomati që tundi dorën si të përzinte mizat që të ngacmojnë në ditët e nxehta të verës.

Përkthyesi kishte ngjitur shkallët.

«Jam i autorizuar t'ju them se qendra është e pakënaqur me veprimtarinë tënde,» — gati kishte kërcënuar njeriu me mballomë në sy.

«Për gjithçka janë në dijeni kolegët tuaj, ata që ikën ditët e fundit,» — kishte sqaruar Telat Korbi me nervozizëm.

«Dokrra!»

«Do të bëni mirë të lexoni gazetat!»

«Qendra kërkon të dijë për misionin «R»...»

«Ai ka kohë që ka dështuar... Edhe për këtë janë në dijeni kolegët tuaj.

«Po me grupin terrorist?»

«Veprime të papërfillshme!»

«Ju jeni mbyllur si miza në qyp.»

«Atë natë që zbritëm na kishin rrëthuar... Në përpjekje së bashku me dy tanët, mbeti i vrasë edhe një kryetar i këshillit antifashist nacional-çlirimtar. E kuptioni?»

«Ç'heroizëm!»

«Për mua ishte tronditëse. Është e kuptueshme se më kërkojnë.»

«Pastaj?»

«Lavdi babait që më strehoi dhe më mësoi si të stërvitem. Ngjis dhe zgres shkallët nga pafingoja në bodrum dhe anasjelltas pesëdhjetë herë në ditë dhe harroj se ata do të më gjejnë sikur të fshihem edhe në bri të buallit.»

«Ç'marifet, — kishte qeshur diplomati. — Kurse qendra pret çastin e organizimit. Çastin për zbarkim.»

Telat Korbi pas këtij gjykim i kishte qeshur.

«Idiot!»

«Keni të drejtë, sër!»

— Tani do të më pëlqente të pinim diçka të fortë, — tha në gjuhën e tij zoti S. që la driten dhe e ftoi lajmëtarin në dhomën e ngrënies. Hapi kanatin e bufesë, nxori një shishe, dy gota që i mbushi në heshtje dhe me gjest shumë solemn i përplasi me njëra-tjetren: — Ju keni një proverb të bukur, me sa di unë... Kur dy vezë...

— Po, — tha lajmëtar i vetëm tashti që kishte zgjatur gotën i shkoi mendja për të zgjepreu çdo mendim kur pa të huajin që rrëkelleu gotën e dytë me fund. — Aktivizimi i kosaxhiut do të ishte i sëkëlldisur, — tha pa ia ndarë sytë trupit të drejtë dhe elegancës së diplomatis, i cili, ndryshe nga tri net më parë, dukej

tepër i freskët dhe i gjëzuar. Bashkë me këto ai zgjoi në kujtesë edhe atë bisedë të frikshme, e cila kishte pasur në qendër planin për zhdukjen fizike të Telat Korbit. Dhe nga variantet e mundshme, zotit S. i kishte pëlqyer helmimi. «Një ampulë kosshitetësit dhe çdo gjë merr fund...» — kishte thënë ai.

Pa fshehur shqetësimin dhe frikën që e kishte munduar së tepërmë, lajmëtarë pyeti:

— Po pastaj ç'do ta bënин trupin e tij?

— Pini, ju lutem! — i tha diplomati.

— Edhe versioni i vrasjes nuk ishte i lehtë!...

Zhurma e armës. Njerëzit e shtëpisë, — tha.

— Okej!

— Më i nxituar ishte mendimi që ta «shë-tisnim» natën me makinë, — dhe përsëri kujtoi atë çast pas mbledhjes kur njeriu me një sy, pasi kishte përdorur fjalën «idiot», i kishte futur krahun Telat Korbit dhe, gjoja për ta zbutur, e kishte pyetur: «Nuk do t'ju pëlqente një shëtitje me makinë në këtë orë të natës?

«Jam i lodhur, sër.» Pastaj e kishte përshëndetur pa përfillje dhe kishte ngjitur shkallët me vrap si të kuptonte qëllimin e të huajit.

— Edhe në këtë rast unë akoma s'e kam të qartë se ç'kishte menduar ta bënин trupin e tij.

— Ushqim për peshqit! — tha mister S. — Çdo lumë derdhet veç në det, — dhe ktheu përsëri gotën me fund. — Ky ishte urdhër... Ma thanë apo arrita... E konstatova edhe vetë... Qendra dyshon se, për të ruajtur lëkurën e tij, mund t'i ketë zhdukur ai dy të tjerët. Prandaj edhe zhdukja e tij ishte... E domosdoshme. Ndryshe edhe ndonjë skandal mund të pritej prej tij, — përfundoi mister S. duke e rritur theksin hundor të fjalëve si të thoshte: «Kështu do të ndodhë me këdo që nuk zbaton urdhrat e Qendrës.»

Njeriu që dëgjonte u drodh.

Dang!... Dung!... Dang!...

— *Dëgjon?*

— *Prifti ynë nuk i harron porositë.*

— *Edhe ata të dy s'besoj t'i tremben natës.*

— *Jo, zotëri. Janë paguar sa s'u vlen lëkura.*

— *As varrezave?*

— *Sigurisht. As varrezave. Çdo gjë do të kryhet pas mesnate... Pasi të heshtin kambanat...*

— *Okej!*

Ndërsa në redaksinë e gazetës N.N. po vriste mendjen se si do të pritej artikulli «Lufta kundër karkalecit», në shtëpinë në qendër të kryeqytetit deputetin akoma s'e kishte zënë gjumi. I gëzohej ligjërâtës që do të mbante në sesionin e ardhshëm të legjislaturës së S... që e kishte titulluar: «Të mos armiqësojmë më tej të mundurit!»

Në burg i pandehuri Alush Boga po përgati-tej rishtas të luante rolin e të sëmurit psikik.

Në këtë orë një pjesë e kasapëve të qytetit kishin filluar gatimin e suxhukëve me mbeturinat e mishit dhe me të brendshmet e bagëtive, pa pyetur për rrezikun e helmimit të popullatës. Pa pyetur për butulizmën... Kurse ca bulmet-shitës nuk e kishin mendjen as te dangu, as te dangu. Ata po zinin kosin. I hidhnin ujë qu-mështit.

Nga «Bashkimi»

(Faqja e parë)

Në telegramet e shumta që punëtorët e krahut e të mendjes, fshatarët e ushtarakët i drejtojnë Komitetit Qendror të P K SH premtojnë se do të vënë të gjitha fuqitë e tyre për kryerjen e detyrave që cakton Partia duke ndjekur me besnikëri rrugën e saj të lavdishme...

..... Nga komunistët e Elbasanit. Nga punëtorët e minierave të Selenicës e të katundit Selenicë Nga Divizioni i Këmbësorisë organizata e partisë e qarkut të Beratit Regjimenti i Shtatë i Divisionit të Tetë

KAPITULLI III

1

— Nga ekspertiza që iu bë kufomës së dje-
gur, — shpjegoi oficeri ekspert, një djalë i ri
me flokë kaçurrel, që mbante gradën e nënto-
gerit, rezulton, — ai shfletoi procesverbalin, mo-
ri frymë thellë si ata që vuajnë nga astma dhe
filloi të lexonte: — Viktima u dërgua në spital
në orën 11 të ditës së djeshme. Pasi e pastruan,
u bë gati për ndërhyrje në orën 15. Autopsia
mbaroi në orën 17. Përfundimi: Viktima është
femër, rrëth të tridhjetave. Bionde. Mjekët eks-
pertë konkluduan se viktima ose është hedhur
me dashje në gropën e gëlqeres, ose ka rënë
aksidentalisht, ose dikush e ka shtyrë pa i shkak-
tuar plagë. Shenja helmimi, goditje ose të ndon-
jë veprimi tjetër të jashtëm, s'ka. As ndonjë
goditje psikike. Është një vdekje normale nga
ana patologjike. Pas autopsisë u thirrën dësh-

mitarët për të identifikuar viktimën. — Këtu nëntogeri heshti pak e pastaj filloi të lexonte me ndërprerje të shpeshta:

— Aliko Gjika. Vjeç 40. Pa punë. Fqinjë e viktimës prej 15 vjetësh. E njohu viktimën sa e pa, lëshoi një klithmë dhe fshiu hundën me shami. Ne e pyetëm: «Si e quajnë?» «Drita», tha ajo. «Drita kush?» e ripyetëm. «E Zeqo Korbit», u përgjigj Aliko Gjika.

Adil Çikës i bëri përshtypje që ngjarjet e dy ditëve të fundit lidheshin me emrin e Korbajve.

— Pas tij u thirr dëshmitari i dytë. I ri rrëth të tridhjetave. Punëtor. Fqinj i shtëpisë dykatëshe ku u gjet kufoma. Me qëndrim të mirë politik. Deklaroi: «E njoh. E quajnë Drita. Është e bija e Zeqo Korbit.» Kur e pyetëm nëse ishte i sigurt, ai u betua për ç'kishte të gjallë dhe të vdekur. «Kemi qenë së bashku gjashtë vjet në shkollë.» Tha dhe diçka tjetër që s'e kam shkruar, shoku kapiten!

— Çfarë? — e pyeti Adil Çika. Oficeri ekspert afroi gojën pranë veshit, të kryehetuesit dhe pëshpëriti ngadalë:

— Ishte femër që i pëlqenin meshkujt e bukur...

Adil Çika e pa me vëmendje oficerin.

— E lamë të lirë edhe atë, — tha oficeri ekspert, — dhe thirrëm dëshmitarin e tretë, Kadri Bylykun, burrë i pjekur që e ka shtëpinë pranë kopshtit të shtetëzuar. Ai deklaroi të njëjtat gjëra. Prandaj e pamë pa vend të zgjateshim. Përfundimi: Viktima quhet Drita Korbi. E pamartuar. Është e bija e tregtarit Zeqo Korbi. Arsyet pse është hedhur në gropën e gjelqeres nuk dihen, mbeten në kompetencë të hetuesisë.

Kapiteni i hodhi edhe një sy ekspertizës që ishte shkruar pastër e me kujdes, mbushur me emra dhe dëshmi. Në çdo radhë pothuaj përmendej emri «Drita» dhe mbiemri «Korbi»... Në fund, i veçuar, ishte emri i oficerit ekspert dhe nën të firma e zgjatur. E palexueshme.

— Me sa mora vesh, kufomës i është gjetur në qafë një kryq! Është e vërtetë? — pyeti Adil Çika pasi kishte dëgjuar gjatë gjithë kohës në heshtje oficerin ekspert.

— Më se e vërtetë, shoku kapiten.

— Po si shpjegohet?

— Duket floriri është i fortë dhe gëlqerja nuk vepron mbi të, — tha me buzën në gaz oficeri ekspert.

— S'e kisha fjalën aty, shoku nëntoger, — tha Adil Çika. — Po, me sa di unë, kryqin e mbajnjë vetëm të krishterët, besimtarët e Krishtit, apo jo?

Oficeri ekspert u step dhe i ndryshoi ngjyra në fytyrë. Kjo hollësi nuk i kishte shkuar ndër mend.

Pas tij në zyrë hyri Mete Jaupi.

— Kam kohë që të pres! — i tha Adil Çika dhe e ftoi që të ulej pranë tij.

— Telashe! Telashe pa fund — u ankua Mete Jaupi.

— Si duket paske kaluar ditë të vrenjtura!

— Në mëngjes, sipas porosisë, shkova në këshillin popullor të lagjes. Prita sa erdhi kryetari dhe së bashku shkuam në shtëpinë nr. 13. Trottëm, po s'na u përgjigj njeri. Përsëri trokitëm... Pritëm, po përsëri asnjeri. Unë i vura supin portës. E shtyva. U hap pa vështirësi. U futëm në një korridor të gjatë. Të errët. Shoku kryetar i këshillit thirri në emër të zotin e shtëpisë, po përsëri s'morëm asnje përgjigje. «Ç'të

jetë?» tha ai. «Dreqi e di,» i thashë. Kryetari me hamendje gjeti çelësin e dritës dhe pas korriderit u ndriçuan edhe një palë shkallë mermari. Ai i foli në emër të zotit të shtëpisë, po përsëri hic. Vendosëm të ngjiteshim lart. Shoku kryetar përpara, unë prapa. Hapëm derën e korridorit në katin e dytë dhe u futëm brenëda... Po ç'të shihje? Hata! Rrëmujë e plotë. Ngrimë të dy në këmbë.

— Ndize! — i tha Adil Çika kur vuri re shqetësimin në fytyrën e tij. Edhe tregimi ishte gati-gati i cunguar.

— Salloni ishte kthyer në një katua kuajsh. Mbi tavolinën e madhe në formë vezake e me këmbë të trasha, fundi i të cilave ngjasonte me putrat e ariut, kishte gjithfarë pjatash me gjellë që binin erë thartirë, meze dhe sallatë që kundërmonin era uthull, copa buke të lagura që kishin zënë myk... Shishe të boshatisura, rrëzuar e derdhur mbi mbulesën e bardhë, në dysheme, mbi qilimin tërë ngjyra. «C'është kështu,» u habit kryetari i këshillit. Unë ngrita supet dhe kalova me kujdes përmes karrigeve pa prekur asgjë me dorë. Dy poltronë ishin rrëzuar, kurse mbi një tjetër të gjatë, vëç blangave të errëta që kishte lënë vera e derdhur, gjeta edhe këtë, — tha Mete Jaupi dhe nxori nga xhepi diçka të mbështjellë me letër që ia zgjati kapitenit. — Më duket se është një ampulë me helm.

Adil Çika e mori në dorë, shpështolli me kujdes mbështjelljen dhe e afroi pranë syve.

— Vura re se edhe në mure ishin përplasur pjata, dhe shishe që kishin lënë gjurmët e tyre. Radioja vazhdonte të qëndronte e ndezur dhe kohë më kohë bënte gërr...gërr... As atë s'e tra-zova. Një tablo me kornizë të trashë në ngjyrë

ari që të kujtonte vjeshtën, kishte rënë përdhe. Xhami i saj ishte përzier me copat e porcelanit, pjatave dhe shisheve të thyera... sirtarët e bufesë dhe të dollapit ishin të hapur... Ishim të përqendruar në këtë rrëmujë, kur dëgjuam derën e ballkonit që u përplas nga era. E hapa me kujdes. Në sallon hyri drithë më shumë dhe çdo gjë u duk më e plotë... Kryetari numëroi katër gozhdë gati të ndryshkura, që tregonin se dera duhej të kishte qenë e gozhduar. Dukeshin edhe gjurmët e levës që e kishin shqyer... Kjo më habiti së tepërmë dhe dola në ballkon. Pashë ca parmakë e shkallë të copëtuara dhe nën të gropën e gëlqeres.

— Po! — tha Adil Çika dhe ferkoi mjekrën.
— Mos Drita Korbin e kanë hedhur nga ai ballkon?

— Më duket diçka e pamundur...
— Ose është hedhur vetë!
— Kjo do të ishte akoma më e vështirë.
Gropa është në të djathë të ballkonit... Tepër larg për një veprim të tillë...
— Po si duhet të ketë ndodhur?

— Kryetari i këshillit më zuri për krahu: «Shiko» më tha. U afrova. Mbi një poltronë pa shë njolla gjaku... Edhe mbi qilim kishte njolla të tillë... U pamë në sy me kryetarin dhe së pari hymë në një dhomë që, ndryshe nga salloni, kundërmonte era parfum. Çdo gjë ishte në rregull. Krevati. Dollapi. Perdet e myllura. Tavolina. Aty duhej të flinte një femër. Një krevat tek. Po më shumë se krevati këtë përshtypje ta linin veshjet... Kombinezoni... Rroba e natës. E lamë çdo gjë siç ishte dhe hymë në dhomën tjetër... Hata. Ngrimë të dy në këmbë. Mbi krevat ishte shtrirë një kufomë.

Adil Çika, që gjatë gjithë kohës vetëm kishte dëgjuar në heshtje, u mat të pyeste.

— Ishte zverdhur. Sytë dhe goja i kishin mbetur hapur. Me të vërtetë llahtari! Nga flokët e verdhë, më shkoi mendja se duhej të ishte Zeqo Korbi. Pyeta kryetarin dhe ai vërtetoi dyshimin tim.

Kapiteni u ngrit në këmbë. Ai do të donte që të gjitha sa dëgjoi të mos ishin të vërteta.

— Tri ditë, tri ngjarje, — tha ai dhe fytyra e tij mori pamjen e njeriut kur mërzitet rëndë.

— Plagën e kishte në kokë, ja këtu! — dhe Mete Jaupi tregoi vendin ku e kishte marrë plumbi. — Revolveri i kishte ngrirë në dorë.

— Vetëvrasje?

— Këtë përshtypje të krijonte! Po më çuditi diçka tjetër. Veç gjakut që kishte ngrirë në ftyrën e tij dhe mbi kuvertën e bardhë, pika të tilla gjetëm edhe mbi pllakat në hyrje të dhomës. Edhe mbi sixhadenë e shtruar. Bile edhe në cepin e mbulesës së tavolinës. Pa i thënë gjë kryetarit, aty për aty gjykova. Kjo s'mund të ndodhë kurrë. Nga erdhën këto njolla kur Zeqo Korbi të linte përshtypjen se aktin e vetëvrasjes e kishte kryer i shtrirë në krevat dhe në një pozicion krejt normal?... Po ampula në poltronë?

Adil Çika, kur dëgjoi dyshimin e Mete Jaupit, e mori përsëri në dorë ampulën që ngjasonte me një vëmje të pazhvilluar dhe, duke u përqendruar mbi stampën e ftohtë, gjykoi me vete se Zeqo Korbi, duke pasur këtë mjet vdekjeprurës, pse preferoi më shumë armën?

— Pastaj ajo dera e ballkonit, — vazhdoi Mete Jaupi duke dashur të shprehte një dyshim tjetër, po Adil Çika, të cilit pohimi i eksperțizës dhe ai i fqinjëve të Zeqo Korbit i ki-

shtet krijuar një lloj pezmi, bëri shenjë me dorë si të thoshte: Mjaft! S'dua të dëgjoj më përkëtë ngjarje. Hapi dosjen dhe i zgjati Mete Jau-pit dokumentet e fundit.

— Ka mundësi! — tha ai si mbaroi leximin e tyre.

— Cila është mundësia? — pyeti Adil Çika.

— Që e djegura në gropën e gëlqeres të jetë Drita Korbi.

— Po ky përfundim duhet të ketë një arsyesh?

— Gjithë ajo rrëmujë flet përdicë. Pastaj ju shpjegova, shoku kapiten, se derën e ballkonit e gjetëm gjysmë të hapur. Të shqyer.

— Ti mendon se ajo nuk është hedhur nga ballkoni!

— Kjo është e pamundur.

— Aq larg ishte gropat?

— Jua thashë. Vetëm në qoftë se më parë ka rënë në kopsht dhe pastaj në gropë.

— Po ekspertiza s'vërteton asnjë gjymtim ose thyerje.

— Dyshoj, se pse duhej të shqyhej dera e ballkonit, — tha Mete Jaipi.

Pas këtij arsyetimi ata shkëmbyen cigare.

— Duke kontrolluar dhomat... (Mete Jaipi heshti për një çast.) — E di sa dhoma ishin, shoku kapiten?... Aq sa mund të strehohej një kompani e tërë. Bile edhe një batalion... Pra, duke kontrolluar dhomat, vura re se në atë shtëpi kishte ca gjëra që të bënin përshtypje, dome-thënë.

— Çfarë? — pyeti Adil Çika që nuk i pël-queu shprehja «domethënë», të cilën Metja e përdorte pa vend herë pas here.

— Kur u ngjitëm në papafingo, pamë veshje nga më të çuditshmet... Të gjitha ushtarakë... Angleze... Gjithashtu gjetëm edhe një çan-

të shpine. Edhe ajo angleze me njëqind xhepa. Edhe atje një krevat i vëtmuar, që të linte përshtypjen se dikush ka fjetur deri natën e fundit. Po mbi të gjitha na çuditi një automatik varur mbi kokën e krevatit, një automatik xhedit i ri...

— I çfarë marke? — pyeti kapiteni.

— Anglez!... I gatshëm për t'u përdorur...

Adil Çikës, ndërsa dëgjonte kolegun, i shkoi mendja te deponimet e invalidit, kurse «ai kosaxhiu duhet të jetë ashtu... tamam një plak i matufepsur», tha me vete.

— I çuditshëm m'u duk edhe bodrumi... Një dhomë e errët, e mbushur me ca karrige dhe poltrona të vjetra. Një tavolinë... Bishta cigaresh pa hesap. Gjithçka që të krijonte dyshim...

— E pyete për këto kryetarin e këshillit?

— Po! Por ai nuk ishte vendas... Dinte pak gjëra për këtë familje. «Tregtar si gjithë të tjerët, tha. I tatuar disa herë dhe asgjë më shumë...» Më falni, shoku kapiten, po në bisedë e sipër kryetari më tha se, me vendim të organeve të pushtetit, Zeqo Korbit i ishte komunikuar urdhri që të lironte katin e dytë të shtëpisë bashkë me papafingon.

— I shtetëzohej? — pyeti Adil Çika.

— Po. Dhe i jepej me të drejtë banimi një punëtori, të cilin i është djegur shtëpia gjatë luftës.

— Kur ishte marrë ky vendim?

— Nuk e di... Nuk e pyeta.

— Po komunikimi kur ishte bërë?

Mete Jaupi ngriti supet dhe u skuq.

Adil Çika, pa i rënë në sy, u mendua duke rrahuar gishtërinjtë mbi syprinën e tavolinës.

— Duhet dërguar grupi i ekspertëve, — tha

Mete Jaupi që e kishte kuptuar se shumë gjérave s'u kishte dhënë dot zgjidhje.

Kapiteni rrrotulloi dorezën e telefonit.

— Po për të birin?

— Nuk e pyeta.

— Mos kemi të bëjmë me ndonjë bastisje?

— Mundet! — tha Mete Jaupi dhe përsëri qortoi veten: «Ngjarjen dhe faktet duhej t'i kisha vlerësuar më shumë,» — tha me mend dhe, i nervozuar, bëri një lëvizje të pavetëdijshme, sikur donte të çlirohej nga diçka që iu duk se e shtrëngonte brenda gjoksit.

Adil Çika, që ia njihte huqet, u ngrit dhe e mori për krahu.

— S'e kuptoj pse ndodh kështu me mua, — tha Mete Jaupi që zemërohej shpejt dhe në këto raste ishte gati që ta fillonte çdo gjë nga e para.

— Shtëpinë e mbyllët?

— Po. Vec kësaj bisedova me shokët... Kemi dërguar njerëz ta ruajnë.

— Pa rënë në sy!

— Doemos pa rënë në sy! — përsëriti Mete Jaupi.

2

Pasi doli Mete Jaupi, shefi i hetuesisë shflettoi edhe një herë dosjen faqe për faqe. Rikujtoi përbajtjen, rrethanat, përfundimet e ekspertizës, përshkrimin e fakteve, thëniet e dërrast, ishin shkruar keq, shpejt e me një shkrim

të nxituar, vende-vende të palexueshëm, fotografët që të ngjethnin mishtë dhe çdo gjë tjetër e sidomos shpjegimet e fundit që dha Mete Jaupi. Çdo gjë që kishte të bënte, siç kishte fillouar ta quante ai, me «çështjen Korbi». Vrasje dhe vetëvrasje kishte pasur edhe herë tjetër, por ato kishin qenë ordinere dhe gjykimi i tyre s'kishte kërkuar kaq shumë punë e kohë. Nga ngjarjet më të komplikuara që kishte hetuar muajin e fundit, Adil Çika kishte konsideruar atë të Refije Dukës, që kishte mbytur të shoqin në pus me qëllim që të trashëgonte pasurinë e tij. Kur se kjo i dukej si dicka pa fillim e fund dhe u ngrit në këmbë. Si zakonisht e përshkoi disa herë kryq e tërthor dhomën, ndezi dhe shoi cigare dhe, pasi e gjykoj edhe një herë ngjarjen, mendoi se duhej informuar e konsultuar për fazën ku kishin arritur hetimet me shefin e seksionit të punëve të brendshme. I sistemoi edhe një herë me mend të gjitha ngjarjet, pastaj shkroi:

Më 12 nëntor, rreth orës dy pasdite shtypet aksidentalisht... Pasi shënoi emrin, moshën, thëni e dëshmitarëve e të dhënat e tjera që tashmë lexuesi i njeh, shtoi: Mbetet për t'u sqaruar: a) Cili është i aksidentuari. (Është apo s'është i biri i Zeqo Korbit?) b) Është aksident automobilistik apo hedhje me dashje në rrotat e makinës. Dhe pas këtyre përsëri në kllapa, me laps të kuq, kryehetuesi shënoi inicialet e emrit të shoferit (K.T.).

13 nëntor Mëngjes. Një brigadë ndërtimi gjeti të djegur Drita Korbin. Duhet sqaruar: a) Ç'domethënje ka kryqi i varur në qafë? Kush e hodhi në gropën e gëlqeres ose ç'motive e detyruan të hidhet, në qoftë se ka ndodhur kështu? Duke shtruar pyetjen e dytë, Adil Çika kujtoi se

akti i vetëvrasjes nuk është një rëndomësi që mund të kryhet nga secili dhe në çdo kohë... Ose sa herë që njeriu ndodhet ngushtë. «Ai është një veprim që nxitet nga motive të forta psikike, — mendoi ai, — diçka e tillë që duhet t'i ngjasë çmendurisë, ose së paku humbjes së logjikës.»

14 nëntor Përshkroi rrethanat në të cilat u gjet zoti Korbi. Pra, problemi s'është kaq i thjeshtë, — pëshpëriti. Dhe pas këtij mendimi çdo gjë iu duk se u errësua. «Po sikur shefi i seksionit të pyesë: Ç'mendoni ju, shoku Adil?» Vrau mendjen gjatë, shtolli dhe pështolli edhe një herë të gjitha faktet, po përsëri nuk gjeti qoftë edhe një pikë mbështetjeje nga duhej të nisej për të motivuar këtë ngjarje kaq ngjethëse. I erdhi inat me veten. U ngrit. Eci përsëri nëpër dhomë. Piu cigare dhe përsëri futi dorën midis flokëve. «Po ta marrim më shtruar dhe më me gjakftohtësi çështjen,» — tha dhe shënoi:

Versioni i parë: Sipas dëshmitarit Astrit Pema dhe 3 fqinjëve të Zego Korbit, vërtetohet se dy nga viktimat janë vëlla dhe motër. Sipas kësaj dëshmie duhet pranuar që, ose të tre pjesëtarët e familjes kanë vrarë veten. (Po si? Pse duhet të ketë ndodhur kjo?...) Ose, ndryshe, dikush tjetër ka vënë dorë mbi vajzën dhe të atin. Duke gjykuar mbi këtë mundësi, Adil Çikës iu kujtuan deri në hollësi shpjegimet e Mete Jaupit. Sipas këtij versioni, Telati ka ikur nga frika. Jo. Nga tmerri ua ka mbathur këmbëve me vrap dhe ka çarë rrëmbimthi mes njerëzve. Ka rrëzuar edhe trastën e plakës dhe, nga gëzimi që ka shpëtuar (ose nga tronditja), s'ka vënë re makinën dhe është gjendur në rrotat e saj... Po edhe kështu s'mund të ketë ndodhur plotësisht. Si duhet shpjeguar vetëvrasja e Zego Korbit? Mete Jaipi tregoi edhe vendin e plagës... Edhe

pozicionin e dorës që mbante armën... Kaq gjak-
ftohtë ky zoti Korbi?

Versioni i dytë: Në qoftë se i aksidentuari
nuk është i biri i Zeqo Korbit (mbështetemi në
ato që tha koshiteti), duhet pranuar se ai, do-
methënë njeriu që u shtyp, duhet të jetë autor i
i të dy kimeve. «Me siguri ndonjë vagabond.
Hajdut ose grabitës,» — tha ai dhe kujtoi se në
këto vite të tillët s'kishin munguar. Ashtu siç nuk
mungonin kontrabandistët e matrapazët. Bile
edhe vrasës që bridhnin qytet më qytet për të
humbur gjurmët. Mos edhe i aksidentuari ishte
ndonjë i tillë? Grabitës dhe vrasës? A nuk tha
Mete Jaupi se kudo në dhomë kishte njolla
gjakut? Pra, si duket, së pari ai duhet të jetë
përlleshur me vajzën, që duhet të ketë hyrë pa-
pritur! E ka gjakosur dhe pastaj, për të humbur
gjurmët, e ka hedhur në gropën e gëlqeres. Edhe
zbërthimi i derës së ballkonit për këtë flet. Ai
ka përdorur levën për ta shpërthyer dhe mandej
është futur brenda. Kjo tregon se ai i ka njo-
hur mirë të fshehtat e shtëpisë... Po, me sa du-
ket, në këtë kohë, pa pritur e pa kujtuar ka ar-
dhur i ati, Zeqo Korbi (ai mund të ketë qenë
edhe në dhomën e tij). Mundet që edhe të jenë
përlleshur dhe më në fund, falë forcës dhe mo-
shiës së tij, e ka vrarë edhe atë dhe, për të hum-
bur gjurmët, i ka vënë në dorë revolverin. Këtë
dëshmojnë shpjegimet e Mete Jaupit. Pikat e
gjakut nga salloni, kishin vazhduar deri në kre-
vat... Pastaj në qetësi ka rrëmbyer ç'i është da-
shur, ka dalë në rrugë dhe nga frika ua ka mba-
thur. Ka rrëzuar trastën e plakës... Po, nga gë-
zimi që i ka shpëtuar rrezikut, s'ka vënë re
makinën dhe...

Versioni i tretë: Sipas këtij versioni duhet
dyshuar se autor i krimtit mund të jetë edhe As-

trit Pema. Motivi: Ndonjë armiqësi e vjetër ose diçka e përafërt. Këtë e vërtetojnë paksa edhe fjalët e tij: «Keni pasur ndonjëherë inat?»... Ose kur u pyet se ku ishte kur ndodhi aksidenti, ai u përgjigj: «Duhet të zbrisja shkallët... ose në korridor»... C'donte ai në shkallët e Zeqo Korbit, ose në korridorin e tij? Po revolveri?» — pyeti përsëri dhe kujtoi se në fund të bisedës ai kishte dorëzuar një armë. Përsëri shkroi: «Nga kontrolli që iu bë armës, u konstatua se ajo nuk është përdorur. Krehri i kompletuar me fishekë. Tyta e pastër dhe e vajisur. Megjithatë, ky është versioni më i lëkundur, — tha me vete Adil Çika. — Po të ishte ai autor i krimtit, pse duhej të tregohej kaq i gatshëm sa të vinte të parqitej që me ftesën e parë në sektionin e punëve të brendshme? Natyrën e kriminelit nuk e karakterizon ndershëmëria dhe sinqeriteti, përkundrazi, fshehja e krimtit, mohimi, ikja. Po kryqi? Po ampula? Po automatiku dhe pajisjet angleze që u gjetën në papafingo?»

Versioni i katërt: Pasi shkroi këto fjalë, la penën mbi tavolinë, mbështeti mjekrën mbi dorën e djathtë dhe u mendua. Formuloi pyetje... Përgjigje... Pastaj qdo gjë iu duk se u përbys. Ai druhej se mos dëshira e tepruar, vullneti dhe hamendjet e futnin çështjen në ndonjë qorrso-kak, prej të cilit do ta kishte vështirë të dilte. Në të njëjtën kohë ai i trembej edhe ftohjes, nënvliftësimit të fakteve. Në këtë rast procesi do të mbetet i zbehtë, i përgjysmuar, në mos në mes të rrugës, gati si jetim dhe i braktisur. Dhe përsëri, duke vlerësuar ngjarjen, e cila sipas gjykit të tij nuk duhet të ishte aq e thjeshtë sa dukej në pamjen e parë, u ngrit dhe shkoi te dritarja. Ndezi cigare dhe pa qytetin, që, ndryshe nga ditët e tjera me mjequll dhe shi, ishte

mbuluar nga drita e fortë e diellit. Ai thithi edhe një herë cigaren dhe mendoi se duhej kontrolluar shtëpia me imtësi. «Kjo do të na japë mundësinë të njihem me gjithçka, që nga marrëdhëniet intime e deri te të fshehtat e kësaj familjeje, të cilat pa dyshim do të hedhin dritë mbi çështjen. Pastaj duhen pyetur të afërmit, të njobur dhe kushdo që ka hyrë e ka dalë në shtëpinë e tyre. Vetëm kjo do të sqarojë cili është i aksidentuari. Nga erdhi? Pse erdhi? Kur erdhi dhe pse duhej të zgjidhte këtë fund? Pse u hodh, ose kush e hodhi në gropën e gëlqeres Drita Korbin? Pse vrau veten, ose kush e vrau Zeqo Korbin?» Dhe pas këtyre pyetjeve Adil Çikës përsëri i shkoi mendja tek Astrit Pema. Ai duhet të dijë, në mos tërësisht, pjesërisht për këto vrasje, ose vetëvrasje... Po kosaxhiu? Pa ç'kishte shkruar. Faqet ishin mbushur me porosi, emra, iniciale, shigjeta që tregonin lidhjen ose afërsinë e faktave, me kuadrate dhe fjalë të lëna përgjysmë, shkruar me një shkrim të imët dhe të ngjeshur. Dhe përsëri pas tyre shënoi data të tjera, emra, hoqi shigjeta dhe rrëthoi në kuadrat paragrafe të tëra. «Fillimi, ndonëse nuk duket gjökundi, duhet kërkuar e gjetur me kujdes, — këshilloi veten, — ndryshe e vërteta do të groposet bashkë me kufomat...»

Ra zilja e telefonit. Mete Jaupi e ftonte nga ana tjeter e telit që të hanin drekë së bashku. Zëri i tij i largët i kujtoi atë vendimin e këshillit popullor të lagjes për shpronësimin e dy kateve të shtëpisë së Zeqo Korbit dhe, pasi e shënoi edhe këtë fakt, e mbylli në një kuadrat më vete dhe e nënvizoi me laps të kuq. «Mos këtu është burimi i të gjithave?» — pyeti dhe u ngrit. Te dera pa shefin e seksionit të punëve të brendshme. Ishte burrë që i kishte

kaluar të tridhjetat. Me fytyrë të gjerë, sy të kaltër, flokë të zez që kishin filluar t'i rralloheshin. Njeri i qetë prej natyre, që fliste zakonisht pak dhe dëgjonte me vëmendje. Adil Çika ishte njohur me të vetëm pas lufte. Ai kishte gradën e majorit dhe përvojë në punën e Sigurimit, sepse që gjatë luftës kishte punuar në organet e informacionit...

— Urdhëroni, shoku major! — e ftoi Adil Çika dhe i afroi informacionin e shkruar.

Shefi i seksionit e lexoi pa zë, ngadalë dhe me shumë kujdes. Herë pas here pyeste përfjajt që s'kuptonte, përfshigjetat, emrat ose edhe përshtetje më të plota. Adil Çika bashkë me shpjegimet s'ia ndante së fytyrës së tij, që herë ngrysej, e atëherë rrudhat i bëheshin më të dukshme në ballë, herë vinte buzën në gaz. Në këto raste Adil Çikës i shkonte mendja se ndoshta ai qeshte me naivitetin e tij.

— Shumë qartë! — tha së fundi majori. — Këtyre përfundimeve duhet t'u shtonit edhe dy fakte të tjera. Ndoshta ju hyjnë në punë!

Adil Çika mori penën të shkruante.

— S'ka nevojë. Janë dy informacione të plotë mëngjes në ish-kopshtin e Zego Korbit punëtorët e ndërtimit kanë gjetur një orë xhepi, kurse letre të shpërndara nga era andej-këtej e rrëzë murit.

Ndërkohë që fliste ai nxori nga xhepi një orë me qostek të gjatë e kapak të verdhë që të linte përshtypjen se ishte prej ari.

— Informacionin e dytë e sollën dy varrështë hapur natën... Ia bashkangjisni dosjes dhe kërkoni autorët e tyre.

— Si urdhëron!

— Mos u shqetësoni, — tha majori kur vuri re se kryehetuesi ishte prishur në fytyrë. — Në punën tonë nuk evitohen edhe të papriturat. Tashti shkojmë të hamë drekë. Me siguri që je lodhur.

Edhe kur dolën në rrugë, Adil Çikës s'i hiqeje mendja nga dy faktet e fundit. «Ja pra, — tha, — asgjë s'duhet marrë që në fillim me entuziazëm. Në punën tonë, ajo që sot na duket si diçka e rastit, e parëndësishme, e zbehtë si hije, nesër mund të kthehet në një fakt-bazë, në argument bindës e me shumë dobi...» — tha ai dhe përsëri kujtoi informacionin e fundit. Qëndroi përballë vendit ku afishoheshin lajmërimet. Një shpallje që sapo ishte ngjitur, u drejttohej të gjithë atyre personave që dispononin kazan për zierje rakie, të cilët brenda datës 20 të muajit në vazhdim duhet të bënin deklarimin e tyre pranë seksionit të financave (zyrës së tatimeve). Shpallja kërkonte që deklarata të vërtetohej nga ana e këshillit të lagjes dhe të përmبante emrin dhe mbiemrin e zotërueshit të kazanit, llojin e kazanit (kazan i thjeshtë apo i perfeksionuar), kapacitetin në kilogram dhe vendin ku ishte instaluar kazani. Shpallja përfundonte me fjalët: MOSDEKLARIMI DO TË DËNOHET SIPAS LIGJEVE NË FUQI. «Hëm! — bëri Adil Çika dhe la afishet, shpalljet, lajmërimet e u fut në një rrugë të ngushtë... — Këtej e tutje do të na duhet të merremi edhe me ata që s'do të denoncojnë kazanët e rakisë.»

Mete Jaupi e priste para Shtëpisë së Officerëve.

Vendimin që Zeqo Korbi të lëshonte katin e sipërm të shtëpisë këshilli popullor i lagjes e kishte mbështetur në një urdhëresë të kohëve të fundit të qeverisë, e cila synonte që të rregullohej sadopak problemi i strehimit për të ardhurit në Tiranë, për ata që u ishin djegur shtëpitë, ose edhe për ata që u ishin dëmtuar gjatë luftës.

— Në të njëjtën kohë kjo urdhëresë shhang mundësinë e abuzimeve dhe të shfrytëzimit, — shpjegoi më tej Mete Jaupi.

— Ju morët përsëri takim me kryetarin e këshillit?

— Duhej! — tha ai. — Ti kishe të drejtë që u zemërove. U takova edhe me shokët e grüpiti që kisha ngarkuar për të fotografuar kufomën e të aksidentuarit dhe plotësimin e dokumenteve të tjera. Dëshmitarët, fqinjë të familjes Korbi, vërtetojnë se ai është Telat Korbi. I arratisur në fund të luftës. Kthimi i tij vazhdon të mbëtet përsëri enigmë.

— Sipas këtij del se pohimet e Astrit Pemës qëndrojnë plotësisht!

— Përputhen, — tha Mete Jaupi.

— Mos gjithë këtë ngjarje e ka shkaktuar kthimi i tij?

Mete Jaupi rrudhi buzët dhe la të kuptohej pyetja: Si? Në ç'menyrë?

— Le të përjashtojmë çdo gjë dhe të pranojmë si të vërtetë pohimin e atyre që thonë se i shtypuri është Telat Korbi. Të pranojmë gjithashtu si të vërteta se i biri i Zeqo Korbit, në fund të luftës, ua ka mbathur me forcat e Bazit!

— Po!

— Pas kësaj logjike të shkon mendjë se ai, një natë të bukur... ta zëmë më 10, 11 ose 9

nëntor, ndoshta edhe më përpara, tashti për tashti s'e përcaktojmë dot datën, është kthyer... Me ç'rrugë dhe ç'qëllim, këtë përsëri s'e dimë. Po është e natyrshme se kjo ardhje e papritur s'kishte si të mos prishtë qetësinë e Korbajve.

— S'i shkoj dot deri në fund çështjes, — tha Mete Jaupi.

— Natyrisht këto janë vetëm supozime që kanë për bazë thëniet e dëshmitarëve. Unë pranova këtë version si më të arsyeshmin, sepse gjykoj se gjatë këtyre dy vjetëve në familjen e Korbajve çdo gjë duhet të ketë rënë në qetësi. Zeqo Korbi ka mbyllur dyqanet. Vajza e tij, përtë cilën akoma s'dimë asgjë, ka harruar se ka një vëlla.

— Dhe në këtë kohë ti mendon se vjen Telat Korbi?

— Pikërisht... Para një dite ose një javë dëgjatë kérkon nga i ati... Çfarë?... Një zot e di... Ndoshta edhe vdekjen e tij. A nuk gjetët mbi poltronë një ampulë? Nga analizat që u bënë ajo ishte e mbushur me cianur që mund të ngordhete në moment edhe një buall...

— Kurse ai zgjodhi vetëvrasjen... Pse?

— Mund të jetë edhe vrasje. Ju pohuat se në sallon, poltronë dhe në dhomën e Zeqo Korbit kishte njolla gjaku.

— Ta ketë vrarë i biri?

— S'di ç'të them!

— Pas kësaj ti gjen ndonjë arsyë që Telat Korbi të hidhet me dashje nën rrrotat e makinës?

Adil Çika kësaj radhe tundi kokën pa dhënë asnjë përgjigje.

— Po Zeqo Korbi pse duhet të vrasë veten?

— S'e di!

— Asaj punës së Drita Korbit c'ëmër t'i vësh?

— Asnjë!

— Atëherë? — pyeti Mete Jaupi.

— E shikon, vëlla, sa gjëra na duhet të dimë ne komunistët, — tha Adil Çika. — Na duhet t'i mësojmë mirë «hilet» e profesionit.

— Po, me këta të pjell groshi!

— Kanë një jetë që sundojnë, kurse ne sapo e filluam. Do të na duhet shumë punë... Duhet ta ruajmë revolucionin, — tha Adil Çika, që e kuptoi për kë e kishte fjalën Mete Jaupi.

— Kurse unë kam pak shkollë.

— Ndoshta do të na duhet të bëjmë edhe vjersha, — tha Adil Çika dhe qeshi.

Qeshi edhe Mete Jaupi.

— Ekziston edhe mundësia që, pas kësaj ngjarjeje, të kemi një përpjekje të armiqve tanë... ose edhe një bllof, ose diçka tjeter të përafërt që kërkon të na hutojë dhe të na largojë vëmendjen kushedi nga ç'problem, — tha Adil Çika dhe i erdhi ndër mend tërë ai konfuzion politik që ishte gjallëruar pas vendosjes së pushtetit të popullit siç ishte organizimi i grupeve armiqësore dhe i lidhjes midis tyre. Bashkimi i kriminelëve, bejlerëve, tregtarëve, intelektualëve reaksionarë e spiunëve që u ndërsyen si qentë në kocka, por që s'u kishte ecur gjatë. Kështu kishte përfunduar pak muaj më parë grupi i «opozitës» me Gjergj Kokoshin, Riza Danin, Shefqet Bejën e të tjerë deputetë. — Hëm! — bëri Adil Çika dhe i tha Mete Jaupit se ata duhet të kenë lënë pas njerëz të tjerë, farë të keqe që është struktur diku në ndonjë cep të «Kalit të Trojës» dhe pret. — E kupton, Mete vëllai, ç'bëjnë aleatët? — dhe përsëri bisedën e solli te grupi i sheh Karbunarës, ai i Sami Qeribashit, tek ata të Maliqit, të U N R A-s, te misionet e Amerikës dhe të Anglisë që kishin ikur në mënyrë demonstrative pasi s'kishin arritur dot synimet e

tyre, te tërë ajo veprimitari që ishte kamufluar me «grupin monarkist», me atë të «Rezistencës» apo «Socialdemokrat» që, si pjesë e «opozitës» dhe e synimeve të Hoxhsonit e Harri Fulcit, kishin dalë hapur kundër ligjit të zgjedhjeve për të gllabëruar revolucionin.

— Mundet të jetë edhe kështu, — tha me gjysmë zëri Mete Jaipi.

— Jep urdhër ta lirojnë shoferin! Pastaj merru me përgatitjen e grupit të ekspertizës. Sonte do të kontrollojmë shtëpinë e Korbajve... Natyrisht pas orës dymbëdhjetë, — tha Adil Çika pa i shpjeguar asgjë për çka kishte mësuar nga shefi i seksionit të punëve të brendshme një orë më parë, dhe përsëri i shkoi mendja tek ato fakte të ngatërruar, të cilat në heshtje po i analizonte me kujdes të veçantë. Cili ishte futur natën në shtëpi? Pse? Po varri? Kush mund ta ndërmerrte një veprim të tillë në mesnatë kur kufoma s'kishte asnjë çentez me vete? Ngjarja, sidomos tashti, herë i sqarohej deri në hollësi, kurse herë tjetër i ngatërrrohej dhe çdo gjë i dukej konfuze e pa fund. «Megjithatë, — tha me vete, — edhe kjo ka pasur një shtjellim dhe si e tillë do të marrë rru-gë.» Ai kishte krijuar bindje se krimet, në çdo kohë e rrethanë që të ndodhin, në fund të fundit kanë predispozion të zbulohen. «Dhe kjo ndodh, — mendonte Adil Çika, — se, sado në fshehtësi që të kryhen, ato përsëri lënë gjurmë... Dhe po ece pas tyre i qetë, gjakftohtë, i matur, s'ka se si të mos e gjesh zanafillën e tyre...»

Astrit Pema ishte zgjuar shpejt dhe si zakonisht kishte dalë të pinte kafenë. Pas tre vjetësh po e shikonte edhe një herë qytetin e tij në një mëngjes vjeshte. Gjithçka iu duk si e mpirë. Shtëpitë. Rrugët. Reklamat e kinemave. Ata që shisnin salep në ibrikët e bakërt... Vite më parë, sa herë që dilte në këtë rrugë, të parin njeri që takonte ishte gazetashitësi i vogël, Meti. «Ku të jetë,» — tha dhe iu kujtua zëri i tij: «Kombi!... Gazeta «Kombi» me lajme të reja!... Blini gazeten «Kombi»... Blini «Kombin» me lajme të reja... Dhe të rejat kishin të bënин me Operacionin e Dimrit që ishte sulur drejt jugut, veriut, lindjes, perëndimit, për të shuar lëvizjen komuniste. Astrit Pemës, bashkë me vjeftën e përgjumur, ditët me shi dhe vitet që kishin kaluar në mënyrë ngjethëse, iu përtéri fytyra dhe trupi i imët i gazetashitësit të vogël, që, bashkë më gazetat, shpërndante edhe komunikatat e Partisë Komuniste të Shqipërisë. «Atëherë u besoja pak, — tha ai me vete, — ose s'u besoja fare. Gjithçka e konsideroja thjesht propagandë, diçka luteriane... Idealiste... Të pamundshme! Hëm! — bëri ai dhe hodhi sytë nga një barakë diku më poshtë, ku vite më parë një djalosh shiste kartolina. — Kurse ai u uronte njerëzve ditë të mbara, muaj të qetë, vite të bollshme... Ëndrra mesnate, — tha dhe përsëri vrou mendjen të kujtonte emrin e tij. Ali? Emin? Jo! Haki? As Haki. Haku ishte ai burri që shiste kikirik dhe bajame me kripë. Rrallë edhe gështenja të pjekura. Po ai ku të jetë? Ron, apo ndoshta... Të gjithë këtu duhet të jenë... Në mos sot, nesër do t'i shoh, do t'i gjej. Po e keqja

është se asnjeri s'do të më njohë kështu si jam katandisur.» Mendimet iu ndërprenen. Në një fasadë pa një portret të madh. Një burrë që i qeshnin sytë. Sy që shikonin larg. Ata flisnin më shumë se çdo gjë tjetër në këtë mëngjes vjeshte. «Cili duhet të jetë ky? — mendoi Astrit Pema. — Me siguri komandanti... udhëheqësi i shtetit të ri!» Diku më tej ishte shkruar me shkronja të mëdha RROFTË PUSHTETI I POPULLIT. LIRI PËR POPULLIN. Në sheshin kryesor, në një shtyllë të lartë metalike valavitej flamuri kombëtar. «Këto s'ishin dje, — tha ai, — apo ndoshta s'i kam parë unë?»

Pas tij mbi rrugët e ftohta ecte vjeshta që të thante fytyrën. Ai ngriti jakën e pardësysë dhe diçka tha me vete per këtë ftomë të hidhur e të parakohshme që dukej sikur zbriste nga viset polare. Ndjeu se një kanat dritareje u përplas me zhurmë. Pastaj një qepen dyqani... La rrugën dhe u fut në ish-«Bar Berlini», që dikur ishte ndër ato lokale që përjashtohej nga ora policore dhe që frekuentohej nga vendosit e kamur dhe të huajt e ardhur, të cilët mund të dëfrenin deri në mesnatë. U ul në të njëjtën tavolinë ku ishte ulur edhe një natë më parë. Bashkë me erën e kafesë ndjeu edhe atë të duhanit të fortë. Ndoshta nga kjo, ai, ndryshe nga herë tjetër, iu duk më i ngushtë, i vogël dhe shumë i thjeshtë. Zëri i kamerierit u përzje me atë të spikerit të Radio Tiranës që diçka thoshte për flotën angleze që vazhdonte të hezitonte të largojhej nga ujërat e Mesdheut. Pastaj për entuziazmin e rinisë shqiptare që sapo kishte përfunduar rrugën Kukës-Peshkopi... Më pas përsëri spikeri dha një lajm për kanalin «Daut Rikaj» në Kavajë, i cili, pas përfundimit të tij, me kontributin që dha gjithë populli i nënprefekturës, do të vadiste 4000 dynymë tokë...

— Kafe?

— Edhe një konjak, — shtoi Astrit Pema që ndjeu mornica në trup.

Ndërsa priste kamerierin, iu kujtua se dikur ky lokal kishte pasur edhe orkestër... «As këngëtarja s'është, — tha. — As kamerierja. As banakieri s'është!» Ndezi cigare, mbushi gojën me tym dhe e lëshoi drejt tavanit që kishte pësuar ca plasaritje që të linin përshtypjen se suvaja nga çasti në çast do të rrëzohej copa-copa.

«Atëherë çdo gjë më dukej ndryshe,» — tha ai.

«Zonjushë, dëshironi kikirik?»

«Jo!»

«Po bajame me kripë?»

«Sot duhet të kishit sjellë tulipanë. Në barintonë tulipanët preferohen shumë.»

«Tulipanët kanë kohën e tyre, zonjushë e ëmbël.»

Dialogu kishte qenë i zgjatur dhe me përbajtje të fshehtë. U mundua të rikujtonte ftyrën, sjelljen dhe shqetësimin e kikirikshitësit, që ishte ulur në një tavolinë pranë tij, kamerierin, që ishte afruar dhe diç i kishte pëshpëritur.

«Ma thanë apo hyra te dera!»

«E njeh?»

«E di që i pëlqejnë çupat e bukura dhe loja e pokerit.»

Astrit Pema e kishte kuptuar se bëhej fjalë për ndonjë nga ushtarakët e huaj që hynin e dilin tërë solemnitet.

Pastaj kikirikshitës Hakiu i ishte afruar dhe i kishte thënë:

«Kur dola në rrugë, kisha një njeri prapa.»

Astrit Pemës i ishte dukur diçka e çuditshme intimiteti i njeriut që shiste kikirik.

«Si ishte?»

«I dyshimtë! Edhe kur u ktheva në një rrugicë, ai s'm'u nda.»

Astrit Pema ishte ngritur dhe kishte dalë jashtë. Bashkë me errësirën kishte ndier edhe një shkulm ere që iu përplas në ftyrë. Veç shkrimtarit K. që vuante nga prostatit dhe çdo herë që dehej dilte dhe pshurrte nën ligustra, s'kishte parë gjë tjetër.

«As jashtë nuk ka njeri.»

Kikirikshitës Hakiu ishte ngritur dhe, për të humbur çdo gjurmë e dyshim, kishte lëvizur nëpër sallë duke u ofruar kikirik dhe bajame me kripë të pranishmëve. Pastaj kishte shkuar përsëri te banaku.

Pas kikirikshitësit atij iu kujtua «invalidi». «Po atë, vallë do ta njoh?» Ai ishte takuar vetëm dy herë me të dhe të dy herët e kishte parë tebdil. Herën e parë i kishin bërë përshtypje mustaqet, kasketa dhe syzet, kurse herën e dytë këmisha e kollarisur dhe kapelja e modës si ato që mbanin intelektualët e kohës. «Veç zërin dhe ngjyrën e syve s'i kishte ndryshuar dot,» kujtoi Astrit Pema kur solli ndër mend atë kaltërsi si të detit të thellë. Herën e parë ai e kishte takuar në një shtëpi të vjetër përdhese në periferi të Tiranës, në një nga ato bazat ku mbildheshin ilegalët, kurse herën e dytë çdo gjë kishte ndodhur rastësisht. Astrit Pema pinte kafe me kikirikshitës Hakiu në një lokal po në periferi, kur kishte hyrë ai.

«Mund të flasim hapur? — kishte pyetur «invalidi».

«Më mirë herë tjetër! — kishte thënë kikirikshitësi. — Po pse herë tjetër? Me siguri ata s'kanë pasur besim tek unë... Dhe kishin të drejtë... Të drejtë,» — tha dhe shtrëngoi grush-

tin. Kujtoi rrugicat. Shtëpitë. Portat që kërcisinin lehtë, dhomat e thjeshta. Minderet. Dritaret e vogla... Netët pa hënë dhe llambat mbi oxhakët me blozë... Fytyrat e panjohura. Ata njerëz të thjeshtë, punëtorë, studentë... Bisedat... Ilegalët... Atentatet... Dhe përsëri kikirikshitës Hakiun dhe atë «invalidin»... Ai ngriti një nga patericat që i ra në çimento dhe po shikonte herë ata që hynin, herë kamerierin... herë motin. «Po ai ku do të jetë? Ndoshta s'është më, — tha. — Sa gjëra kanë ndryshuar. Dhe kanë ndryshuar aq shumë sa...» Dhe përsëri iu kujtua nata. Bari. Majori Fon Brymer... casti kur i kërkoi kamerieres konjak. Telat Korbi që kishte hyrë në sallë dhe si zakonisht ishte drejtuar te banaku, kishte marrë një gotë konjak dhe me gjysmë zëri ishte drejtuar nga ai.

«Shëndet, o njeri me kollaro të kuqe! Apo mos doni këngë?

*Për vdekjen as trembem, as derdh lot,
Me mirë gjë në botë s'gjendet dot.
Trembem ngajeta që i madhi zot,
Më kot ma dha dhe ia kthej më kot.»*

Mbas kësaj deklarate në bar kishte hyrë edhe i ati, Zego Korbi, që, pa e vënë re të birin, i kishte hedhur sytë anekënd sallonit.

«Ti harrove të përshëndesje, i dashur baba!»
«Po ti?»

«Si zakonisht, provoj të pi.»

«Të kam porositur se duhet të jesh para kësaj ore në shtëpi!»

«Sonte do të vonohem... çelësin e derës e kam me vete...»

«Do të të mësoj si të sillesh me babanë kur je në kafene!»

Zego Korbi kishte dalë si i tërbuar.

*Natën kur flija më tha shpirti «pi!»,
Në gjumë dhe në varr s'ka lumburi...
«Shpëtove paq, — i kishte thënë kamerierja,
— tashti mund të këndosh dhe të hedhësh valle
tërë natën.»*

Kjo e kaluar disi e largët Astrit Pemës iu shfaq si pjesë e një spektakli të copëzuar e shumë fragmentar, prej të cilët kishin mbetur dialogë të shkëputur, ndonjëherë edhe pa lidhje, fytyra që s'i kujtonte dot, ose i kujtonte me vështirësi. «Është tepër vonë,» — pëshpëriti dhe thirri kamerierin.

— Urdhéroni!

— Jo, jo. Asgjë.

— Më falni, por m'u duk sikur...

— Jo! — përsëriti ai dhe pastaj me vete falenderoi edhe një herë këtë djalë që e zgjoi nga ai gjumë i largët. Ferkoi sytë dhe hodhi vështrimin përtej xhamave që fshiheshin nga perde të holla me lule të mëdha shumëngjyrëshe. Koha vazhdonte të ishte e ftohtë, me diell të vakët. Ungrit. Një palë sy të lëngëzuar, të vegjël e të fshehur nën syzet me xham të trashë, me pështirje dhe përbuzje iu ngulën mbi duart dhe trupin e tij, që në çdo hap të linte përshtypjen se bënte një kërcim të mundimshëm për t'u rikthyer në jetë. «Po tashti ku të shkoj?» Doli jashë dhe kujtoi përsëri ato net kur në këto rruge, bashkë me hapin e rëndë të patrullës dhe errësirën e dendur që dukej se nuk do të merrte fund kurrë, njerëzit ishin mësuar të dëgjonin edhe ndonjë krismë. Dy. Tri... Si ajo kundër majorit Fon Brymer. «Kurse unë atëherë bluaja mendime si një mokër e prishur.»

Dita iu duk e pafundme. Qëndroi një copë herë dhe pa xhaminë me minare të copëtuar. Sahatin. Shtëpitë e rrëzuara... «Drevo punë, —

tha dhe kujtoi sejeta e tij i ngjante diçkaje të dyzuar, të troshitur. — Jetë pa jetë, si diçka e shurdhër, anemike.» Ai kishte mbetur herët jetim dhe ishte marrë me lloj-lloj punësh derisa një xhaxhai i tij, pronar i një hani, i kishte dhënë mundësinë të vazhdonte shkollën qytetëse. Pas qytetëses kishte vazhduar liceun. Ditën mësonte, kurse natën punonte te një furrxhi. «Pastaj çdo vit më rrëmbeu nga një copë jetë. Viti 1942, të qeshurën dhe humorin. Dyzetetreshi vendosmërinë, kurse dyzetekatra të gjitha. Bile edhe një-rën këmbë,» — tha dhe tingulli i pafkës metali-ke të këpucës së vetme vazhdonte të dëgjohej si diçka e harruar që u ngjante ca tingujve të lodhur.

«Vdekje fashizmit!»

«Poshtë tradhtarët!»

Diçka e shtypi fort në témtha, aq sa ndjeu dhimbje. «Po unë në cilën kategori bëj pjesë? — pyeti dhe, duke e gjykuar veten me egërsi, gati sa s'bërtiti: Jo! Unë nuk tradhtova. Gabimi i vetëm ishte se zgjodha rrugën e mesme, atë të pritjes dhe ja përfundimi.» Një... dy... Trang... Tup, tup, — dëgjoi prapë tingullin e hapave të tij... — Të gjithë ecin me dy këmbë, kurse unë me katër. Një këmba. Dy proteza. Tre paterica. Katër paterica. Këmba, proteza. Paterica, Po më tej? S'e di! S'e kuptojet dot ç'do të bëhet me mua, — mori një pamje teatrale, dhe përsëri pyeti me dyshim: — Si do t'i vejë filli? Si do të më presin? Ç'do të thonë vallë komunistët kur të marrin vesh se njëfarë Astrit Pema na u kthye. U kthye? Hëm! Dje bëje sehir!... Doje t'i nxirrje gështenjat nga zjarri me... Jo! — bërtiti përsëri fort. — Jo, jo, kjo s'është e vërtetë! Dhe përsëri u egërsua.

— Ti erdhe edhe dje, bir!

Ky zë e zgjoi Astrit Pemën nga gjendja e ankthit që ditët e fundit kishte ndjellë tek ai mërzi dhe ndjesi të liga. Përballë tij mbi një copë muri të rrëzuar ishte ulur një plakë.

— Mérzitem! — tha Astrit Pema.

— Ka dhe më keq, bir! Ke qenë komisar? — e pyeti dhe me bisht të syrit pa këmbën e gjymtuar dhe dy patericat.

Astrit Pema ndjeu përsëri dhimbje koke si ta godiste një peshë e rëndë... Hodhi sytë nga muret e rrëzuara të shtëpisë dhe pa atë barin që përdorej për të qetësuar dhimbjen e veshëve.

— Edhe unë komisar e kisha tim bir! — tha plaka dhe pa sytë e hirtë të Astrit Pemës.

— Nënë Hyrie!

— T'u bëftë nëna! Po cili je, more bir?

— Unë jam Astrit Pema!

— Larg syve! — tha ajo.

— Nuk më mban mend?

— O perëndi!

Ndoshta në këtë kohë plaka kujtoi ndonjë përrallë nga ato të fëmijërisë. Ndoshta atë të Kostandinit që ngrihej nga varri.

Astrit Pema e mori plakën për qafe.

Ajo lëshoi nga duart barin që shëronte vëshët dhe e puthi në faqe, në sy, pa mundur t'i thoshte: «Sa më ka marrë malli, bir...» ose «Po ku humbe, more Kostandin?»

Më 15 nëntor njeriu me një sy hante drekë
në hotel «Dajti». Përtypej dhe pinte verë të kuqe
pa hequr vëmendjen nga njerëzit që e rretho-
nin... «Dreqi e njeh natyrën e këtij vendi,» —
tha. Kështu kishte thënë edhe një javë më parë.
Atë natë kur ndjeu së dyti zërin e lodhur e të
mekur të sirenës, që i kujtoi edhe një herë fun-
din e udhëtimit dhe i sosi çdo kuriozitet që ki-
shtë ushqyer ditë të tëra për të arritur sa më
parë në atë port të vogël. Ndoshta i ishte dukur
kështu ngaqë s'i kishte pëlqyer ngjyra e errët
e qiellit ose ngaqë ky vend i vogël që në takimin
e parë i kishte sjellë mërzi dhe i kishte
krijuar përshtypjen se punët nuk do t'i shkonin
aq mbarë. Vend tepër i largët, kishte thënë si
të pëshpëriste një mallkim dhe, pasi i ishte
shmangur vështrimit të bashkudhëtarëve, kishte

zbritur në platformën e betonit me dokumentin e identitetit në dorë. I ishte nënshtuar kontrollit të doganës, pyetjeve të nepunësit, buzëqeshjeve të çastit, pastaj kishte dalë nga këto zyra që i ishin dukur tepër të ngushta. Kishte shkuar drejt portës ku e priste një veturë e tipit «xhips», mbuluar me mushama të zezë. Ishte përshëndetur me shosferin dhe me gjysmë zëri, si të shprehte bashkë me lodhjen edhe shqetësim, kishte urdhëruar që të niseshin. Edhe pse tërë ato ditë në vapor kishte folur veç për këngët dhe kryeqytetet e pasluftës, kishte ndier se këtij udhëtimi i mungonte entuziazmi. Kujtoi këto dhe i tërhoqi vëmendjen vetes se nuk ishte as udhëtar i thjeshtë, as turist që kishte ndërmarrë një udhëtim çlodhës, por i dërguar i posaçëm që vininte nga vise tepër të largëta. Pagoi. Tundi paketën pranë veshit si ta kontrollonte nëse kishte më cigare dhe e përplasi mbi tavolinë. Ngjiti shkallët dhe në qetësinë e hollit piu kafe me pak.

Pas tij kamerieri që shkundi mbulesën, bashkë me monedhat letër, futi në xhep edhe paketën. Ishte «Diamant» nga tanët që ia dorëzoi berberit në rrojstoren e katit të dytë.

Në mbrëmje: Berberi u takua me Ahmet Bregun në dyqanin e reklamave. Nën qepenat metalikë. Ahmet Bregu u takua para mesnatës me deputetin... Deputeti me...

Në kishë:

Prifti — Sonte s'do të bien kambanat.

Kambanari — S'ka vdekur njeri?

Prifti — Jo!

Kambanari — As që do të vdesë?

Prifti — Jo! Prandaj as dang... As dung!

Kambanari — Qoftë lëvdue Krishti!

Prifti — Amen!

Natën koha herë hapej, herë mbyllej. Kishte re. Mjegull e hollë. Ftohtë. Kambanat s'u dëgjuan...

I pandehuri Alush Boga, arrestuar dy muaj më parë për veprimitari armiqësore, pasi u krua në spitalin psikiatrik të Vlorës dhe pasi u konstatua i shëruar, u rimor në pyetje më datën 15 nëntor, ora 16.00. Në fillim heshti. Kafshoi duart me dhëmbë dhe bëri përpjekje të përplaste kokën pas murit...

U pyet me kë mbante lidhje. Heshti! U pyet se në cilën parti bënte pjesë. Heshti. U pyet... Heshti dhe u mundua të vazhdonte lojën e dy muajve më parë. Ra përtokë dhe filloi gjoja të shkumonte, kurse në dhomën e izolimit u qetësua plotësisht. Piu duhan dhe fjeti më se tri orë. Në orën 21.00 u mor përsëri në pyetje. Heshti. Pastaj përsëri gjoja tentoi të përplaste ko-

kën pas murit. Natën fjeti shumë qetë. Gjatë seancave të hetimit nxori si pa kuptuar vetëm dy fraza: «Ai buburreci i Kolorados... dhe ru-huni nga tifo exantimatiqe»... (Ndoshta e shqiptoi edhe extint...) Hetuesi, edhe pse nuk e kuptoi përbajtjen e tyre, i shënoi me kujdes këto shprehje dhe raportoi të nesërmen.

VI LIJUTIEN

KAPITULLI IV

1

Shoku major!... Është për t'u habitur. S'ka veç një javë i biri i botës që ka ardhur në Shqipëri dhe bën ca veprime të çuditshme. Siç dihet ai është me një sy... Pikërisht kjo më çudit, sepse, në orët e natës, kur del shëtitje nëpër kopsht, nën hijen e rëndë të pemëve të mëdha, ose ndonjëherë edhe kur është brenda godinës, kam vënë re se ai i ka të dy sytë. Dua të them e heq mballomën e zezë. Edhe në mëngjes kur bën gjimnastikën e heq... Do të thoni ju: «Kështu ndodh me ata që kapë vetëm një sy. Kurse mua më duket se i ka të dy. Dhe nuk është aq i pakujdeshëm. Ai do të duket me një sy vetëm kur del jashtë... (Del ose me xhipsin e tij, ose në këmbë.) Atëherë nguroset para pasqyrës dhe me kujdes të veçantë vë çdo gjë në vendin e vet. Këtë e kam parë unë, Ma thonë shokët a

shërbimit. Ma ka thënë edhe pastruesja... Edhe diçka tjetër, shoku major: ai edhe veshjen e ndryshon herë pas here. Herë vishet si kopshtar, herë si rojtar dhc herë të tjera pispilloset tej mase. Ndonjëherë edhe xhipsin e nget vetë. Ka raste që del herët dhe kthehet herët, veç gjithnjë del natën dhe gjithnjë me mballoomën në sy. Nuk e di sa i sigurt jam, por një natë m'u duk se me xhipsin e tij solli edhe dy njerëz të tjerë. U futën në një dhomë të ndriçuar dobët. Dolën pas dy orëve dhe përsëri i përcolli me xhips. Do t'ju informoj!

Shefi i seksionit të punëve të brendshme, nisi mbaroi së lexuari informacionin, tundi kokën. Iu bë qejfi që Sala kishte filluar ta përmirësonte shkrimin në mënyrë të dukshme. Mbi të gjitha po bëhej shumë i qartë në ato që shkruante. Informacionin e futi me kujdes në dosjen përkatëse, kurse në bllokun e tij hodhi shënimet e nevojshme. Veçoi porositë për Adil Çikën. Hoqi viza me laps të kuq.

2

— Urdhëroni, — tha Orman Lika.

Adil Çika e pa me bisht të syrit këtë zyrtar të vjetër. (Mënyra si ishte veshur, syzet, këmiشا e kollarisur, gravata e zezë, kapelja republikë varur pas dere i lanë përshtypjen se edhe ky shef ishte nga ata intelektualë që pushteti i ri u kishte bërë thirrje të punonin në speciali-

tetin e tyre.) Adil Çika i shpjegoi arsyen e vizitës. Orman Lika u ngrit në këmbë, i shtrëngoi dorën dhe e ftoi të ulej duke i kërkuar ndjesë që s'e kishte njohur, ose së paku s'e kishte marrë me mend nga veshja se cili duhej të ishte.

— Erdha për problemen e Zeqo Korbit, — tha oficeri i hetuesisë, pa pritur që biseda të zgjatej me pyetje dhe përshëndetjet e rëndomta «si je», «ku jemi parë», «në ç'brigadë keni qenë» e të tjera pyetje të këtij lloji.

— Ju kuptoj, — tha Orman Lika. — Me sa na lejoi koha, mund t'ju themi: (Shefi i komisionit të tatimeve hapi sirtarin dhe nxori që andej një fletore.) — Po, — pëshpëriti ai. — Komisioni i tatimeve e ka regjistruar Zeqo Korbin që në listat e para. Sipas vendimit nr. 82... Adil Çika u mundua që të ishte sa më idnatyrshëm. Ndezi cigare dhe, me qëllim që të mos ndikonte në përgjigjet e Orman Likës, po dëgjonte me vëmendje shpjegimet e tij.

— Sipas të dhënave që disponojmë ai kishte dy dyqane. Një dyqan manifature në Rrugën e Dibrës dhe një tjetër parfumerie në Rrugën e Kavajës. Për këtë arsyen nga komisioni është **tatuuar tri herë**. Radhën e parë me dy milionë. Të dytën me një milion e gjysmë dhe të tretën me një milion e treqind mijë.

— I ç'kohe ka qenë tatimi i fundit?

— I gjashtë muajve më parë, — tha Orman Lika.

Adil Çika shënoi diçka në bllokun e tij dhe përsëri priti vazhdimin e bisedës.

— Ja dhe lutja e fundit e të tatuuarit, — tha ai.

— Ç'kërkon?

— T'i hiqet tatimi, sepse, sipas tij, nuk disponon asnë mundësi pagesë.

— Ia falët?

— Jo! — Orman Lika tundi kokën.

— I pagoi?

— Po!

— Ku i gjeti?

— Sipas të dhënavë që disponojmë (shefi e përdorte shpesh këtë shprehje) shiti në ankand gjithçka kishte, — tha dhe e futi bisedën në hollësitë e ankandit.

Për Adil Çikën këto hollësi, edhe pse të pashnjohura, ishin pa interes, prandaj dëgjonte me indiferencë shpjegimet e shefit të komisionit të tatimeve dhe kërkonte me mend diçka tjetër, të largët e jashtë këtij takimi. Le të ishte kjo qoftë edhe rëndomësi e ditës, p.sh. diçka nga programi i filmave që shfaqeshin në kryeqytet, ose edhe nga orari i ri i lëvizjes së autobusëve nga Tirana në drejtim të qyteteve të tjera të vendit, mjafton që të ishin sa më larg këtyre hollësive tregtare. Bile, po të mos njihte të kalluarën e Orman Likës (intelektual që kishte mbajtur qëndrim të mirë gjatë Luftës Nacionalçirimtare), do ta kishte marrë për njeri të dyshimitë dhe do t'i kishte «qarë hallin» komisionit të tatimeve.

— Pas ankandit e tatuanc edhe me gjysmë milioni, — tha Orman Lika dhe i afroi paketen e cigareve. — E kuptioni, shoku kapiten? I kemi thyer brinjët...

— Sigurisht që i pagoi edhe këto.

— Jo menjëherë, — tha Orman Lika. — Ka paguar treqind mijë me tri këste dhe me një letër të tretë na lutet që t'ia falim këstin e fundit.

— Cili ishte mendimi i komisionit?

— Në asnjë mënyrë! Ne mendojmë se edhe kaq ai do t'i ketë dhe pastaj... — shefi i komi-

sionit përplasi duart me njëra-tjetërën në atë mënyrë si të thoshte «falimento» dhe ia nguli përsëri sytë oficerit.

Edhe Adil Çika e pa me shumë vëmendje këtë njeri të pasionuar pas punës. Ndoshta kjo e shtyu që të pyeste:

— Ku keni punuar më parë?

— S'jam komunist, po e dua popullin tim dhe të ardhmen e tij, — tha Orman Lika.

— Po shtypshkronjën? — Adil Çika e hodi prapë bisedën te Zeqo Korbi.

— Ajo është detyrë e një komisioni tjeter! — i dha fund shpjegimit me lëvizjen e duarve dhe rrudhjen e buzëve. — S'kemi ç'i marrim më. Aq më tepër kur mësuam se, për të siguruar jetesën, është detyruar të punonjë si punëtor në ndërtim.

— Para tri ditëve ai u gjet i vrarë në shtëpinë e tij, — tha Adil Çika.

— Është e tmerrshme ndjenja e pasurisë! — Orman Lika ndezi përsëri cigare pa u mera-kosur për lajmin që mësoi.

— Kjo të jetë arsyaja? — qesëndisi Adil Çika.

— Dëgjo mua! S'është i pari ky. Pyet mua ti!

— Faleminderit për shpjegimet, — tha Adil Çika që kishte vënë re se në fjalët e tij, bashkë me dëshirën e mirë për të kryer detyrën, dallohej urrejtja për këta njerëz që mbi çdo gjë kishin vënë fitimin në kurriz të popullit. «Hëm!»

— bëri kryehetuesi dhe, pasi doli në korridor, tha se Orman Lika ishte njeri i mirë dhe s'dihet pse iu kujtua ai V.B.-ja, drejtor i fermës shtetërore të Lushnjës, kundër të cilit sapo kishte filluar procesi i hetimeve, sepse në vend që ta bënte fermën model për gjithë fshatrat përreth

dhe të arsyetonte besimin që i kishte dhënë puschtet i ri, e kishte lënë atë në një gjendje katastrofike dhe bashkë me magazinierin... eh, djalili si quhcj, e kishin kthyer fermën në çiflig. Vidhnin. Shpërdoronin. Domatet i bënин salcë pér vete. Rrushin raki. Me grurin dhe misrin ushqenin derrat e tyre. «C't'i thuash kësaj? — pyeti Adil Çika, ndërsa zbriste shkallët e komitetit ekzekutiv. — Dhe ec e mos i dëno këta njerëz!» Dhe përsëri i dha të drejtë Mete Jaupit që, sa herë binte fjala pér armiq të këtij kallëpi, që ditën fshiheshin si kërmilli, kurse natën... (hëm... nata ishte e tyrja), ai nxehet dhe zinte në gojë gjyqin ushtarak.

Kishte qëndruar në fund të korridorit, pranë dritarës, dhe sodiste qytetin nga lartësia e kattit të tretë. Iu kujtuan fjalët e Orman Likës: «I kemi thyer brinjët...» dhe qeshi. Pastaj përsëri në xhamë pa të fiksuar, si përmes mjegullës, atë pjesë të qytetit që vishej dhe zhvishëj herë pas here nga retë e dendura. Ishte një lagje që s'ndryshonte shumë nga të tjerat, me godina të ulëta, mure me qerpiç, tjegulla në ngjyrën e ndryshkut, rrugica të ngushta e të deformuara. Njerëz, karroca, biçikleta dhe rrallë ndonjë veturë të vjetër. Në qoftë se dritarja do të kishte qenë në drejtim të veriut, ai do të kishte pasur përballë lagjen «Brakë», me barakat përdhese dhe ndyrësinë e rrugëve. Më tej lumin. Dhe akoma më larg shkollën e vjetër bujqësore, që ishte fshehur midis pemëve të dendura...

BASHKIMI

16 nëntor

Nr...

Faqe e tretë. (Anash. Okelo)

Vitin e kaluar karkaleci u përhap, siç pri-tej, dhe bëri dëme të pallogaritshme sidomos në qarqet e Shkodrës, Tiranës, Durrësit, Beratit dhe Korçës. Dëmet të ndjeshme... Po rreziku do të jetë më i madh vitin që vjen në qoftë se do ta favorizojnë, veç të tjerave, edhe faktorët klimaterikë. Prandaj në luftë kundër këtij insekti është preokupuar bota mbarë... Insekt shkatterrimtar, zhvillimi i të cilit, për shkaqe që di-

hen, ka disa vjet që ka marrë hov të paparë, aq sa na jep të drejtë që përpjekjen pér shfatosjen e tij, ta quajmë iminente... Bile shumë serioze. Serioze si të shfaqeje buburreci i Kolorados.

... Mënyrat e luftimit të karkalecit janë të shumta dhe të ndryshme: luftohet me anë të djegies me benzinë: (Rrethohet një copë vend. ngushtohet duke e detyruar insektin të grumbullohet, spërkatet dhe digjet). Po kjo mënyrë kërkon një sasi të madhe benzine, pér të cilën ne kemi kaq shumë nevojë. Megjithatë Ministria e Ekonomisë ka shpërndarë deri tani 24 000 litra benzinë. Po sigurisht vetëm kjo rrugë do të na kërkonte tërë Kuçovën. Prandaj ne kemi kërkuar nga aleatët një sasi arsenat sodiumi. Kontigjenti i parë erdhi. Ky bar është një lloj helmi që shtohet me ujë tre deri katër pér qind dhe përzihet me krunde. Zonat ku do të shpërndahet së pari ky preparat do t'ju njoftohen së shpejti (çdo zone do t'i jepen nga 220 litra...).

Kërkoni edhe rrugë të tjera me më pak shpenzime dhe që duhet të praktikohen më gjërësisht.

(Kërkojmë falje pér gabimet gjuhësore.)

N.N.

Në hotel «Dajti»:

Kamerieri, pasi futi në xhep paketën e cigareve që la mbi tavolinë mister S., përsëri u ngjit në rrojtoren e katit të dytë.

Berberi në mbrëmje u takua me Ahmet Bre-gun. (Ata flisnin me zë të ulët. Me qepena të ulur... Mc...)

Mamitë:

1) Makbule Dizdari

Rruga...

2) Zyhra Gjyli

Apartamentet e lagjes së nepunësave,

Cështjet e vjetra që kishin përgjigje
në këtë fjalë, janë:

1) Nëse është e mundur që një vajzë
të bëjë vajza e saj?

2) Nëse një vajza e bën vajza e saj,
është e mundur që vajza e saj
të bëjë vajza e saj?

3) Nëse një vajza e bën vajza e saj,
është e mundur që vajza e saj
të bëjë vajza e saj?

4) Nëse një vajza e bën vajza e saj,
është e mundur që vajza e saj
të bëjë vajza e saj?

5) Nëse një vajza e bën vajza e saj,
është e mundur që vajza e saj
të bëjë vajza e saj?

6) Nëse një vajza e bën vajza e saj,
është e mundur që vajza e saj
të bëjë vajza e saj?

7) Nëse një vajza e bën vajza e saj,
është e mundur që vajza e saj
të bëjë vajza e saj?

Ju flet Tirana!

Në Breg të Matës gjendet një fshat i vogël i quajtur Talë. Atje dhjetë familje bujqish kanë bashkuar qetë e punës dhe Pashka Gjoni punon me traktor. Korrespondentit tonë ajo i tha: «Mësova me drejtue traktorin në një ditë e gjysmë. Për një javë kam nxanë tanë veglat e tij... Tash punojmë së bashku si me kenë një shtëpi...»

KAPITULLI V

1

Kryehetuesi mbylli gazeten. «Kolorado,» — përsëriti ai, — Nga na doli sërishmi ky cep i humbur i një kontinenti? Kolorado... Buburreci i Kolorados. Ku e kam dëgjuar këtë emër? Sa po më lë kujtesa,» — tha dhe iu drejtua njeriut që sapo kishte hyrë.

— Ju keni qenë shitës në dyqanin e Zeqo Korbit?

— Si urdhëron, zoti kapiten, si biçim shegerti.

— Me përqindje?

— Jo Çne!... Me një pagë aq të vogël mujore, sa mezi mbaja familjen... Po kurrë s'kam abuzuar, — tha njeriu me trup të vogël e veshje të dalë boje që i mbulonte një pardësy e modës së vjetër me jakë të ngjyrosur nga djesa. Ai ishte i thatë, me sy të lëngshëm që i

fshinte herë pas here me një copë rreckë të bardhë, me vesh hollak si kërce buke, hundë të rrjepur dhe mollëzat e faqeve të dala jashtë. Fjalët i nxirrte me zor, copa-copa dhe si me grep. Të krijonte përshtypjen se ky njeri tërë jetën ishte munduar të siguronte me mundim bukën e gojës. Kjo e kishte detyruar që të shikonte punën e tij e të mos i bënte kurkujt keq, të heshtte dhe të mbyllej brenda lëkurës së vet. «Nga ky njeri, — mendoi me vete Adil Çika, — s'ke ç'mëson më shumë sesa numri i dyqaneve, çmimet e mallrave dhe fitimet që kishte nxjerrë pronari i tij...»

— Deri në ç'vit punove për Zeqo Korbin?

— Edhe një vit pas Luftës Botërore, — tha ai.

Ç'kuptonte ai me Luftë Botërore? Me siguri fundin e vitit 1944, ose majin e 1945-s... «E ç'rëndësi ka kjo?» — mendoi Adil Çika dhe përsëri pyeti:

— Po pastaj?

— Ai më dëboi nga dyqani duke ua hedhur fajin tatimevë të rënda.

— Për qëndrimin e tij gjatë Luftës mund të na thoni gjë? — pyeti Adil Çika, megjithëse e kuptoi që biseda po largohej nga qëllimi i këtij takimi.

— Nuk ka qenë i keq, me sa di unë, zoti oficer.

— I mirë, atëherë? — pyeti kryhetuesi.

— Si të them unë, zoti oficer... Kisha vënë re disa herë se ndihmat për Nacionalçirimitaren nuk i kursente...

— Po në parfumeri kush shërbente?

— Një mik im!

— Si quhej?

— Qemal. U vra gjatë bombardimit ajror...

— Po pas lufte?

— Pas lufte dyqanin e parfumerisë e mori
në dorë e bija.

— Për gjithë kohën?

— Kur i tekej, — tha shitësi plak. — Ashtu
e kishite ajo, zoti oficer!...

— Si?

— Ju me siguri që i dini të gjitha.

— Ne s'dimë asgjë!

Ish-shitësi i Zeqo Korbit, që si duket u pen-
dua pér fjalët që tha, u mblodh e u bë akoma
më i vogël.

— Kishit vënë re... Mos Drita Korbi mbante
në qafë një medalion... desha të them një kryq
të artë?

— Më duket se po, zoti oficer!!!. Po, po!
Tashti më kujtohet. Vitin e fundit, sa herë vin-
te në dyqan, e kisha parë që luante me kryqin
që mbante në qafë.

— Po çne? Ata a nuk ishin myslimanë?

Ish-shitësi mblodhi supet.

— Muhamedanë, zoti oficer, — dhe plaku
nxori përsëri leckën e bardhë, fshiu sytë dhe
u mundua të shihte vjedhurazi se ç'sprehje ki-
shtë marrë ftyra e oficerit. Pastaj u afrua më
pranë tavolinës, pa hapësirën e dhomës me dro-
jë dhe, me zë të gjysmuar, pëshpëriti: — Ajo
ruante ca lidhje të fshehta, zoti oficer.

— Me cilin? — pyeti Adil Çika aty pér aty.

Shitësi u zverdh. Fërkoi përsëri sytë me lec-
kën e bardhë dhe sërishmi u mblodh e u duk
sikur e futi më thellë kokën në zverkun e butë
dhe, po me atë frikë e zë të gjysmuar, pësh-
përiti:

— Me një prift!... Është një prift i ri. Ndoshta
prifti më i ri i kishës katolike të Tiranës, — tha
ai... — Duket ia ka dhënë sì kujtim, qse...

— Emrin ia dini?

— Më duket se quhet Kolë, ose Kel... Po ajo i thërret Like...

— I sigurt?

— Ju lutem!... Nuk dua që kjo të dalë nga unë, zoti oficer. Unë jam një i krishterë i bindur. Pyesni ku të doni.

Adil Çika e pa me keqardhje këtë njeri plak që kishte përballë dhe u dha fund pyetjeve.

«Ja edhe enigma e kryqit,» — mendoi me vete Adil Çika dhe, si në pasqyrë, i doli përrpara figura e klerikut të ri me rasë të zezë. Një ditë më parë ishte takuar me të. Bile edhe kishin shkëmbyer ca fjalë dhe kryehetuesit iu kujtua çasti kur i kishte futur krahun Vitos dhe të dy ecnin në rrugë. Shëtisnin më nge si gjithë të tjerët.

«Ta lashë!» — i kishte thënë Vitos kur pranë tyre u kishte kaluar një hoxhë plak. «Pesë me katër,» — ishte përgjigjur ajo dhe kishte afruar faqen pranë supit të tij. Pastaj përsëri kishin vazhduar shëtitjen dhe këtë garë me pika që në ata muaj ishte në modë. Çdo fetar barazohet me një pikë, kurse klerikët katolikë bënin përjashtim, vlerësoheshin me dy. S'dihej pse u ishte bërë ky «privilegj». Ndoshta nga fakti se dy vitet e fundit ata po pakësoheshin me ritme të shpejta. Vitoja ecte dhe kërkonte njerëz me rasë të zezë për të barazuar rezultatin. «Ta lashë!» — kishte bërtitur ajo me gëzim. Kleriku me bastun dhe syze të arta që e kishte kuptuar se ishte në qendër të lojës, kishte qëndruar përballë tyre. Adil Çika kishte parë fytyrën e tij dhe syzet me rreth të artë... Kryqin e bardhë që varej në gjoksin e tij. Kleriku kishte lënë përshtypjen se ishte fyter nga loja dhe ishte drejt

tuar nga ata. Vitoja, si e zënë në faj, kishte ulur kokën.

«Nuk bëni mirë, zoti oficer, të talleni me njerëzit e perëndisë.»

«Nuk e kishim me ju, padre!»

«Unë ju dëgjoval!»

«Sot kishim në shenjë njerëzit me borsalinë.»

«Ashtu është,» — kishte plotësuar Vitoja dhe ia kishte ngulur sytë fytyrës së tij.

«Të paktën më thoni se ku mbeta?» — kishte vazhduar kleriku dhe i kishte ngrirë në buzë një e qeshur e kërkuar.

Adil Çika nuk kishte dashur ta zgjaste më tej këtë bisedë bajate.

«Uratë, shikoni punën tuaj.»

«Në udhë të zotit,» — kishte thënë kleriku i ri dhe kishte vazhduar rrugën.

«U trembe?» — e kishte pyetur Viton Adil Çika.

«Sesi më erdhi.»

«U bëmë pesë me gjashtë.»

«Mos u tall, të lutem!»

«Nuk e njeh?»

«Nuk i shkon as veshja, as sqima...» — mblo-dhi supet ajo.

Të zënë fort për krahu ishin futur në rrugicën që të shpinte në kinema «17 Nëntori».

Adil Çika solli ndër mend edhe një herë fytyrën e klerikut Kel dhe pohimet e bakallit. Iu duk se ky ishte një fakt i ri për çështjen. Prandaj përsëri kujtoi: «Ajo mbante ca lidhje të fshehta me një prift... Dhe ç'lloj lidhjesh duhet të kenë qenë këto? Mos ky prift është shkaku i vetëvrasjes së Drita Korbit?» — tha dhe iu duk se ngjarja mori shtytje të re. Po eksper-tiza s'kishte thënë asgjë për shtatzanësi. As përgoditje. Mos ndoshta çdo gjë ka ardhur nga ndo-

një mëri e tyre? Apo mos nga kompromentimi publik? Gjersa këto marrëdhënie ishin bërë të njoitura aty edhe për bakallin plak, kuptohet se të tjerët nuk kanë qenë të paktë. «Mundet që problemi të jetë edhe më i thellë, më i ndërlikuar, me përmasa më të gjera dhe qëllime më djallëzore,» — mendoi Adil Çika dhe, pasi mbylli zyrën, doli në rrugë. Era e nëntorit që i pikonte fytyrën s'ia largonte mendjen nga prifti Kel dhe marrëdhëni e tij me Drita Korbin... Ai u fut në një rrugicë dhe mori drejtimin e hotelit.

2

— Hyr! — e ftuan nga brenda.

Adil Çika përshëndeti dhe vari kapelen pas derës.

Astrit Pema, që s'e priste këtë vizitë, u hu-tua dhe harroi t'i thoshte të ulej. Tri ditë më parë ishte takuar me atë ushtarak..., pra s'duhej të kishte ardhur kot...

— Uluni, ju lutem! — e ftoi me pak vonesë.

— Faleminderit! — tha kapiteni dhe vetëm mbështeti dorën në drurin e karriages.

Në dhomë sundoi heshtja. Dëgjohej vetëm zhurma e erës që rrihte xhamat e dritares.

Adil Çika rrrotulloi sytë nëpër dhomë dhe i mbajti gjatë mbi tavolinë ku ishte një shishe konjak dhe një gotë.

— Zakonisht nuk më merr etja për të, — u përgjigj Astrit Pema që ia kapi vështrimin. Hodhi konjak në gotën e ujit dhe ia zgjati. I ra

në sy se vizitori akoma vazhdonte të qëndronte
në këmbë dhe i tha i turpëruar:

— Po ju uluni...

— Ndoshta donit të çlodheshit...

— Kam një jetë që pushoj!

— Gëzuar!

— Faleminderit! — takuan gotat. Pinë. Kry-
qëzuan vështrimet.

— Pas ca ditësh është Festa e Çlirimt, — tha
Adil Çika.

— E vura re. Rrugët kanë ndryshuar pamjen.
Qyteti është zbukuruar...

Zakonisht, ata që sapo njihen, e shikojnë një-
ri-tjetrin vjedhurazi, instinktivisht kryqëzojnë vë-
shtrimet. Përballë njëri-tjetrit e me gotat e kon-
jakut përparrë ata ngjanin si miq të vjetër. Një
i tretë do të mendonte se ishin prej një krahi-
ne, ose kishin lindur në një ditë, ose diçka të
përafërt me këtë. Adil Çika vriste mendjen si
ta fillonte bisedën. Një pakujdesi e vogël, ose
një ndërhyrje pa takt, në vend që ta sqaronë
çështjen, mund ta komplikonte më keq e ta fu-
ste në qorrssokak. Gjersa ishte futur në atë
shtëpi... Ishte gelësi i vetëm që kishin tanë për
tanë për atë çështje. Duke gjykuar këto, arriti
në përfundimin se më e mira ishte t'i fliste
hapur. T'i tregonte se si ishin shtjelluar më tej
punët pas aksidentit dhe ta pyeste drejtpërsë-
drejti për Drita Korbin dhe të atin.

— Shoku Astrit... Erdha të bisedojmë edhe
një herë për aksidentin që ndodhi në Rrugën e
Dibrës.

— Unë ju kam pritur...

— Pas jush u takova me atë kosaxhiun që
ka dyqanin përballë shtëpisë së tyre. Ai dekla-
roi diçka tjetër... Ndryshe nga ju.

— A mund të di?

— Tha se Telat Korbi na paska ikur... dome-thënë është arratisur.

Astrit Pema mblođhi supet.

— Nga verifikimi i mëtejshëm doli se ju kishit të drejtë. I aksidentuar, që vdiq po atë ditë në mesnatë, ishte Telat Korbi.

— Për sa ju thashë isha i bindur.

— Edhe pohimi i kosaxhiut është i vërtetë... Na intereson të dimë si erdhi Telat Korbi, kur erdhi, pse erdhi dhe pastaj pse u hodh nën rrotat e makinës.

Astrit Pema përsëri ngriti supet.

— Më 12 nëntor u gjet e djegur në një gropë gëlqereje Drita Korbi, kurse një ditë më vonë i vrarë, ose i vetëvrarë në dhomën e tij, Zeqo Korbi. — Adil Çika fliste dhe ndiqte me vëmendje se si do të reagonte Astrit Pema pas këtyre fakteve. — Si mendon ti për të gjitha këto?

Nga qëndrimi dhe mënyra si e kthente gotën e konjakut dukej sikur ai donte të thoshte: «S'kishte si të ndodhë ndryshe, shoku kapiten!»

— Unë erdha vetëm t'ju thosha një të vërtetë për të cilën akoma ngul këmbë: shoferi është i pafajshëm, — tha Astrit Pema po me atë bindje që e kishte shprehur edhe tri ditë më parë.

— Ju kishit të drejtë... E liruam dje... Tashti na duhen të dhëna për këtë ngjarje, — tha dhe, duke dashur që të ishte sa më lakonik, pyeti: — Për Zeqo Korbin si mendoni, ka vrarë vreten, apo...?

— S'di ç'të them! Kur u ngjita në krye të shkallëve, dëgjova zérat e tyre... Të tre ishin gjallë.

Adil Çika regjistroi faktin në kujtesë dhe u mundua që, ashtu siç e kishte menduar, çdo gjëje t'i jepte mundësishët pamje sa më miqësore.

- Vetëm këta të tre ishin në dhomë?
- Në sallon! — korrigjoi Astrit Pema.
- Më falni!
- Më mirë t'i marrim me radhë. Nga doni të fillojmë?
- Nga Korbajt. Ju besoj se jeni njohur me kohë me ata.
- Vite më parë.
- C'ju lidhte?
- Asgjë. Dikur kisha punuar si tipograf në shtypshkronjën e tij.
- Shumë kohë?
- Jo!
- Pse u larguat?
- Më largoai ai... Zeqo Korbi, — tha me inat Astrit Pema.
- Për c'arsye?
- Politike... Në shtypshkronjën e tij shtypeshin komunikata komuniste. Ai kishte kërkuar nga unë disa herë që të tregoja njerëzit...
- Ti kishe dijeni?
- Natyrisht... Prandaj edhe më hodhi në rrugë... Bile më arrestuan, por, për mungesë provash, më liruan.
- «Këtu duhet të jetë burimi i mërisë së tyre,»
- mendoi Adil Çika dhe takoi gotën me atë të Astrit Pemës.
- Gëzuar! — tha dhe qëllimi i pyeti: — C'njeri ishte Zeqo Korbi?
- I keq.
- Në ç'drejtë?
- Në të gjitha... Smirëzi. I vrazhdë. Makut...
- Po qëndrimi i tij ndaj luftës sonë?
- Shumë armiqësor...
- Po e bija?
- Vajzë e përkëdhelur dhe mendjelehtë. Bururia, tualeti dhe veshja me gusto bëri që të

binte në sy pa mbushur njëzet vjetët... Në fillim iu vardisën moshatarët e saj dhe më pas nëpunësit tanë e ushtarakët e huaj... Kjo e kompromontoi shpejt... Ç't'ju them? Veprimet e saj nuk ishin shumë të pastra. Kurse i vëllai ishte tip më vete. Një pijanec që të neveritej... Dot të thosha një njeri që s'e përcaktoje dot karakterin dhe të ardhmen e tij.

— Po q'e detyroi të veshë uniformën e oficerit? — pyeti Adil Çika.

— S'di ç't'ju them për këtë, shoku kapiten, — tha Astrit Pema dhe vuri në buzë gotën e konjakut.

Adil Çika, për të zënë përsëri fillin e bisedës, pyeti:

— Herën e fundit unë ju pyeta: ku ndodhet shit kur ngjau aksidenti...

— Po! — e ndërpreu Astrit Pema. — Pasi përshkova korridorin e errët, ngjita shkallët e katit të dytë. Ishin po ato shkallë me mermer të bardhë të kombinuar me harmoni me bordura të zeza... Vetja m'u duk krejt e huaj dhe vetëm atëherë pyeta se përse erdha. Ç'do të bëja? Ç'kuqtim kishte një ballafaqim kaq i papritur me atë familje? Lashë valixhen në anë të shkallëve, i hoqa armës siguresën, rregullova patericat nën sjetull dhe, me kujdes, vazhdova të ngjittja shkallët. Nga salloni vinte zhurmë. Ishin copa bisede. Të bërtitura. Kërcënime. Dëgjova shkoqur se njëri përmendi emrin e njëfarë Smithi... — e ndërpreu bisedën dhe s'dihet pse hapi perden dhe pa motin,

— Po! U ngjitët... I hoqët siguresën revolvent... Dëgjuat të bërtitura... — përsëriti Adil Çika me qëllim që të vërtetonte saktësinë e tregimit të tij. — Po më tej?

— Dëgjova kërcënime... Pastaj, siç ju thashë, emrin e njëfarë Smithi.

— Kush e zuri në gojë këtë emër?

— Me sa duket Telati... «Do t'ju hapja shumë telashe po të ndodhët kjo,» tha ai dhe dëgjova që u ankua për kokën që i dhembte shumë... Umbështeta mbi parmakun e drunjtë. Edhe pse dera ishte gjysmë e hapur, vura re se asnjeri s'kishte dëgjuar hapat e mi. Ata crrreshin, bërtisin, flisnin si në ethe, si në kllapi, urdhëronin... s'di ç'bënин, kapiten! I njoha. Në fillim u përqendrova te plaku. Ishte hequr ca në fytyrë, mollëzat i kishin dalë më shumë, kurse hunda e buzët i ishin holluar. Edhe femra dukej më e plakur nga ç'e kisha lënë dhe të binin në sy njollat e tualetit blanga-blanga, buzët e fryra, sytë e futur thellë. I treti e kishte futur kokën e vogël midis duarve që i dridheshin. Pastaj ai bërtiti: «Baba!... Drita!» Ishte po ai zë që kishte përmendur emrin e Smithit. Pastaj u ankua për kokën që i dhembte dhe prapë tha: «Po, ndërsa unë e kam shpëtimin tim,» dhe i tregoi të atit diçka që mbante në dorë, «ju...» «Hidhe atë,» e urdhëroi i ati. «Smithi na porositi ta përdorim vetë dhe për vete,» dëgjova përgjigjen e tij. «Mos u çmende?» thirri Zeqo Korbi me sa kishte në kokë. Unë vura re se ajo ishte një ampulë e vogël... Pastaj dëgjova të bijën, Dritën, që iu lut të atit, s'di përsë, dhe përsëri Telatin që i tha: «Unë i dëgjova të gjitha, baba. Ç'do të bëhet tashti me mua? A nuk do të na marrin shtëpinë? Këtu pas një javë do të vijnë banorë të rinj... Ku do të stërvitem unë? Në bodrum? Po armët? Po ato që keni fshehur ju?...» Zeqo Korbi kishte ngrirë në mes të sallonit iu lut të birit që të qetësohej.

Pas këtij shpjegimi, ndërkohë që Astrit Pema

ndezi cigare dhe e ftoi Adil Çikën të pinin, kryehetuesi përtériu në mend gjithçka kishte dëgjuar dhe u ndal në fjalët e fundit: «A nuk do të na marrin shtëpinë... Ç'do të bëhet me mua pastaj?...» Tundi kokën dhe tha me vete: «Ky ishte një fakt që duhej vlerësuar. Mundet që ky vendim i organeve të pushtetit të ri të jetë burimi i dramës për familjen Korbi.» — Astrit Pema vazhdoi: — «Tashti me siguri do kërkon që përsëri të arratisem, kurse ai i ardhuri me mballomë në sy, sipas urdhreve që ka marrë, ka kurdisur një plan tjetër. Mbrëmë më ftoi të shëtisnim me makinë... E kuption që llimin e tij, baba?» pyeti të atin... «Sot kush-edi ç'do të kërkojë prej meje. Me siguri një provë besnikërie... Dhe, pasi t'i konsumojë të gjitha planet, porositë që ka marrë dhe, natyrisht edhe dëshirat e tij, të cilave unë nuk do t'u bindem, do të më urdhërojë që të përdor ampulën... Po edhe atëherë keq do ta keni. Si do më varrosni? Ku do më varrosni?... Ndoshta prifti... Ndoshta morri i kuq... exantimatikja.» Përsëriti këto fjalë pa kuptim dhe përsëri dëgjova një «oh» të gjatë... «Mos mendo kështu, biri im,» iu lut Zeqo Korbi, po ai s'e dëgjoi dhe i tha se donte të dilte jashtë. «Mos u çmende?» — e pyeti i ati. «Do t'ju hap shumë telashe edhe në qoftë se do të çmendesha. Në spitalin psikiatrik do të kërkojnë shkakun e sëmundjes.» Pastaj u ankua se i dhimbte shumë koka dhe iu lut së motrës që të lajmëronte një mjek. «Po më dhemb shumë, baba,» — u ankua ai dhe përsëri e pa me kujdes ampulën... Zeqo Korbi duket u tremb dhe përsëri ia kërkoi me lutje. Ai shtrëngoi dorën dhe dëgjova që tha: «Ky është kujtimi i fundit nga kapiten Smithi... Mjafton ta kapër-

dish dhe çdo gjë merr fund.» «Hidhe!» e urdhëroi gati si i çmendur Zeqo Korbi.

Telati s'luajti nga vendi. Vazhdonte të shtrëngonte në grusht atë pilulë të vogël dhe shikonte me sy të çakërdisur. «Jo,» tha ai dhe humbi drejtpeshimin e ra në dysheme. I ati dhe e motra u sulën mbi trupin e tij. E morën në krah dhe e shpunë në një dhomë ngjitur. Kjo ishte e gjitha, shoku kapiten, — Astrit Pema mori në dorë gotën e konjakut. — Gëzuar!

— Pastaj ju u larguat?

— Jo. Gjithçka m'u duk e çuditshme dhe shumë rrëqethëse. U shkëputa nga parmakët dhe s'e di as unë si e mora atë guxim. Pa u menduar gjatë, isha futur në sallon... Mbi tavolinë kishte cigare. Mora një dhe e ndeza...

— Tavolina ishte e shtruar?

— Dicëka kishte, po unë isha krejt i hutuar...

— Pjata, gjellë, shishe?

— Si t'ju them, shoku kapiten.

— Pastaj?

— Qëndrova ashtu. Pija cigare, shtrëngojë revolverin në xhep dhe prisja... Nga dhoma e tyre rrallë dëgjohej ndonjë fjalë si lutje... S'di ç'ndodhi më tej... S'di sa prita dhe pastaj duket qortova veten për këtë veprim të pamatur. Hapa derën dhe zbrita shkallët. Mora valixhen dhe... S'kisha dalë akoma nga korridori, kur dëgjova një britmë tjetër... Pastaj hapa të rëndë nëpër shkallë... Ktheva kokën. Qëndrova. Edhe ai qëndroi... U shtang... Deshi të thoshte dicë, por, kur më pa së dyti, duket se më njoihu. Ndoshëta më mori edhe për fantazmë... Ndoshëta për hije! Dëgjova që thirri: «Baba», dhe më pas lëshoi një hungërimë si bishë dhe, sikur unë të isha me të vërtetë fantazmë, u drodh. Përsëri një zë i frikshëm dhe u sul përjashta. Dëgjova de-

rën që u përplas dhe po prisja në heshtje i mbështetur pas murit. Pastaj zërin e së motrës që i thirri: «Teli... Teli.» Dola në rrugë. Ngrita kokën nga papafingoja... Dëgjova bilbilin e policit... Një ulërimë femre s'di nga erdhi...

— Po ju atë ditë na thatë se e patë Telat Korbin vetëm kur ishte i përgjakur? — e pyeti Adil Çika.

— Pikërisht kështu ndodhi. Kisha qëndruar në krye të rrugës. Në kryqëzim ishin grumbulluar njërëz. Eca drejt tyre... Po ju s'po pini, kapiten?... Gëzuar!

— Gëzuar! — ia ktheu Adil Çika dhe piu. Nga toni dhe mënyra se si i shqiptoi fjalët e fundit, kuptoi se ky ishte fundi i tregimit të tij.

— Ditën e parë që biseduam bashkë ju po-huat se, ndërsa po bëheshit gati të futeshit në dyqanin e kosshitësit, dëgjuat portën që u hap dhe kthyet kokën. Që andej kishte dalë një njeri. Kur ju pyeta unë se cili ishte, ju u përgjigjet: «Njeriu që u shtyp»... Sot po e shpjegoni ndryshe. Si qëndron e vërteta?

— S'është e mundur ta kem thënë kështu.

— Ju siguroj!

— Ai që doli në atë kohë ishte tjetër.

— D.m.th. një i katërt? — pyeti me interes Adil Çika.

— Po.

— Ju lutem, mundohuni ta kujtoni dhe na e thoni edhe një herë si ndodhi kur akoma s'ishit futur në shtëpi.

— Kur u drejtova për te dyqani i kosit, pa-shë se u hap porta e shtëpisë, — përsëriti. — Kisha humbur në këto mendime dhe në zallahinë e ditës së parë në kryeqytetin tim, kur dëgjova portën që u hap, pastaj pashë njeriun që doli.

— Cili ishte ai?

— As vetë s'e di pse iu fsheha shikimit të tij dhe kundrova vitrinën, — tha Astrit Pema, dhe përsëri ndezi cigare dhe piu konjak.

Adil Çika, vuri re se, ndryshe nga takimi i parë, ai ishte i qetë, fliste ngadalë dhe ishte bindës e i sigurt në ato që thoshte.

— D.m.th. ju s'e njohët atë?

— E kuptoj që atë ditë s'i paskam thënë të gjitha, — tha ai dhe fërkoi ballin me nervozizëm. — Më falni, po s'kam dashur t'ju fsheh as gjë, shoku kapiten. Ai kishte veshur një mushama të zezë dhe e kishte ngritur jakën aq shumë, sa dukej sikur kokën e kishte futur në një këllëf. Prandaj s'kisha si e njihja, aq më tepër që ai nxitonë dhe koha ishte me shi.

Kur dëgjoi këtë pohim, Adil Çika mendoi se çështja megjithatë po merrte rrugë. «Na doli dhe një i katërt, — tha. — Ja pra, sado në fshehtësi që të kryhet krimi, ai përsëri lë gjurmë...»

— Po ku mund ta kërkojmë... Të paktën afërsisht?

— Besoj se s'do ta keni shumë vështirë. Do ta gjeni.

— Pse e keni këtë bindje?

— Sepse tek ata hynin e dilnin pak njerëz! — tha Astrit Pema dhe përsëri takoi gotën me atë të Adil Çikës.

Pas kësaj bisede të gjatë Adil Çika formoi bindjen se ai s'kishte asnë lidhje me çështjen Korbi. Prandaj e pa me vend që çdo gjë ta ndërpiste këtu pa e pyetur se nga vinte, ku ishte gjyntuar e të tjera hollësi si këto. «Çdo ngacim do të jetë jo i këndshëm për të, në mos i dhimbshëm, — mendoi. — Një herë tjetër... Ka kohë, — tha dhe, pasi takoi gotën përtë fuqdit herë, u ngrit. Doli në rrugë duke

vrarë mendjen tani për të katërtin, i cili duhej ta njihte edhe fillin. Edhe fundin... Edhe shkakun e këtyre ngjarjeve. Po cili duhet të ishte ai? Hajde ta gjeje! «Po ky Smithi cili të jetë? Ah, Smith, Smith! — pëshpëriti ai. — S'm'u ndave që s'm'u ndave tërë jetën, — dhe kujtoi se gjatë luftës atij i kishte takuar të shoqëronte për dy muaj rresht një oficer me emrin Smith, ish- i dërguar i misionit ushtarak anglez pranë forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. — Ndoshta është i njëjtë Smith, ndoshta Smith me ftyrë tjetër. Po ampula? Ç'ka dashur të thotë njeriu që u shtyp? «Kapiteni Smith më porositi...» Çfarë të ketë porositur? Sigurisht që ampulën ta ruante për çastin e fundit dhe vetëm për vete! Ja pra si morën rrugë ngjarjet, — tha Adil Çika dhe iu duk se u lëkundën tërë versionet dhe supozimet. — Më duket se diçka tjetër na doli përpara, — tha, — diçka më serioze nga ç'e pandehnim,» — dhe nuk harroi të kujtonte as priftin, që, sipas ish-shitësit të Zeqo Korbit, na ruante ca marrëdhënie të fshehta me Drita Korbin», as «të katërtin», që duhej gjetur me çdo kusht, se ai kishte dalë nga shtëpia pikërisht në një moment kaq të acaruar. Dhe përsëri i dolën para syve ampula me cianur, medallioni i artë me Krishtin e kryqëzuar... Ora në kopësht... Monedhat rrëzë murit... varri i hapur. «Në djall të shkojnë të gjithë!» — tha dhe u përqendrua mbi një shpallje të shkruar me shkronja të mëdha që kishte mbështjellë shtyllën e betonit, gjë që i krijoi bezdi në të lexuar. Era, ose ndoshta edhe ndonjë dorë fëmije, kishin grisur copa të saj dhe lagështira kishte formuar ca shirita ngjyrash në të.

Shpall

Gjithë popullatës së

Ruhuni nga tifo exantimatiqe (e morrit)

Në stinën e ftohtë vijnë edhe shumë sëmu
të ndryshme prej të cilave ajo me zak
shtë tifo axanti ti — e mo

Kjo sëmundje është e rrezik

na përhapet më lehtë në gjii
asa preventivues që

) Të jemi gjithnjë të pastër. Të lah

b) Të luftohet paraziti morr sa herë që

c) Vaksinimi pranë ambullan
sëmundja paraqitet

Rreziku i ma

eventual

seksioni i ish

N. Cl.

Adil Çika la shtyllën e betonit, lajmërimet, shpalljen dhe vetëm tashti vuri re se kishte filuar të errej. «Karkaleci, — tha ai me vete. — Butulizma. Buburreci i Kolorados. Ja edhe kjo si e kishte emrin? Exam... jo exanti... exantimatkja... Ptu! Dhe të gjithë janë sulur si bisha kundër pushtetit të ri. Edhe këto insekte, këto mikrobe të vogla e të padukshme mundo-hen që ta gjunjëzojnë pushtetin e ri, ta dobësojnë sadopak. Ta mundin... Ptu! Dhe këto janë jo më të mira se borgjezët, se armiqtë, se spekulatorët,» — tha dhe ndjeu se një gllom-kë iu formua në grykë... Po atë ditë nga një informacion që kishte dërguar seksioni i veterinarisë thuhej: «Njësoj si tregëtarët e tjerë edhe ata të bulmetit, spekulojnë, kanë gjetur dhe

praktikojnë forma nga më të djallëzuarat për të fituar në kurriz të popullit. Bile një pjesë e tyre dëmtojnë shëndetin e tij... Qumështit i marrin ajkën e i hedhin ujë. Dhe më e keqja është se i hedhin ujë të çfarëdoshëm... Bile edhe ujë kanalesh me bacile të tifos...» Edhe ky mikrob duhet të jetë i përafërt me atë, hë! Si quhej? Exantimantike... e morrit, — tha Adil Çika dhe kujtoi se i njëjti spekulim ndodhte edhe me gjalpin, të cilin shitësit e shtonin me kungull të zier, me mjaltin, gjizën e produktet e tjera... — Ptu! — bëri. — Ç'telashe i dalin përpara pushtetit të ri... Veç armiqve që s'i hedhin kollaj armët, s'të lënë as këta, — tha dhe përsëri iu kujtuan hollësirat e informacionit, i cili diku nën vizonte: ... «Një kg ujë shitet mbi shtatëdhjetë franga... Dhe kjo ndodh sepse kemi gjetur tregtarë që i shtojnë gjalpit edhe mbi pësëdhjetë për qind ujë...» Ptu!»

3

Vitoja e priste në vendin ku afishoheshin reklamat e kinemave. Ajo lexoit titujt e filmave, pa me radhë fotografitë e artistëve dhe, e mërzitur nga pritja e gjatë, u fut në një dyqan antikuarësh, pastaj në një tjetër manifature dhe përsëri shkoi në vendin e takimit. Retë lëviznin në drejtim të jugut.

— U vonova? — pyeti Adil Çika.
— Si gjithnjë, — ia ktheu ajo dhe e zuri nga krahu.
— Shëtisim? Apo ulimi diku?

— Më mirë të shëtisim!

Për të arsyetuar vonesën, atij i shkoi ndër mend të fuste në bisedë diçka nga takimi me Astrit Pemën dhe ndoshta atë pjesë që kishte përbajtjen më të dhimbshme. Këmbën. Patricat... Por gjëzimi që shquhej në sytë e njerëzve që shëtisnin të ngeshëm, e bëri të hqite dorë dhe kërkoi diçka më të bukur e argëtuese.

Ecnin në heshtje. E pa në sy dhe iu duk se hëna kishte shpërndarë retë e kishte zbritur pranë tij.

— A e di si quhej më parë kjo rrugë?

— E «Barrikadave!» — tha Vitorja.

— Jo! «Mbretëresha Elen».

— Cila ka qenë kjo?

Adil Çika, ngaqë s'e kishte paraparë kurrë se një ditë mund ta pyesnin për mbretëreshën, së cilës i dinte vetëm emrin, nxitoi të thoshte:

— Më vonë mori emrin «Ruga mbretërore».

— Sa frikë i kam princeshat dhe mbretërit,

— tha ajo kur pa ca mure të larta që rrethonin rezidencën e ish-mbretit Zog.

Nga errësira erdhi një kollë e thatë.

— Kthehem, — tha ajo.

— Shiko si vrapojnë retë! — tha Adil Çika, i penduar që në bisedën e tyre përsëri kishte futur diçka nga e kaluara.

— Shkojmë në kinema?

— S'ka asnje film të ri.

— Shohim programin!

— E pashë. Janë të njëjtët filma: Në kino «Kosova» shfaqet filmi «Vasilika e bukur» me Druzhnikovin dhe Tamarovën. Në kinema «17 Nëntori» «Tahiri dhe Zyraja...» Filloj përsëri shi, — tha ai.

— Vrapojmë?

Të dy u zunë pér dore dhe u futën në një rrugicë.

— Eja, — i tha ai dhe e têrroqi nën strehën e gjerë të një shtëpie të vjetër.

— Ti u lage, — i tha Vitoja dhe afroi buzët në faqen e tij.

— Të kishe marrë çadrën.

— S'e prisja, — tha ajo.

— Shkojmë atje! — dhe tregoi një palë shkallë druri.

— Shkojmë, — tha ajo.

— Me vrap, — dhe i shtrëngoi dorën. — Një, dy, tre.

Kapërcyen një pellg me ujë, një kalldrëm të copëtar dhe u futën nën ahurin e vjetër.

— Këtu do ketë minj, — tha Vitoja.

— Le të ketë edhe ujq, — tha ai dhe i hodhi dorën në qafë.

— Kam frikë!

— Pse?

— Nuk dëgjon këmbë?

— Janë banorët e shtëpisë, — tha ngadalë dhe ngriti kokën.

Nga hapësirat e dyshemesë që ndërpritej nga trarë të vjetër zbriste një dritë e hollë dhe e mekur që çante errësirën e nënshkallares, sfumohet dhe humbiste në tokën e përbaltur. Dyshemeja kërciste sa herë që shkelnin mbi të. Hapat ishin të përtuar dhe gati-gati të humbur.

— Ç'karakatinë! — tha ai.

— Kam frikë! — tha përsëri ajo dhe u afrua më shumë pas trupit të tij.

Të dy përgjuan zérat që vinin nga dhoma e vjetër dhe u puthën.

— Mos!

— Le të na dëgjojnë!

— Më duket se këtu banojnë dy pleq.

— Qofshin edhe bebe, — tha Adil Çika dhe diçka i tha në vesh...

— Thonë se kanë një jetë që banojnë bashkë.

— E pastaj?

Dyshemeja kërciti përsëri.

— Po kurrë s'janë martuar!

Adil Çika qeshi.

— Pse qesh?

— Dy pleq që bëjnë akoma jetën e të dashuruarve, — tha ai dhe, pa mbaruar, dëgjoi përsëri diçka që u përplas në dysheme. Pastaj u dëgjua një kollë e mbetur.

«Plasja,» — iu përgjigj kollës një zë i ngjirur.

— Është gruaja, — tha Vitoja. — Dëgjoje!

«Mos më shaj,» — u dëgjua një zë tjetër më i fortë. ... «Çdo gjë e lindur prej zotit nuk bën mëkat. Ai nuk mund të bëjë mëkat sepse ka lindur prej zotit.»

«Kush i ka thënë këto fjalë?»

«Zoti pra, — tha zëri i burrit. — Dhe u drodh zemra e Davidit pasi regjistroi popullin. Dhe i tha Davidi zotit bëra mëkat të madh duke vepruar kështu.»

«Po këtë quan mëkat Davidi?»

«Pse si duket?»

— Më vjen të qesh me zotin.»

Shiu kishte pushuar. Adil Çika ia hoqi nga krahët xhaketën Vitos, e veshi dhe dolën në rrugë.

— Si e kam mbajtur gazin! — tha ajo.

— Botë e perënduar, — tha Adil Çika.

— A nuk të kujtojnë diçka të lodhshme?

— Ashtu duket. Bile diçka të dhimbshme.

— Diçka të mjerueshme do të shkonte më shumë, ose gati-gati diçka pa jetë.

— Edhe tani kam frikë, — tha ajo. — Me gjithatë do të kisha qejf t'i njihja!

— E ç'të duhen?

— Kot.

— E marr me mend se si duhet të jenë katanësur.

— Si? — pyeti Vitoja.

— Mos më keq. Sijeta e tyre boshe... Sterile.

Ata i ishin afruar shtëpisë dhe Vitoja e tër-hoqi pér krahu që ta merrte brenda.

— Jo! — iu lut Adili.

— Mos ma prish, shpirt! Ata na presin.

— Jam i lodhur. Do të ha bukë dhe do të shtrihem. Nesër kam shumë punë, — tha ai pa i treguar se, edhe pasi të ndaheshin, nuk do të shkonte në hotel.

— Do të shihemi?

— Ndoshta!

— Unë do të pres në dritare deri vonë, — i tha ajo dhe e puthi.

— Natën e mirë! — e uroi Adil Çika dhe nxitoi hapat.

Nata ishte e errët e pa hënë. Dritat ishin të zbehta dhe ai eci me kujdes se mos futej në pellgjet që kishin mbetur në rrugën me gropat.

Përsëri afër mesnatës.

Ministri, që luante tenis, pasi bëri **dushin e zakonshëm**, lëpiu flokët pas ballit të gjerë, u mbështoll me rrobëdëshambrin **e trashë pushtor**, u ul në një **kolltuk** të butë dhe ndezi cigare në **pritje** të zotit deputet. Ai hodhi sytë mbi tavolinën e punës ku ishin stivosur njëra mbi tjetrën disa paketa «Diamant» dhe tha me vete: «Gjithçka e presin nga unë... Hëm! Kurse ai zoti S. vetëm na jep urdhra... Gënjen. Na gënjejnë!...»

Mendimet ia ndërpree zilja elekrike. Në studion e tij hyri Ahmet Bregu, i cili, pa shkëmbyer asnje fjalë, i zgjati një paketë «Diamanti».

Ministri e pa në sy. Edhe Ahmet Bregu kështu bëri.

— Kush ta dha?

— Berberi.

— S'të tha gjë tjetër?

Ahmet Bregu tundi kokën në shenjë mohimi.

— Po deputeti?

— S'e di.

— As prifti s'është dukur?

— Jo!

Papandehur të dy kthyen kokën nga dritarja. Dëgjuan në heshtje kambanat. Dangun. Dungun...

Gruaja që vuante nga astma u fut në majë të këmbëve në dhomën e punës të deputetit dhe, si me shaka, e gudulisi në ije.

— Bullafiqe! — e shau ai dhe mori frysme thellë.

— Deputeti im!

— Më lër vetëm! — tha ai dhe zgjati duart nga oxhaku.

— Do një kafe?

— Edhe ajo më duhet dhe...

— Dëgjova se zotin Shefqet¹⁾ këto ditë do ta nxjerrin në gjyq. Eshtë e vërtetë?

— Lexo gazetat.

— Deputeti im, pse je kaq nervoz?

— Më lër! Nuk e sheh që kam kaq ditë e s'po qułlos gjë, — tha dhe i tregoi së shoqes tufën e letrave që kishte mbushur duart.

1) Eshtë fjala për Shefqet Bejën që u arrestua me grupin e deputetëve për veprimtari armiqësore kundër pushtetit.

— Thonë se do ta ekzekutojnë... Edhe të tjerët.

— O perëndi!
Zhurma e kambanave të mesnatës e ndërpren bisedën e tyre.

— O perëndi! — pëshpëriti ai sërishmi dhe iu lut ta linte vetëm.

Prifti në këtë kohë po kapërdinte tabletën e tretë për të qetësuar zemrën, ndërsa zoti S. në selinë e misionit të tij pinte uiski, i binte kryq e tërthor dhomës së shtruar me tapet duke vrapë mendjen që raporti që do të transmetonte me radio të ishte sa më lakonik. Bindës dhe...

Në hetuesi dialogu filloj kështu:
Hetuesi — I pandehur Alush Boga!
A. Boga — Urdhëroni, zoti hetues.
Hetuesi — Kur e keni filluar aktivitetin kundër pushtetit popullor?

A. Boga — Herët.
Hetuesi — Para Çlirimt ku ke punuar?
A. Boga — Në zonat e okupuara nga gjermanët.
Hetuesi — Ç'shkollë keni mbaruar?
A. Boga — Shkollen teknike në Tiranë.
Hetuesi — Me drejtor?
A. Boga — Harri Fulcin.
Hetuesi — Përveç mësimeve merresh me punë tjetër?
A. Boga — Edhe me një kurs spiunazhi, të

cilin e zhvillonim në orët e vona në shtëpinë e nëndrejtoris, Çarli Hallingstenit.

Hetuesi — Ishit shumë?

A. Boga — Bajagi...

Hetuesi — Me ç'parullë njihnit njëri-tjetrin?

A. Boga — «Eja, buburreci im».

Hetuesi — Po buburreci i Kolorados ç'ishte?

Ai hesht! Pas çdo pyetjeje hesht dhe bën përpjekje të përtërijë sëmundjen e improvizuar. Detyrohem t'i ndërpres këtu hetimet.

Gjyqësore:

Nesër në qytetin e Vlorës fillon seanca gjyqësore kundër tre armiqve sabotatorë që kanë shtrembëruar udhëzimet e Qeverisë Demokratike në zbatimin e Reformës Agrare. Këta armiq kanë shpërdoruar besimin e popullit, kanë bërë allish-verishe duke e përdorur tokën sipas interesave të tyre. U kanë dhënë tokë njerëzve që nuk u takon, që s'janë marrë kurrë me bujqësi dhe që banojnë në qytet. Kanë marrë ryshfete dhe para.

Mbi ta le të bjerë grushti i rëndë i popullit.

Okazion:

*Shitet një lokal në Rrugën e Durrësit.
Përmasat: 7x8 m (Me lozhë)*

*Pajisjet: 10 tavolina të përdorimit mesatar.
40 karrige. Banak. Qepenë hekuri me bravë se-
krete.*

Çmimi: (Vendoset pasi të jepet pëlqimi.)

*Pronari
Llaqi T.*

KAPITULLI VI

1

Ato ditë plot tension e kishin lodhur së tepërmë Adil Çikën. As nga gjendja shpirtërore s'ishte mirë. Nuk flinte dhe nuk hante si duhej. Përtatë mposhtur këtë shqetësim lexonte deri vonë në mesnatë. Kurse në mëngjes, ngrihej herët. Pasi pinte kafe, shkonte në zyrë, hapte dritaren dhe mbështetej mbi parvaz. Kundronte qytetin që zgjohej. Qytetin që merrte jetë e ripërtërihej çdo ditë. Dhe s'dihet pse herë-herë e ngulte vështrimin në një pikë, afër një kryqëzimi qorr. Shikonte dhe çdo gjë e krahasonte më të kaluarën...

Ndjeu të ftohtë dhe iu afrua sobës. Kontrolli në shtëpinë e Korbijve kishte mbaruar afër mëngjesit... Ai s'e hiqte dot mendjen nga tërë ato hollësi që i ishte dashur të shikonte e t'i regjistronte me kujdes... Iu afrua përsëri dritares.

Një copë mjegull e ftotë, transparente rrinte si e ngrirë mbi kryqëzimin e rrugës. Ishte diçka e lodhshme kur shikoje vetëm këtë copë mjegull që s'lëvizte nga vendi. Një copë mjegull gati pa ngjyrë. Pas saj ia tërroqi vëmendjen një motoçikletë që ndaloi me zhurmë. Me shpejtësi kaloi edhe një veturë e dëmtuar në pjesën e parë dhe më vonë një prift me rasën e zezë, me kamillaf e këpucë të zeza... Adil Çikës iu errën sytë dhe harroi çdo gjë: kryqëzimin e rrugës, veturën e dëmtuar dhe në vend të atij prifti, tek i cili gjithçka ishtë e zezë, s'dihet pse iu faneps fytyra e një kleriku tjetër, ajo e dom Kelës, që i rikujtoi ngjarjen. «Ç'është kështu,» — tha dhe tundi kokën fort. Figura e priftit u zëvendësua me një tjetër po aq të errët. Shkoi te tavolina dhe rimendoi ngjarjen dhe radhën se si duhej të kishin ndodhur krimet. Po përsëri prifti s'i hiqej nga mendja. Ju bë se ishte ulur galic në trurin e tij dhe gjykoi: «Mos vallë i katërti është ai dhe gjithçka është rezultat i ndonjë përpjekjeje që ka bërë për të fshehir lidhjet me Drita Korbin që pa dyshim kërcënonin autoritetin e tij? Le t'i shkojmë çështjes deri në fund dhe të besojmë mundësinë se i vëllai i Drita Korbit, Tetlat Korbi, që ka munguar gjatë këtyre dy vjetëve, ka mësuar për këto marrëdhënie të papëlqyera dhe... Dhe çfarë pastaj? — pyeti Adil Çika me qesëndi pas këtij gjykimi që ia kishte mpirë mendimet... — Jo. Kjo nuk qëndron. Ndryshtet të ketë ndodhur. Ngjarja duhet të ketë motive më të forta. Duhet të jetë më e thellë...»

— Mirëmëngjes, shoku kapiten! — përshëndeti Mete Jaipi.

— Si u dive, Mete? Më duket as ti s'i paske mbyllur? Kohë e keqe!

— Se ka sajin koha, po nata, — tha Mete Jaupi.

— Ndize!

— Esëll?

— Sikur është hera e parë! — ia ktheu Adil Çika.

— Më ka çarë dora, — u ankua Mete Jaupi dhe i afroi shkrepësen e ndezur. — Erdha të të njoh me jetën e tij.

— Të kujt?

— Të zotit Korbi, — tha Mete Jaupi dhe hapi dosjen.

— U plotësua informacioni?

— Besoj... — tha Mete Jaupi dhe zgjati fletët e shkruara.

• • • • •

Dera e Korbajve nuk kishte pasur kurrë më shumë se një mashkull. Prandaj pleqtë mbanin mend se lindja e Zeqo Korbit ishte pritur me batare armësh. Po klithmat e para të fëmijës kishin dërguar në botën tjeter shpirtin e s'ëmës, dhe fëmija u rrit me gjirin e një jevge që kishte qumësht të mirë (*aq të mirë*, kishte shkruar me qesëndi Mete Jaupi, *sa, kur djali mbushi pesë vjeç, peshonte sa një dem*). Adil Çika qeshi me këtë krahasim të Mete Jaupit dhe levoi më po-shtë: «Kur mbushi 20 vjet, Zeqo Korbi ishte ngatërruar me një moshatarin e tij dhe kishte shtënë me armë. Kjo ngjarje e kishte detyruar të hidhej matanë kufijve.»

— Me se është marrë atje? — pyeti Adil Çika.

— Një perëndi e di, — tha Mete Jaupi. — Ai nuk u kthye as kur kishte marrë vesh për vdekjen e të atit dhe as kur kishte mësuar se njerka e kishte bërë rrush e kumbulla pasurinë e tij. Nga emigracioni u kthye bashkë me prinçin

Zog, krah tij dhe natyrisht dhe si miku i tij. Pas një viti i erdhi dhe e shoqja. Thonë se ishte malazeze e bukur, — tha Mete Jaupi dhe qeshi...

Me ndërhyrjen e Zogut ishte harruar gjaku dhe Zeqo Korbi ishte bërë pronar i një çifligut të mbetur buzë Erzenit, pronë e një beu fanolist. Pastaj vuri ullinj e bagëti dhe shpejt emri i tij ishte bërë i dëgjuar jo vetëm në fshatrat e krahinës, por edhe në Tiranë ku jetonte malazezja me dy fëmijët... Ai ishte njeri praktik dhe, si i tillë, më shumë se ofiqet, ndiqte me kujdes marrëdhëniet e reja që po lindnin, kapitalin e huaj që po depërtonte çdo ditë e më shumë në Shqipëri dhe përpjekjet e atyre që po ndërtonin hotele, dyqane, punishte. Tamam në këtë kohë nxitoi të blinte një dyqan në mes të Tiranës dhe shpejt mori emrin «tregtar Korbi». Pas dyqanit bleu një shtypshkronjë të vogël ku shtypeshin gjithfarë gjérash, nga kartëvizitat deri te lajmërimvdekjet dhe bllonet për llogaritë e bakejve. Më pas mori në sipërmarrje ca ndërtimë shtetërore që, veç të ardhurave, i dhanë emër dhe e bënë të njohur me rrethet e larta zyrtare të qeverisë mbretërore. Bile u përtëri miqëmbente kartëvizita dhe t'i dërgonte peshqeshe... E kërkonte koha dhe rangu i tij që një pjesë të kapitalit ta harxhonte për shkollimin e fëmijëve. Telati vazhdoi Liceun, kurse vajza shkollën «Nëna mbretëreshë»... Ardhja e Italisë dhe ikja Korbin, po shpejt e mori veten dhe bashkë me mbretit Zog, sikur e tulatën në fillim Zeqo tregtinë fillooi t'i pëlqente edhe karriera ushtarakë. Të birin e dërgoi në Itali ku studioi dy vjet... Por jetën e rehatshme të Korbajve e tronditën ca ngjarje të papritura e dramatike: Në fillim

ra zjarr në shtypshkronjë. Pa kaluar tre muaj u mbyt zonja Korbi. Hamendjet qenë nga më të ndryshmet. Ca ua hodhën fajin nervave, ca mërisë, kurse të tjerë thanë se malazezen, tashmë të shkuar në moshë, i shoqi e kishte zënë me një nga shërbëtorët. Pas një muaji u kthyesh edhe i biri nga Italia, që gjeti si shkak vdekjen e nënës dhe shpejt u vu pas pijes dhe kumarit. I ati, që po i kalonte të pesëdhjetat, kishte ngulur këmbë që i biri të martohej. Po kjo s'ndodhi kurrrë. Në fillim njerëzit dyshuan se mos ndiqte zakonin e të parëve të tij, po u dëgjuan zëra të tjerë. Gojë të liga thanë se, gjoja, Telat Korbi, kur na paskësh qenë në Itali, kishte marrë një sëmundje të rëndë, që s'i dihej emri e s'i gjen-dej ilaqi.

Pushtuesit e rinj, si edhe të parët, s'i sollën ndonjë të keqe. «Po s'i ngave, s'të ngasin.» Ky kishte qenë parimi i tij dhe i zgjidhi mirë punët e veta, pa rënë në sy për keq as te të huajt, por as tek ata të Lëvizjes.

— Të tjerat dihen! — tha Adil Çika.

— Po Telat Korbin çfarë e ka detyruar që të braktiste jetën e shthurur të kafeneve dhe një ditë të bukur të lidhej me forcat e Bazit?...

— Këtu ka diçka të errët. Por sidoqoftë vërtetohet nga të gjitha dokumentat që kemi se si ai është hedhur me forcat e Legalitetit... Pastaj është arratisur. Zego Korbi ka përballuar me shpresë presionet e pushtetit të ri dhe ka pritur me sot e me nesër zbarkimin e aleatëve! Prandaj mendoj se nuk duhet të kemi të bëjmë thjesht me një krim, qoftë edhe të jashtëzakonshëm, ose me ca vëtëvrasje të rëndomta, por me diçka më serioze. Ndoshta-ndoshta me diçka të organizuar, — dhe përsëri iu kujtua prifti që s'kishte se

ç'e lidhte me Drita Korbin veç lufta kundër puhetit të ri, dhe i katërti që ishte zhdukur para se të ndodhnin këto ngjarje të ngatërruara.

Mete Jaupi përsëri mblodhi supet.

— A nuk të duket se kjo ngjarje po na merr shumë kohë? — pyeti ndihmësin e tij Adil Çika dhe shkurtimisht i tregoi për pohimet e fundit të Astrit Pemës.

— Megjithëse kemi gjykuar, dëgjuar e parë shumë raste, vdekja e Drita Korbit dhe atit të saj më duket akoma e errët... Si... si sëmundje ngjitëse... Si tifoja e morrit. Në dreq të venë! — shau Mete Jaupi. — Ndoshta s'e gjeta mirë fjalën «sëmundje». Më duket si ethet e beharit, ose, ose, si njëfarë etjeje. Etje behari!

Adil Çika qeshi. Pastaj u ngrit dhe eci me përtesë. «Tifo e morrit, — përsëriti me vete, — si ajo e xanti... ntimatikja... Butulizma... Buburreci i Kolorados... Dos!... Çfarë dose,» — tha dhe u kthyte nga Mete Jaupi që po e ndiqte me kujdes çdo veprim të tij.

— Ti më duket s'je mirë... Sikur vuan nga një dhimbje e mundimshme, ndoshta-ndoshta e keqe.

— Jam vetëm i lodhur, vëlla!

— Léri! Në dreq të venë të gjithë!

— Janë të profesionit, — tha ai.

— Eja. Duhet të dalim. Duhet ta heqim menjen për pak orë nga kjo sëmundje, nga këto ethe të verdha, — u tall Mete Jaupi dhe i futi krahun.

2

Sapo hyri kosaxhiu, Adil Çikës i ranë në sy prekat dhe ngjyra e verdhë e ftyrës. E ftoi të ulej. Pastaj e pyeti për shëndetin, tregtinë dhe

i dha cigare. Kosshitësi herë shikonte kapitenin, herë tavolinën dhe herë tjetër gishterinjtë e tharë e të fishkur. Pyetjes nëse e kishte marrë vesh ç'kishte ndodhur në familjen Korbi, ai iu përgjigj menjëherë: «Po, zoti oficer! I kam dëgjuar nga të tjerët. — Dhe pasi u betua për Jesu Krishtin e pa i kërkuar shpjegime të mëtejshme, vazhdoi: — Ata kanë qenë vetëm klientët... Nuk di asgjë më shumë. As të afërmit e tyre s'i njoh. As miqtë», — tha dhe mori fryshtë thellë.

— Po një njeri që kishte ndër mend të fejohej me të bijën e Zego Korbit e ke njohur? — pyeti Adil Çika pa u futur në hollësira të tjera.

— Po, zoti, oficer!

— Si quhet?

Ai ngriti sytë nga tavani dhe u duk sikur u mendua.

— Ahmet!... — Po, po, Ahmet, — përsëriti.

— Po mbiemri?

— Nuk e di, zoti oficer. Di vetëm se dikur ka punuar në shtypshkronjën e Zego Korbit... Pastaj u fol se do të fejohej edhe me të bijën e tij... e ku di unë tjetër...

— Po banesën e tij e di?

Kosshitësi pas kësaj pyetjeje u hutua dhe balli iu mbush me bulëza djerse, heshti për një çast, u mendua dhe, pasi u bind se pyetjet s'kishin të bënin fare me punët e tij, u përgjigj:

— Në mos gaboj, në lagjen e nëpunësve.

— Tjetër gjë s'di për të?

— Thonë se kohët e fundit ka hapur një dyqan. Shkruan lajmërimë e ku di unë çfarë tjetër, — përsëriti së dyti kosaxhiu.

— Ju faleminderit! Mbaruam!

Kosaxhiu s'u zuri besë veshëve. «Për kaq më thirri, — mendoi. — S'e besoj!» — tha kur kujtoi se, para se të nisej në seksionin e punëve të

brendshme, përse nuk e kishte vrarë mendjen. Aq më tepër që ftesën e kishte lidhur me një kontroll të seksionit të veterinarisë të komitetit ekzekutiv të dy ditëve më parë dhe me ca pyetje delikate të inspektorëve që kishin të bënin me cilësinë e qumështit, kosit dhe gjalpit që tregtonte. Po të gjitha i harroi kur pa kapitenin që u ngrit në këmbë. Ashtu bëri edhe ai dhe, duke i uruar oficerit ditë të mirë, vuri dorën në zemër dhe përkuli trupin.

— Unë erdha për një punë, shoku kapiten.

— Personale?

— Pothuajse jo. Kam dëgjuar se familja e Korbajve u shua dhe thashë të ndihmoj edhe unë me ato që di... Kam parë se kanë dalë e hyrë oficerë atje dhe...

— Cili jeni ju, shoku qytetar?

— Kasap. E kam dyqanin përballë shtëpisë së Korbajve, ngjitur me kosaxhiun. Ai kot është trembur aq shumë. I thashë: Kot e ke, more Grigor. Kjo qeveri s'i bie njeriu në qafë po s'pate faj. Po hajde mbushi mendjen atij!

Kapiteni vuri buzën në gaz.

— Nejse! Unë desha t'ju vë në dijeni se një natë para se të ndodhnin ato vdekje vura re se në shtëpinë e Korbajve erdhën njerëz.

— Vonë?

— Vonë ishte, zoti oficer. Edhe herë të tjera kanë ardhur njerëz.

— Me siguri bënин ziafet.

— S'e besoj, zoti oficer.

— Ndoshta luanin kumar?

— As kumar, zoti oficer. Ata qëndronin pak kohë dhe përsëri largoheshin. Por gjithnjë natën.

Adil Çika bëri sikur nuk e vlerësoi këtë fakt dhe qëllimisht shkoi drejt derës. Pastaj e pyeti:

— Po cilët ishin këta njerëz?

— Ishte shumë vonë dhe binte shi. Unë, pasi kisha siguruar mishin se mos e pështynin mizat, shova dritat e dyqanit dhe fillova të pastroja xhamat e vitrinës. Vura re se u ndez tri herë rresht drita e papafingos. U ndez... U shua... Prapë u ndez... Dhe nuk kaloi shumë kohë dëgjova kambanën e kishës që ra katër herë.

— Katër herë?

— Vetëm katër herë, zoti oficer! Bëra kryqin dhe lëvdova Krishtin. Mendova se dikush duhej të kishte shkuar në atë jetë në këtë mesnatë me shi. «I ndrittë shpirti,» thashë. Nuk kaloi shumë kohë nga goditjet e kambanave dhe pashë në fillim një njeri që u fut në atë rrugicë... Eci drejt, shtyu portën dhe u fut brenda... Epo, thashë dhe vazhdova të pastroja vitrinën. Binte shi dhe ishte aq vonë, sa... Po s'kaloi shumë dhe përsëri pashë një të dytë që ishte fshehur nën ombrellë. Edhe ai shtyu portën dhe u fut brenda. Pastaj pashë një të tretë... Një të katërt. Shumë njerëz hynë me radhë. Ishin të panjohur, zoti kapiten, dhe të dyshimtë. Thashë: Binte shi. Pastaj pashë se në krye të rrugës ndaloi një veturë. Dikush zbriti. Edhe ai u fut, — tha kasapi dhe u duk se këtu iu shterën fjalët.

— Pastaj?

— Dolën shpejt dhe përsëri një e nga një, zoti kapiten. Nuk e di cilët ishin? C'kërkonin? Ndoshë atë... — e la fjalën përgjysmë dhe ngri- ti supet. — Binte shi. Unë pastroja xhamat.

— Kaq?

— Këto kisha për t'ju thënë, zoti oficer!
Adil Çika, pasi regjistroi emrin e tij, e falën-
deroi dhe e përcolli deri te dera.

Ndërsa Mete Jaupi qëndroi përballë një vi-
trine, Adil Çika vazhdoi të ecte i menduar. Nuk
i hiqej nga mendja dëshmia e kasapit. «Pse du-
hej të shuhej dhe të ndizej tri herë drita në pa-
pafingo? — pyeti veten. — Dhe vetëm pas këtij
sinjali duhej që kambanat e kishës të binin ka-
tër herë? Kurse tërë këto ditë ata me siguri ka-
në dashur të humbasin gjurmët... Apo sinjali va-
zhdon?... Apo u ka shkuar mendja në diçka tje-
tër? Sidoqoftë duhet verifikuar nëse nga ajo dri-
tare duket kambanorja e kishës! Që nesër,» —
tha dhe të gjitha këto i lidhi me dëshminë e
Bejaze Rekës, fqinjë e Korbijve, që kishte po-
huar se në shtëpinë e tyre, vec të tjerëve, kishte
parë se hynte edhe një prift. «Vinte vazhdimisht
natën, zoti oficer, — kishte pojuar ajo. Edhe
të tjerët kështu thonë: vjen natën. Dhe ndry-
shonte veshjen... Herë vinte kapele, kurse herë
tjetër beretë.»

— Pimë kafe? — pyeti Mete Jaupi.
Takimin me shefin e seksionit të punëve të
brendshme e kishin lënë në orën dy... Kishte aco-
ma kohë.

— Pimë! — tha Adil Çika pasi pa orën.

— Nga kontrolli i shtëpisë së Korbajve, veç të tjerave, u gjetën mjaft dokumente që kompromentonin të kaluarën e Zeqos dhe të fëmijëve. Para të fshehura në mur, pas kornizës me fotografinë e çiftit Korbi, në qilar dhe nën shkallë. Floriri ishte groposur më së miri në themelet e shtëpisë... Në papafingon që shërbente si dhomë gjumi për diversantin Telat Korbi, u gjet një automatik, dhjetë granata, gjashtë karikatorë, një revolver dhe pajisje të tjera ushtarake. Të gjitha të markës angleze. Megjithatë ekspertiza nuk arriti dot të konkludonte për kohën e kthimit në atdhe. As për misionin e tij. — Adil Çika, ngriti sytë nga letra dhe priti mos shefi e seksionit të punëve të brendshme kishte ndonjë pyetje... — Edhe në tavanin e dhomës së gjumit të Zego Korbit u gjetën armë. Dy automatikë... Një arkë me municion, bomba dore. Këto të markës gjermane dhe të mbështjella me batanije, të pastruara e të vajisura... Edhe këto të gatshme për t'u përdorur në çdo kohë.

Ndërsa Adil Çika raportonte, shefi i seksionit dëgjonte me vëmendje informacionin dhe, për të fshehur zemërimin, shkaraviste shifra e viza në një copë letër dhe herë pas here pëshpëriste: «Ncëk! Ncëk!»

— Edhe në dhomën e së bijës u gjetën shumë materiale të papëlqyera. Veshje të modës që do t'i mjaftonin për njëqind vjet dhe erë parfumi të rëndë... Një kuti me korrespondencën e saj. Letra. Kartolina. Kartëvizita...

— Me interes? — pyeti shefi i seksionit.

— Besoj se po, — tha ai dhe përmendi se pjesa më e madhe ishte korrespondencë intime

që fliste për një shthurje të plotë. Autorët e kësaj korrespondence ishin ushtarakë, studentë, nëpunës të lartë, tregtarë të cilët herë i uronin Drita Korbit shëndet ose ditët e festave, herë tjetër e ftonin në takime. Kishte edhe të atilla, që, pas të puthurave, përfundonin vetëm me iniciale emrash, ose të tjera me firmë të palexueshme, ndërsa brendia e tyre linte shumë për të dyshuar. Më me interes Adil Çikës i ishte dukur korrespondencia që kishte pasur me priftin, e cila kishte vazduar deri ditët e fundit.

— Gjithnjë pa dalë nga rrethi i marrëdhënive intime, — tha Adil Çika, — ato lënë shteg interpretimi... Për ta bërë sa më konkrete dashurinë e tij, prifti gjen gjithëfarë shprehjesh, që, pa dyshim, kanë nëntekstin e tyre... Po është akoma shpejt për të konkluduar. Sapo u kám hedhur një sy, t'i krahasoj, t'i ballafaqoj dhe...

— Prifti duhet të ndiqet me kujdes! — e ndërpren majori.

— Kam menduar ta ngacmoj nga larg.

— Veç gjithnjë pa i rënë në sy. Ai s'duhet të nuhasë se e ndjekim.

— Vetëm se do ta gudulis.

Majori vuri buzën në gaz.

— Kujdes! — tha.

Pas këtij dialogu kryehetuesi shtoi se atë ditë që kishte ndodhur ngjarja ata duhet të kishin pasur ndonjë gosti, ose ndonjë festë familjare, ose gjendje siç e kishte përshkruar Mete Jaipi. Çdo gjë dukej se e kishte humbur shkëlqimin dhe ishte zymtuar. Mureve u kishte dalë boja, kurse erës që kishte lënë kufoma, përmendi kapiteni, ndihej edhe ajo e gjellëve të prishura dhe e al-koolit. Pastaj shtoi se nga gatimet dhe llojet e plasarisht e krijohej përshtypja se gostia ishte

shtruar vetëm për meshkuj... Pra, me sa dukej, kishim të bënim me një festë mashkulllore.

— Mungonin émbëlsirat? — pyeti shefi i sektionit.

— Edhe pijet e émbla, — plotësoi Adil Çika.

Majori vuri përsëri buzën në gaz.

— Njollat e gjakut kishin filluar të nxihe-shin... Gjeta të tilla në çdo cep të sallonit mbi shtresat dhe mobiliet. Megjithatë Drita Korbi nuk është gjakosur. Gjaku është i plagës së parë që ka marrë në kraharor Zeqo Korbi.

— Më tej?

— Edhe ora që është marrë nga bufeja dhe paratë që janë gjetur në kopsht e rrëzë murit, përsëri janë një «shpikje» për të na çoroditur... Një manovër.

— Kishte shenja të tjera bastisjeje?

— Asgjë me rëndësi... Ca rroba të hedhura andej-këtej. Ndonjë sirtar i hapur... Si t'ju them? Një veprim i kryer me nxitim dhe shumë frikë. Këtu duhet vlerësuar një fakt: Mendoj se bandilli që është marrë me këtë punë ka hyrë përsëri nga dera e ballkonit, e cila, edhe pse ishte gozhduar nga njerëzit tanë, përsëri u gjet e shqyer, — tha Adil Çika pa u futur në hollësi të tjera siç ishte letra mbi tavolinë (ishte një copë letër me përbajtje pak enigmatike... Ose e kodifikuar, e shkruar anglisht, të cilën Adil Çika akoma s'e kishte deshifruar), një kopsë e këputur që kishte njolla gjaku e të tjera si këto.

Majori mbështolli mjekrën me dorë kur Adil Çika e vuri në dijeni për informatën se, para se të ndodhë krimi, nga shtëpia e Korbajve kishte dalë një person, për të cilin tashti për tashti dinin vetëm emrin.

— Quhet Ahmet, — tha Adil Çika dhe pas

emrit dha hollësirat që kishte mësuar për të.

Shefi i seksionit të punëve të brendshme diçka shënoi në letrën që kishte mbi tavolinë dhe pastaj pyeti:

— Po mbiemri?

— Akoma s'e dimë.

— Ky njeri duhet identifikuar sa më parë!

— Një kasap na dha një informatë me vlerë.

Pasi i verifikuam thëniet e tij, del se gjithçka është zhvilluar siç thotë ai. Kulla e kambanave shikon plotësisht papafingon e shtëpisë dykatëshe, kurse bodrumi ka shërbyer për mbledhjet e tyre. Nga mënyra si ishte errësuar... bishat e cigareve dhe pajisjet, të linte përshtypjen se aty edhe herë të tjera duhet të jenë mbledhur njerëz, — tha Adil Çika dhe palosi fletën e shkruar.

Majori u ngrit në këmbë dhe, i menduar e në heshtje, lëvizi disa herë nga tavolina te dritarja.

— Harrova edhe një hollësi: kapaku i grafonit ishte i hapur... Mbi radio kishte pllaka të tjera me muzikë italiane, gjermane, franceze... Kjo do të thotë se gjatë gostisë ata kanë vallëzuar si miq... Kurse pastaj grinden... Vritten. Pse? — Pas këtyre Adil Çika heshti për një çast dhe u mendua.

Ndërsa majori vazhdonte të lëvizte nëpër dhomë, ai, pa ditur ç'mendim kishte krijuar, hodhi vështrimin mbi tavolinën e tij ku ishin radhitur disa shpallje njëra mbi tjetrën. Lexoi «*Shpallje bis*» dhe më pas lajmërimin e seksionit të veterinarisë pranë komitetit ekzekutiv të KPNÇl të prefekturës së Tiranës, i cili njoftonte konsumatorët se kohët e fundit kishte konstatuar që shumë kasapë, duke përfituar nga nevojat e tregut, shisnin sallam të prodhuar me

gjithfarëlloj mishi. Ky veprim kishte shkaktuar helmime herë pas here.

«Spekulime! Spekulim në stil të gjerë bëhet me suxhukun», — nën vizonte shpallja dhe përsëri ritheksonte rrezikun e helmimit nga suxhuku, rrezikun e butulizmës... helmimi që shkakton vdekje të pashmangshme. «Seksoni përkatës mori masa të menjëherëshme dhe urdhëron:

Ndalohet kategorikisht prodhimi. për nevojat e tregut, tashti për tashti autorizohen vetëm dy shtëpi: bufe «Nacional», të cilat, mbushjen e suxhukut do ta kryejnë në prezencë të një tekniku të diplomuar.»

— Hë? — ripyeti majori.

— Më parë duhet të mësojmë për Ahmetin, — tha kapiteni, që ishte dhënë pas leximit të shpalljes. — Gjersa ai ka dalë nga shtëpia vetëm pak minuta para se të ndodhët aksidenti, me siguri duhet të dijë... Ndoshta-ndoshta mund të jetë edhe autor i gjithçkaje që ndodhi në familjen e Korbajve.

— Në ç'mënyrë?

— Mjafton të ketë sjellë vetëm një urdhër, — tha ai dhe përsëri iu kujtua copa e letrës që kishte gjetur mbi tavolinë... ose... S'di si ta mendoj.

— Kurse unë e shoh gjendjen më të plotë... gjithçka që kemi në dorë... Tri vrasje... Armatim i bollshëm... Takime të fshehta... Një prift... Një i katërt që deri më sot s'nihej... Një mister S... e të tjera vetvetiu të shpien në përfundimin se pas gjithë këtyre fshihet një dorë e fortë. Diçka më e madhe.

— Të krijohet kjo bindje, — tha Adil Çika

dhe e pa në sy majorin nga i cili tashti priste vetëm urdhër.

— Prandaj mendoj se së pari dhe menjëherë duhet të arrestohet gazetari që shkruan me iniciat N.N.

Adil Çika ngriti kokën dhe e pa më me vë-mendje.

— Nuk e njihni? — pyeti majori dhe nxori nga sirtari një gazetë të palosur më katersh.

— Jo!

— Lexoni, — tha shefi i seksionit që e kishte shpalosur «Bashkimin» në faqen e tretë:

Adil Çika u përqendrua mbi të.

— Lexoni pjesën ku jo pa qëllim nënviso-het rreziku i tij, i cili krahasohet me atë të burrecit të Kolorados.

Adil Çika, që ishte përqendruar mbi shkrimin, nuk reagoi.

— Nuk të kujton gjë as ky emër?

— Të pandehurin Alush Boga, — tha kapi-teni pas një pauze të shkurtër.

— Po me fjalët: «Kontigjenti i parë arriti» c'do të thotë?

Adil Çika s'dha përgjigje.

— Më shkon mendja se edhe këtu nuk është fjala për preparatin e arsenatit të sodiumit, por për diçka tjetër... Ndoshta dikë do të lajmërojë se zoti S. arriti në Shqipëri shëndoshë e mirë.

— Këtë s'e kisha gjykuar kaq thellë, — tha Adil Çika.

— Keni kundërshtim, ose ndonjë mendim tjetër?

— Jo! — tha Adil Çika dhe përsëri i hodhi sytë nga lajmërimet dhe shpalljet që ishin radhi-tur mbi tavolinë.

— Të tjerët të mbahen nën kontroll!

— Po ky veprim... d.m.th. arrestimi i N.N. nuk do të krijonte alarm tek ata?

— Natyrisht që do të na prishte shumë punë. Bile, po të përsëris fjalët tuaja, do të krijonë alarm... Prandaj arrestimi i tij duhet menduar mirë, — tha majori dhe, kur pa se Adil Çika shprehu dyshim në fjalët e tij, ai vazhdoi: — Ta zëmë se gazetës patjetër i duhet një reportazh nga fshatrat e Zadrimës për përfundimin e Reformës Agrare. Në këtë rast ai mund të dërgohet me shërbim urgjent ose edhe jashtë shtetit. Mund të zgjidhet edhe një rrugë tjetër. Po për çdo variant që do të na duket më i arsyeshëm, duhet zhdukur çdo lloj dyshimi te të afërmit dhe bashkëpunëtorët e tij. Gjithashtu duhet të kemi parasysh që të mos nxitohemi, se në një hetim si ky që kemi në duar, ku çdo ditë po mësojmë fakte të reja dhe po na dalin njerëz të shumtë, çdo gjë duhet të ndiqet heshtas dhe të veprohet me shumë kujdes. Ndryshe...

— Çështjen të gjithë shokët e kanë vlerësuar...

— Nuk ju kritikoj, — tha majori dhe vetëm tashti që pothuajse kishin mbaruar punë, ky ishte një zakon i përhershëm i tij, i zgjatë paketën e cigareve dhe, pasi ia ndezi, e këshilloi që të mos harronin se detyra e hetuesit nganjëherë i ngjan lojës... — Dhe kjo ndodh sepse mund ta kërkosh të fshehtën për shumë kohë dhe të mos e gjesh kurrë, kurse herë të tjera, qoftë edhe kur merresh me një punë tjetër, të del përpala pa pritur e pa kujtar. Si fëmijët kur luajnë kuka-fshehthi, — qeshi majori. — Po ndodh edhe ndryshe: Për një kohë të gjatë nuk arrin asnjë rezultat dhe atëherë, natyrisht, të mërzitet çdo gjë dhe, ose heq dorë, ose e nënvliftëson... Po edhe në këto raste s'na lejohet të humbasim besimin...

Adil Çika rilexoi disa herë artikullin për rrëzikun e karkalecit. Nënvizoi paragrafet e dyshimta. Emra. Numra. Mbylli zyrën dhe doli në rrugë. Ndjeu të ftohtë që i përshkoi tërë trupin. Pastaj spazmë në gjoks. «Kjo çështje s'është aq e thjeshtë,» — përsëriti me vete.

Vetminë e rrugës ai e ndjeu më shumë kur iu afrua kangjellave të hekurta që rrethonin hyrjen e kishës. Gjithçka dukej e zymtë. Dyert. Harqet e gurta të kambanores. Kambanat, që nga lëkundjet e erës lëshonin një echo të zhurmshme. Të largët. Në fillim Adil Çika mendoi të trokiste, ose t'i binte portës së hekurt me diçka të fortë, qoftë edhe me thembrën e çizmes, po, kur vuri re se kanati kishte mbetur paksa i hapur, e shtyu dhe u fut brenda.

— Në këtë orë nuk kryhet asnje shërbesa! — ndjeu një zë që erdhi nga një cep i largët i murit. Dukej se ishte një strehë e mbuluar, ose diçka e përafërt, ku strehohej njeriu që ruante kishën.

— Dua të takohem me dom Kelën! — iu përgjigj aty për aty Adil Çika.

Njeriu që kishte hedhur krahëve një rrobë të zezë, u ngrit, flaku tej një bisht cigareje dhe iu afrua më afër Adil Çikës.

— As dom Kela s'është.

— Po kambanari?

— As ai!

— Po ju?

— Jam roja e natës, — tha njeriu me të zeza, që tashmë i ishte afruar aq afër Adil Çikës, sa ndihej edhe era e duhanit përzier me atë të hudhrës që kundërmonte. Me mëngën e xhaketës fshinte herë pas here hundët që i lëngëzonin.

— Vij nga seksioni i punëve të brendshme!

Roja ndjeu diçka brenda kraharorit. Tre muaj më parë bashkë me një prift që kishte lidhje me kishën franceskane ishte thirrur edhe ai si dëshmitar. Bile mund të ishte ngarkuar edhe me përgjegjësi ligjore, po të mos ishin marrë parasysht ca rrëthana lehtësuese. Prandaj kjo vizitë e papritur jo vetëm që e hutoi, por edhe e tronditi, aq sa mezi po qëndronte në këmbë. Kjo, ndoshta, i kujtoi se po në këtë kishë ishte strehuar edhe ish-kapiteni i xhandarmërisë, ndërlidhës i organizatës «Bashkimi shqiptar». Në këtë fakt, që e dinte vetëm ai, e kërkoi shkakun e kësaj vizite të vonë rojtari. «Pas këtij, — mendoi ai, — me siguri do të ketë të tjerë, — dhe frika iu shumëfishua. — Ndryshe pse duhej të zgjidhët një natë kaq të errët e me shi?» — pyeti dhe ktheu kokën nga porta që e përplasi era.

— Ec përpara! — e urdhëroi Adil Çika.

— Ku, zoti oficer!

— Në strehën e hyrjes!

— Ah! Mirë, zoti oficer!... Unë harrova shiun!

— tha ai dhe hodhi përsëri rrobën e zezë mbi kokë. — Veç, ju lutem flisni më fort se s'para dëgjoj mirë nga veshët. Ca nga pleqëria... ca nga moti i keq...

— Në kishë ka njeri?

— Jo, zoti oficer.

— Aq më mirë, — tha Adil Çika dhe shkoi

drejt derës së drunjtë mbërthyer kryq e têrthor me pafka tê trasha hekuri, ku çdo gjë dukej e errët dhe e zezë. Ai shtyu derën që lëshoi një zë që tê ngacmonte nervat, kapérceu parmakun e gurtë latuar nga këmbët e besimtarëve tê shumtë.

Rojtari e ndiqte me frikë. Adil Çika, bashkë me erën e temjanit, pa edhe qirinj që ndriçonin ikonostasin pas kolonave tê ftohta. Gjithçka tê krijonte njëfarë boshllëku dhe gjendje ankthi. Pérreth kishte ndenjëse tê drunjta. Shenjtorë tê gozhduar, kryqe që zgjasnin krahët, ikona dhe engjëj që fluturonin në hapësirën e zbrazur e tê ftohtë, që tê krijonin përshtypjen se çdo gjë kishte humbur drejtimin dhe trupat ishin gati tê pérplaseshin me njëri-tjetrin, tê shkëputeshin nga kapitolet dhe tê binin në humnerë. Në krye, mbi tê gjithë, i kryqëzuar, i përvuajtur dhe i ftohtë si akulli, ndriçohej trupi i Jesuit me kokë tê varur.

— The se nuk ka njeri në kishë! — përsëriti Adil Çika kur ndjeu një lakuriq nate që përplasi krahët mbi kokat e tyre.

— Veç nesh është edhe Jesu Krishti, — tha rojtari dhe kryqëzoi dorën e djathtë në gjoks.

Adil Çika dëgjoi një zë tê ngordhur që pëshpëriti: «Në emër tê atit, tê birit, tê...»

— Në tê ri ke qenë ndonjëherë prift?

Rojtari bëri sikur s'dëgjoi gjë:

— Mos nuk e bëra në kohën e duhur pyetjen?

Rojtari u gjend më ngushtë dhe tundi kokën, në atë mënyrë që mund ta merrje si diçka që qëndron pezull midis dështimit tê karrierës dhe fatit tê keq. Ai u mendua për një çast nëse duhej tê tregonte tê vërtetë apo ta fshihte atë, ashtu siç kishte vepruar në procesin e parë.

— Xhakon në një fshat tê malësisë?

— Po, zoti oficer! Ju më njihkeni, kurse unë...

jo, — tha rojtari pér t'i hedhur më shumë mje-gull bisedës së tyre.

— Të kanë thirrur ndonjëherë «o atë»?

— Isha i ri atëherë, zoti oficer! — tha rojtari i kishës dhe Adil Çika dëgjoi një zë të dridhshëm, në të cilin fshihej edhe njëfarë mëdyshjeje.

— Si je, dom Prenga?

— Ka kohë që më thërrasin vetëm rojtar, — tha ai. — Thjesht rojtar. Dhe kjo, zoti oficer, pér detyrën që kryej... Po ne pse nuk ulemi, zoti oficer?

— Ka dhomë të veçuar?

— Ajo e etërve.

— Mirë, — tha Adil Çika. — Mund të flasim edhe këtu, — dhe u ul në shkallët e drunjta që të ngjisnin në dhomat e mistershme të etërve, pas faqes së ikonostasit që ishte veshur me dru të gdhendur. Pranë tij u ul edhe rojtari i kishës që, nga frika, do të kishte pranuar të ulej edhe mbi mallkimin e zotit, vetëm kjo bisedë të merrte fund sa më shpejt... — Ti ke miqësi me dom Kelën? — e pyeti kapiteni që kishte vënë re se ai dëgjonte pér bukuri.

— Unë?... Jo, zoti oficer!

— Po një femër që vjen shpesh në kishën tuaj e njeh?

— Jo, zoti oficer.

— Mendohu... E kam fjalën pér një vajzë që vishet me rroba të zeza.

— Nuk e di, zoti oficer! — mohoi po me më-dyshje rojtari i kishës.

— Mbi rrobat e zeza hedh edhe një ferekhe!

— Unë shërbiej vetëm natën, zoti oficer.

— Edhe unë pér orët e vona pyes. Një femër e re. E hollë, E gjatë. Me flokë të verdhë... Mos u nxiton! Ju pyes me përgjegjësi ligjore!

Kur dëgjoi këto fjalë, rojtari u step. Heshti. U kapërdi. E pa oficerin në sy.

— Jo edhe fort shpesh, zoti oficer! — tha me zë të shuar si s'gjeti rrugë tjetër.

— Si quhet?

— Unë nuk e njoh, zoti oficer. Ajo vjen, rrëfhet, ikën.

— Te dom Kela?

Rojtari vetëm tundi kokën.

— Mos e ka emrin Drita?

— Nuk e di, zoti oficer!... Për emër të zotit... — tha ai dhe u drejtua nga kryqi. U betua përtë, për shpirtin e së motrës dhe shau me vete dom Kelën gjer në brezin e shtatë. — Për emër të...

— Lëre atin!

Rojtari e la përgjysmë betimin dhe e pa në sy Adil Çikën që dukej i vrazhdë e i lodhur.

— Nuk kam shumë kohë përtë humbur! — tha Adil Çika me ton të prerë.

— Më duket se po, zoti oficer!

— Drita Korbi?

— Po, zoti oficer!

— Pra, edhe ti e ke parë kur falte mëkatet?

— Si t'ju them, zoti oficer! Unë bëj punën e rojës së natës dhe kaq.

— Ti vetëm se e ke futur brenda, apo jo?

— Po, zoti oficer!

— Kurse përtë dalë ka përdorur portën e prapme! Nuk është kështu?

— Kështu është, zoti oficer! — rojtari i kishës s'gjeti dot përgjigje tjetër. — Po unë s'kam asnjë faj. Ata ruajnë ca marrëdhënie të tyre... Si t'ju them, zoti oficer, — tha ai dhe mezi priste që të merrte fund ky takim.

Adil Çika u ngrit në këmbë dhe eci drejt daljes. Ishin pak a shumë të njëjtat fjalë që kishte

përmendur edhe njeriu që kishte shërbyer në dyqanin e Zeqo Korbit... «Ata ruanin ca marrëdhënie të fshehta.» Ç'do të thotë kjo? Si ndodh që nga dy njerëz krejt të ndryshëm dëgjoj të njëjtat fjalë?

— Po si janë njobur ata të dy? — pyeti Adil Çika rojtarin që i shkonte pas.

Ai pa u menduar nxitoi të thoshte:

— Ashtu rastësisht!

— Ç'i lidhte? — pyeti Adil Çika që kuptoi fshehtësinë e përgjigjeve.

— Moshë! Patjetër mosha, zoti oficer!

Pas kësaj bisede ata kishin dalë në oborrin e kishiës.

Adil Çika ngriti kokën lart për të parë motin. Binte shi i imët. Në dendësinë e tij humbisnin konturet e godinës së zezë dhe kryqet me krah të zgjatur mbi kambanore.

— Këto që biseduam, s'duhet t'i marrë vesh njeri!

— Jo, zoti oficer.

— Ndryshe!...

Mister S. hoqi kufjet nga veshët, fshiu mellérën e dorës ballin, ngriti grilën, mënjanoi perden e trashë ngjyrë rozë, hapi kanatin e dritares dhe ndezi e shoi cigaret njérën pas tjetrës duke u munduar të harronte sinjalet piu, piu... ta, ta, ta... ti, ta, që akoma i tingëllonin në thellësi të veshëve.

Mbushi një gotë uiski dhe pastaj shenjat e koduara i shndërroi në fjalë. Fjali. Urdhra: «Të riaktivizohet grupi i klerikëve katolikë. Të shpërthehen depot e U N R A-s... Krijoni mundësi për incident në selinë e misionit të Unionit Sovjetik. (Ngarko me këtë detyrë dy deputetët kolonelë, Radovickën dhe Ujanikun.).

... Çekun me dhjetë mijë dollarë. . .»

«Këto më takojnë mua,» — tha me vete mis-

ter S. dhe e ktheu gotën e uiskit me fund. E mbushi përsëri, rishikoi një letër të shkruar, e futi midis cigareve të paketës «Diamant» dhe vetëm tashti i shkoi ndër mend të ulej në shezlon-gun që lëkundej... «Okej,» — tha me vete dhe përsëri piu uiski... Dhe shqiptoi «budallenjtë», pa përcaktuar se kujt ia adresonte, njerëzve të tij që jepnin urdhra me radio trasmetuese, apo grupit që mblidhej në errësirë... Nëpër bodrumë... Deputetëve. Ministrit që bënte vjersha. Dom Kelës. Zonjës A.

Përplasi së dyti gotën pas shishes dhe piu. Piu që të trullojë. Që të flinte pa ëndrra të...

Deputeti: — Si urdhëron!

M... që bënte vjersha — Çfarë si urdhëron?

Deputeti — Domethënë...

M... që bënte vjersha — Çfarë domethënë.

Deputeti — Zoti Ministër i Punëve të Brendshme s'u prononcua... Bile u hoq si i paditur dhe gati më kërcënoi.

M... që bënte vjersha — Po më çudit.

Deputeti — Edhe unë u habita.

M... që bënte vjersha — Merri!

Deputeti — Çfarë janë, vjersha?

M... që bënte vjersha — Kjo për dom Kelen... për zonjën Alime bej... Për atë që shkruan reklama... Për kolonel...

Deputeti — Kaq shumë?

M... që bënte vjersha — Këto vetëm përsonte.

Në kishë.

- Kambanari ku është?
- Këtu ishte një oficer me gradat e kapitenit.
- Ç'kërkoi?
- Edhe ai kambanarin.
- Ç'i duhej?
- Pastaj pyeti për ju.
- Dhe më pas? — pyeti dom Kela që zgjidhi litarin dhe i bëri zë rojtarit ta ndihmonte. Dang... Dung... Dhe përsëri dang... Dhe përsëri dung... — Tashti lidhe litarin pas ganxhës së hekurit... Doli në bulevard.
- Atë natë piu dy tableta për zemrën.

Në hetuesi:

- Hetuesi — Ku e lamë bisedën herën e kaluar, i pandehur?
 - A. Boga — Nuk më kujtohet, zoti hetues.
 - Hetuesi — Ku jeni mbledhur për herë të parë?
 - A. Boga — Në shtëpinë e një tregtari tiranas.
 - Hetuesi — Ju kujtohet emri i tij.
 - A. Boga — Në mos gaboj, quhej Zeqo... Zeqo Korbi.
 - Hetuesi — Kush e kryesonte mbledhjen.
 - A. Boga — Nuk e njihja. U prezantua si i dërguar i U N R A-s. Pastaj foli një anëtar i Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar. Më duket se ishte dhe deputet.
 - Hetuesi — Përse foli ky i fundit?

A. Boga — Për shtrirjen e aktivitetit në të gjithë Shqipërinë... Do të zgjidheshin komitetet e qarqeve.

Hetuesi — Kush do të bënte pjesë në këto komitete?

A. Boga — Unë isha caktuar për nënprefekturën e Kavajës. Duhet të aktivizoheshin të gjitha mbeturinat e Ballit... Tregtarë... Çifligarë. Të gjithë ata që ishin kundër pushtetit.

Hetuesi — Po më parë mbanit lidhje me të huajt?

A. Boga — Sigurisht. Unë kam njohur Harri Fulcin... Gjeneralin Hodson... Dhe një femër gazetare.

Hetuesi — Ç'ju kanë premtuar?

A. Boga — Para. Armë dhe zbankim apo të krijojeshin kushtet...

Hetuesi — Ti ke marrë para?

A. Boga. — (Hesht. Përtërin përsëri lojën e improvizuar të të sëmurit psikik.) (I ndërprenë he-timet.)

Krediti agrar!

..... Krediti agrar do të luajë një rol me rëndësi në zhvillimin e bujqësisë.
..... Dy janë sot për sot që i shtrohen përparrë kreditit agrar:

- 1) Shpërndarja e tij në sektorin privat të bëhet në favor të bujqve të varfër
- 2) Pas akordimit të huasë, të kontrollohet investimi i plotë i saj për qëllimin e caktuar.

Lajmërim!

Lajmërohet populli se në të gjitha degët e këtij dyqani është vënë në shitje miell tershëre me 2 fr. kg.

Ai zëvendëson fare mirë orizin që hëpërhë mungon në dyqanin tonë dhe është e këshillueshme të përdoret edhe për ushqimin e fëmijëve.

Njoftimin e bën dyqani i
Shtetit Nr. 2
Tiranë

KAPITULL MÈ VETE

Përsëri edhe natën e 16 nëntorit kishte fryrë erë e fortë, që kishte bërë dëme në pemë, shtylla telefonike, në rrjetin elektrik, në tjegullat e shtëpive dhe faqet e mureve. Kishte hallakatur nga të katër anët e kryeqytetit degë të shkëputura nga pemët e vjetra dhe gjethe të kalbura. Nëpër rrugë, trotuare e në pusetat e shkarkimit të ujërave, gjatë gjithë gjatësisë së bulevardit, gjeje gjithfarë mbeturinash, kuti konservash, copa reklame, gazeta të grisura, rroba të vjetra, reklama filmash me ftyrat e gërvishtura. Astrit Pema ndjeu të ftohtë, qëndroi, i mblodhi duart bashkë dhe i afroi pranë gojës. Trupin e mbështeti mbi patericat që shtrëngonte nën sqetull dhe fryu me gojë «Huu, hu». Një ditë më parë ai kishte marrë një lajmërim me anën e të cilit e ftonin që të paraqitej në komitetin ekzekutiv të nënprefekturës. «Zoti e di përsë, — tha më vete. — Naty-

risht që s'i ka marrë malli pér mua,» — dhe përsëri mendja i shkoi te njoftimet dhe shpalljet e shumta që lexonte përditë pér të ardhurit pas lufte, që ishin pa dokumente banimi, të cilët duhet të paraqitnin pranë komitetit ekzekutiv bashkë me kërkesën edhe lejën nga fshati ose nënprefektura përkatëse nga vinin. «Mund të më thërrasin edhe si të dyshimtë, ose ndokush ka bërë ndonjë deklaratë s'dihet pérse... Ta zëmë pér... Pér shitje mallrash mbi çmimet që ka vënë shteti... ose pér vrasje. Ndoshta ndonjë nga ata që është kthyer para meje mund t'i ketë thënë gruas së doktorit se atë e vramë ne. E pastaj? — tha me vete. — Ajo ishte një vrasje e ligjshme. Doktori duhet të vdiste, sepse mbi trupin e njerrëzve eksperimentonte mundësinë e zhvillimit të tumoreve, sepse fëmijëve u hiqte të drejtën të flisnin, të ankoheshin, u hiqte kordat zanore dhe ata vetëm kuisnin. Kuisnin si qeni kur dridhet nga të ftohtët, — kujtoi ai. — Dhe ne ta linim gjallë?!... Ndryshe s'ka pérse të më duan,» — tha pér të njëqindtën herë dhe eci përmes bulevardit duke u ruajtur nga pellgjet dhe gropat e mbushura me ujë. Por të gjitha këto mundësi i harroi, kur kujtoi se ndoshta e thërrisin pér t'i dhënë përgjigje pér kërkesën që kishte bërë tri ditë më parë. «Kaç shpejt?» — mendoi. E vërteta ishte se ato pak para që i kishte dhënë përfaqësuesi i shtetit tonë pranë forcave të Mesdheut, në Bari, para se të nisej pér në atdhe, po i mbaroheshin. Mendimi i fundit e gëzoi. «Ndryshe më duhet... Çfarë më duhet?... Të lyp? Apo të blej një kasetë druri. Dy furça. Pastaj të zë një qoshk dhe të fshij këpucët e të tjerëve... Ndoshta më gjejnë një punë,» — shpresoi dhe iu kujtua se gjatë këtyre ditëve që sillej i ngeshëm nëpër qytet ai kishte lexuar dhjetëra lajmërimë si këto:

«Ministria e Punëve të Jashtme kërkon një skicograf...» Gazetës «Bashkimi» i duhen 18 shpërndaresh gazetash. Të interesuarit të paraqiten në mesagjerinë e shtypit. «Radio Tirana është e interesuar për tre spikerë...» Spiker! Dhe më poshtë ishin formuluar kërkesat: «Të lexojë mirë... diksion të qartë... Shkollë...» «Ministria e Arsimit në muajin maj do të hapë kurse përgatitjen e arsimtarëve në çdo qendër prefekturë. Të interesuarit...» «Ndërmarrja e ndërtimit e prefekturës së Tiranës kërkon specialistë për këto profesione...» «Banika e shtetit... Arkëtarët duhet të kenë të paktën shkollën qytetëse dhe shëndet të...» «Hëm! — tha ai me vete. — E kush më jep mua punë të tillë? Të parën gjë që do të më thonë do të jetë pyetja: «Ku ishe? Nga vjen? Cili je? Po dje? Ç'bëje dje? Pa na e vërteto se ke shpëtuar ashtu siç thua ti! Po unë ç'do t'u them? Cila ështëjeta ime? Një paragraf i errët. I shkarravit, — tha dhe pa orën që qëndronte mbi kullën e gurtë. — Derisa s'dëgjohen goditjet edhe ajo s'punon. Ndoshta mekanizmin e saj e ka plagosur ndonjë predhë, ashtu si plagoset organizmi i njeriut... Si këmba ime. «Tang, pafka e këpucës. Tang, dy patericat. Tang. Tung. Ose ndoshta ndonjë gur nga ata të minares së përgjymuar. «Ç'kiamet duhet të ketë parë Tirana gjatë atyre ditëve që çlirohet,» — tha.

Pa e kuptuar ai kishte ngjitur shkallët e komitetit ekzekutiv dhe kishte qëndruar përballë portinerisë ku ishte ulur një njeri me uniformë blu. Në të djathë, në një stol të gjatë ishin ulur njerëz të tjerë. Një plakush me borsalinë. Një grua që kishte mbështjellë qafën me pellush të zi. Një njeri me një dorë. Edhe në të majtë të korridorit kishte të tjerë, që nga pamja të linin përshtypje se ishin njerëz që u përkisin shtresave të ndryshme.

Astrit Pema bëri dy hapa përpara dhe gati futi kokën në dritaren me xham të portinerisë.

— Urdhëroni!

— Unë dua.. Më falni! — dhe zgjati copën e letrës.

Portieri u ngrit në këmbë.

Astrit Pema e pa në sy dhe priti ç'do të ndodhët.

Portieri, mund të ishte edhe nëpunësi që kryente shërbimin ditor doli nga portineria dhe, pasi i futi krahun, i tha se duhej të ngjitej në katin e tretë, në dhomën nr. 20... Në sallën e pritjes.

Astrit Pema u ul në një nga kolktukët e veshur me lëkurë të zezë dhe priti. Kthimi i tij ishte marrë vesh. Më shumë se kushdo këtë e kishte popullarizuar sportelisti i hotelit dhe gjatë këtyre ditëve kishin kërkuar të takoheshin me të shumë njerëz. Nga Tirana, qytete e rrethe të tjera, që donin të mësonin për të afërmit e tyre... për ata që s'ishin kthyer. «Mos vallë edhe këta të pushtetit duan të më pyesin?» — tha përsëri dhe hodhi vështrimin tej dritares, në kaosin e çative që ishin fundosur në një tym gri. Nuk e ndjeu as derën që u hap, as njeriun që hyri... ktheu kokën qetësish dhe pa një njeri. «Cili të jetë ky? Ndoshët edhe atë e kishin dërguar të priste në këtë dhomë. Apo ndoshët s'dihet pse ka ardhur,» — mendoi dhe instinktivisht përshëndeti.

— Nuk më njeh?

— Jo! — tha Astrit Pema.

— Kurse unë, apo më thanë se kishit ardhur në komitet për të kërkuar punë, u kujtova.

— Unë hiç!

— Dikur unë shisja kikirik!

— Kikirik?

— Po, po!

— Shoku Haki? — e shqiptoi ngadalë emrin e tij Astrit Pema dhe gati sa nuk u rrëzua. — Nuk shpresoja t'ju shihja, — tha ai kur Haki Bora e mbërtheu për krahu dhe e uli në një poltronë të gjérë.

— As unë! — tha Hakiu dhe me kujdes i hodi sytë mbi patericat, protezën e shtrirë dhe fytirën e zbehtë. — Nga ajo natë kanë kaluar tre vjet... Më vonë mësova internimin. Pastaj...

— Pastaj qdo gjë ia besova fatit! — qeshi Astrit Pema.

— Kam pyetur! — tha Hakiu.

— Edhe unë, — tha Astrit Pema dhe deshi t'i kujtonte se në një urdhëresë të komitetit ekzekutiv që kishte lexuar para tri ditësh përmbylljen e një dyqani që ishte kthyer në qendër korrupzioni, alkooli, kontrabande dhe kumari, kishte parë emrin e Haki Borës dhe nën të detyrën që kryente. Ndërsa fliste, Astrit Pema përsëri kujtoi çastin kur kikirikshitësi kishte nxjerrë revolverin dhe kishte qëlluar mbi majorin Fon Brymer...

Ata pinin kafe dhe herë pas here shikonin njëri-tjetrin. Astrit Pema e pyeti për *invalidin*. Miku i tij thithi cigaren dhe mblodhi buzët. Në ballë iu duk një shenjë dëshpërimi. «Ai nuk është më, — tha me gjysmë zëri... — E torturuanc... Pastaj e pushkatuan.» Astrit Pema ndjeu dhimbje. «Sikur e parandieja,» — tha me vete dhe u shtrembërua nga dhimbja e këmbës.

— Ju dhemb?

— E kam nga koha.

— Mua më thanë se ishit zhdukur.

— Zhdukja ishte diçka e rëndomtë atje.

— Ndize!

— Faleminderit!

— Po si bëre që shpëtovë?

— U arratisa. Ika! Kjo ndodhi aty nga fundi i luftës. Gjatë kohës që qëndruam në kamp, ese-sët na vinin në punë të rënda. Nxirrnim gurë, transportonim gurë... Edhe kur gurët s'duheshin për asnjë gjë, ne duhet përsëri të nxirrnim... Duhet të konsumoheshim që të bëheshim sa më pak të rrezikshëm për ata. Ne ishim dhjetë mijë veta në kamp. Vdiqën kushedi se sa... Kishte nga të gjitha vendet dhe shtetet... Vetëm shqiptarë ishin njëqind e ca... Njerëz me uniformë laramane. Si zebrat... Njerëz numra. Dhe vdisnin numrat në dhomën e gazit... Pastaj i digjnin në kremator. Kjo që do t'ju tregoj, ndodhi në gurre. Ishte një ditë me diell, monotone, si të tjerat... Po afronte behari. Mbartja gurë nga një anë e rrugës në tjetrën. Aty pranë uturinte një motoçikletë. Ishte motoçikleta e një korrieri... një motor ushtarak. Unë dikur kisha ngarë një të tillë. Prandaj e shikoja me lakmi. Dëgjoja motorin që punonte dhe mendoja: Po sikur t'i hipit? Ai punonte i qetë, në minimo dhe qëndronte gjithnjë para meje. Më tej ishin rojat. Pranë meje ishte një djalë që quhej Fredi. Ishte çifut nga Polonia. I ati kishte qenë avokat, kurse motra e tij s'dihet në c'mënyrë kishte vdekur... Ai thoshte se kishte therur veten në një shtëpi publike nga ato ambulantet që u shërbën nazistëve. Më kishte mbetur vetëm Fredi, se Albertin, një mjek italian, e dogjën në kremator. Të shoqen e tij, Merin, e takova më vonë... Ia tregova Credit motorin që gërhiste si astmatik. «Ai të shpëton,» i thashë unë. «Mundet,» tha Fredi... Bis-sedën tonë e ndërpreeu një zë nga maja e masivit shkëmbor: «Ej, njerëz! Ruhuni, Shkëmbi!»

Njerëzit, kur panë se si lëvizi masa e gurtë, ia mbathën vrapit. Përplaseshin, rrëzoheshin.

Edhe Fredi vrapoi. Edhe unë vrapova. Po në të kundërt të tij dhe, pa e kuptuar, u gjenda pranë motorit që qëndronte akoma mbi këmbalecat e tij, i qetë dhe i matur. Rreshteri, korrier eses, ishte zhdukur. Edhe rojat. Edhe oficerët ua kishin mbathur. Motori vazhdonte të punonte. S'di ç'ndodhi pastaj... U kujtova që isha gjallë vetëm kur i kisha vënë marshin e tretë. Pastaj i vura të katërtin dhe i lëshova gjithë gazin. Dëgjova një automatik mbas shpine. Ky ishte kujtimi i fundit nga kampi «Stalag 7. A»

— ?

— Ju thashë se nga këmba më rridhte gjak. Gjak i kuq... Kurse motorin e kisha ngritur mbi këmbalec. Pranë tij rridhte një lumë. Pas kishim lënë një rrugë të pluhurosur. U mendova... Shpëtimtari kaq duhej. Gjurmët e tij nëpër pluhur arrinin gjer te rrota e parë. Pas gjurmëve kishte gjak. Prandaj vendosa ta hidhja në lumë. E afrova në breg dhe e lëshova me marshin e parë. Ai në ujët e turbullt, unë mora fushën përmes të lashtave. Po sa më shumë ecja, aq më shumë e ndieja këmbën e plagosur. Pastaj s'mundesha më. Fillova të zvarrisesha. Shpejt erdhi nata. Kjo ishte më mirë. Edhe po të më ndiqnin, s'do të më gjenin dot në këto korije. Larg dallova dritat e një fshati malor. Edhe ata mbanin bagëti dhe qenë si te ne.

Unë trokita në shtëpinë e parë që takova.

Një vajzë hapi portën dhe bërtiti e trembur. Pas saj dolën një plakë dhe një burrë. Klara që bërtiti më erdhi në ndihmë e më mori përkrahu. Klara me sy të kaltër. Ne me Klarën më vonë u bëmë miq. Ajo më mësoi ca fjalë në gjuhën e saj. Atje jetova nja tre muaj.

— ?

— E ku ta kuroja? Në gjithë vendin kishte nazistë. Mua më strehuan në një katua me bar. Kurse këmba po bëhej keq e më keq. Plumbi kishte qenë i infektuar...

Klara rrinte tërë ditën me mua në katua dhe qante. Unë i lëmoja flokët. Ajo qante dhe më puthte. Më thoshte se s'do të më linte të vdisja... Së shpejti do të vinin partizanët.

Eh! Ç'vajzë ishte ajo Klara me sy të kaltër. Ajo solli një mjek dhe ai më preu këmbën.

— ?

— Në Itali më shpuri rruga, por shkova të takoja edhe Merin... Ju thashë. Meri ishte gruaja e Albertit. E mjekut Albert... Edhe ajo kishte sy të kaltër, po në ta dallohej trishtimi. Kishte dy djem dhe shpresonte t'i kthehej i shoqi, Alberti. I thashë se do të kthehej. Ajo me siguri e pret akoma, atë e dogjën në kremator... Jo! Më parë e mbytën me gaz... Me CO. Pastaj për ca kohë më kuruan në një sanatorium.

Stacioni i fundit ishte Durrësi.

Ja kështu ndodhi... Tashti eci me paterica.

— : , , ,

Haki Bora gjatë gjithë kohës dëgjonte dhe pinte duhan. Zëri i Astrit Pemës rridhete i qetë, shtruar, i dhimbshëm. «Sa keq, — tha disa herë me vete Haki Bora, — që ky njeri nuk diti të luftonte si duhet, — dhe iu kujtua përpjekja e shokëve të celulës, guerilasve, e njerëzve që vepronin në qytet për ta bërë me vete, për ta hedhur në lëvizjen çlirimtare, kurse ai ishte treguar vazhdimesh i pavendosur, i lëkundur. — Nuk kishte besim në fitoren tonë dhe ja,» — tha ai dhe kushedi sa herë hodhi sytë nga këmba e vetme, proteza dhe patericat.

— Tashti si mendoni? — e pyeti Haki Bora kur vuri re se heshtja e kishte rënduar së tepërmi Astrit Pemën.

— Tashti?

— Po!

— As unë s'e di.

— Ku mendon se mund të punosh?

— Si të them!

Haki Bora qeshi dhe i shpjegoi se problemin e kuadrit e kishte marrë plotësisht në dorë shteti i ri, i cili, për nevojat e shumta, kishte mobilizuar edhe një pjesë të administratës së vjetër që nuk kishte kryer krime dhe veprimitari antipopullore dhe pothuaj tërë intelijencien e specializuar në shkolla të mesme ose të larta para Çlirimt...

Astrit Pema dëgjonte në heshtje.

Haki Bora vuri re se për të ishte i panjohur mekanizmi i shtetit të ri. «Me siguri, — tha me vete, — që ai s'e koncepton dot përbysjen e madhe që është bërë... Bile duhet të jetë çuditur me gjithçka tonën.» U mundua t'i shpjegonte se, për të përballuar sulmin e spekulatorëve, furnizimin normal të popullatës së qytetit dhe shpërndarjen racionale të bukës, mishit, ushqimeve dhe veshmbathjes, me vendim të veçantë të Qeverisë, do të vendosej sistemi i triskëtit.

— Nuk e kuptoj ç'është ky lloj sistemi?

— Pranë komitetit ekzekutiv do të krijohet një seksion i veçantë... Kërkohen njerëz të ndershëm, — tha Haki Bora. — Se më shumë se kudo këtu mund të abuzohet me anë të bonove që do të shpërndehen, sepse shteti merr përsipër vetëm furnizimin e atyre që janë të angazhuar në marrëdhënie pune shtetërore, d.m.th. ata që punojnë në ndërmarrje, në ushtri, në administratë dhe në sektorë të tjera shtetërorë. Kurse privatët, ose ata që akoma ngurrojnë të futen në punë

shtetörorre, pérjashtohen nga ky lloj furnizimi i garantuar... Pikërisht këtu qëndron rreziku i abuzimit, — shpjegoi Haki Bora dhe i kërkoi mendim Astrit Pemës nëse mund ta propozonte në organet përkatëse pér të punuar në këtë sektor...

— Nëse më besohet!...

Haki Bora vetëm buzëqeshi.

— Nëse më besohet!...

— Për Telat Korbin? —
— S'ndihet asnjë shqetësim.
— Jeni të sigurt se ata s'e kanë identifikuar?
— Më se të sigurt. Trupi u rigropos në vend tjetër, larg varrezave.
— Okej!
— Po për Drita Korbin?
— Janë kryer hetime të gjata. Janë marrë njerëz në pyetje.
— Nëse merren vesh marrëdhëniet e tyre, çdo shpjegim duhet të motivohet vetëm me marrëdhënie intime. Ose vetëm në çastet e fundit, kur të mos gjendet rrugë shpëtimi, vdekja e saj duhet shpjeguar si një duel dashnorësh që janë përlleshur sa u janë bërë hundët gjak... — tha

- Për Telat Korbin?
— S'ndihet asnjë shqetësim.
— Jeni të sigurt se ata s'e kanë identifikuar?
— Më se të sigurt. Trupi u rigropos në vend tjetër, larg varrezave.
— Okej!
— Po për Drita Korbin?
— Janë kryer hetime të gjata. Janë marrë njerëz në pyetje.
— Nëse merren vesh marrëdhëniet e tyre, çdo shpjegim duhet të motivohet vetëm me marrëdhënie intime. Ose vetëm në çastet e fundit, kur të mos gjendet rrugë shpëtimi, vdekja e saj duhet shpjeguar si një duel dashnorësh që janë përlleshur sa u janë bërë hundët gjak... — tha

mister S. — Më tej le t'u punojë logjika, në qoftë se s'u dhimbet lëkura. Po zoti Korbi?

— U varros pa asnje ceremoni!

— E kam fjalën për ata?

— Duket e kanë motivuar me një vrasje ordinere...

— Për të tjerat konsultohuni me zotin deputet dhe ai me zotin ministër. Okej!

Dom Kela kishte njëzet e katër orë që vuante nga barku... diareja... S'doli nga shtëpia. S'u dëgjua as dangu... as dungu...

Informacion nr...

I pandehuri Alush Boga në mesnatën e 17 nëntorit vari veten. Ky veprim u krye me qëllim që i pandehuri t'i shpëtonte gjyqit të popullit. Si mjet varjeje i pandehuri ka përdorur çarçafin, të cilin e ka lidhur pas hekurave të dritares.

Vetëvrasja është kryer me paramendim dhe në kushte krejt normale. Arsyetojmë kështu, sepse tri orë më parë ai rideklaroi se ishte pjesëtar i grupit të deputetëve (i organizatës terroriste-sabotatore) dhe anëtar i Komitetit Qendror të kësaj organizate. Aktivizuar që në vitin... dhe i ngarkuar me detyrën e organizatorit të Komitetit Qarkor për prefekturën e Durrësit.

Ky ishte deponimi i fundit.

Një rosë e egër që mbante një unazë me mbi-shkrimin «Londër 83. 654» u vra nga Mark Zefi në fshatin Mali Kolaj. Gjahtari e dorëzoi rosën që i kalonte dy kg në organet përkatëse. Mark Zefit iu dha si shpërblim rosa dhe 50 franga shqiptare.

Unaza do t'i adresohet inst. «Rosa dhe pata e egër»

**Londër
Ingliterë**

Lajmërim tjetër tris.

Ka më se tre muaj që funksionon rregullisht orkestra e lokalit «bar-restoran Kontinental». Më mirë se në të kaluarën drejtoria e re ka për ta rritur kujdesin për shërbimin, pastrimin dhe qetësinë.

Gjatë muajve të nxehthë dancingu do të bëhet në lulishten e lokalit.

Kontinentali. Drejtoria

Mamitë:

- 1) Makbule Dizdari
- 2) Zyhra Gjyli

Barnatoret: Duke filluar nga data 20 barnatore «Deljallisi» fillon shërbimin natën.

KAPITULLI VII

1

Në pamjen e parë ai të krijonte përshtypjen se kishe të bëje me një babaxhan që kishte rënë viktimë e të tjerëve. Duke i dhënë urdhër të ulej, kryehetuesi, kujtoi frikën dhe tronditjen e gazetarit natën e arrestit. «I shkreti gazetar,» — tha me vete Adil Çika kur mendoi se ato dy ditë në dhomën e izolimit duhet të kishin qenë për të ditë torturë të padurueshme. Dukej i çoroditur dhe i paaftë për të sakrifikuar shëndetin dhe nervat. Nga të dhënat kryehetuesi kishte mësuar se Nimet Nano ishte prej Durrësi. Lindur në vitin 1891, po, për çudi, disa herë, i pëlqente ta shihte veten më të ri në moshë, ose herë tjetër, natyrisht kur i interesonte, edhe më të madh. Kishte mbaruar Normalen e Elbasanit dhe për disa vjet kishte punuar si mësues në fshatrat e Durrësit dhe më pas, ndihmuar nga ca bashkë-

shkollarë, ishte vendosur në Tiranë. Veten e hiqte nationalist dhe me bindje përparimtare. Pro reformave që favorizonin shtresat e varfra të qyettit dhe të fshatit. Kishte marrë pjesë në Revolucionin që solli Fan Nolin në fuqi dhe pas dëshimit të tij kishte emigruar në Itali. Mbreti Zog e kishte dënuar në mungesë. Për dhjetë vjet brodhi nëpër Evropë. Me ndihmat filantropike të një shoqërie angleze, një zot e di se ç'shoqëri ishte kjo, theksonte informacioni, mundi të vazhdonte 3 vjet studime të larta për shkencat shoqërore. U kthye në Shqipëri në vitin 1935. Anmistia i dha edhe të drejtën të punonte për pak kohë si mësues në liceun e Tiranës, në atë të Shkodrës... Në Durrës. Pas vitit 1939 u vendos përfundimisht në Tiranë. I formuar në moshë e në bindje e radhiste veten krah parisë ose disa krerëve që ishin gati të bëheshin «therorë» për çështjen e kombit. Me të Nacionalçirimitares s'u përzje. Edhe Ballit Kombëtar i qëndroi larg... Edhe Legalitetit. Prandaj ndërrimi i pushtuesve, klikave vendase dhe rrjedha e viteve s'i sollën asnje dëm zotit Nimet Nano. Vazhdonte të jepte mësim në Lice dhe të frekuentonte lokalet luksoze të kohës. Të diskutonte dhe të mbronte haptas e me zjarr idetë nacionaliste. «Edhe këta s'kanë pse më ngasin,» — mendoi ai kur erdhi në fuqi pushteti i popullit. Po s'kaluan muaj dhe në skenë dolën miqtë e vjetër. Pas një darke të këndshme në selin e misionit anglez, fare papritur, u emërua gazetar i «Bashkimit» dhe, për të humbur gjurmët që, me sa dukej, ruanin enigmë, miqtë e këshilluan që shkrimet e tij t'i firmoste vetëm me inicialet N.N.

Tek kujtoi këto, Adil Çika s'ia ndante sytë kokës pa flokë, beretës që mbante në duar dhe atij trupi të imët e kërcijve të hollë.

— Është e çuditshme, — tha kapiteni, — se si u shkon mendja disa njerëzve që të shpifin përtë ndershmin. — Dhe sérishmi hapi gazetën.

— Vetëm me këto marifete s'jam marrë kurër, — tha N. N. duke vrarë mendjen se ku donte të dilte ky oficer me këtë pyetje.

— E besoj! S'ka mundësi që një njeri si ti, veçanërisht në këtë moshë, të përzihet në një valle si kjo.

— Unë në valle?

— Unë përdora fjalën «valle», kurse për ty thonë... E ç'nuk thonë. Mbi shtatë veta kanë shkruar. E ç'nuk shkruajnë! — trilloi kapiteni pa ia ndarë sytë gazetës, ndonëse i téri ishte përqendruar mbi N. N. dhe po hetonte se si do të reagonte ai.

— Po ç'kanë me mua?

— Po hë de, ç'kanë?! I fundit sapo doli. Dhe e di si më tha? Tha se e njoh zotin N. E kam mik dhe koleg, po më vjen keq që është përzier në këtë gjellë... Pastaj vazhdoi: — I shihja çdo ditë me Zego Korbin. Edhe në kafe bashkë. Edhe në rrugë po ashtu. Edhe në shtëpi... S'është e mundur, i thashë. Mua më thua, nguli këmbë. E lëshoj edhe me shkrim po ta kërkoni.

— E çfarë do të shkruante, zoti hetues? — tha pas kësaj heshtjeje të gjatë N. N.

— Ca gjëra për të cilat s'të vete mendja kurrë. Se gjoja Zego Korbin e paske vrarë ti... Sa dëgjoi fjalën «vrasje», N. N. mori një pamje tepër të mjerë. Iu drodh mjekra dhe iu shterën fjalët. Kishte ulur kokën dhe kishte shtrënguar fort në duar beretën.

— Po natyrisht unë as që mund t'i besoja këtij njeriu dhe thashë pa ta pyes një herë vetë gazetarin.

— Unë s'e kam vrarë, zoti hetues... As e marr dot me mend se si mund të vritet një njeri!

— As që di gjë se kush mund ta ketë vrarë?

— Jo, zoti hetues!

— As të bijën?

— As atë, zoti hetues.

— Ja ç'do të thotë kur të vijnë informata të rreme! Bile dikush në një letër thotë se gazetari N. N. e ka kryer këtë krim i shtyrë nga dikush tjetër dhe përmend pastaj emrat e dy gazetarëve anglezë, mikeshat tuaja që i ke shoqëruar nëpër Shqipëri... Si?... Si e kishin emrin? Po! Të zonjës Kalin që, ç'është e vërteta, me qëllime djallëzore ka mbledhur mjaft të dhëna të këqija, dhe të zonjës Penington, — tha kapiteni dhe mbeti në pritje duke krijuar përshtypjen se ai vetëm sa donte të informohej për këto thënie dhe pastaj do ta linte të lirë gazetarin N. N.

— Ata me siguri janë të çmendur, zoti hetues.

— Nejse! — tha kapiteni dhe, duke u nisur nga ato që kishte mësuar për karakterin e gazetarit, u mundua që të ishte sa më miqësor. — Si mendoni ju, nuk do të ishte e udhës që, duke kërkuar vrasësit e Korbajve, të kërkonim edhe ca lidhje të tjera.

— Si t'ju them, zoti hetues!

— Dreqi e mori. Ja përsëri m'u kujtua se dikush sot në mëngjes më mori në telefon dhe më tha: E lexuat «Bashkimin»? Natyrisht, i thashë. Po artikullin që bën fjalë për rrezikun e karkalecit. Jo, i thashë dhe i kërkova datën e gazetës. E ditës së premte, më tha. Faleminderit, i thashë. S'është fjala për të më nderuar, por për ca gjëra të tjera, tha dhe e holloi zërin. Pastaj seç përmendi ca fjalë pa kuptim.

N. N. dëgjonte si i hutuar. Akuza për vrasjen

e Korbajve dhe shtytjen nga disa misionarë të huaj. D.m.th. vënia në shërbim të tyre... Artikulli për rrezikun e karkalecit... «Cila duhet të jetë arsyja e arrestit?» — mendoi.

Adil Çika vuri re se sjellja e tij s'kishte asnje pozë, asnje shtirje, asnje prirje për ta zgjatur fazën e hetimit. Prandaj, apo Adil Çika e pyeti nëse ishte ai autor i shkrimit, apo ndokush tjetër, pa hezitim, u përgjigj:

— Po, zoti hetues. Unë e kam shkruar.

— Profesioni yt është agronomia?

— Jo!

— Veteriner? — e pyeti Adil Çika.

— Gazetar. Në të kaluarën kam qenë mësues në lice, — shpjegoi ai dhe më pas shtoi se para se të shkruante për rrezikun e madh që shkakton karkaleci, ishte marrë vesh me redaksinë dhe pastaj me seksionin e bujqësisë. — Specialistët më njohën me dëmet e mëdha që bëri ky insekt vitin e kaluar... Ata m'i treguan edhe rrugët se si mund të luftohet ky insekt, — tha ai pa ia ndarë sytë kapitenit dhe mënyrës se si do të reagon.

— Artikull i shkruar me kulturë! — tha Adil Çika.

— Mundohemi. Tërë barra e gazetës rëndon mbi tre-katër veta, — tha gazetari për të lënë përshtypjen se oficeri e kishte gjuar me komplimentin e tij.

— Nuk kuptova diçka, — tha Adil Çika. — Ti, kur shkruan për rrezikun e këtij insekti, thua se ai është aq i madh, sa na jep të drejtë që përpjekjen për shfarosjen e tij ta quajmë iminente... Bile shumë serioze. Nëlloj si buburrecin e Kolorados.

— E thjeshtë, shoku kapiten!

— Cila?

Gazetari deshi t'i bënte një koment të gjatë

shkrimit të tij dhe të kthehej përsëri te rreziku i këtij insekti.

— E kam fjalën për buburrecin e Kolorados, — tha kapiteni. — M'u duk si diçka e largët, e padëgjuar... Ndoshta, ndoshta edhe...

— Është vetëm një krahasim, shoku Kapiten!

— E ke gjetur bukur!

— Kur shkruajmë, na duhet vazhdimisht të shfletojmë.

— Kaq i rrezikshëm është ky insekt?

— Shumë! Diku kam lexuar se bën kërdinë.

— Sidomos në Kolorado!

— Përhapet edhe në kontinente të tjera, shoku kapiten.

— Diku shkruani për njëfarë preparati... Për arsenatin e sodiumit... Pastaj shton: «Kontigjenti i parë erdhi.»

— Informacionin e kam marrë nga seksioni i bujqësisë, — shpejtoi të përgjigjej gazetari N.N.

— Pyeta. Ata s'kanë asnje dijeni për këtë çështje.

— Ndoshta e ngatérroj me atë të ekonomisë.

— Edhe ata u përgjigjën negativisht... A mund të na e zbërthesh më hapur përbajtjen e artikullit dhe bashkë me këtë të na thuash se kush ta ka diktuar atë?

— Nevoja e luftës kundër karkalecit, zoti kapiten.

— Gázetari N. N., besoj do të të mjaftojnë 24 orë për tu menduar.

Në dhomë hyri ushtari me uniformë gri.

— Më falni, zoti kapiten, po mbrëmë s'm'u kujtuan të gjitha... Ndoshta edhe pse gjithçka ndodhi papritur... ndoshta mosha... Po më mirë po jua tregoj ngjarjen fill e për pe. Unë si rojtar nate rrija te porta e jashtme. Ishte dimër. Errësirë. Ja, si mbrëmë. Po kjo ka ndodhur vitin e kaluar, zoti oficer, dhe zoti do të më falë po të kem harruar ndonjë gjë...

— Vazhdo!

— S'dua që ta marrë vesh as dom Kela!... Ai doli vonë atë natë nga kisha. Po para se të dilte ai, unë ndjeva takat e një gruaje që ecte në trotuar. Ju thashë që ishte errësirë. S'kishte njërez.

Rojtari heshti. U duk sikur u druajt për atë që do të thoshte në vazhdim, pa Adil Çikën, Mete Jaupin, fundin e dhomës.

— Kela e ndoqi nga pas. Ajo u fut në rrugicë. Edhe dom Kela në rrugicë. Femra e pa dhe iu duk diçka e habitshme. — Këto fjalë i shqiptoi ngadalë dhe të veçuara. — Po duket vajza e kishte parë edhe herë tjetër priftin tonë dhe duket i kishte pëlqyer, zoti hetues... punë i foli: «Mund ta bëjmë bashkë këtë copë rrugë?» tha.

— Po ajo?

— M'u dëgjua: «Unë e kam këtu afër shtëpinë.» Pas këtyre fjalëve ai i tha: «Ç'rëndësi ka nëse e ke afër apo larg shtëpinë?» «Po si t'ju them, padre,» i tha ajo dhe mbajti këmbët. «Unë di një rrugë... Është rruga që të shpie te zoti.» Të dy kishin qëndruar në një vend ku mungonte ndriçimi, — shpjegoi rojtari. — Dëgjova përsëri

priftin që i tha: «Eja!» dhe e tërroqi për dore. «Jo,» i tha ajo. «Jam e lodhur.» «Mbështetu tek unë!» «Jo,» përsëriti ajo dhe bëri të ikte. «Mos u tremb,» i tha ai, «Natën gjérat duken më të mëdha, më të llahtarshme, po në të vërtetë s'janë ashtu. Vetëm duken.»

— Ajo qëndroi? — pyeti Adil Çika.

— Natyrisht, zoti oficer. Të dy ishin pranë njëri-tjetrit.

— Pastaj?

— «Nata ka shumë mistere,» i tha Dom Kela, «kurse ne...» «Çfarë ne?» e pyeti femra. «Nata po na bën miq,» i tha ai. Pastaj pashë që dom Kela e tërroqi për krahu më në thellësi të frugicës. Ajo kundërshtoi, po ai e urdhëroi dhe ajo i shkoi pas... «Duket se bëni jetë të varfër,» i pëshpëriti dom Kela. «Jo edhe aq,» tha ajo. «Flas për jetë shpirtërore,» i tha dom Kela. «E kuptova ndryshe,» tha ajo. «Qetësinë e ka falur zoti,» i tha dom Kela dhe i hodhi duart në qafë.

Rojtari i kishës përsëri heshti. Adil Çika e pa në sy gati si me inat dhe e kuptoi se diçka ose ishte stisur në këtë tregim, ose nuk ishte në vendin e vet. Po cila ishte e rrema? Iu duk se mendimi ngeci në një pikë dhe s'mundi të ecte më tej.

— Pastaj? — pyeti ai.

— Edhe ajo, zoti oficer... Ky ishte takimi i parë i tyre. Pastaj u bënë miq dhe takoheshin jorrallë... Edhe në qelë, zoti oficer. I thashë të gjitha dhe tashti më duket se e shpëtova shpirtin, — tha ai dhe kroi hundën me gishtin e trashë.

Adil Çika u kthye nga Mete Jaupi. Ai mblođhi supet. Rojtari i kishës priste që t'i thoshin: «Ik, faleminderit.»

— Po ti si e pe gjithë këtë ngjarje?

— Ju thashë, zoti hetues, prifti e ndaloi femrën në rrugicë.

— Dhe ti iu vure mbrapa?

— Ishte errësirë, zoti oficer.

— Po si e dëgjove me kaq hollësi këtë bisëdë të gjatë? Ti atë natë më the se s'para dëgjon nga veshët.

Rojtari uli kokën, fërkoi duart dhe u hoq sikur i vinte rëndë t'i përgjigjej kësaj pyetjeje.

— Isha afruar shumë afër, zoti oficer... I pashtë edhe kur u përqafuan.

— Mëkat! — u tall Adil Çika.

— Zoti i fal mëkatet e të rinjve, zoti hetues.

— Kështu thotë ungjilli?

— Besoj se bëra mirë që erdha dhe jua thashë si qëndron e vërteta, se nesër s'i dihet si vjen puna dhe s'dua të dal fajtor.

— Mirë bëre! Tashti që e shpëtova shpirtin, shko! — urdhëroi Adil Çika.

Rojtari e pa për një kohë të gjatë. U ngrit me frikë, futi kapelen nën sqetull, bëri kryq dhe eci mbrapsht.

— Qoftë lëvdue Krishti! — tha ai dhe mbylli derën.

Të dy oficerët u panë në sy.

— Kuptove gjë? — e pyeti Adil Çika.

— Jo! — tundi kokën Mete Jaupi.

— Një lojë e kurdisur keq dhe vetëm kaq, — tha Adil Çika. — Gjithçka është përgatitur nga dom Kela.

— Si duket ai përgatitet që ta humbasim kohën mbas dashuriçkave...

— Te ky motiv ai nuk sheh asnjë rrezik dhe kërkon që ne të harrojmë kryesoren. Ndrysht pse duhej të vinte rojtari? Kjo lojë me siguri është përgatitur sa po jam larguar unë nga kisha.

Pasi kanë shoshtur çështjen, kanë mësuar përmendsh të njëjtën pjesë!

— Ç'budallenj!

— Veprim fëmijëror! — u tall Adil Çika.

3

Në pritje të të pandehurit N. N. Adil Çika hapi dosjen dhe nxori informacionin që bënte fjalë për veprimtarinë e të arrestuarit A. K. Le-xoi: «...në allishverishet e tij janë përzier një sërë tregtarësh dhe elementë të tjera të deklasuar. Deponimet e tij janë vërtetuar tëresisht. Tre persona (emrat e tyre ishin nënvizuar) kanë ndërruar në bankë për llogari të A. K. pesëdhjetë mijë franga shqiptare. (Të tre personat ishin njerëz të kompromentuar, që kishin përfituar nga i pandehuri nga pësëqind franga secili.)

Shtesë: Nga kontrolli që iu bë, të pandehurit iu gjetën para të groposura. Llogaria e tyre nuk është bërë akoma.»

«Të tjerat i di,» — tha dhe, sikur të donte ta harronte emrin e A. K.-së, e përqendroi vëmendjen në një informacion tjetër që ishte firmosur nga toger Jaho Binoja. Përbajtja e tij u kushtohej deponimeve të dy të pandehurve të tjerë që kishin falsifikuar para letër, me një mënyrë mjaft banale e primitive, kurse, për të hedhur flori në qarkullim, u kishin hapur monedhave nga një birrë, që të krijonte përshtypjen se ato ishin pjesë të bizhuve. Po fitimet më të mëdha ata i kishin bërë, siç përmendte togeri hetues, në kohën e ndërrimit të monedhës. Me

emra fals dhe në qytete të ndryshme kishin aktivizuar shumë njerëz dhe kishin fituar mbi njëzet e pesë mijë franga shqiptare...

Adil Çika ishte përqendruar në hollësirat e informacionit, në shifrat dhe emrat e matrapazëve të monedhës kur hyri ushtari me uniformë gri që shoqëronte ish-gazetarin N. N.

— Ulu, i pandehur!

— Urdhëroni, zoti hetues!

— Shpresojmë se je menduar.

N. N. uli kokën dhe pa gjunjët e hollë që i dridheshin.

— Kërkoj që të përgjigjesh drejt. Veç që ndihmon çështjen, por në këtë mënyrë lehtëson edhe veten... Mos u nxito! Dëgjomë deri në fund që të bindesh se ne dimë gjithçka. «Buburreci i Kolorados» s'ka asnje lidhje me shkrimin... Na thuaj pse është futur në të dhe cili është nënteksti?

— Zoti hetues...

— Kur shkruan se «kontigjenti i parë arriti», nuk është fjala për preparatin e arsenatit të sodiumit... Dikë ke dashur të njoftosh se njeriu që pritej erdhi... Cili është ai?

N. N., që s'e priste që organet e punëve të brendshme të kishin informacion kaq të plotë, u hutua dhe e pa gjatë oficerin në sy, si të kërkonte të lexonte në ta kufijtë e dijeve të tij.

Edhe Adil Çika s'ia ndau sytë fytyrës që kishte filluar të zverdhej, mjekrës së parruar, qafës së hollë dhe së fundi pardësysë së tij.

— Të qenka këputur një kopsë?

— S'di se kur!

— Në dhomën e izolimit?

— Ndoshta! Dreqi e di. Ne pleqtë jemi të pakujdeshëm për vete.

— Në këtë rast më shumë është faji i gruas,
— tha Adil Çika si me shaka.

— Jo! Ajo e shkreta disa herë më kishte thënë: «Dale ta qep, more burrë, se na turpë-rove!»

Adil Çika vendosi të mos e zgjaste më tej bisedën.

— Kopsën tënde ne e kemi gjetur në sallonin e shtëpisë së zotit Korbi.

— S'është e mundur!

— Bile ka edhe një njollë gjaku. Si e shpjeton këtë? — tha Adil Çika që nxori kopsën nga xhepi dhe ia vuri para syve?

— Duhet të jetë diçka krejt e rastit, — tha gazetari N. N. që iu duk sikur kryehetuesi do ta pyeste: «Mos ke shtënë ti kundër Zeqo Korbit?»

Adil Çika vuri re se ai ishte zverdhur tej mase dhe e mbuloi djersa.

— Do ujë?

— Pak! Sa të lag buzën, po qe e mundur?

Adil Çika i dha gotën. Ai piu me gllënjkë të mëdha dhe, sa herë që kapërdihej, i kërciste gurmazi.

— Si lidheshit me njëri-tjetrin, i pandehur?

N. N. përsëri hezitoi të përgjigjej dhe, pasi bëri dorën si hinkë, e vuri në llapën e veshit e pyeti:

— Çfarë?

— Vetëm me anë të shkrimeve të tua?

— Jo, zoti hetues.

— Cili ishte ndërlidhësi?

— Nuk e njoh, zoti hetues.

— Kambanat?

— O perëndi! — belbëzoi ai dhe lëpiu buzët e holla me gjuhën e mpirë.

— Dom Kela?

— C'kërkoni, zoti hetues?

— Po ti me kë lidheshe?

N. N. s'kishte nga t'ia mbante. Filloj:

— Me një kasap! Kishim edhe forma të tjera.

Adil Çikës iu kujtua lajmërimi për tifon e morrit mbi shtyllën e betonit dhe si me pëshpërim tha: «exantimatikja»?...

— Aty afishohej gjithnjë orari i barnatoreve.

— Edhe shtëpitë e mameve, — dhe pas kësaj përgjigjeje Adil Çika hapi sirtarin, nxori një letër të shkruar me germa të mëdha, lexoi:

Makbule Dizdari. Rruga Hasan Prishtira. Nr. 24. Zyhra Gjyli. Apartamentet e lagjes së nepunësve. Të dy mamitë shërbejnë në çdo orë të ditës dhe të natës me kundrapagesë duke i transportuar me pajton. Ç'thua?

— Numri i shtëpisë së zonjës Dizdari lajmëronte orën e takimit, kurse ai i barnatores së natës datën e takimit.

Adil Çika, pa e pyetur për adresën e mame së dytë, nxori nga sirtari një letër tjetër të shkruar po aq bukur sa e para dhe përsëri lexi:

Zyrtare: Ministria e Arsimit kërkon të blejë një veturë të markës...

— Kjo s'përfaqëson asgjë, zoti kapiten. Ishte thjesht një lajmërim i zakonshëm.

— Për të kamufluar sinjalat e tjera?

— Edhe për këtë.

Kapiteni, pa e parë në sy, lexoi lajmërimin e tretë:

«Okazion: Shitet një piano e markës «August Forster». Të interesuarit të paraqiten Rruga «Qemal Stafa» Nr. 124 te zonja Alime Bej.»

— Shtëpinë ku do të mblidheshim, — tha gazetari N. N. dhe kërkoi përsëri ujë.

— Po ky? — pyeti Adil Çika dhe lexoi lajmërimin e katërt:

— «Private: Kërkohen tavolina dhe karrige metalike të një lloji dhe dimensioni. Pranohen të çdo ngjyre. Nevojtari Hotel «Kontinetal» (Për lulishten)»

— I zakonshëm... Pa pikësynim, — tha gazetari N. N.

Adil Çika pa nga Mete Jaupi për t'i dhënë të kuptonte nëse kishte gjë për të pyetur.

Togeri tundi kokën në shenjë mohimi. Brënda tij ishte mbledhur një zemërim i tërbuar, me gjithatë ai bëri përpjekje që t'i buzëqeshte me zor kolegut të tij.

— Ju lutem, zotërinj, kini mëshirë. Unë s'kam faj. Më futën në valle.

Lajmërim:

I bëhet e ditur popullit se më 16 nëntor ditën e mërkurë, ora 9 para dite, në kinema «Tomori» fillon gjykimi i kriminelëve të njojur: Seit Matja, Fadil Treska, Xhemal Zhegu.

Abuzim në furra:

Eshtë vënë re se shumë furra që gatuajnë bukë me miell të marrë nga KANÇl i qytetit, nxjerrin bukë me një kualitet të ndryshëm nga ai që eshtë caktuar.

Me një inspektim që bëri drejtori i tregtisë dhe industrisë, z. Namik Vesho, u konstatua se në furrën e Rustem Ballës buka nuk i përshtatet aspak kualitetit që duhet të kishte.

Mielli i grurit përzihet me miell misri... Seksioni i ekonomisë bëri proceset e duhura dhe vendosi që furrxhiu t'i jepet gjyqit të popullit.

**Sek. ek.
Tiranë**

BASHKIMI

Datë...

Nr...

Në garat për under të festës kombëtare, 29 Nëntorit, është përfshirë gjithë kombi. Vetëm qarku i Gjirokastrës i ka kursyer pushtetit të popullit 2 106 143 fr. ari. Ai i Vlorës. Miniera e Selenicës. e naftës në Kuçovë dhanë mbi planin 20 000 tonë naftë.

Përgatitje për festën:

*Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!
Rroftë Pushteti i Popullit!
Rroftë Gjeneral kolonel Enver Hoxha!
Rroftë!
Lavdi!*

Sabotatorët e Maliqit në litar!

KAPITULLI VIII

Ata po shëtisnin të qetë në një rrugë me drita
të rralla midis kopshtijeve dhe vilave të Tiranës
së Re.

— Sa ngadalë që i thua fjalët! — tha ajo.

Adil Çika e pa dhe lëmoi me dorë flokët e
gjatë e të zez që i kishin mbuluar shpatullat.
Kishte sy të zez. Vështrim të qetë. Fytyrë të
rrumbullakët e të bardhë si qumësht që e bënte
të bukur dhe të dashur. Edhe ajo fliste ngadalë
dhe vazhdimisht e shikonte në sy Adil Çikën.

— Ti je shumë i heshtur dhe aq i qetë,
thua se nuk di të flasësh.

— Të duket ty, Vito!

— Jo! Kam kohë që e kam vënë re.

— Kurse unë mendoj ndryshe për veten, —
tha ai pa e hequr cigaret nga cepi i buzëve që

në errësirë dukej sikur lodronte një valle e bezdissime.

— Hiqe! — i tha ajo dhe ia flaku tej...

— Bukurezë! — tha Adil Çika.

— Ku?

— Ja! — dhe i tregoi dritën e cigares që humbi diku midis barishteve.

— Kam frikë! — tha ajo dhe kujtoi se një i panjohur me zë të trashë, gati si të ngjirur, i kishte telefonuar paradite. «BRASHI?» «Po!» «Vito Marini?» «Po.» Kemi frikë, zonjushë, se, në qoftë se i fejuari juaj do të vazhdojë të merret me punët e kishës dhe priftin tonë, s'do të bëni kurrë dasmë dhe do të vishni për tërë jetën rroba të zeza...» Ajo kishte mbyllur telefonin dhe kishte vrapiuar te Mete Jaupi.

— Pse dridhesh? — pyeti Adil Çika.

— Po sikur të dalë njeri? — trilloi aty për aty Vitoja, — të na thotë: «Ç'bëni këtej në këtë orë të natës?»

— E cili ishte ai i marrë që do ta bënte këtë?
— tha Adil Çika dhe e shtrëngoi më pranë vetes.

— Ta zëmë një polic.

— Po ç'punë ka polici me ne?.... Bile me këdo tjetër. Te ne secili mund të shëtisë, të këndo-jë... Aq më tepër që unë jam oficer, — tha ai dhe afroi buzët në faqen e saj.

— Ose një tjetër, — tha ajo dhe deshi të shtonte: «Ta zëmë një njeri me zë të trashë», po iu kujtua porosia e Mete Jaupit që i kishte thënë që nga këto të mos i tregonte asgjë Adil Çikës. «Jam unë gjallë», kishte thënë ai dhe, për ta qetësuar, e kishte kaluar bisedën gjetiu. Edhe tashti që ata të dy shëtisnin të ngeshëm, ai ishte nja pesëdhjetë metra larg tyre. Ekte anës rrugës e pa rënë në sy....

Kishte filluar përsëri të frynte një erë e lehtë që sillte me vete aromën e gjithçkaje që fillon e kalbet në muajt e ftohtë. Ishte një erë fort e këndshme, që s'i ngjante as asaj të luleve, as asaj të kafesë, as të gjelltoreve....

— Kot thashë. Unë, kur jam me ty, nuk trembem kurrë, — i tha ajo.

Adil Çikës këto fjälë i kujtuan natën e parë kur ishin njojur. Edhe atëherë ishte mbrëmje e frynte erë. Ata shëtisnin po në këtë rrugë, larg njerëzve dhe dëgjonin vetëm hapat e tyre që shkelnin mbi gjethet e zverdhura të pemëve. Ajo i kishte thënë se, kur ishte me atë, nuk kishte frikë. «E pse të kesh frikë?» — e kishte pyetur Adil Çika. «Sepse jemi vetëm,» — i kishte thënë Vitoja. «Po pastaj?» Sidoqoftë ne sa jemi njojur, — i kishte thënë përsëri. Pastaj edhe ajo kishte parë dritë në sytë e tij. Ai kishte sy të ndezur.

«A e di, Vito? Unë në luftë kam pasur një shoqe.»

«Kjo është gjë e bukur.»

«Edhe ajo kishte sy si të tutë.»

«Megjithatë unë përsëri nuk zemërohem.»

«Sy të zez... fytyrë të bardhë... Rita e quanin.»

Asaj i ishte dukur se gjithë errësira ishte grumbulluar e mbledhur rrëth tyre. I kishte futur krahun Adil Çikës e ishte mbështetur në trupin e tij.

«Unë të dua, Vito.»

«Po Ritën?»

«Ajo s'është më. Ajo ishte një vajzë trime. Dhe sa e mirë. Dhe sa e dashur!»

«Kisha idenë se partizanët.... Domethënë edhe oficerët partizanë nuk dinë të duan»

Adil Çika kishte qeshur me të madhe. Edhe tashti qeshi.

Ata u kthyen.

Ka ca mbrëmje që mjegulla i bën shumë të mërzitshme. Qielli mbylllet dhe errësira zbret aq poshtë, sa të duket sikur e mban mbi supe, ose sikur rri kaluar mbi shtëpitë, rrugët, pemët. Kështu dukej edhe bregu i Lanës dhe më tej fusha e Shallvares ku karrocat vazhdonin të zbraznin gjithfarë mbeturinash.

Adil Çika pa fenerët që mezi ndriçonin natën, hotel «Dajtin,» bredhat me hije të rëndë në lulishten para tij dhe i lindi ideja se rregullimi i kësaj ane dhe shndërrimi i saj në park do të ishte një gjë e bukur. «Edhe bregu i Lanës mund të sistemohet, — mendoi ai. — Edhe anët e rrugëve. Tashti te ne duhet që çdo gjë të ndryshojë. Të bëhet e bukur.»

Vitoja qeshi dhe i tha se organizata e rinisë e kryeqytetit do të ndërmerrte së shpejti këtë aksion.... «Shallvarja» e braktisur do të shndërrohej në park pér rininë.

Rrugës deri në qendër, ku dikur kishte qenë bunkeri gjerman, futën në bisedën e tyre gjëra pa rëndësi.

— Eja! — i tha ajo.

— Ku?

— Në shtëpi. Ata na presin.

— Sonte po! — tha Adil Çika dhe i shtrëngoi krahun.

Në rrugë njerëzit shëtisnin më nge.

Ishte natë me mjegull nëntori. Mete Jaupi i përçollti deri afér shtëpisë. Ekte pas tyre dhe kërkonte në mendje urimin më të mirë kur të ndahej nga ata. «Sa të lumtur e ndiejnë veten,

— tha dhe përsëri i shkoi mendja tek ai kërcë-nimi në telefon. — Cili duhet të jetë njeriu me zë të ngjirur? Prifti? Jo. As njeriu që shkruan parulla... Atëherë kush? — pyeti dhe i hipi gjaku në kokë. — Le të guxojnë!..: — Ekte i vëtmuar në trotuar. Qyteti ishte ndriçuar më mirë se herë tjetër. — Edhe ca ditë, — tha ai, — dhe erdhi Festa e Çlirimtit.»

151819

Agrare:

Këshilli Ministror i Republikës Demokratike Popullore të Shqipërisë, mbasi mori dijeni të plota mbi përfundimin me sukses të Reformës Agrare në të gjithë territorin e Republikës, vendosi që data 17 Nëntor 1946 të shpallet ditë festë. Festë e Reformës Agrare, kësajëndrre shekullore të....

Në Krutje të Myzeqesë, fshatarët, me vullnet të lirë, bashkuan tokën, krahët, kafshët dhe veglat e punës dhe formuan të parën kooperativë fshatare.....

.....Kooperativa ka 120 anëtarë, prej të cilëve 50 gra. Ka një sipërfaqe toke prej 2100 dynëmësh dhe 26 pendë pune....

KAPITULLI IX

1

Në mesditën e 20 nëntorit, shefi i seksionit të punëve të brendshme kishte thirrur në zyrën e tij Adil Çikën dhe Mete Jaupin.

— Kur na pa, u shqetësua pa masë. Ne s'e zgjatëm. Zonjusha Tashko i kërkoi ta shikonte pianon. Na futi brenda. Zonjusha Tashko hapi kapakun dhe luajti diçka. Dhoma u mbush me tinguj.

— Edhe unë që s'marr vesh, m'u duk se ishte plaçkë e mirë. Edhe këngëtarja kishte zë të shkël-qyer.... S'e kisha dëgjuar kurrë, — tha Mete Jaupi.

— E pyetët për çmimin.

— Katastrofik. Një gjysmë milioni!....

— Kjo pritej! — tha majori.

— Ne i kërkuam pazar të dytë. «Për hatër të zonjushës këngëtare, mund t'ju ul 10 000 franga»,

— tha ajo. Vura re se ishte qetësuar plotësisht. Shtëpia ishte e fshehur në një rrugicë. Rrethuar me mure qerpiçi, me oborr dhe pemë të dendura. Me sa vura re, kishte dy hyrje. Dhomat ishin të bollshme. Kur dolëm, na këshilloi të mendohehim.

— Gjithçka e qartë! — tha majori.

Mete Jaupi ndezi cigare.

— Pasi e diskutuan me shokët, arritëm në përfundimin që sonte të arrestohet Ahmet Bregu. Prifti. Zonja Alime Bej.

— Po misionari i huaj? — pyeti Adil Çika.

— Do ta presim në orën e caktuar dhe do tā këshillojmë që ta heqë mballonëm nga syri. Pastaj do t'i tregojmë itinerarin që ndoqi misioni i shtetit të tij.... Mister Fulci... Hoxhscni..... Do t'i lutemi që të marrë me vete edhe unazën me nr: 83 654 për institutin «Rosa dhe pata»....

Ushtarakët qeshën.

— Kalojmë në çështjen e dytë: Ju mbrëmë më vutë në dijeni për intoksikacionin e gazetarit.

— Ishte diçka më shumë se intoksikacion.

— Jeni të bindur?

— Analizat këtë treguan.

— Kjo na vë para shumë pyetjeve.

— S'di ç'të them, shoku major! E kemi pësuar gjatë edhe me Meten.

Togeri miratoi me kokë.

— Kush duhet të ketë vënë dërë?

— Keni të drejtë të dyshoni tek unë, — tha Adil Çika.

— Ose tek unë, — pasoi Mete Jaupi.

— Doni të thoni tek unë? — pyeti majori.

— Në seksion vetëm ne të tre kemi dijeni për arrestimin e tij.

— Po! — pëshpëriti së koti shefi i seksionit

të punëve të brendshme. Pastaj tha: — Mos ndoshta kuzhinieri?

— Mundet edhe ndonjë nga kolegët tanë... Si duket ata e kanë njojur mirë karakterin e tij. Janë trembur se ai do të zbërthehej që në seancën e parë dhe kanë vrarë mendjen të gjenin rrugën më të lehtë për ta hequr qafe, — tha. Dhe instinktivisht kontrolloi xhepin e xhaketës ku ruante një letër që nga të lexuarit disa herë ishte zhbravitur. Ishte një letër anonime me anën e së cilës Adil Çikën e kërcënnonin që të mos i ngjyente shumë duart në pilaf.... Dhe më poshtë shkoqur e fare hapur e këshillonin që të mos ngacmonte klerin, se... «në varrezat pranë Korabajve ka akoma vend bosh».

— Kurse mua më shqetëson si u mor vesh arrestimi i tij.

— Mua jo! — tha Adil Çika dhe ndezi cigare, megjithëse e dinte se shefit të seksionit i pëlqente të pinte duhan vetëm mbasi mbaronin punë. — Jam i bindur! — iu përgjigj Adil Çika vështrimit pyetës të dy kolegëve të tij dhe, pa dhënë asnje shpjegim tjetër, shtoi: — Edhe kësaj çështjeje do t'i vijë radha të sqarohet, — dhe në mend solli dy fytyrat e oficerëve madhorë atë të kolonelit me duar të vogla, nofulla të dala e dhëmbë të bardhë dhe të nënkolonelit të UDB-së, që nga trupi dhe tiparet të krijonte bindjen që në shikimin e parë se ishte me origjinë serbe. Sapo kishte hyrë në zyrë, Adil Çika kishte dashur të nderonte, por koloneli shqiptar ishte ngritur në këmbë, e kishte marrë përkrahu dhe e kishte ulur në një nga poltronët e ftohtë pranë oficerit të huaj. «Këshilltari ynë për punët e hetuesisë, nënkolonel Blagovic.» Adil Çika kishte zgjatur dorën. «Kam marrë vesh se jeni lodhur, kapiten.» «Jo dhe aq, shoku kolonel!» — i ishte

përgjigjur. Pastaj, pa e stërholluar bisedën, koloneli e kishte kritikuar se ai dhe vartësit e tij po vraponin pas ca grimcave. Adil Çika ishte çuditur. Çfarë quante grimca koloneli? Por ndër-kohë ai dëgjoi: «Kam porosi nga udhëheqja e Ministrisë që t'ju tërheq vërejtjen.» Adil Çika kishte ngritur sytë. «Vërejtje?... Përse?... » — kishte pyetur veten. Por edhe këtë mendim s'e kishte çuar dot deri në fund. «Jam gjithashtu i porositur nga... E kuption besoj se nga... Që punën e gazetarit N.N... Bile edhe të ndonjë tjetri, për të cilin kushedi ç'mendim të sillet në kokë, ta shihni me gjakftohtësi.... Si ta them... — përtypi ca fjalë nëpër gojë dhe përsëri vazhdoi: — Me veprimet tuaja të nxituara na keni vënë në pozitë të vështirë... Po na futni në qorr-sokak. Kleri është zemëruar... Dhe mës e shkëpusni atë nga populli!» Pas këtyre fjalëve koloneli kishte parë nga këshilltari i UDB-së që gjatë gjithë kohës luante nofullat si të përtyponte çamçakëz...

Adil Çika, sa herë që e kujtonte këtë takim, shtrëngonte buzët, tundte kokën dhe përsëriste me vete: «S'është e mundur! Jo!...» Prandaj as tashti s'u tha gjë kolegëve të tij. Majori që e ndjeu shqetësimin e tij nxori paketën dhe u ofroi cigare. Ndezi edhe përvete.

Ahmet Bregu u arrestua në orën 18⁰⁰ në shtëpinë e tij. Akuza: vrasje me paramëndim. Në orën 20⁰⁰ u mor në pyetje. Ishte i qetë dhe gjak-

ftohtë. Në ftyrën e shformuar që i ngjante një portreti të gdhendur keq, dallosheshim ca pikatë zeza të futura thellë në mish. Kishte nofulla të dala. Ballë e veshë të mëdhenj! Sy të vegjël e të zbehtë si të sëmurë nga verdhëza. Herë merrte pamjen e njeriut që e sheh çdo gjë me përbuzje, herë atë të cinikut që donte të thoshte: «E ç'do të më bëni?» Po çdo gjë ishte një përpjekje e sforcuar, sepse, apo Ahmet Bregu u ul në karrige, ushtarakët vunë re se, nga frika, ftyra i ndryshoi ngjyrë.

Ndërsa Adil Çika diçka shkruante, Mete Jaupi, që kishte zënë vend në të djathtë të tij, po shikonte me vëmendje veshjen e zgjedhur dhe të pastër. Këmishë me ngjyrë të ndezur, xhaketë sportive me kuadrate, pantallona sipas modës... Me kokën midis duarve dukej sikur luante rolin e njeriut që apo i kanë komunikuar dënimin me vdekje.

Kur u pyet se si e konsideronte arrestimin, ai u përgjigj pa u menduar:

— E keni bërë në kohën e duhur.... Ndryshe...

«Ç'do të thotë me këtë «ndryshe,» — mendoi Adil Çika. — Mos na kërcën? Apo ndonjë masë ndëshkimore ndaj vetes?» Ai ndiqte fshehur heshtjen e kryehetuesit.

— E dija se pas atyre ngjarjeve natyrisht që...

— e la fjalën përgjysmë Ahmet Bregu dhe, ndonëse sytë i kishte krejt të pastër, nxori shaminë, bëri sikur fshiu lotët. — Që nga dita që e mora vesh, besomëni, zoti hetues, s'kam vënë gjumë në sy... Bile më ka mbetur peng. Kishim javë që ishim prishur me njëri-tjetrin. As për të ngushëlluar të atin s'kam shkuar, — tha ai dhe, pa i lënë radhë që kryehetuesi të pyeste se ç'ishte kjo ftohtësi, vazhdoi: — Atë ditë, përfat të keq, s'u ndodha këtu... Isha në Durrës.

Më vonë... si t'ju them?.... Sedra e sëmurë... Më erdhi turp. Pastaj mendova se si do të më pri-stë ai. Zeqo Korbi është njeri i vrazhdë. S'dihet se ç'mund të mendonte, ndoshta më bënte shkaktar, sepse ajo prej natyre ishte shumë e ndjeshme, zoti oficer! — tha dhe e pa në sy kryehetuesin, duke u munduar që të mos lëvizte asnje muskul në fytyrë.

«Një alibi e kurdisur me kujdes,» — i shkoi në mend Adil Çikës, që kishte mësuar deri në hollësi për veprimet dhe lëvizjet e Ahmet Bregut gjatë këtyre ditëve.

— Kurse faktet flasin ndryshe, — tha ai për të parë reagimin e të pandehurit.

— Po të isha në vendin tuaj, edhe unë kë-shtu do të gjykoja... Sepse marrëdhëniet tonë ishin të atilla, sa gojët e botës... — tha dhe mbu-loi fytyrën me duar. — Ajo ka vdekur, kurse unë... O perëndi! A ka mundësi që të shkoj sa më parë pranë saj? Mos më kurseni, ju lutem! E kam dashur shumë!

— Po ajo?

— Jo dhe aq, zoti hetues. Bile më tradh-tonte.

— Me cilin?

Ahmet Bregu, pas kësaj pyetjeje, heshti, për t'i lënë kohë vetes të mendohej nëse duhej të përmendte emra të tjerë, apo të hiqej sikur nuk i njihte.

— Me shumë, zoti hetues.

Mete Jaupi mezi po e dëgjonte këtë pohim të turpshëm. «Mashkull i pacipë, — shau. — Si mund të të tradhtoië një femër kur e do aq shumë, ose si mund të duhet një femër që e di se të tradhton me dikë tjetër?»

— Më 12 nëntor ju kanë parë që keni shëtitur me Drita Korbin. Pastaj jeni ulur diku nga

fundi i barit në «Dajti». Keni pirë kumel, — trilloi edhe Adil Çika pér t'iu kundërvënë alibisë së tij. — Pastaj keni dalë në rrugë. Q'ndodhi më tej, a mund të na thoni?

— Ajo më ftoi që të shkonim në shtëpi.

— Po ti?

— Unë nuk pranova. Jua thashë, zoti oficer, me atin e saj s'i kisha punët mirë!

— Po si ndodhi pastaj?

— Nuk e di, zoti oficer.

— Ju e përcollët deri te rrugica, u futët në kopsht?

— Si t'ju them, zoti oficer! — tha dhe u përgatit që të pranonte shumë më tepër se kaq. «Kësisoj, — tha me vete, — akuza po lehtësohenet dhe do të trajtohem thjesht si një dëshmitar...»

— Ti mendove se vdekje më e rehatshme s'kishte si gjendej tjetër pér një njeri kur e do shumë dhe e shtyve në gropën e gëlqeres?

— Jo, zoti hetues! — tha gati me britmë Ahmet Bregu që s'e priste këtë version përgatitur me kaq kujdes.

— Dhe ajo, pas ulërimës, ra brenda...

— Ju betohem, zoti hetues, unë s'e kam vrarë, — tha ai dhe përsëri mblodhi kokën midis duarve dhe rënkoj.

— Aq shumë e keni dashur, sa ta vrisnit?

— Zoti hetues!

Pasi doli Ahmet Bregu, toger Mete Jaipi u ngrit në këmbë, ndezi cigare, zuri mjekrën me dorë dhe lëshoi një «t'ëmën e s'ëmës».

— Pohimet e tij duan të fshehin të vërtetën.

— Ju e përjashton mundësinë e krimit nga ana e tij? — pyeti Mete Jaipi.

— Plotësisht! tha Adil Çika pa asnjë hezitim.

— Pse e krijoi alibinë? Pastaj pse pranoi pa kundërshtim të gjitha versionet që krijuat ju deri në prag të vrasjes?

— Kjo tregon se çështja jo vetëm që është e komplikuar, por në të duhet të jenë përzier shumë motive. Megjithatë vetëm ai e di të vërtetën. Po natyrisht këto ngjarje s'duhet të jenë të largëta nga veprimet që kanë lidhje me priftin, as me ato të gazetarit N.N., ose të deputetit... Zotit S... E kompani... Alibia! — përsëriti.

3

Domi Kela u arrestua në orën 20⁰⁰. Kishte ditë që ishte i shqetësuar nga ajo vizita e papritur e kapitenit dhe nga biseda që kishte bërë me rojtarin. Ai pothuaj çdo natë kishte pritur në ankth. Edhe ditën... Dhe nja tri-katër orë para se të futej në shtëpinë e Alime Bejt... për të qetësuar nervat kishte porositur një pajton dhe po i binte kryeqytetit kryq e tërthor. Frynte erë dhe karrocieri që i ngacmonte në të rrallë kuajt, ishte mbështjellë thnjë urdhrat e priftit.

— Djathtas! - dëgjoi një zë.

Ai ktheu kokën dhe pa një njeri me bicikletë që e cte paralel me kuajt.

— Djathtas! Dëgjoi një zë të dytë në krahun tjeter. Edhe ai ishte me bicikletë.

Karrocieri i drejtoi kuajt djathtas. Prifti s'u bë i gjallë.

— Përsëri djathtas!

Karrocieri vuri re se dy njerëz u futën në karrrocë...

Pas 10 minutave karroca ndali në oborrin e sektionit të punëve të brendshme...

Dom Kela u mor në pyetje në orën 23^{oo}.

Gjatë gjithë kohës që kishte qëndruar në dhomën e izolimit ishte përpjekur të skiconte disa variantë të gjenjeshtërtë, të cilave çdo orë u shtonte hollësira, me qëllim që ta bënte sa më të besueshëm versionin se marrëdhëniet me Drita Korbin s'i kishin kaluar kurrrë caqet e intimitetit. Ky ishte versioni jo vetëm më i leverdissëhem për të, por edhe i diktuar. Prandaj ai e shtjelloi aq gjatë në kokë sa iu duk se edhe zoti po e ndihmonte që ky të bëhej më bindësi dhe përsëri kujtoi vizitën e oficerit të sektionit të punëve të brendëshme atë natë me shi dhe interesimin e tij vetëm për marrëdhëniet me D.K.. Por ndërkoħe e shqetësonte arrestimi aq papritur dhe pikërisht me 20 nëntor... Për tri orë ishte hequr e transformuar, sa lëkura e hollë dhe e ndritshme, gati si e tejdukshme, kishte marrë ngjyrën e rrathiëve të syzeve. Këtë shprehnin edhe sytë e tij që kishin humbur ngjyrën e zakonshme e ishin futur thellë në zgavrat e kafkës e u ngjanin dy rruazave të zbehta pa ngjyrë. Adil Ċika e ftoi të ulej. Pastaj qëllimisht po rrëmonte në sirtarin e tij s'dihet përse, dhe rrallë e vjedhurazi shikonte nga prifti. Edhe ai herë i ulte sytë përdhe, herë i hidhte anash, ose herë tjetër i përqëndronte në gishtat e kryqëzuar, në uniformën e tij, ose edhe tej xhamave të dritares, në errësirën e natës...

— Na falni, hirësi! Deri tashti ju kemi njohur vetëm me emrin Kel dhe titullin dom! Na duhet edhe mbiemri!

— Ndou, zoti oficer! - shpejtoi përgjigjen prifti.

— Dom Kel Ndou! Kështu?

— I pagëzuar para 27 vjetëve...

Kjo përgjigje i solli ndër mend Adil Çikës gjithçka që kishte lexuar në informacionin për të kaluarën e tij. Ai rridhte nga një familje qytetare. Mësimet e para i kishte marrë në shkollën e ulët qytetëse, pastaj në Kolegjin Saverian të fretërve dhe më vonë edhe tre vjet mësime të larta jashtë shtetit. Në vitin 1943 ishte dorëzuar prift. Të dhënat për kohën e luftës ishi në zbehta. Njihej vetëm miqësia me një kapiten nazist. Pas çlirimt ai ishte munduar të ruante ekuilibrimin dhe të mos binte në sy. Bile s'dihej pse eprorët e tij e transfruan nga Shkodra në Tiranë. Paraqitja e jashtme, ndoshta edhe detyra që kryente, e cila ishte pak si e lartë për moshën e tij, bëri që ai të binte menjëherë në sy. Veç dijeve fetare, informacioni lavdëronte edhe zgjuarsinë natyrale të këtij kleriku.

Për të térhequr vëmendjen e priftit dhe për të shtuar masën e nervozizmit dhe të përhumbjes, që s'e pati të vështirë ta lexonte në fytyrën e frikësuar të priftit, Adil Çika i kujtoi qëllimi i dëçka nga aktiviteti armiqësor i kishës franceskane që «shtëpinë e zotit», muret, dyshemetë, aty edhe stallën e derrave, i kishin kthyer në depo të blinduar. Prifti herë pas here tundte kokën, sikur donte të thoshte «nuk di gjë», dhe mundohej t'i bënte bisht kësaj bisede.

Papritur ai u ngrit në këmbë dhe bëri kryqin. Bashkë me lëvizjen e dorës që kishte filluar t'i dridhej ai pëshpëriti: «Në emër të atit, të birit, të shpirtit të shenjtë». Pastaj u ul. Nxori shaminë e bardhë dhe pastroi xhamat e hollë. Adil Çika tërthorazi u mundua të kalonte tej rrathëve të artë

dhe bëri përpjekje të depërtonte në bebëzat pa ngjyrë për të lexuar se q'fshihnnin ato. Frikë, apo hile...

— Edhe ata kështu u betuan... Për atin... birin dhe shpirtin e shenjtë!

— Ati është i të gjithëve, zoti oficer, dhe secili e respekton sipas bindjeve të tij.

— Po biri?

— Është Jesui! Biri i atit, ose ati bir.

— Po shpirti i shenjtë?

— Zoti oficer, mos mëkatoni me këto pyetje!

— tha dom Kela kur vuri re ironinë në cepat e buzëve të oficerit. — Zoti ynë ka thënë se, kush talllet me të madhin... - po s'mundi të vazhdonte më tej, sepse Adil Çika, gjatë kohës që prifti po mendohej ta formulonte këtë mendim sa më me kujdes, si pa vëmendje e krejt në mënyrë instinktive, nxori nga sirtari i tavolinës një zinxhir të artë që, duke e tundur si për të kaluar kohën, ose për të qetësuar nervat, e përdroddi në gishtërinjtë e dorës së djathë. Prifti i nguli sytë te kryqi i shndritshëm, mbi duart dhe këmbët e kryqëzuara të Jesuit dhe diçka i ndriçoi mendimin: Arrestimi me siguri, ashtu siç i kishte shkuar në mend, kishte të bënte me vrashjen e Drita Korbit dhe marrëdhëni e tyre. Ky mendim e ngrohu disi dhe tha me zë të butë e gati miqësor:

— Ju po bëni sakrilegj, zoti hetues. Të tallesh me Jesuin, fyeni zotin dhe kishën e shenjtë.

Pas kësaj dom Kelës i shkoi mendja se ndoshta «shakaja» me medalionin më shumë se pakujdesi ishte një provokim dhe i lindi mendimi që ta ndryshonte fillin e bisedës. Balli iu mbush me djersë, Sytë iu zbehën.

— Kur e kryqëzuan Jesuin...

— Në Golgotha? - e ndërpree kryehetuesi.

— Kështu thotë bibla... Po ka shumë mendime, - u përgjigj prifti dhe u bë gati të shtjellonte historinë e kryqëzimit. Po Adil Çika vendosi njëherësh që të mos e zgjaste më tej këtë kotësi dhe qëlloi atje ku dom Kela s'e priste.

— Hirësi, në qoftë se nuk dëshiron që hetimet të zgjaten...

— Po veproni kundër urdhrit tonë, zoti oficer!

Adil Çika vuri buzën në gaz:

— Protestoni?

— Kjo është fyerje. Ne kemi hierarkinë tonë dhe, mbi të gjitha, zotin...

— Kurse pushteti i popullit ka aprovuar ligjet e veta dhe para tij të gjithë shtetasit janë të bartë, padre. Ju këtë e dini!

— Ne merremi vetëm me punët e zotit. Dhe këtë të drejtë na e ka siguruar vetë shteti. Çdo gjë tjetër për ne është e huaj.

— Të njohim, zoti dom Kela, — tha gati me inat Adil Çika. - A mund të na thuash se ku duhet të ishe në këtë orë?

— Natyrisht në shtëpi, zoti hetues.

— Në atë të zonjës Alime Bej?

— Zoti hetues, në emër të atit protestoj.

— Po, hirësi! - dhe përveshi mëngën. — Ora 24^{oo}. Shikoje!... Pikërisht tashti merr fund gjithë përpjekja juaj.

— O Jesu!

Dom Kela kishte shkëputur kurrizin nga karrigia dhe gati-gati ishte mbledhur kruspull... «Si bëhet njeriu, — tha me vete Adil Çika. — Për të ardhur keq. «Krimb misri,»» — i shkoi ndër

mend. Tamam si krimb mielli ishte mbledhur nën rasën e zezë trupi i njeriut të perëndisë dhe përsëri Adil Çikës i doli përpara qëndrimi i tij para besimtarëve, ligjërata, zëri kumbues dhe trupi i drejtë, i hollë, i gjatë. Po ndryshe nga herë tjetër; tashti zëri i priftit dukej i lodhur dhe pezmi që e kishte mbërthyer për gryke spikati si diçka e bronztë. Adil Çika s'ia ndau sytë asaj fytyre të zbehë që ngjante me gjethet dhe drunjë e zhveshur në vjeshtë.

— Ju s'po më dëgjoni? Po shikomëni një herë
në sy të shkretën, shoku... Ka net që s'më zë gjumi
fare. Vras mendjen: Umorëm pushtetin. Po s'mjaf-
ton kjo. I futëm në burg. Pushkatuam. Po edhe kjo
u duk pak dhe u morëm pasurinë... Tokat... I tatuam.
Po ku do të shkojmë më tej? Ja si e mendoni ju,
shoku..., ishte për të arrestuar prifti, dom Kela,
pas atij grupi të tërë që dërrmuam në Shko-
dër? Edhe në Durrës... Njeri perëndie! S'e keni
njohur? Një klerik që njihte shtëpinë dhe ki-
shën e shenjtë. Një shpirt i mirë që e kalonte
floririn e bankës. Një.. Po më shumë se kjo du-
het menduar se ç'do të thonë katolikët e mirë te
të cilët ai gëzonte autoritet të plotë. Do të armi-
qësohem me popullin, dëgjomëni mua. Dhe po

ndodhi kjo ç'ju mbeti ju komunistëve... Edhe ne patriotët s'presim të mirë.

— *Urdhëro, ndize!*

— *Faleminderit! Po me gazetarin N.N., ç'patët? Ç'kishte bërë ai veç artikujve aq të bukur që shkruante. Një goxha burrë. I ditur. I ndershëm dhe, mbi të gjitha, vuani njëqind sëmundje. Me një këmbë në varr. Ju them unë, në qostë se s'ka vdekur, prite kur të vdesë në burg... Ju, shoku..., thoni se ka argumente të bazuara për... Se luan mëndsh një, apo tre oficerë që s'pyesin as për të kaluarën e tij, as... Fanolist i biri i botës... I dënuar nga Zogu. Dhe sap një natë të bukur i mbushet mendja njërit, apo edhe treve, dhe shkojnë e marrin. Po çfarë të marri, thoni ju? Pa të keq fare. Kështu, shoku..., mund të ndodhë edhe me mua, megjithëse jam deputet. Kush më garanton? Pse nuk ndodhi kështu me Shefqet Bejën, me zotin Selaudin... Aty edhe me Sami Qeribashin. Po Suat Asllani?*

E ç'bënë ata. Formuan një «opozitë». E pastaj ç'u bë? Prishi Shqipërinë opozita e tyre?... Jo! Gjersa themi se kemi demokraci... U zemërove? Duket sikur s'të bëjnë fare përshtypje këto! E çë! Atëhere të mos flasim? Mirë s'flasim! Po si mund të heshtë një deputet kur merr vesh se venë e arrestojnë aty dhe një bojaxhi. Bojaxhi për ideal. Njëfarë Ahmet Bregu. Dhe me ç'motive e arrestojnë? Se na shkruaka ca lajmërimë. Ca shpallore. Arsyë është kjo? Të vësh dorë mbi të, është njësoj si të... Si ta them? Po të flasim si miq. Pse pak dëm na bënë njerëzit tanë që kaluan në eks-

1) Anëtarë të grupit të deputetëve, organizatorë dhe udhëheqës të opozitës, që dhanë llogari para gjyqit të popullit në vitin 1946.

trem. Që vepruan si deshën si me ata që u tatuan me të shpronësuarit, apo edhe me ata që kishin bërë ndonjë krim në kohën e luftës. Këto më mirë se unë i dini ju shoku... Se me sa di e kam dëgjuar ju ishit të parët që u ngritët në Berat kundër sektarizmit dhe ekstremizmit të... Edhe që s'jeni për kaq masa të rënda ndaj atyre që s'u bashkuan me ne dje, e di. Atëherë pse me këta u mjaftuan vetëm me ndonjë masë administrative. Pse janë komunistë? Kanë luftuar! Mirë! Po jo me ca kështu e me ca ashtu. Se shqiptar jemi të githë. Disa gabuan dje, ca gabojnë sot, të tjerë do të... E keni marrë vesh, besoj, edhe për një grua. për zonjën Alime Bej. Edhe me gra do të merremi?

— Ndize!

— E biseduam dhe me shokun ministër të... Shko, më tha, tek ai. E kishte fjalën për ju. Fol edhe në emrin tim, më tha... Se më e keqja është tashti që ikën dhe misionarët anglezë, amerikanë dhe ata të U N R A-s. Kështu e gjykuam. Se ndoshta për të pasuruar veprimtarinë e tyre armiqësore, oficerëve tanë u shkrepet dhe e inkuadrojnë edhe zotin... Besoj, do ta fillojmë që nga zoti Generalin Hoxhson, Xheikobsin dhe Fulcin, pa hrruar as zotin Hill,¹ që sic e dini, gjysmën e jetës ia fali vetëm çështjes shqiptare... Dhe pastaj... Dhe pastaj... E thjeshtë! Merr fund çdo shpresë për njoftjen e qeverisë demokratike. Fillojnë protestat. Dhe me të drejtë edhe... Po le t'i lëmë të gjitha... Ju e besoni se, pas gjithë këtyre masave që janë marrë, mund të ekzistojë akoma një grup i fuqishëm, apo po deshët le ta quajmë edhe organizatë

1) Misionarë amerikanë dhe anglezë në Shqipëri, organizatorë të opozitës dhe të veprimtarive të tjera armiqësore, që synonin përbysjen e pushtetit popullor.

si ajo terroristja, apo anarkistja, prozogistja e ku di unë çë, kaq e fshehtë kaq e fuqishme, sa t'ju shpëtonte nga veshët edhe juve, shoku...? Dhe mbi të gjitha, kjo midis nesh, duan të thonë se në të është implikuar përsëri edhe ndonjë deputet. Ministër. Ushtaraku... Edhe një... — fjala iu zu në grykë dhe, kur pa se shoku... Vetëm heshtte. I zemëruar vuri republikën në kokë, mori bastunin dhe përshëndeti në mënyrë tepër origjinale. Duke tundur kokën.

Ushtaraku madhor gjatë gjithë kohës kishte vrarë mendjen si duhej mbyllur kjo çështje. «Duhet mbyllur pa krijuar asnje shqetësim. Me çdo kusht!» — tha dhe, pa luajtur nga vendi, mori receptorin në dorë.

Pas datës 20 nëntor, i pandehuri N.N. deklaroi se:

«I dërguari me mballomë në sy që e hiqte veten si politikan pa funksion ishte i dërguar i C I A-s dhe përfaqësues i U N R A-s.

Prifti, përfaqësues i Vatikanit.

Deputeti, përkrahës i socialdemokratëve...
Vetë gazetari N.N. bënte pjesë në grupin e re-

zistencës.
Zeqo Korbi, ndonëse kishte kohë pa çifligje, ishte i agrares, kurse Alush Boga ishte anëtar i Komitetit Qendror të organizatës agjento-sabotatore (ose terroriste)...

Të tjerët ngushëlloheshin me premtimet që u dërgonin ish-aleatët... Me lajmet e «Zërit të Amerikës» dhe zoti Zavalani që në emisionet e tij lajmëronte vazhdimisht se të arratisurit në një nga shtetet fqinje, pasi kishin formuar organizatën «Shqipëria e lirë» kishin shpallur mbret Ahmet Zogun e Parë!

Hetuesi - Për kryengritjen e Shkodrës ç'di të na thuash?

— Para saj kishim rënë dakort me kriminelët e arratisur.

Hetuesi - Po anglezët kishin dijeni?

— Do të zbarkonin mbas dy-tri ditëve si të triumfonte kryengritja.

Hetuesi - Po kleri?

— Vendimi u mor në Komitetin Qëndror të opozitës një muaj më parë. Pastaj u përkrah edhe nga Komiteti Qarkor dhe kleri katolik.

Hetuesi - Po pse s'u respektua afati i kryengritjes?

— Ajo ishte caktuar për t'u bërë më 15 shtator, por u avancua për në datën 9 shtator.

Hetuesi - Pse?

— Këtë nuk e di me siguri... Po ma do mendja për shkak se u arrestuan dy nga udhëheqësit; Riza Dani dhe Kolë Prela.

Ia heqin njëri-tjetrit.

Nga Roma Agjencia Italiane e Lajmeve njoftonte se të arratisurit, tradhtarët e kombit që kërkonin... Vizhdan Risilia me anën e B.Deromemës vrau H. Pipën. (Si shpërblim i premtoi të bijën për grua dhe pasuri). Armiku... u vra!... Vdiqën dhe Mufit Risilia pas shamatasë shtiu tri herë... vrau mikun e tij Enver Bushatin!... E plagosi. Lek Marashi vdiq.

Gjak i fëlliqur që...
Tradhti! E cila...
Larg syve...

Zbulohet një rrjet tjetër kontrabandist floriri
...Gjyqi kundër...

X KAPITULI

FTESE:

Kapiten Adil Çika lajmëron shokët, miqtë dhe fisin e tij se më datën 3 dhjetor celebron martareshen e tij me shoqen Vito Marini.

KAPITULLI X

1

— Ti ishe në gjumë?
— Jo, zoti hetues. Mendoja.
— Çfarë kishe ndër mend?
— Nënën. E kam lënë vetëm dhe pa asnje mbështetje, — tha Ahmet Bregu.

Kur dëgjoi emrin «nënë», Adil Çika i ndërpren për një çast pyetjet dhe kujtoi nënën e tij që në këtë orë të natës s'e kishte zënë gjumi dhe me siguri e kishte mendjen tek i biri. Ndoshta pëshpërit: «Të keqen nëna, bir... U lodhë, bir.» Dhe do të kishte vazhduar gjatë të mendonte për të po të mos kishte përpara Ahmet Bregun.

Mete Jaupi herë pas here fërkonte dorën e plagosur sikur qahej nga ky mot me lagështirë që i ndillte reumatizmin.

— Besoj je menduar.
— Po! — tha ai.

— Ke gjë për të shtuar rreth vdekjes së Drita Korbit?

— Asgjë, zoti kapiten.

Adil Çika shtrëngoi dhëmbët. Pastaj kyçin e dorës, veprim që e përsëriste për të përbajtur veten dhe për të ruajtur gjakftohtësinë...

— Po për Zego Korbin?

— Jo, zoti hetues? Ju thashë se është njeri i ashpër, i vrazhdë, i zyntë.

— Kurse, për çudinë tonë, edhe ai nuk është më, — tha Adil Çika në atë mënyrë sikur këtë lajm ta kishte mësuar dy ose tri minuta më parë

Ahmet Bregu u shtir sikur shprehu habi.

— Mos ai, pasi ka parë të bijën në gropën e gëlqeres, ia ka hequr vetes? Apo mos ndoshta dikush tjetër ka vënë dorë mbi të?

— S'di ç't'ju them!

— Flitet për një hasmëri të vjetër...

— Diçka më ka zënë veshi. Një hasmëri e hershme që s'duhet lënë pas dore, — tha Ahmet Bregu që u duk sikur e vuri veten në mendim për të ndihmuar pyetjen e kapitenit.

— Po ju nuk njihni ndonjë njeri që gjatë këtyre ditëve të jetë interesuar për satin e Korbajve? Ndonjë nga farefisi, ose edhe ashtu rastësisht.

— Jo, zoti hetues!

— Po ti ishe apo s'ishe në shtëpinë e tyre?

Ahmet Bregut, që e kishte llogaritur gjatë përgjigjen e kësaj pyetjeje iu duk se kapiteni i doli në shtegun që priste. Mendoi se hetimi po zhvillohej përsëri në favorin e tij.

— Po, zoti hetues... Por shumë vonë. Kur shkova unë, ai ishte i gjakosur. Duhet të ketë ndodhur siç menduat ju. Ai me siguri ka qëlluar mbi veten e tij, - trilloi Ahmet Bregu për t'i humbur më shumë gjurmët e së vërtetës, — ose dikush

tjetër ka vënë dorë mbi të. S'di ç'të them.

— Ti e gjete gjallë?

— Kur e pashë ashtu, tërë gjak, ua mbatha shkallëve.

— Je i sigurt për këto që thua?

— Me kokë, zoti hetues.

— Pastaj?

— Pastaj heshta, zoti hetues.

— Sigurisht nga frika, - e provokoi Adil Çika që s'u kishte zënë besë thënieve të tij.

— Po, zoti hetues.

— Ti natyrisht që nuk ke vepruar mirë, i pandehur, kështu sillen vetëm vrasësit. Kurse duhej të kishte lajmëruar së paku spitalin. Ndoshta ai mund të shpëtohej... Dhe ky veprim, natyrisht, do të të ngarkojë sadopak me përgjegjësi, megjithëse kuptohet që ti çdo gjë e ke bërë nga frika,

— e zbuti pohimin e tij Adil Çika.

— Si urdhëron, nga frika, zoti hetues. U frikësova se mos më ngarkohej mua vrasja, - gënjeu përsëri ai dhe uli kokën si i penduar me mendimin se edhe ky version që s'e kishte shkuar kurrë në-për mend ishte në favorin e tij.

Ndërsa Adil Çika shkruante, Ahmet Bregu vriste mendjen se ç'i shtynte që ta mbyllnin kështu këtë ngjarje. Dhe bashkë me njëfarë gezimi i shkoi mendja se çdo gjë rridhte nga paaftësia e tyre. Nga naiviteti e padija... «Njerëz që sapo kanë zbritur nga mali, që s'njohin as elementet e para të mjekësisë ligjore dhe jo më juridikcionin dhe sekretet e tij,» - tha dhe përsëri lavdëroi durimin dhe këmbënguljen e tij.

Adil Çika e ndërpreu lojën. Pa orën. Pastaj Mete Jaupin që pinte duhan dhe ishte gati të priste mëngjesin

— Edhe për sonte mbaruam, i pandehur! — tha Adil Çika.

Dom Kela mbështolli duart grusht. Kapiteni përsëriti pyetjet që i kishte bërë edhe Ahmet Bregut dhe, në pritje të përgjigjes, hapi kapakun e kasafortës, nxori një letër, të cilën ia zgjati dom Kelës. Prifti nuk denjoi të ngrinte as sytë. As të zgjaste dorën. Dhe përsëri u mundua të tregohej indiferent ndaj pyetjeve që pasuan

— Je i ndershëm në atë që thua?

— Si në altar kur i lutem zotit! — tha me gjysmë zëri dhe vetëm tani u kujtua se në qelën e tij, nën jastëkun e butë, midis dërrasave të krevaltit, në një vend fort të fshehur, ai ruante kopjen e një letre që ia dërgonte njërit prej krerëve të organizatës terroriste. Ndonëse letra ishte e koduar dhe me një nëntekst që zor se mund të déshifrohej, në një çast si ky dhe përballë pyetjeve të tillë, dom Kela s'mund të ishte i qetë. «Mos vallë e kanë zbuluar?» — i shkoi mendja aty për aty duke harruar tërësisht bisedën që kishte bërë me rojtarin e kishës dhe njoftimin e papëlqyer që i kishte dhënë ai. Për pyetje të tjera ishte përgatitur dom Kela, kurse ky oficeri, sikur po e taproonte ca. Dhe atij i shkoi mendja përsëri në një leter tjetër, që ishte fshehur po në qelë, me të cilën krerët e tij indirekt dhe po në mënyrë të koduar i hiqnin vërejtjen se, në marrëdhëni me D.K., kishte rënë tepër në sy dhe gati-gati ishte kompro-

mentuar. Nga tërë ajo përbajtje, mbushur me porosi, vërejtje, këshilla postulate, paragrafe, atij iu kujtuan vëtëm fjalët: «*Ruhu nga mëkati! Më shumë se mëkatin ki frikë komunistët!* Në një paragraf të veçantë thuhej se pas përballimit të sulmit të protestanizmit, tashti katolicizmit i duhej të përballonte komunizmin. Të pafetë.

Për të kontrolluar se cilën nga këto letra kishin hedhur në dorë organet e punëve të breshtme, dom Kela zgjati dorën si një qenie e ngathtët.

— Mos guxo! — e urdhëroi Adil Çika kur vuri re se prifti u zverdh më shumë dhe shfaqi shenja nervozizmi — Ne kemi fotokopjen e saj.

— As që më intereson dhe as kam dijeni për këtë letër, — tha prifti dhe si pa interes e la mbi tavolinë.

— Bukur! Tashti fillojmë. Në Shkodër, gjatë luftës, ti je njobur dhe ke pasur miqësi me një oficer gjerman, — e ndryshoi fillimin e bisedës Adil Çika.

Dom Kela, i zënë ngushtë, heshti për një çast, ngriti syzet dhe, si i hutuar, belbëzoi:

— Unë?... Me oficer gjerman?! —

— Në mos gaboj, njëfarë Hansi që punonte me rininë katolike.

Kapiteni vuri re se dom Kela u mundua të krijonte përshtypjen se i lutej qiellit.

— Jo, zoti oficer. Unë gjatë okupacionit gjerman isha një prift në periferi, thjesht në xhakua.

— Po për organizatën «Aksioni katolik» ke dijeni?

Edhe radhën e kësaj pyetjeje, nëse do të bëhej, dom Kela e kishte llogaritur shumë më vonë nga që bëri Adil Çika, për të mos thënë se e kishte shtyrë deri në harresë dhe, për të larguar çdo

dyshim, u përgjigj gati-gati si pa vëmendje:

— Asgjë, zoti oficer!

— Po për organizatën «Bashkimi shqiptar» dhe filialin e saj në Tiranë?

— Nuk di gjë, zoti oficer!

— Njëfarë Frano Mirakaj e ke njojur? Me sa jemi në dijeni, ai ka ardhur disa herë në kishën tuaj.

— Ju betohem për emër të Jesuit.

— Po ish-kapiteni fashist Nino Shkurti?

Dom Kelës duket iu mbaruan betimet dhe kësaj radhe ngriti vetëm supet.

— Po patër Faustin?... Atë me siguri që duhet ta kesh njojur. Ai mbahej si i pari i katolicizmit në Shqipëri.

— Jo, zoti oficer!

— Kurse ai gjatë procesit të gjyqit ka deklaruar ndryshe.

Prifti nxori shaminë dhe fshiu ballin që po i mbulohej nga djersa.

— Po dom Kolë Ndreun?

— Jo, zoti kapiten!

— Kemi ca të dhëna se edhe ai ishte dërguar nga kisha franceskane për t'u lidhur me kishën tuaj.

— Nuk e di, zoti hetues!

— E gjitha kjo ishte një bisedë... thjesht bisedë pa 'ndonjë rëndësi... — tha Adil Çika dhe përsëri e qëllimi isht ngriti dorën lart. Kryqi me Krishtin e kryqëzuar u tund si lavjerës. Prifti kishte ulur kokën.

— E njeh? — pyeti Adil Çika.

— Është Jesui! — tha prifti.

— Them për medalionin! Desha të di nëse e ke parë 'ndonjëherë.

— Përditë, zoti oficer! — shpejtoi të thoshte prifti.

Adil Çika kujtoi përsëri se informacioni që kishte lexuar për të kaluarën e dom Kelës lavdëronte zgjuarsinë e tij.

— Në kishë, zoti oficer, — përsërithi ai, — ne s'lutemi për tjetër gjë, veç për Jesuin.

— Pyeta për këtë! — tha Adil Çika dhe bashkë me zinxhirin e hollë mblodhi në grushtin e tij edhe kryqin.

Dom Kela, që e priste me padurim këtë pyetje, e quajti të tepërt çdo zgjatje tjetër.

— E njoh, zoti oficer... Kur njeriu gjykon me ndjenja, dhe kjo i takon rinisë, del edhe nga rruga e zotit, — dhe u përpinq të shpjegonte si diçka të rastit njohjen me Drita Korbin në një natë vjeshte. — Kur u shkëputa nga ajo, i fala atë medalion, zoti oficer, — tha prifti, që, pas këtyre shpjegimeve, priti që kapiteni ta fuste bisedën në dramën e familjes së Korbajve dhe në pyetje të tërthortë: «Mos vallë...» «Si ndodhi?» «Ju ku ishit?» «Qysh?» «Po Zeqo Korbi» Po ngriu kur Adil Çika, ndryshe nga c'kishte pandehur ai, pyeti:

— Parulla «Krishti ka lindur në kashtë dhe s'ka thënë të ndahen tokat» c'kuptim ka pasur për ty?

— S'e kam dëgjuar kurre, zoti hetues, — dhe u drodh.

— Mbaruam! — tha Adil Çika.

— Zoti hetues!

Te dera u duk ushtari me uniformë gri.

- I pandehuri N.N.!
- Urdhéroni!
- Ke qenë ndonjéherë në selinë e misionit anglez para se të vinte mister S...?
- Po!
- Herën e fundit përse është biseduar?
- Më bënë të njojur largimin e tyre. Më dhanë para për deputetin dhe porosinë që të kryhej atentat kundër udhëheqësit të shtetit të ri shqiptar.
- Këtë kush duhet ta bënte?
- Po të kundërshtonte Telat Korbi, duhej të gjendej një tjetër... Ose një grup... ose ndonjë nga ushtarakët... Nga deputetët...
- Në grup kishte edhe ushtarakë?
- Po, por unë s'i kam njojur. Na thuhej se në momentin e duhur ata do të vepronin me anë të ushtrisë.
- Adil Çika krijoj bindje se për sa ishte pyetur ai s'kishte mbajtur asnjë rezervë.
- Atë që hoqe ishte peshqesh nga njerëzit e tu, — i tha kryehetuesi.
- E prisja! — tha N. N.
- Pse?
- N. N. tundi kokën dhe s'foli.
- Adil Çika, kur vuri re inatin e gazetarit, e pyeti:
- Drita Korbin kush e hodhi në gropën e gëlqeres?
- Nuk e di!

— Po mbi Zego Korbin kush vuri dorë?

— Unë jo!

— A mund tē na thuash se kush?

— Jam shumē i lodhur, zoti hetues, — tha
ai.

Adil Çika, kur vuri re shqetësimin e tij, i ndërpren hetimet.

— Alo! Më dëgjon, kolonel? Veç informacionit sa po mora vesh se shokët e sekcionit të Tiranës paskan shkuar shumë larg. Është e vërtetë, kolonel? Po, po, ju dëgjoj. Po... Po. Jo, kolonel... Nuku, nuku... Jo, jo... këto i kemi biseduar... E besoj. Mund t'i kemi verifikuar të gjitha. Arrestimet mund të jenë kryer në rrugë ligjore... E pastaj?... Mund të jetë marrë edhe aprovimi i prokurorisë së Tiranës, po fundin e këtyre veprimeve e kupton, shoku kolonel? Nuk janë veprime aq të thjeshta sa ndoshta ju duken juve në pamjen e parë... Ju dëgjoj, ju dëgjoj, po porosia është e prerë... Po, po! Po s'ka ç'më duhet ky respekti yt: «Po, leitnant... Si urdhëron, leitnant, e dëngla të tjera,» — tha dhe lëshoi një breshëri tjetër fjalësh që kolonelit gati i çanë timpanin e veshit.

— Jo me kaq ashpërsi. Këtë e kemi biseduar, apo jo? — ngriti dorën e tundi gishtin tregues në erë... — Jo kështu, bre! Cazë më butë!... Pastaj i dëgjoni cazë edhe këshilltarët jugosllavë. Përse na kanë ardhur sipas jush? Po, po!... Jo, bre, jo! Do të merrem vetë thua! Po duhej të ishe marrë më parë, bre! — tha ai me nervozizëm. — Ku i njoh unë sa ndihmës ke ti... As e njoh cili është prokurori i Tiranës... Lëre bre Partinë mënjanë, ajo ka punët e saj, kurse Sigurimi... E pra Sigurimi është mbi këdo... — u shpreh ashpër e po me atë ton dhe i erdhi inat që koloneli, edhe pse kishin biseduar, sado që larg e larg, s'kishte kuptuar akoma se duheshin goditur «të pabindurit»... Lëre tani përgjegjësinë dhe jepi rrugë... Rrugë... Dëgjoj, dëgjoj, po gjej zgjidhje dhe më raporto. Sa më shpejt, — porosi ai kur e kuptoi se kolonelit po i shternin fjalët. — Edhe për atë oficer kokëgdhë dua të di cili është... Më kuption? Kështu pra! Alo! Më dëgjon besoj? Se kemi përgjegjësi para... — Fjalët e fundit i përtypi nëpër gojë dhe e përplasi receptorin me nervozizëm, ndërsa koloneli vazhdonte akoma ta shtrëngonte dorezën në dorë dhe të përsëriste si një vjershë: — Si urdhëron, shoku leitnant... Po, shoku leitnant. Oh, shoku leitnant, — tha së fundi. Ministrit të tij më shumë se çdo titull i pëlqente vetëm ai i leitnantit, gradë që e mbante vetëm ai...

Nga gazeta

(Njoftimi i këshillit gjyqësor për sabotatorët e Maliqit)

Këshilli gjyqësor i gjykatës së lartë ushtarake në emër të popullit dha vendimin:

Ingjiner Abdyl Sharra dhe ingjiner Kujtim Beqiri dënohen me ekzekutim në litar. Ingjiner Vasil Mano, Zyrako Mano dhe Engerio Scaturo me vdekje. Për të pesë të dënuarit me vdekje ekzekutimi do të bëhet në Maliq.

Numrat fitues në llotarisë së Kryqit të Kuq:

Kinematë:

Lajm!

*Sonte ora 21 shtëpia e kulturës organizon një
mbrëmje dëfrimi për anëtarët e saj.*

*Si biletë hyrjeje vlejnë triskat e anëtarësisë.
Lutemi që anëtarët të jenë të shoqëruar me
dama.*

KAPITULLI XI

1

Dom Kela e kishte vrarë mendjen gjatë se ku duhej ta kishin gjetur atë letër të mallkuar. Edhe tashti që qëndronte përballë dy oficerëve hetues këtë po mendonte: «Si t'u ketë rënë në dorë?» dhe ashtu i ulur po shikonte ngultas herë njërin, herë tjetrin përmes qepallave të dendura. Po çdo shpresë u shua, ashtu si edhe drita në bebëzat e syve kur dëgjoi zërin e kapitenit.

A. Çika — Pse ke kérkuar që Telat Korbi t'ia mbathë andej nga kishte ardhur?

Prifti — Vetëm jo, zoti hetues. Ishte vendimi i përbashkët.

A. Çika — Do të ta lexojmë ç'ke shkruar?

Prifti — Atë s'e kam shkruar unë, zoti hetues?

A. Çika → Vec shkrimit, i cili, me gjithë

përpjekjet që ke bërë për ta ndryshuar, këtë e vërteton edhe rojtari i kishës, Prenga.

Prifti — Asnjëherë, zoti hetues!

A. Çika — Ja ç'deklaron ai! «Me datën 10 ose 11 nëntor, mundet edhe një ditë më përpara ose më prapa dom Kela më thirri në qelë dhe, pasi më futi në gji një letër të mbyllur, më urdhëroi t'ia çoje mikeshës së tij, Drita Korbit. Unë e pashë në sy. Ai më kërcënoi. Dola në rrugë. Ishte vonë. Binte shi. Frynte erë. Qëndrova në një cep të ndriçuar, nën strehën e një vitrine... Ndoshta ishte kurioziteti i tepruar që më shtyu ta hapja letrën... U çuditai. Dom Kela i kërkonte asaj që T. (Sigurisht germa T përfaqësonte një njeri që unë s'e kam njojur kurrë) të ikte. T'ua mbathite një orë e më parë... E mbylla letrën... Pasi lexoi letrën, ajo erdhi me mua. Hymë nga deriçka e prapme. Ata u futën në qelë dhe biseduan gjatë.» Ç'i thua këtij depomimi? Do të ballafaqojmë?

Prifti — Jo.

A. Çika — Pra pse ke këruar që ai t'ua mbathë?

Prifti — Kjo ishte bërë e domosdoshme. Kishin dijeni se ai kohët e fundit po kalonte një krizë të rëndë psikike. S'i dihej...

A. Çika — Kush ta kishte dhënë këtë porosi?

Prifti — Morëm vendim!

A. Çika — Ku?

Prifti — Në një mbledhje tonën.

A. Çika — Ahmet Bregu kishte dijeni?

Prifti — Natyrisht!

A. Çika — Edhe ai këtë porosi kishte marrë?

Prifti — Më të repte, ose ta helmonte, ose ta zhdukte në një formë tjetër. Ai dilte dhe hynte lehtësisht në familjen e tyre.

Dita e tetë, pas hetimesh të sforcuara, kapi-
ten Adil Çikës iu duk si një ditë përmallimi e
largët, si një cak që ia kishte zhdukur lodhjen
dhe të tèrin e pëershkonte një ngazëllim dhe një
kënaqësi e brendshme, që rrallë e kishte provuar
në jetën e tij. Shikonte mëngjesin e bardhë të
brishtë, vitrinat që reflektonin dritën e diellit,
reklamat e kinemave dhe të ndeshjeve sportive
dhe iu bë se Tirana ishte fundosur në bukurinë
e ditëve të nëntorit, që me gjithë ftomën e stinës,
ruanin diçka nga e nxehta e gushtit dhe e shta-
torit. Ekte i ngeshëm. I qetë. Pothuaj pa sjellë
në mend, siç ndodhët ditë tjetër, asnjë nga ato
takimet e lodhshme me burra. Gra. Njerëz që
kishin njohur korbajt dhe fqinjë të tyre. Me
ekspertët ushtarakë. Me të arrestuarit. Tashti
çelësin e çështjes e kishte në dorë. «Sado që të
rezistojë, së fundi do të dorëzohet,» — tha me
vete dhe më këtë mendim arrii para portës së
oficerit të rojës. Përhëndeti dhe u fut brenda.

— Urdhëroni! — i tha Adil Çika Astrit Pemës
dhe i zgjati cigare. — Ju bëmë të prisnit pak.

— Asgjë, — tha ai.

Adil Çika, ndryshe nga ç'e kishte menduar,
vuri re se invalidi s'ia hodhi sytë fare Ahmet
Bregut. «Urrejtje e tërbuar,» — mendoi dhe
tërë kujdesin e përqendroi në pyetjet që do t'i
bënte dëshmitarit.

— E njeh?

Pas kësaj pyetjeje Astrit Pema ia nguli

sytë njeriut që ishte ulur në një stol në këndin e dhomës. Koka e qethur, e vogël me lëkurë të bardhë e sy të dalë iu duk si diçka e shpër-fytyruar. Ndjeu neveri dhe u kthyesh nga krye-hetuesi.

«Si është e mundur? — pyeti veten Ahmet Bregu kur pa Astrit Pemën. — E pabesueshme,» — tha. Pyetjen, nëse e njihte njëfarë Astrit Pema, që i kishte bërë kryehetuesi, në një nga seancat, ai e kishte marrë vetëm si provokim, ose si diçka të rastit, kurse tashti i mungoi kura ja ta shikonte atë trup të gjymtuar me fytyrë të zbehtë, flokë të rënë... Ky dëshmitar i padëshiruar e bëri që të humbiste edhe atë pak shpresë që ushqente për të fshehur fajin e tij.

— Po! — tha. — E njoh. Por më besoni. Në qoftë se do ta kisha parë në vend tjetër, do të kisha bërë të gjitha përpjekjet që t'i shmangesh takimit. Dua ta harroj këtë fytyrë dhe të mos e kujtoj për tërë jetën, ashtu siç do të veproj apo të dal nga kjo zyrë.

— Besomëni! Unë s'ju kam bërë kurrë keq, — tha Ahmet Bregu me zë të lartë.

Astrit Pema ktheu përsëri kokën dhe e pa me përbuzje, sa Ahmet Bregu, për një çast, u hutua, harroi çdo gjë, bile edhe se ishte i arrestuar. Kjo ndodhi se bashkë me të papriturën ai kujtoi atë natë dimri të tre vjetëve më parë kur Fon Brymeri ishte shtrirë mbi mozaikët shumëngjyrësh. Dyert që u përplasën. Njerëzit, Kamerierët, Banakieri, Kikirikshitësi, Gazetari i vogël Met, Astrit Pema. Dhe përsëri Fon Brymeri dhe tri të shtenat. Kështu kishte ndodhur. Pas këtyre ai hodhi sytë mbi këmbën e gjymtuar të Astrit Pemës dhe ndjeu frikë. «Po sikur ta ketë marrë vesh se ne ishim shkaktarë,» — mendoi dhe

u drodh. Çdo gjë kishte ndodhur pas vrasjes së Fon Brymerit.

(«Po ti ku ishe?» — e kishte pyetur të birin Zeqo Korbi.

«Kërkova njerëz të mirë.»

«I gjete në konjak?»

«E çuditshme! Edhe konjaku s'më pihej. Brodha bar më bar, pastaj shëtita rrugëve. Nuk më shihni si jam bërë? Shiu ka filluar të bjerë me shtamba.»

«Kur të të pyesin nëse ke qenë në «Bar Berlini» në kohën që u krye atentati, s'do të pranosh!... As nga shtëpia nuk do të dalësh!» — e kishte urdhëruar i ati.

«Për këtë vështirë të të premtoj, baba!»

«Në qoftë se të dhimbet lëkura dhe s'do që të kalbesh në burg.»

«Po të më japid për të pirë, edhe atje s'do të jem keq. Liria ime është atje ku ka konjak. Unë jam mësuar me atë si fëmija me biberonin....»

«Ku shkon?»

«Do të ndërrrohem. Të ftohtët më ka hyrë në palcë.»

«Gjysmën e jetës e humbasim për të mësuar fëmijët,» — ishte ankuar i ati.)

Ahmet Bregu dëgjoi një pyetje të oficerit hetues, e cila e shkëputi për një çast nga këto ngjarje të largëta. Pa Astrit Pemën me bisht të syrit dhe përsëri u habit nga pamja e tij. Dukej i plakur.... «Gati gjysmë njeriu...» — tha me vete dhe u rikthyte tek ajo natë që tashti kishte mbetur si një kujtim i harruar.

(«Thonë se ai që shtiu me revolver është zhdukur. Edhe kamerierja me banakierin janë zhdukur. Është vënë gjithë Gestapoja në kërkim... Po na del se e gjithë Tirana qenka bërë komuniste», — kishte thënë me inat Zeqo Korbi që s'e kishte

hequr cigaren nga goja tërë atë natë. «Mundohen kot. Armikun e kemi brenda,» — kishte pohuar Ahmeti me armiqësi. Pastaj kishte shtuar se në bar ishte edhe ai dhe se e kishte parë me sytë e tij kur u rrëzua majori... Ndërsa ai fliste, Zeqo Korbi kishte sjellë ndër mend gjithë atë bisedë që ishte zhvilluar një orë më parë në zyrat ushtarake, shqetësimin e komandës gjermane dhe masat ndëshkimore që do të merreshin.)

Pas gjithë këtyre Ahmet Bregu u duk sikur ndjeu dhimbje të fortë në kokë dhe pa nga kryehetuesi që vazhdonte të bisedonte me Astrit Pemën. «Po sikur ai t'i ketë mësuar? — pyeti veten.

— Jo, jo, s'është e mundur», — tha.

(«Ti e pe kush qëlloi mbi majorin?» — kishte pyetur Zeqo Korbi.

«Sonte po më çudit me këto pyetje, baba! — ishte përgjigjur ftohtë i biri. Pastaj ishte ulur në një poltronë dhe, sikur të mos kishte ndodhur gjë në këtë botë, kishte zgjatur dorën në tavolinë, kishte marrë gôtën, kishte parë të atin, të morën dhe së fundi Ahmet Bregun. — Pikërisht kjo më çudit!»

Të tre ia kishin ngulur vështrimin gotës.

«Mos shikoni këtë! Unë pyes pse ky interes i jashtëzakonshëm pér ato që ndodhin rrëth nesh? Mirë! Unë po hesht. Le t'jua tregojë Ahmeti si ndodhi. Ne së bashku dolëm nga bari, por me një ndryshim: Ndërsa unë erdha në shtëpi, ai kafshoi edhe një copë mermer nga tavolina.»

«Teli gënjen, zoti Zeqir. Njeriu që qëlloi majorin ishte së bashku me Astrit Pemën. Ata janë shokë...»

«Këto m'i tha edhe mua Ahmeti, baba!» — kishte thënë Drita.

«Këtu s'ka vend pér dyshime! Unë i pasë të gjitha sa ndodhën në bar,» — ishte mburrur

Ahmet Bregu. Pastaj sallonin e shtëpisë e kishte mbështjellë heshtja. Ndihej vetëm tiktaku i orës së murit, era dhe shiu që përplaseshin në xhamat e dritares.

«Mua më duket se nuk jam para gjyqit, baba! — ishte përgjigjur Telati që kishte tundur kokën dhe kishte shkuar përsëri te bufeja për të mbushur gotën me konjak. — Unë mendova se me grushtin që hëngre do të kishe shkuar në ndorje klinikë, kurse ti paske ndjekur një rrugë tjeter! — ishte tallur dhe përsëri kishte pirë konjak. — Tashti nuk ka më rëndësi se kush qëlloi mbi majorin, baba. I besoni Ahmetit. Po, po, i besoni atij. Por mos harroni se edhe unë isha atje.»

Kishte qeshur.

Drita kishte mbledhur fytyrën me duar.

Zeqir Korbi kishte përplasur grushtin mbi tavolinë dhe kishte shkuar drejt telefonit.

«Mos e shkoni kot një bisedë telefonike, ati im! Këtë shërbim që doni të kryeni ju, e bëri më përpara Ahmeti. A nuk ishit në Gestapo para se të vinit këtu?»

«Ti do të heshtësh!»

«Unë tashti llap kot, baba. Edhe ju kot vrissni mendjen. Atë e arrestuan në kohën që dola në rrugë. Ishin dy nënëficerë dhe një kapiten eses.» Ai kishte thënë edhe diçka tjeter që Ahmet Bregu e kishte dëgjuar mbytur dhe pastaj i ishte dukur sikur ishin errësuar dritat. Sikur sipari kishte rënë. Sikur shfaqja kishte marrë fund.) Ajo kishte qenë një natë alarmi. E përgjakshme. E zhurmshme. Me krisma armësh dhe shpejtësi automjetesh në rrugët e kryeqytetit. Natë arrestesh dhe lebetitje grash.

«Po pse duhet t'i tregoj këto? — pyeti veten duke iu shmangur vështrimit dhe pritjes së ofi-

cerëve. — Pse duhet të rrëfehem si në kishë dhe pse duhet të flas kur ata kanë vdekur? Kur të vdekurit s'kanë mundësi që të flasin?»

— Spiun! — shau Astrit Pema që pati dëshirë ta pështynte në fytyrë. — Tashti më kujtohet gjithçka tha ai. Të ecurit e tij, mënyra se si i mbante duart në xhepa, si e kishte mbledhur qafën...

— I pandehuri ka kaq ditë që mundohet të fshehë të vërtetën. Ju lutemi mund të na thoni edhe një herë nëse e gjetët në sallonin e Korbajve Ahmet Bregun, apo...?

— Jo! — tha Astrit Pema. — Unë hyra pasi kishte dalë ky. — Dhe, pa e kthyer më kokën nga i arrestuari, vazhdoi: — Shtyva derën, u futa në korridorin e errët, i hoqa siguresën revolverit dhe ngjita shkallët...;

Ahmet Bregu gjatë gjithë kohës që Astrit Pema tregonte, herë dukej sikur kafshonte gisherinjtë, herë sikur shkulte flokët, herë tjetër rënkonte si ata që pendohen. Në të vërtetë ai përsëri mundohej të zgjidhte variantin më të favorshëm, me më pak përgjegjësi, sa më pak kompromentues dhe më të lehtin nga ato që do t'i paraqitej.

— E kuptova, kolonel. D.m.th. ai kapiteni i ri... Po, po. Mos e zgjat më shumë. Duket tepër i zellshëm. Po me zellin e tij po na hap shumë telashe. Kam kohë që kam dashur të bisedoj për të. Me siguri pas gjithë këtyre grupeve që janë asgjësuar edhe atij i është ndezur fantazia. Bile më shkon mendja se ai duhet të jetë një kokëngjeshur që po me kaq siguri dyshon për një grup madhor si ata de, për të mos thënë më të rrezikshëm. Me siguri i bëhet se shikon armiq nga të katër anët, — tha dhe qeshi. — Kështu që me siguri do të presim të na thotë se ata Kor-bajt i ka vrarë një grup i tërë....

— Në takimin që pata me të ai më tha ca fjalë që mezi e mbajta veten...

— Pa hë!

— Më tha se pas asaj çështjes që ka të bëjë

me Korbajt fshihet, ashtu siç e quajtët ju, pikërisht një grup i madh.

— *Kulmi!*

— *Është përfundim i të gjitha dokumenteve dhe dëshmive që disponojmë, më tha... Një organizim i përsosur që në krye të tij është një peco.*

— *Mos e ka fjalën për mua? Apo ndoshta edhe për shokun leitnant.*

— *Jo, shoku...*

— *S'dihet. Edhe kjo mund të ndodhë.*

— *E ka fjalën për një diplomat.*

— *Pa shiko, shiko ku i ka shkuar mendja.*

— *Që pretendon se gjoja ka ardhur për punë të tjera, po që natën merret me veprimtari subversive, tha.*

— *E ka mësuar edhe ai fjalën «subversive», ë? Pa shiko, shiko ç'bëhet, kurse ne jemi mjaf-tuar vetëm me një informacion të thjeshtë që kemi marrë nga shefi i seksionit...*

— *Bile shkoi më tej i marri. Tha se ai i ka vënë vetes detyrën e organizimit të një komploti kundër shtetit. Gjoja se ky diplomat na vazhdua-ka atë punë që na paškan lënë përgjysmë kolegët e tij të mëparshëm... E kuption për kë është fja-la? Sidomos për ata të UNRA-s.*

— *Një çështje që e paska joshur. Nejse, me-gjithëse nuk është kaq e thjeshtë, kemi ndonjë tjetër?*

— *Jo, shoku kolonel.*

— *Po si quhet ai kapiteni?*

— *Adil Çika, kryen detyrën e shefit të hë-tuesisë.*

— *Ai djale vlen për diçka më shumë. Me sigeuri që i është hapur dosje?*

— *Është e treta herë që e thërrësim, shoku kolonel.*

— *Po se e thërrisni edhe një herë për së ka-*

tërti ç'u bë?... Dhe po s'mjaftoi kjo, edhe së pesti.

— Si urdhëron!

— Shëndet! — i tha. Pastaj ndezi cigare dhe tha me vete: «Nga njerëz si ky kapiten Çika një dité mund të na vijë edhe neve e zeza. Këta s'përtojnë të më vënë hekurat as mua. Bile as leitnantit,» — dhe përsëri e thithi cigarin pa qejf.

KAPITULLI XII

1

— I pandehur!

Ahmet Bregu u duk sikur u përmend nga kllapi.

— Do të të ballafaqojmë edhe me gazetarin që shkruan me pseudonimin N. N.?

— Jo!

— Po me priftin Kelë?

— Jo! — tha i dërrmuar nga pyetjet e fundit.

— As me zonjën Alime Bej?

— Ju lutem, mjaft. Më thoni ç'kërkoni? — tha mbasi u bind se organet përkatëse, «këta nai-vë që sa po kishin zbritur **pandehur ai, ishin në ditën e shtëpisë e Korbajve.**»

— Pra gjithë këto ditë kemi dëgjuar përralla të bukurë, kurse e vërteta është kjo: më datën 12 nëntor ti ke qenë në shtëpinë e Korbajve.

— Po.

— Përse?

— Për të marrë pjesë në ditëlindjen e Drita Korbit.

— Në shtëpi së bashku me ty kanë qenë Zeqir Korbi, Drita Korbi, për habinë tonë, edhe Telat Korbi. Është e vërtetë?

— Po! — tha dhe përsëri nduku gishtérinjtë.

— Për atë s'na ke thënë asgjë, — tha Adil Çika.

Ahmet Bregu mblohdhi supet si të thoshte: «Kur s'di gjë, ç'mund të prisni.»

Adil Çika, që e kuptoi përsëri dredhinë e tij, për të ruajtur durimin, përsëriti zakonin: shtrëngoi dhëmbët dhe kryqëzoi gishtérinjtë e duarve.

Mete Jaipi, që e vuri re nervozizmin e tij, i zgjati cigare.

— I pandehuri Ahmet Bregu, ngrije kokën dhe dëgjo. Deri tashti e ke luajtur më së miri rolin që të kanë ngarkuar.

Ahmet Bregu drejtoi qafën që i përngjante diçkaje të ngurosur.

— Gjithçka e ke kurdisur me marifet. Ti nuk e ke vrarë Drita Korbin dhe as që ke qenë me të në kohën që ajo ka rënë në gropën e gëlqeres. As Zego Korbin s'e ke parë të plagosur. Ti je takuar me Telat Korbin po atë ditë, disa minuta para se ta zinin rrrotat e makinës. Po ti vetëm hesht dhe pranon ato fakte që janë në favorin tënd.

— Unë nuk kam gënjer, zoti hetues.

— Po. Bile për gjithë kohën që je në pyetje.

— Më besoni, zoti hetues! — dhe u zverdh si squfuri e filloj të dridhej. — C'kërkoni nga unë, zoti hetues, thoni dhe unë do t'i nënshkrua j

të gjitha.

Adil Çuka vuri buzen në gaz.

— Ju lutem, mos qeshni. Unë e kam vrarë Drita Korbin. Unë e kam vrarë Zego Korbin.

Meqë e kërkoni, unë e kam shtyrë në rrrotat e makinës edhe Telat Korbin, — tha Ahmet Bregu.

— Tashti më jepni letrën të nënshkruaj.

— Si shumë gjëra po merr përsipër, djalosh!

— Vetëm atë që kërkoni ju, zoti hetues. Po të dëshironi, mund të nënshkruaj se edhe Krishtin e kam kryqëzuar unë...

— Lëre Krishtin. «Ai ka lindur në kashtë...»

Ahmet Bregu më lehtë do të kishte pritur vdekjen, sesa këtë pohim të thënë kaq troç. «Kjo tregon se këta dinë gjithçka,» — mendoi dhe bëri përpjekjen e fundit për ta larguar bisedën nga e vërteta:

— Ju lutem mos u tallni, zoti hetues.

— Ti ke dalë nga shtëpia para orës dy.... Pas teje është zhvilluar ajo bisedë që dëgjove nga dëshmitari Astrit Pema. Pastaj ka dalë Telat Korbi dhe pas tij kanë ndodhur tërë ato të parritura. Na i thuaj, i pandehur, pse kështu?

— Të gjitha nuk i di, zoti hetues.

— Çfarë di?

— Si t'ju them, ju pyesni dhe unë do të përgjigjem.

— Kush i kreua dy krimet e tjera?

— Nuk e di, zoti hetues.

— Ti mos çove ndonjë letër, ose porosi?

— Jo, zoti hetues. Unë shkova vetëm se më ftuan.

— Po si u kthye dhe kur u kthye Telat Korbi në Shqipëri e di?

— Këtë po, zoti hetues.

Adil Çika i ndërpren pyetjet dhe priti përgjigjen e tij.

I pandehuri ktheu kokën nga të gjitha anët si të kërkonte një cep shpëtimi. Në të vërtetë ai po bënte llogaritë e fundit se ç'qëndrim duhej të mbante. Ç'duhej të tregonte dhe ç'duhej të ruante akoma rezervë.

— Hë!

Ahmet Bregu së fundi, kur e pa se nuk kishte rrugë tjetër, me pamjen e tij si të përvuajtur kerkoi të linte përshtypjen se kishte vendosur t'i tregonte të gjitha pa kursyer as veten, as njerezit e tij.

— Në fillim të vitit 1944 ai vuri në supe gradat e togerit.

— Këto i dimë!

Ahmet Bregu që s'e priste këtë u gjet ngushëtë.

— Po u çudita së tepërm kur mora vesh se një natë pa pritur e pa kujtar ai kishte trokitur në portën e shtëpisë së tij.

— Kur ka ndodhur kjo?

— Duhet të ketë qenë fundi i vitit 1945, ose fillimi i vitit 1946.

— Ti si e mësove këtë lajm?

— Nga Drita... Pastaj unë u takova me të. Disa herë e kisha këshilluar të dorëzohej, po ai s'pranonte... As i ati.

Adil Çika vuri buzën në gaz kur dëgjoi këtë pohim.

— Kjo është e vërtetë, zoti hetues.

— Natyrisht ti e kishe vështirë të informoje organet tonë.

— Si t'ju them, zoti hetues... Gabim.

— Pse ishte kthyer Telat Korbi?

— E kishin dërguar!

— Kush?

— Një qendër spiunazhi nga Londra.

— Përse?

— Kuptohet, zoti hetues. Për diversion. Për t'u bashkuar me armiqtë e brendshëm. Për të organizuar përbysjen...

— Ku qëndroi gjatë gjithë kësaj kohe?

— Në shtëpi... Vetëm në shtëpi, zoti hetues.

— Pak si e çuditshme!

— Është pikërisht kështu, zoti hetues. Për të mos humbur gjallérinë, i ati e kishte detyruar që të ushtrohej dhe të stërvitej brenda katër mureve të shtëpisë. Lexonte romane policore, pinte medikamente për të qetësuar nervat dhe e priste çdo zhurmë me gishtin në këmbëzën e automatikut.

— Po kjo ç'është? — pyjeti Adil Çika pasi shpalosi një letër para syve të tij.

— Si t'ju them, zoti hetues.

— Lexoje! — urdhëroi Adil Çika dhe ia afroi akoma më afër copën e letrës.

— Unë nuk di anglisht, zoti hetues.

Adil Çika mezi e mbajti të qeshurën kur vuri re hutimin e Ahmet Bregut.

— Është shqip, i pandehur. Ne e kemi përkthyer, — tha Adil Çika që, vetëm nga kjo përgjigje e pamenduar, zbuloi se ai nuk kishte shkuar aq rastësisht në familjen e Korbajve dhe si i ftuar në ditën e njëzetetëvjetorit të lindjes së Drita Korbit, por me një detyrë të caktuar: T'i dorëzon të letrën Telat Korbit... përbajtja e së cilës ishte thjesht një ftesë.

2

«Ajo pinte duhan. Mbi tavolinë, në një vazo të bukur kishte vënë një tufë me degë pishe. Qau dhe kujtoi nënën, ndjesë pastë! Pastaj mbushi një gotë pije dhe e ktheu me fund... E mbushi prapë. Mua më bëri kafe... Fshiu sytë dhe më përsëriti: «S'e heq dot mendjen nga ajo. Kur ishte gjallë, më vinte te koka e krevatit, më puthte në faqe dhe më uronte të bëhesha një-

qind vjeçë... Dhe më varte në qafë ose më vinte
në dorë varëse. Oh, sa mirë ishte atëherë,» —
tha dhe qau me lot dhe prapë piu duhan. Jashtë
binte shi. Dita ishte e mbyllur. Edhe ajo mbylli
perdet. «S'e s'dua të dëgjoj as hapat e këtyre, —
tha... — As bilbilin e policit s'dua të dëgjoj,» —
tha. «C'thuas kështu, moj bijë? — e qortova. —
C'të duhet ty politika?» Këtu e premë bisedën,
se dëgjuam hapa në shkallë. Në sallon hyri një
djalë dhe unë dola. Thuhej se me atë djalë ajo
do të fejohej?» Adil Çika, pasi mbaroi së lexuari
dëshminë e plakës, iu kthye Ahmet Bregut:

- Èshtë kështu, i pandehur?
- Po!
- Pastaj?
- Pasi doli plaka, ne qëndruam vetëm.
- Po i vëllai ku ishte?
- Në papafingo. I kyçur. Ajo më propozoi
që të shkonim në «Dajti».
- Po ti?
- Unë e pycta se ç'do të thoshte i ati kur
ta merrte vesh. «Do t'i bëhet qejfi», tha ajo dhe
u përлот kur e kujtoi. «Bukën e drekën i merr
me vete siç bënин më parë ata që shtronin kall-
drëm.» Pastaj i qau hallin se duart e këmbët i
ishin ngjeshur me kallo. Iu lut zotit dhe ndezi
cigare. Më shau mua që isha bërë i mërzitshëm
dhe i ftohtë për të. U ankua që në parfumerinë
e tyre shteti i ri kishte vënë shitëse një grua që
s'bënte kurrë tualet. Shau sistemin e triskëtimit
dhe Radio Tiranën që transmetonte vetëm këngë
partizane dhe muzikë popullore, oficerët që s'i
flişnin me gojë dhe që pinin kafe edhe me ushta-
rët pa grada... Unë heshtja dhe dëgjoja. Kisha
frikë. Më tmerronin radhët tua ja, zoti hetues.
Më dukej sikur muret kishin veshë... Sikur... si-
kur...

— Alime Bej!

Gruaja e plakur ngriti kokën.

— Ti ke dekluar se më 12 nëntor, para se të ndodhët aksidenti, ishe për vizitë në shtëpinë e Zeqo Korbit.

— Po!

— Ishe thjesht për vizitë apo?...

— Thjesht për vizitë, — gënjeu ajo.

— Gjete njeri atje?

— Po!

— Cilin?

— Ahmetin dhe Dritën.

— Ç'bënин?

— Ndoshta dhe kërcenin ose dhe...

— Nga e kuptove.

— Nga muzika e disqeve. E ku di unë. Ai, sa më pa, u tremb dhe deshi të ikte. Unë e mbajta dhe i thashë: «Bëhu burrë. Kur bën kundravajtje, i thuaj pollicit më fal dhe kur të të vijë radha për të marrë presh, shitëses të lutem...». Pastaj qeshëm dhe pimë konjak... Pas një ore dola. Cdo gjë e lashë në rregull.

— Pastaj ç'ndodhi?

— Telati duket përgjoi daljen e zonjës Alime Bej dhe zbriti shkallët. Muq më erdhi rëndë, — tha Ahmet Bregu që e hijte veten si të lodhur nga kjo seancë e gjatë.

— Pse?

— Si t'jua shpjegoj, zoti hetues... na kérkoi falje dhe tha: «Kështu është kur hyn pa trokitur.» Më përshëndeti dhe shkoi te bufeja. Duke kérkuar me radhë sirtarët, hidhte romuze. «Sugurisht sot ke ardhur për të uruar Dritën për 28 vjetët e saj», tha. Unë nuk fola. Kundrova veshjen e tij që m'u duk sa e çuditshme aq edhe e frikshme. Xhakavento kaki. Kilota me copa meshini te gjunjët. Çizme të lustruara dhe të ngjitura pas pulpave... Drita u mburr se gjoja unë i kisha shpënë një peshqesh më të bukur se të çdo viti tjetër. Pastaj e pyeti nëse mund ta gjente se ç'ishte. «Konjakun dhe profecitë kam kohë që i kam lënë mënjanë!» tha ai. «Atëherë pse dole kaq herët,» e pyeti Drita. «Për cigare,» tha Telati. Drita i kujtoi se i ati do të zemërohej po ta gjente jashtë dhomës së tij. «Do t'i them se në mëngjes përtova të lëvizja, u mora me ca punë të miat... Kështu që do të më duhet ta filloj tashti stërvitjen që më ka imponuar. Ky është ligji i brendshëm për ata që privohen nga liria e bulevardit, motër e dashur.» Ajo shkoi te dritarja dhe i tha se ne të tjerët disiplina komuniste na kishte mbërthyer në grykë. «Natyrisht, — tha ai, — unë jam ca më i privilegjuar. Lëvizjet më janë bërë të zakonshme. Deri në bodrum janë gjithsej 33 shkallë. Duke i zbritur çdo ditë nga 50 herë, bëj 1650 hapa. Po kaq hapa duhen edhe për t'u ngjitur kur s'kapërcej nga dy ose nga tri shkallë bashkë. Kësaj i thonë liri e bodrumit, motër. Po ti, ç'mendon?» m'u drëjtua mua. «Anuk do të ishte një mrekulli sikur gjithë njerëzit e shekullit tonë të stërviteshin në këtë mënyrë? Të imponuar?»

— Po ti? — pyeti Adil Cika.

— I thashë se tërë ditën lyeja me furçë. Lëvizja duart dhe ngrija e ulja trupin. Duke nde-

njur pér kaq kohë mbyllur dhe i vettuar, pérse s'i shkonte mendja? Prandaj ia kishim frikën.

— Kjo ishte arsyjeja që kérkuat së fundi ta zhduknit?

— Unë jo, zoti hetues... Ai i kérkoi falje motrës me tallje dhe i tha se asnjeri në botë nuk do të kérkonte më shumë se kaq nga ai. «Bile edhe njerëzit e pushtetit të ri do ta prisnin me kënaqësi nëse armiqtë e tyre privonin veten nga liria kështu si unë dhe me dëshirë do të mbylleshin në bodrume ose në VC dhe vetëm aty do të èndërronin me sy hapur derisa të vdisnin... Të vdisnim» tha. Ai nuk fliste, po gati shkumëzonte. Pérplaste grushtin në tavolinë. Veç ta shikonit, zoti hetues. Mua më hyri përsëri frika, kurse e motra i premtoi se do t'i sillte diçka më të fortë nga farmacia. Pastaj e pa me inat dhe i tha që të fillonte ushtrimin e përditshëm, se ndryshe do të egërsonte keqas të atin. Ai u ankua se i dhimbte koka shumë dhe shkoi te bufeja, hapi sërishmi sirtarët dhe kérkoi diçka pér të pirë. «Ku janë ilaçet,» — pyeti. «I paske pirë të gjitha?» u shqetësua e motra. Telati u nis. «Pa bërë as gjysmat e hapavet, babai do të jetë këtu,» tha ai, «thuaji se jam fare mirë. Pastaj, uluni në tryezë dhe mos më harro edhe mua atje në bodrum. Ç'të bëj? Dua edhe unë të përtyp ndonjë kockë nga ato që do t'ju mbeten juve. Pastaj do të mendoj si fëmijët që u besojnë përrallave, pér gogolë dhe përbindësh. Sa jetë romantike!» Ishte diçka e frikshme të shikoje atë fytyrë, zoti hetues. Ata sy të çapëlyer. Nofullat i dridheshin. Drita u mundua ta qetësonte dhe i tha se i ati mendonte më shumë pér të. «Edhe këtë e besoj», u përgjigj ai gjysmë i zalisur. «Babai ka një jetë që merret me mua. Në fillim më dërgoi në Itali. Pastaj, kur

erdhën gjermanët, më tha: Fillo gjermanishten. Tashti më ka vënë të mësoj anglishten që flasin amerikanët. Mbaj revolverin nën jastëk dhe pres... Pres duke ngjitur dhe zbritur shkallët 50 herë në ditë... Pres njerëz me mballonë në sy. Priftërinj. Të falimentuar...» «Do t'i dëgjoja më me ëndje vargjet e Kajamit,» — i tha Drita. Duket se ishte mësuar me këtë gjendje. «Edhe ato i kam harruar», ia ktheu ai. «Kur pija, vargjet rriddhnin vetvetiu, kurse tanë... Tre hapa i bëra. Duhen bërë 3300 të tillë.» Ai deshi të thoshte edhe diçka tjeter, po Drita e qortoi së-rishmi.

— Ata i trembeshin gjendjes së tij?

— Natyrisht. Ai herë pas here dukej se protestonte. Ndonjëherë shprehte edhe mendime të errëta. Ankohej dhe përsëri se vetja i dukej e mbyllur si në dhomat e rontgenit, — tha Ahmet Bregu që tashmë tregonte me nge.

«... E kam njojur mirë, kemi qenë shokë në Lice. E njoha edhe në Itali. Të dy shkuam në një kohë. Ai për artiljer, kurse unë për ndërlidhje. Pasi studiuam dy vjet, përsëri u kthyem së bashku dhe për të njëjtin qëllim. Të luftonim fashizmin italian... Por, ndërsa shumë nga ne u lidhën me Lëvizjen dhe njësitet guerile, ai... zgjodhi një rrugë tjeter. Atë të kafeneve. U vu tërësisht pas pjes. Frekuentonte «Kursalin» dhe «Bela Venecian». Atje mblidheshin pjesa e asaj rinie që vetëm diskutonin... Intelekualët e ngathtët. Bitet e të kamurve. Të paformuarit. Ditët i kalonte në mejhane të ndyra ku luhej kumar e

bëhej korruption. Kishte humbur çdo interes për jetën. Njeri ekscentrik dhe i paekuilibruar që i kishte acaruar marrëdhëniet keqas me të atin. Zeqo Korbi e dinte se ai jetonte duke kruar sirtarët e dollapëve, ose me ç'mund t'u rrëmbente bakejve të dyqaneve, por më shumë se kësaj ai ia kishte frikën ndonjë veprimi të pamatur në atë kaos politik. Prandaj, donte s'donte, kohët e fundit kishte filluar të shqetësohej seriozisht për të birin... Si t'ju them. Jeta e tij ishte gati-gati e papërcaktuar. As intelektual, as naiv. As i vullnetshëm, as egoist. Njeri që siç u duk nuk kërkoi kurrë më shumë se gota e konjakut. Një anarchist indiferent...

Ndërsa shokët tanë vritheshin në mënyrën më heroike, ata gjerbnin kafe dhe konjak... Unë isha takuar disa herë me Telat Korbin. Isha munduar ta bindja dhe ta tërhiqja në anën tonë... Por ishte e pamundur. Dhe, ndonëse s'kishtë lamar kurrë që mbi varrin e tij të shkruhej asnjë mbishkrim lavdie, në të njëjtën kohë, ishte po kaq e natyrshme se ai s'mund t'i shpëtonte as ndikimit të familjes, sidomos kujdesit që tregoi i ati kohët e fundit, as presionit që ushtronte ambienti që e rrethonte dhe të mbetej deri në fund indiferent. Ky fund për të ishte i pashmangshëm. Pritej. Prandaj s'u çuditëm fare kur ai një ditë të bukur veshi uniformën ushtarakë dhe u hodh me forcat e Bazit.

— Janë të vërteta këto? — pyeti Adil Çika.

— Në kafene e kalonte kohën më të madhe, zoti hetues.

— Do të na interesonte të dinim diçka edhe për të kaluarën tënde gjatë luftës.

— Unë kam parë vazhdimisht punën time.

— Nuk i ke shërbyer në asnjë rast okupatorit?

— Jo, zoti hetues. Ndryshe do të isha me kohë në burg.

— Kurse pas shtetëzimit të shtypshkronjës së Zeqo Korbit, e braktise atë dhe u more me tregti duhani kontrabandë!

— Vetëm me tregti, zoti hetues.

— Janë disa dëshmitarë që kanë pohuar se edhe ti në atë kohë frekuentoje «Kursalin», «Bela Venecian» dhe lokalet e tjera ku mblidheshin «baballarët e kombit», po ndryshe nga Telat Korbi, ti ishe anëtar i organizatës së Ballit Kombëtar.

— Jo, zoti hetues!

— Bile ke kryer edhe ca shërbime në fillim përfashizmin dhe pastaj për ata fë Gestapos.

— Zoti hetues!

— Dhe më vonë për ata të Intelixhens Servisit... Pastaj u lidhe edhe me ata të UNRA-s dhe së fundi me njeriun me një sy.

— Zoti hetues! — tha ai dhe u hoq sikur i rëndonte koka nga dhimbja.

— Je fshehur shumë bukur, i pandehur, — i tha Adil Çika dhe i kujtoi vitet e rinisë së tij, kur ishte në shkollën teknike, dhe lidhjet me drejtorin e saj, zotin Fulc. Pastaj vitin 1938 kur ishte dënuar në burg për vjedhje me dhunë. Në prillin e 39-s ishte liruar dhe ishte vënë në shërbim të SIM-it. Pastaj për qëllime të caktuara u lidh me Zeqo Korbin. Këto marrëdhënie i trashi sidomos kur u arratis Telat Korbi, se miqësia me Dritën i ushqeu edhe shpresat për të trahëguar pasurinë e Korbajve. Por ja papritur

doli në skenë miku i vjetër, drejtori i tij, Fulci, dhe bashkë me miqësinë që u përtëri, u përcaktua edhe shërbimi i ri: ndërlidhës i të gjitha grupeve, organizatave, kriminelëve dhe njerëzve që përgatisnin përbysjen e pushtetit popullor... Nuk është kështu, zoti Gjirafa? — u tall me ironi Adil Çika.

Ahmet Bregu, që gjatë gjithë kohës i ngjante diçkaje të ngurosur, tashti ngriti kokën, s'e prishte që «këta naivë» të kishin mësuar edhe pseudonimin e tij.

— Kohët e fundit kishe marrë edhe një detyrë tjetër...

— Jo, zoti hetues!

— Po! Të kryeje atentat kundër...

— Jo unë, zoti hetues! — e ndërpren Ahmet Bregu gati me ulërimë.

— Më tej?

— Pastaj erdhi i ati. Drita u ankua pér Telin. Ai u hodhi të dy fëmijëve duart në qafë dhe i porositi se s'duhej të silleshin kështu. Se s'duhej të grindeshin. Sidomos atë ditë që Drita mbushte njëzet e tetë vjeç. Iu mbushën sytë me lot, i pa me radhë të dy dhe u tha se, pa ata, ai prej kohësh do të kishte shkuar pranë së shqes. I biri hoqi krahun nga shpatullat dhe i tha: «E shoh se të gjithëve u jam mërzitur. Buka me triska... Triskat s'do t'ju mjaftojnë pér vete.» Dhe u nis. Kur Zego Korbi e pyeti se ku do të shkonte, ai iu përgjigj: «Detyrën. Do të stërvitem. A nuk më ke këshilluar të ushtrohem? Se, pas gjashtë muajsh, ose e shumta një viti, përsëri pritet diçka... Duhet përgatitur që të mos mbetemi pas...» I ati e porositi që në çdo dhjetë ngjitje dhe zbritje të shkallëve të paraqitej tek ai, kurse të bijën se këtej e tutje nuk duhej lënë vetëm. Teli atë ditë ishte shumë i aca-

ruar, megjithëse ilaçet i kishte pirë me grushte.

Unë ndërhyra dhe iu luta që ai të qëndron-te me ne. «Jo,» kundërshtoi Zeqo Korbi. «Kështu duhet,» këmbëngula unë. «Sillna gotat!» urdhëroi ai. «Edhe kafshët kur i mbajnë në kafaze hekuri, tërbohen më shumë,» i kujtova dhe e pashë në sy si do të reagon te. Ai u koll aq fort, sa salloni u mbush me një zhurmë të mytur. Pastaj e urdhëroi të bijën të na sillte për të ngrënë dhe u ankua për tregun që ishte bosh. «Çdo gjë arsyetohet me luftën, kurse vaporët e UNRA-s i ktheyen mbrapsht,» tha. Hyri Telati që nga lodhja ishte mbuluar me djersë. Flokët i ishin ngatërruar. Ishte zverdhur dhe mezi merrte frymë. I ati e pa gjatë dhe e urdhëroi: «Merre gotën... Uro motrën dhe vazhdo ngjitjet dhe zbritjet e tjera!» Ai i kërkoi falje së motrës që po e uronte duarthatë. «Tek unë në papafingo ka minj, armë dhe hije që të kallin frikën,» tha dhe ktheu gotën... «Më mori kokën,» tha për rakinë... Dhe kot së koti lavdëroi ushtarakët e shquar... Napoleonin, Aleksandrin, Çezarin... u ankua si i ati e kishte lidhur si lidhin fëmijët brumbullin me gjalmë... «Brumbulli gjithnjë fluturon nga e tërheqin ata», — tha i nervozuar. «Mendo se budallenjtë dhe qerozët kanë fat vetëm në përrallat,» i kujtoi i ati që s'ia ndante sytë. Ata qëndronin ballë për ballë. Bëri një lëvizje të pakontrolluar dhe përséri u kthye. Na pa me radhë me përbuzje dhe gati sa s'u përplas në tokë. Unë e mbajta për krahu. «Edhe kapiten Smithi, kur na përcolli në aerodrom, na dha të treve nga një ampulë.» Ai ktheu jakën e bluzës dhe tregoi me dorë një send të ndritshëm të bardhë. «Ishte natë. Frynte erë dhe ne mezi e dëgjonim zërin e tij. Duajeni jetën, na tha, luftoni kundër vdek-

jes, por, kur t'ju kërcënojnë, mos bini të gjallë
në duar të komunistëve!» Pas këtyre fjalëve
Zego Korbit i ngriu gota në dorë. Drita lësho
një rënkim. «Unë kam tre vjet që s'kam vënë
pije në gojë, baba. Më jepni edhe një gotë!»
llut të atit dhe, kur e mori në dorë, e ktheu
fund. Pastaj u ankua për kokën. U çudita
më parë ai falte gjysmën e jetës për një gotë
konjak, kurse tashti...

Në korridor u dëgjua zilja elekrike. U shtrëngëm.
Zilja u përsërit. Ishte rojtari i kishës
Prenga.

5.

Kur hyra unë, salloni ishte mbushur me tym
duhani. Më qerasën me piye dhe cigare... Rrija
mbi gjemba dhe s'gjeja rast që të dorëzoja let-
rën. Se dom Kela më kishte porositur t'ia jepja
në dorë Dritës, kurse aty ishte edhe i ati. Edhe
një i tretë, të cilit, edhe pse e njihja, s'kisha
i besoja. Ruajta rastin. Ia lashë letrën në dorë
dhe ika tërë frikë. Përbajtjen e letrës nuk e di-

Deklaroj me përgjegjësi ligjore
Prengë Prenga

- Përse bënte fjälë letra?
- Míster S... E shkruante dom Kela, po posítë ishin të atij.
- Çfarë kërkonte?
- Një ftesë të dytë. E ftonte Telat Korbin pér të bërë një shëtitje me makinë.
- Në q'mënyrë?
- Në letër caktoheshin vendi dhe ora... Rru-ga e Elbasanit. Në cep të urës... Me sa më kujtohej, do të fikeshin dhe ndizeshin dritat e makinës dy herë radhazi. Ky ishte sinjali. ,
- Telati si e priti ftesën?
- U tèrbua, zoti hetues. Kërkoi të pinte dhe shau të huajin. Mua dhe gjithë njerëzit e globit.
- Ti e dije qëllimin e kësaj ftese?
- Natyrisht.
- Po i ati?
- Diçka kuptoï... Edhe Dritën e habitit ftesa e dytë... Telati, pasi lexoi letrën, u bë si nata dhe kërkoi të pinte. Piu. Ndoshta do të kishte gëlltitur edhe shishen, por ndodhi diçka që s'e prisnim. Zilja e derës prishi atë qetësi varri... U habitëm. Kush duhej të ishte tjetër në këtë orë të drekës. Në atë mot me shi? Të katër mbetëm si të ngrirë. Tingulli i ziles u përsërit. Zeqo Korbi, pasi u mendua, e urdhëroi të birin që të ngjitej në papafingo, kurse së bijës i tha: «Hape derën! Kujtdo që të jetë, thuaji se në shtëpi s'ka njeri.» Dhe kështu ndodhi. Ndërsa Drita zbriti shkallët, Teli u ngjit në dhomën e tij. Mbylli derën me çelës dhe me siguri që bëri armën gati. Unë u ula në një poltronë. Zeqiri u mbështet në një tjetër dhe mori gazeten në dorë. Po prisnim. Binte shi dhe fryntë erë. Nuk e di, zoti he-

tues, pse pata një parandjenjë të keqe. M'u drodh zemra sidomos kur dëgjova zhurmë në shkallë. Pastaj në sallon u futën dy njerëz. Ishin dy burra, gati të një moshe. Zeqo Korbi e humbi toruan për një çast. Pastaj u ngrit në këmbë, iu afrua derës dhe, si të kishte kohë që i priste, u tha: «Urdhéroni!» Pastaj po me atë mirësjellje i ftoi të uleshin. U habita me gjakftohtësinë e tij... Bile do ta quaja bujari. «Si mund të shtiret njeriu i tillë, mendova dhe përsëri pashë dy të porsaardhurit. U mundova të kujtoja ftyrat e tyre, por ishte e pamundur. S'i kisha parë kurrë. «Po ju uluni ju lutem,» përsëriti Zeqo Korbi. «Vijmë nga Këshilli Nacionalçlirimtar i lagjes,» tha njëri prej tyre. «Kjo është gjë e mirë», tha po me atë gjakftohtësi Zeqo Korbi... «Me siguri ndonjë mbledhje... Ose ndonjë hall.» «Jo!» tha tjetri prerë. «Në emër të pushtetit të popullit, urdhéroni!» Dhe ai nxori nga xhepi një zarf. «Ç'është kjo shkresë?» pyeti Zeqo Korbi. «Vendim që të lironi katin e dytë dhe të tretë të shtëpisë,» tha po me atë ton ai që mbante letrën në dorë. Zeqo Korbi ngriu dhe vetëm pyeti: «Ç'do të thotë ky vendim?» «Është pjesa e shtëzimeve,» — u përgjigj i dyti. «Po ne?» «Në bodrum! Ose diku tjetër,» tha i pari. Pas këtij dialogu kaq lakonik, Dritës i ra tabakaja nga dora. «Do ankohem!» kërcënoi Zeqo Korbi që harroi gjithë atë mirësjellje dhe bëri një lëvizje të pakontrolluar që shprehte nervozizëm. «Urdhri hyn në fuqi pas një javë. Më 20 nëntor shtëpia duhet të jetë e lirë!» tha përsëri njëri prej tyre dhe la zarin mbi tavolinë. Pastaj të ardhurit përshëndetën me grusht dhe zbritën shkallët. Zeqo Korbi u shuk si pa ndjenja në poltronë. Drita filloj të mblidhte copat e pjatancës. Dera e jashtme u përplas me forcë.

— Telati e dëgjoi këtë bisedë? — pyeti Adil Çika.

— Sigurisht që ai përgjonte. I ati e mblohdhi veten shpejt dhe puna e parë porositi që këtë lajm të padëshiruar s'duhej ta mësonte në asnjë mënyrë i biri. Pastaj u ngrit dhe shumë i trondit, i lodhur e si pa shpirt i ra kryq e tërthor sallonit. Piu duhan. Konjak. Fliste me vete. Shante.

— Cilin? — pyeti Adil Çika.

— Asgjë s'i merrej vesh. Po me siguri ata që sollën urdhrin... Óse Nacionalçlirimtaren...

— Po ti?

— S'dija ç'të bëja. U gjeta ngushtë, zoti hetues, dhe natyrisht vendosa të ikja. Ç'më duhet mua, thashë... Po në këtë kohë dëgjuam zhurmë. Diçka e rëndë u përplas në dyshemenë e dhomës ku ishte mbyllur Telati... Pastaj një rënkim... ose britmë të mbytur... S'di si ta quaj. Drita ngjiti shkallët me vrap, por dera ishte e kyçur. I dhashë një të shtyrë... Ajo u fut pas meje dhë lëshoi një ulërimë që shoqëroi bilbilin e policit në rrugë. «Ç'ka ngjarë?» pyeti me zë të dobët dhe pa luajtur nga vendi Zeqo Korbi. «Teli!» tha ajo. «Çfarë?» pyeti ai. «Është shtrirë pa ndjenja.» Unë vrapova te sirtarët e bufesë për shishen me amoniak. «Duhet të lajmërojmë spitalin, baba!» tha e alarmuar Drita. I ati e pa me inat. Hapa shishkën e vogël dhe ia afrova Telit pranë hundës. Ai turfulloi nga era e amoniakut. «Kjo s'më kishte shkuar kurrë në mendje,» tha Zeqo Korbi që kishte mbetur si i ngrirë. I afrova përsëri shishen e amoniakut te hunda. Teli u përmend. «Biri im, si e ndien veten?» iu lut Zeqo Korbi. «Po më zihet frýma, hapni dritat. Kokën e kam turbull, po më dridhen gjunjët,» u ankua i biri. «Duhet të lajmërojmë spitalin.

Ñdoshta na dërgojnë doktorin e rojës ose ambulancën,» tha Drita përsëri pa e vrarë mendjen se i vëllai ishte një i arratisur politik. «Jo,» tha i ati. «Teli është më mirë,» dhe, pasi e zbritëm në sallon, e pyeti të birin: «Nuk je më mirë? Për hir të babait thuaj se je mîrë.» Ai u ngrit, mblođhi gjunjët me duar dhe na pa me radhë me sy të çakerritur. Edhe ne po e shikonim. Ishte diçka e rëndë, zoti hetues. Unë s'kam parë sy të atillë në jetën time. As fytyrë të atillë që herë zverdhej, herë mbulohej nga djersa e mandej mbushej me pulla të kuqe, të bardha, të zeza. Si dukej s'ngopej me frysë dhe kërkoi ajër. «Qetësohu, biri im. Shtrihu,» iu lut i ati. Ai u ngrit dhe na pa me neveri. «Ty s'të dhimbset jeta ime, baba. As juve. Ju trembeni se mos vdes dhe s'keni si të më varrosni. Po kapiten Smith ka menduar gjatë. Ai na ka siguruar një vdekje të rehatshme. Ja,» tha ai dhe shkëputi ampulën nga jaka. I ati që natyrisht mendoi se ai do ta kapërdinte, e urdhëroi me zë të fortë, por tërë frikë, që t'ia jepte atij. Telati që kishte marrë pamjen e një idiota qeshi dhe tha: «E kuption sa keq jemi katandisur, baba? E kuption që jemi para greminës? Nuk e shihni ç'shi që bie? Nuk e ndieni furtunën as tashti pas asaj urdhërese?» dhe, pasi mori zarfin në dorë, e tundi, ashtu si të kërcënët një njeri kur mban armë në dorë. «Kjo do të na përplasë në fund të honit... Oh! Koka... Po, ndërsa unë e kam shpëtimin tim,» përsëriti ai dhe tregoi ampulën, «ç'do të bëhet me ju, baba... Me ty, Drita... Edhe me ty, Ahmet?» m'u drejtua mua. Unë pas këtyre fjaleve e humba. Kaq më kujtohet, — tha Ahmet Bregu dhe përsëri futi kokën midis duarve.

— Kaq? — pyeti Adil Çika.

— Ishte një fund që s'e prisja... M'u duk se çdo gjë u errësua dhe mori ngjyrë të zezë. Edhe balloni. Edhe dyert. Edhe muret. Edhe tablotë e vjetruara. S'mbaj mend gjë tjetër, zoti hetues... Ika.

— Si ike, i pandehur?

Fjala «i pandehur» që kapiteni e përsëriti pas kaq kohe iu duk se i çau daullen e veshit dhe ngriti kokën. E pa hetuesin në sy dhe tha:

— Dola në rrugë dhe vravova. Binte shi... Të tjerat, zoti hetues, i dini. Bile edhe ato që kanë lidhje me orën 12 të natës së 20 nëntorit. Në shtëpinë e zonjës Alime Bej... — tha Ahmet Bregu dhe vetëm tashti që i kishte pohuar të gjitha, iu duk se i ishte zhdukur çdo ndjenjë frike dhe druajtjeje.

«Kjo është psikologjia e armiqve,» — mendoi Adil Çika, që kishte ndjekur me kujdes të gjitha pohimet e Ahmet Bregut. Iu përtéri ç'kishte depouar ditë më parë Astrit Pema. Ato ishin disi vazhdimi i asaj që la mangut i pandehuri.

«Biri im, qetësohu.»

«Unë nuk të bindem më, baba. Koka po më dhëmb shumë... sytë më janë errur.»

«Qëndro!»

«Çdo gjë mori fund... Nesër këtu në shtëpinë tonë do të vijnë banorë të rinj.»

«Natën do të ikësh.»

«Eshtë e kotë... Çdo gjë është e kotë... Dua të dal të gjendem edhe një herë midis njerëzve. Lamtumirë, baba! Lamtumirë, motër!»

«Teli!»

«Ja dhe kapsula e kapiten Smithit! Merre!»

«Biri im.»

«Yt bir vdiq! Ai s'është më! Ky ishte fundi im, yti, baba. Yti, Drita...»

«Teli!»

«Teli!»

«Deri këtu është e qartë. Po pastaj,» — tha me vete Adil Çika dhe filloj të shfletonte procesverbalin. Rilexoi deponimet e të pandehurve, thëniet e dëshmitarëve dhe letrat që i ishin bashkangjitur dosjes, rezultatet e ekspertizave dhe fotografitë e shumta. I mblodhi këto me kujdes si mblidhen copat e një ene kur thyhet dhe, i përqendruar tërësisht mbi ngjarjen, u mundua të formonte të tërën, atë që ishte shpërbërë, të gjente jo vetëm si kishte ndodhur, por edhe pse kishte ndodhur kështu. «Po si mund të ndodhë ndryshe? — pyeti veten. — Edhe ai me siguri i ka bërë disa herë këto pyetje. Atë për tërë kohën e ka ndjekur nga prapa frika jonë, krimet që ka kryer në kohën e luftës, tradhëtia... Prifti, Zonja Alime Bej... N.N. Dhe ja së fundi edhe njeriu me një sy. Po kaq shumë e ka trembur edhe riikja. Riarratisja. Ai s'u ishte bindur urdhraive të tyre. Ai s'kishte kryer detyrën që i kishin ngarkuar. Një jetë e çuditshme, — tha Adil Çika. — Gati e zbrazët. Boshe. Dhe e mbushur me të papritura.» Dhe përsëri ai solli në mend rininë e tij, po himet e dëshmitarëve për të. Ato të Astrit Pemës. Të Ahmet Bre-gut. Vendimin e këshillit nacionalçlirimtar. «Pas kësaj frike të gjatë, ankthi dhe tronditjeje nervore, Telat Korbi ka dalë në rrugë. Ka vrapuar. Ka vrapuar si bisha kur shpëton nga kafazi, — mendoi Adil Çika, — dhe është turur drejt... S'ka vënë re as njerëzit, as makinën dhe është gjendur pa e kuptuar as ai nën rrotat e saj. (Kështu kishin deponuar edhe dy dëshmitarët e tjerë. Edhe shoferi.) Duket Drita Korbi ka bërtitur: «Teli, Teli!» dhe është sulur pas tij... Po i ati duhet ta ketë mbërthyer të dera dhe e ka përplasur diku. Ai e ndiente rrezikun... Po pas-

taj, — pyeti Adil Çika. — Si duhet të ketë ndodhur?» Ai la penën mbi tavolinë dhe u ngrit, si zakonisht përshkoi dhomën kryq e tërthor disa herë duke sjellë ndër mend gropën e gëlqeres, përgjakjen e sallonis, letrën që kishte gjetur mbi tavolinë, derën e shpërthyer. Dhe përsëri vendimin e këshillit popullor... «Sa turbull që i shoh gjërat,» — tha dhe u ul në tavolinë. Ndezi cigare. Iu kujtua se kur kishte pyetur gazetarin N.N. se kush kishte vënë dorë mbi Zeqo Korbin, ai ishte hequr si i lodhur. Dha urdhër ta sillnin.

— Nën pretekstin se ishe i lodhur në takimin e fundit s'iu përgjigje pyetjes se kush e vrau Zeqo Korbin.

— Isha me të vërtetë i lodhur, zoti hetues.

— Tashti mund të na thuash?

— Po!

— Si ndodhi? — pyeti Adil Çika dhe u bë gati të shkruante.

— Më 12 nëntor pasdite shkova te zoti Korbi.

— Shkove, apo të dërguan?

— Më dërguan.

— Kush?

— Dom Kela erdhi në shtëpi dhe më tha: «Do të shkosh te zoti Korbi dhe do të qëndrosh me të, pa e lënë që të dalë jashtë» dhe, pasi më shpjegoi ç'kishte ndodhur me të birin, më dha porosi që të mos i tregoja asgjë.

— Po në rast se ata e kishin marrë vesh?

— Unë duhet t'uua mohoja, ose, në të kundërt, ta zbusja çështjen pa e lejuar që sa ishte ditë të mos dilte nga shtëpia. Të priste natën.

Edhe unë vetëm pasi të errej duhej të dilja.
Kështu bëra.

— Rreth çfarë ore shkove te Zeqo Korbi?

— Ndoshta rrreth orës 4, ose 5 pasdite. Qëndrova me të. Ishte gati i dehur dhe shumë nëmerak për të birin, që e priste t'i kthehej nga casti në çast... Ose të mos i kthehej kurrë.

— Dinte gjë për aksidentin?

— Vetëm dyshonte. I shkonte mendja nga të gjitha anët.

— Po e bija?

— Ajo shkoi të takonte dom Kelën. S'di përsë!

— Këtë porosi ia solle ti?

— Po! Bashkë me një letër.

Adil Çika, që kishte vrarë mendjen gjatë përtë gjetur përbajtjen e koduar të lëtrës dhe autorin e saj, pyeti:

— Në ç'orë dolli Drita Korbi.

— Porosia ishte si të fillonte të errej. S'i vura rëndësi. Unë kisha edhe një detyrë tjetër, — tha N.N. dhe shpjegoi se të dy pleqtë kishin mbetur vetëm deri aty nga ora tetë e darkës.

— Po mbas kësaj ore?

— Unë dola. Isha matur disa herë të dilja, se kështu isha porositur, po ai, ashtu siç ishte, i dehur dhe i shqetësuar, s'më linte të ikja. Më thoshte të rrija. Dhe qante... Herën e fundit iu shkëputa me forcë... Atëherë, zoti hetues, duhet të më jetë këputur edhe ajo kopsa e pardësysë... Zbrita shkallët shpejt... Kur dola te porta, pashë se prisnin dy veta. Ata më dhanë një të shtyrë dhe u futën rrëmbimthi brenda... Ishin të rinj në moshë, trupa të bëshëm. Kur mora vesh vdekjen e tij, menjëherë më shkoi mendja tek ata... E them me bindje. Ata, zoti' hetues, e kanë vrarë Zeqo Korbin...

Ushtari me uniformë gri që i solli kapitenit një paketë cigare, ndryshe nga herë tjetër, vuri rë se ai tashti kishte fytyrë të qeshur. Edhe zëri ashtu iu duk. Buzëqeshi edhe ai dhe doli.

Kur mbeti vetëm, kryehetuesi shfletoi dosjen dhe, pasi nxori që andej një letër, lexoi gati me zë:

«Drita Korbin e kisha parë shumë herë të zbriste në kopsht dhe, pasi takohej me një mashkull, fshiheshin pas trungut të një kajsie, bisedonin të mbërthyer për qafe. Mbas shtetëzimit të kopshtit s'i kam parë më...» Më poshtë si në-për dhëmbë lexoi rreshta dhe fjalë të shkëputura, pjesë nga dëshmia e fqinjës së shtëpisë Korbi që duket ishin pa ylerë, ose edhe pyetje të rëndomta e pa rëndësi. «.... Atë natë duhet të ishte ora 8, ose 9, dëgjova një zë femre që briti fort. Dola në dritare dhe hodha sytë nga kopshti. Çdo gjë m'u duk si e zhveshur. Pastaj vura re një hije të kërrusur që zvarrisej rrëzë murit. Doli nga kopshti. U zhduk në rrugë...

«Kështu deklaron fqinja e tyre Zeliha, — tha me vete Adil Çika dhe u përpoq t'i bashkonte këto me deponimet e gazetarit N.N. dhe ato të fqinjëve të vjetër të Korbajve. — Hija që u zhduk anës murit duhet të jetë prifti që vishet me sqimë, dom Kela, — tha. — Pasi e ka ftuar

Drita Korbin në kishë, ose edhe në ndonjë shtëpi, ose zoti e di se ku, ka pritur natën. Orën 8 ose 9. Natyrisht, gjatë tërë kohës ata kanë biseduar për të vellanë dhe s'dihet sa variante të mundshme ka trilluar ai për ta qetësuar Drita Korbin. Pastaj, i veshur tebdil, e ka shoqëruar duke zgjedhur rrugët dhe rrugicat më të errëta. Nën pretekstin që të mos i shihte njeri, janë futur në kopsht nga pjesa që kanë hapur punëtorët e ndërtimit. Kanë kaluar rrëzë murit buzë gropës së gëlqeres dhe... Dhe ja, — tha Adil Çika, — ai i ka dhënë një të shtyrë — dhe pa vetëdije shtriu duart me forcë sikur ta kryente vetë atë veprim... — Dom Kela, dom Kela, — pëshpëriti ai me zemërim dhe kujtoi varësen e artë me kryq... — Cdo gjë është e qartë. S'kishte rrugë tjetër për ta. Pas aksidentit dhe identifikimit të Telatit, të cilin ata pa dyshim e quanin diçka të mundshme, vinte dekonspirimi. Dështimi. Këtë ata e kanë konsideruar logjike. Të paevitueshme, të padiskutueshme... Prandaj kanë marrë vendimin e shpejtë: Korbajt duhet të vdesin... Dhe dom Kela i ka bërë mirë llogaritë. Së pari ka përcaktuar vendin se ku duhej të kryhej krimi, i cili duhej që mundësishët të ishte sa më afër shtëpisë. Prandaj më të përshtatshme se gropë e gëlqeres që ishte hapur vetëm disa metra nën ballkon, s'ka gjetur dot vend tjetër. Pastaj ka zgjedhur rrugët... Ka pritur errësirën... Kohën... Dhe mënyrën se si do ta kryente krimin... Ç'vdekje mizore, — tha Adil Çika dhe u ngrit në këmbë. Ndezi cigare dhe përsëri i ra dhomës kryq e tërthor. U shtriq dhe përsëri u ul në karrige e filloj të shkarraviste. Viza. Fjalë. Rrathë. «Dhe bash në këtë kohë mundet edhe pak më përpara, ose më pas, dy djelmoshat e fuqishëm bënin pazar me plakun. Për të përligjur alibinë, pas

një «shakaje» të gjatë, e kanë qëlluar me armë. Në fillim në gjoks. Afër zemrës. Prandaj duket plaku s'ka rënë menjëherë. Është zvarrisur. Ka bërtitur. Është ankuar. Ose edhe e kanë zvarrisur ata. Ndryshe pse salloni duhet të ishte aq i përgjakur?... Pastaj, pas kësaj «lodre të gjatë», duke qenë të sigurt se s'kishte ç'i kërcënonte, me qetësi e kanë marrë kokë e këmbë dhe e kanë hedhur në krevat. Këtu i kanë dhënë goditjen e dytë. Në tëmtha. Pastaj i kanë shtrënguar armën në dorë dhe e kanë vendosur në atë pozicion që kujtdo t'i krijonte përshtypjen për versionin e vetëvrasjes, kurse ai Ahmet Bregu gënnen kur deklaron se e gjeti të përgjakur. Dhe kjo është e natyrshme. S'kishte rrugë fjetër, — përsëriti ai. — Pas aksidentit të të birit, edhe plaku u bë po kaq i rrezikshëm sa edhe e bija. Prandaj edhe ai duhej zhdukur. Dhe e zhdukën... Kurse, me përgjakjen e sallonit, kanë dashur të përligjin një version të turbullt se gjoja me Drita Korbin dikush është përleshur. E ka goditur dhe, së fundi, e kanë hedhur nga dera e ballkonit në gropën e gëlqeres. Ndryshe s'ka asnjë arsyе të shpërthehej ajo kur ata kanë dalë po aq lehtë dhe qetësish andej nga u futën... Nga porta kryesore... Kjo është logjika e ngjarjes. Këtu të shpien faktet. Dëshmitë, — tha Adil Çika që tashti i ndizte dhe i shuanë cigaret njëren pas tjetrës. — Për të fshehur të vërtetë dhe për të na çoroditur, kanë përmbysur poltronat. Kanë derdhur pjatat. Kanë rrëzuar e thyer shishe... Kështu krijohej mundësia që të mendohej se kemi të bëjmë me një bastisje të thjeshtë. Me ca hajdutë të rëndomtë dhe natyrisht kësisoj, organet tonë do të ecnin pas gjurmëve të tyre, do të kërkonin vagabondë ose vrasës ordinerë... Po cilët duhet të jenë këta të dy? — pyeti së fundi

Adil Çika. Ndezi përsëri cigare e, siç e kishte zakon duke vazhduar të shkarraviste viza, rrathë e kuadrate, tha: — Kjo tani për tani ka pak rëndësi ose s'ka fare. Çdo gjë është e qartë. Pas tyre qëndron prifti. Ministri që luan tenis e bën vjersha. Dy ushtarakët deputetë, zoti S., gazetari N.N. Është rrjeti që komplotonte. Armiqtë e Republikës. Ata që kërkonin të përbysnin pu shtetin. — Së fundi ai qeshi me vete dhe përsëri tha: — Kështu ndodh kur të pëlcet bomba në dorë. Kur i hyn në pjesë popullit. — Sa kohë janë përpjekur për përbysjen tonë, aq kohë kanë jetuar në ankth. Bile në alarm të përherëshëm. I ka trembur çdo hap që kemi hedhur ne. Marshimi ynë.

Mete Jaupi përsëri hyri pa trokitur. Adil Çika e ftoi të ulej dhe i shpjegoi hollësisht përfundimet në të cilat kishte arritur.

— E besoj, — tha.

— Kjo ishte një vdekje e natyrshme.

— Ju e parashikonit një gjë të tillë.

— Revolucioni i ka këto, vëlla, — tha dhe, pasi u ngrit, si zakonisht, e shtrëngoi Mete Jaupin fort pas vetes. Kësaj radhe më fort se çdo herë tjetër.

Kambanat e mesnatës kishin net që s'dëgjoheshin më.

Dritat e rrugës ishin ndezur. Mjegulla ishte shpérndarë.

— Sonte do të hidhen fishekzjarrë, — tha Mete Jaupi.

— Do të gëzojmë edhe ne. Pas festës përgatit. Do të udhëheqësh procesin e ri.

Kishin zbritur shkallët e katit të parë. Mete Jaipi ngadalësoi hapat dhe, pasi u mendua përnjë çast, e pyeti Adil Çikën:

— Kam tërë ditën që vras mendjen, more Adil, ç'domethënë fjala «aklamacion»?

Adil Çika qëndroi dhe e pa me shumë mall sikur të kishin vite të ndarë dhe, pa i kthyer përgjigje, tha me vete: «Sa shpejt po rritemi.»

— A nuk e ke lexuar gazetën e sotme?

— Adil Çika pohoi me kokë.

— Në kryeartikull, mbi fotografinë e Komendantit, ishte shkruar: «Kuvendi Popullor deklroi me aklamacion Gjeneralkolonel Enver Hoxhën Hero të Kombit.»

— Edhe pse s'e di këtë fjalë, — i tha Adil Çika, — ti do të udhëheqësh procesin e ri, — dhe qeshi.

— Unë?

— Le ta quajmë atë «Procesi Smith», — tha Adil Çika.

Përshëndetën oficerin e rojës dhe dolën në rrugë. Diku në trotuar afër reklamave të kine-mave i priste Vitorja.

Të tre humbën midis njerëzve.

Republika festonte dyvjetorin e Çlirimit.